

UNIVERSITETI I SHKODRËS
“Luigj Gurakuqi”

BULETIN SHKENCOR

Seria e shkencave shoqërore

Viti XLXII i botimit

Nr. 72

Shkodër, 2022

REDAKSIA

Kryeredaktor : prof. dr. Artan HAXHI
Sekretar shkencor : dr. Zamira SHKRELI
Anëtarë : prof. dr. Nertila LJARJA, prof. as. dr. Arben PRENDI,
prof. as. dr. Orjeta BAJA, dr. Bresena KOPLIKU,
prof. as. dr. Edlira BUSHATI

DREJTOR I REVISTËS
Prof. dr. Suzana GOLEMI

Korrektori dhe punoi në kompjuter: *Arta Bajrami*

Pronë letrare e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Adresa e redaksisë: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
Redaksia e revistës “*Buletini Shkencor*”
(seria e shkencave shoqërore)
E-mail : qsa@unishk.edu.al

PASQYRA E LËNDËS

• *Gjuhësi*

Gjovalin SHKURTAJ

Hulumtimet e reja shkencore dhe tradita e shkrimit akademik

New scientific research and the tradition of academic writing 7

Rozana RUSHITI

Prania e fjalësit të Xhuvanit në fjalorët e gjuhës shqipe dhe fushat e përdorimit

The presence of the dictionary of prof. Aleksandër Xhuvanit

in the dictionaries of the Albanian language and the fields of its use..... 17

Artan HAXHI, Tefë TOPALLI

Terminologjia si sistem

(Fjalor i termave të gjuhësisë)

The Terminology as a system

(Dictionary of linguistic terms) 27

Valbona SINANAJ

Mbi ndarjen në rrokje të fjalës. Rasti i diftongut

In the division of syllables of the word.

The diphthong case..... 35

Orjeta BAJA

Figurat e stilit

(Fjalor terminologjik shpjegues)

The figures of the style

(Explanatory terminological dictionary)

(L, M, N, O, P)..... 45

Evalda PACI

Rreth librit kishtar të shtypur në gjuhën shqipe: ekzemplarë hershmërie dhe ndikimesh kulturore në shekujt XVII-XVIII

About the books published in Albanian: exemplars of antiquity

and cultural influences 53

Suela KASTRATI, Manjola ZAÇELLARI

Një vështrim gjuhësor për poetikën e Primo Shllakut (Dashunia fillon prej gjysmës)

A linguistic review of Primo Shllaku's poetics65

Leonora LUMEZI, Hatixhe SEJDINI

Integrimi i aftësive të inovacionit në mësimdhënien e gjuhës së huaj

Integrating innovation skills in foreign language teaching 75

• **Letërsi**

Alfred ÇAPALIKU

Poema e parë e Kolë Thaçit

The first poem of Kolë Thaçi: „The change of the year” 87

Arben PRENDI, Valbona KARAKAÇI

Balada shqiptare e ringjalljes, përkime me traditën zakonore

The moral and customary world in the Albanian oral ballads, its coincidences with the old codes 91

Alma HAFIZI

Santori si pararendës i shkrimtarëve shqiptarë që shkruajnë në italisht.

(Reflektim mbi romanin *Il soldato albanese*)

Santori as a forerunner of the Albanian italographer writers

(Reflection on the novel *The albanian soldier*) 105

Ermira ALIJA

Kontributi i prof.dr. Miaser Dibrës në studimin e trashëgimisë kulturore e letërsisë dhe në drejtimin e sistemit akademik shqiptar

The contribution of prof. dr. Miaser Dibra in the study of cultural heritage and Literature as well as in the directing of the Albanian

Academic System 115

Veron DOBROSHI

Fenomene letrare dhe kulturore në diskursin kritik të Krist Malokit.

Literary and cultural phenomena in the critical discourse

of Krist Maloki 125

Ermira YMERAJ

Letërsia botërore si urë dialogu mes kulturave të “Hylli i dritës”; “Leka” e “Fryma”.

The world literature as a bridge dialogue between cultures in "Hylli

i dritës", "Leka" and "Fryma" 135

• **Histori**

Ilir SALLATA & Rita LOLOÇI

Shtypi botëror mbi ekonominë e centralizuar shqiptare në vitet 1970-1973.

The world press on the centralized Albanian economy in the

years 1970-1973 143

• **Gjeografi**

Sokol AXHEMI

Lëvizjet migruese në zonat urbane të vendit tonë. Dinamika e faktorëve ndikues

Migratory movements in the urban areas of our country.

Dynamics of influencing factors 153

Flora GJONI, Bresena KOPLIKU, Migena MUÇAJ

Aplikimi i transhumancës, qasje zhvillimi aktuale në Alpet Perëndimore, impakti i tij në krijimin e vendbanimeve sezonale

The application of transhumance, current development approach in the Western

Alps, its impact on the creation of seasonal residences 165

Elvira BOLLOBANI, Majlinda MUKA

Potenciali natyror dhe kulturor i bashkisë Kuçovë - bazë e një zhvillimi të qëndrueshëm

The natural and cultural potential of the municipality of Kucovo are the basis of a sustainable development 179

NEKROLOGJI

Nevila Dibra

(1969 – 2022) 197

JETA SHKENCORE:

I Veprimtari shkencore

Scientific activity 199

II Botime

Publishing.....210

Gjovalin SHKURTAJ

HULUMTIMET E REJA SHKENCORE DHE TRADITA E SHKRIMIT AKADEMIK

(Njohja e thelluar e bibliografisë si bazë e akribisë së të shkruarit)

Dua ta nis kumtesën time me një ko incidencë të thjeshtë, të largët në kohë, plot 111 vjet të shkuara, por që m'u duk domethënëse për ta pasur si synim largvajtës e të dobishëm për hulumtimet shkencore dhe për krejt procesin e të shkruarit, qoftë zyrtar (akademik) apo edhe në të gjitha shkëmbimet e komunikimet me shkrim.

Në vitin 1917, një shqiptar, ish-student i Universitetit të Harvardit, **Kostë Çekrezi**, botonte në Boston (Amerikë) librin "Udhërrëfyes për komunikimin" (*Modele letrash, shkresash zyrtare dhe private, fjalor*). Po atë vit, në Amerikë, botohej edhe një libër "sivëlla" për nga tematika, me titullin "The elements of stile" (*Elemente të stilit*) nga **Wiliam W. Strunk**. Të dy këta libra, njëri i shkruar shqip, nga një shqiptar i Amerikës, dhe tjetri i shkruar anglisht nga një amerikan, i ngjanin njëri-tjetrit për nga përmbajtja dhe destinacioni, porse do të dalloheshin nga fati i tyre i ndryshëm:

Libri i amerikanit Wiliam W.Strunk, edhe pse në përmasat e një librushi a libri mjaft të hajthëm për nga madhësia, mbeti i përhershëm në shkrimtarinë zyrtare të Amerikës, si model të shkruari dhe, në disa prej ribotimeve të tij në rrjedhë të viteve, i janë bërë vetëm disa shtesa në parathëniet e rastit, prej ish-studentëve të autorit. Ndërkaq, "**Elemente të stilit**" është edhe sot e gjithë ditën si libri i parë i këshilluar për t'u pasur si model të shkruari në Departamentin e Shtetit dhe në të gjitha shkresat zyrtare të SHBA-së.

Libri i Kostë Çekrezit, pasi qe përpirë nga shqiptarët e Amerikës dhe të 2500 kopjet e botimit të parë u shitën brenda 3 vitesh, autorit iu desh ta rishtypte për herë të dytë në vitin 1927.

Po pastaj?

Pastaj, ky gur i çmueshëm i letrave shqipe do të mbetej në të errët dhe do të ishte harruar krejt, po të mos ishte dashamirësia e botuesit Naim Zoto, që e ribotoi parvjet në kolanën "Naimi", pajisur edhe me një Parathënie të shkëlqyeshme të shkruar prof.dr. Shaban Sinani, ish-studenti im i shkëlqyer, sot akademik e penë aq e zhdërvjellët e letrave shqiptare.

Po citoj një pjesë të shkurtër nga kjo parathënie: “Libri i Kostë Çekrezit është një pasqyrë ku administrata e sotme shqiptare nuk do të ketë guximin të shihet dhe më mirë të mos shihet. Në vendostë të shihet, dhe në pastë aq mend sa të kuptojë ndryshimin, me siguri do të thyejë pasqyrën. Por në ndodhtë që të urdhërohet të marrë si model katalogun e shkresave të Kostë Çekrezit, tek e fundit nuk ka pse të ndihet keq, sepse të mësosh prej të parit haravardist shqiptar nuk është turp.”

Duke qenë se modelet e letërkëmbimit që përmban koleksioni i Kostë Çekrezit, si të atij vetjak e familjar, ashtu dhe të komunikimit zyrtar, edhe sot e kësaj dite shërbejnë për të ndihmuar individët dhe zyrat si të shkruajnë një letër private a një shkresë administrative, në këtë botim gjuha e autorit vjen e përshtatur me drejtshkrimin e shqipes së sotme, pa prekur leksikun dhe ndërtimin e fjalisë, që ruhen si në dy botimet e para. Për të gjithë ata që dëshirojnë të thellojnë njohjen e tyre në këtë koleksion si specialistë të korrespondencës, filologjisë së tekstit, shkencave të komunikimit, kulturës zyrtare dhe për qëllime të tjera, në botim përfshihen faksimile të letrave të botimit të vetë autorit.

E dija se ekzistonte ky libër, por nuk e kisha në dorë as kur shkrova librin “Si të shkruajmë shqip” (Toena 2008), as në ribotimet e zgjeruara të tij në vitin 2012, e 2013 dhe as kur shkrova librin “Urgjenca gjuhësore” (2015), por e mora vjet dhe, më në fund, e kam cituar në botimin e dytë të “Urgjencës gjuhësore”, Botimet “Naimi”, 2017.

Më në fund, qoftë edhe pse me vonesë, në trajtesën time për studentët e pasuniversitarët, po edhe në ato që do të parashtroj në këtë ligjëratë, do t’u shtoj edhe idetë themelore të librit të K.Çekrezit e të W.Strunkut, po edhe një sasi të mirë prurjesh të vlefshme nga parashtrësja e akad. Kristo Frashërit *Çështje metodike dhe metodologjike*, me të cilën çelet në fakt libri i tij “Etnogjeneza e shqiptarëve” (Vështtrim historik), Tiranë, 2013.

Po të isha i pasur, sikundër e kam thënë edhe herë të tjera, do t’ua kisha dhuruar këta tre libra, së paku këta të tre, bashkë me librat e mi “Si të shkruajmë shqip” dhe “Urgjenca gjuhësore” të gjithë atyre që dëshirojnë të merren me studime shkencore e me shkrimtari, qoftë edhe për të shkruar letra e shkresa zyrtare, **kurse për studimet albanologjike**, do të kisha kërkuar që libri “Etnogjeneza e shqiptarëve” i akad. Kristo Frashërit të ishte i detyrueshëm për t’u lexuar, konspektuar e dhënë provim nga të gjitha ata që pranohen në institutet kërkimore dhe në katedrat albanologjike në të gjitha hapësirat shqiptare.

Dhe, tani, në vijim e në përputhje me temën e zgjedhur, po lejohej të lexoj disa vlerësime, mendime e piketa pune, që shkojnë në boshtin

tematik, që unë edhe në librat e mi e kam titulluar pikërisht ashtu si do ta mbaj këtu sot: *Prej skedës bibliografike deri te shpallja dhe botimi i studimit shkencor*.

Kryekreje, do të theksoja se është e nevojshme të mos harrojmë të vërtetën e thjeshtë, por të përjetshme, se edhe në kohën e zhvillimeve të sotme teknologjike e elektronike, nga të gjitha makinat dhe teknologjitë, **mjeti kryesor dhe i pazëvendësueshëm gjatë çdo pune hulumtuese dhe përgjithësisht krijuese, mbetet njeriu dhe truri njerëzor**. Prandaj, edhe pse zbulimi i kompjuterit dhe përdorimi i internetit i kanë mundësuar hulumtuesit qasje të shpejtë deri te të dhënat e domosdoshme (bibliografike dhe të gjitha të dhënat e tjera), “stili i vjetër” ka mbetur ende në përdorim, qoftë paralel me “stilin e ri”, kompjuterik, qoftë krejtësisht si i tillë.

Edhe sot hulumtuesit, madje jo vetëm hulumtuesit, por edhe autorët, krahas “shënimit” kompjuterik, do t’i përdorin edhe skedat klasike. Letra, pra, do ta ndjekë fotografinë në ekran. Asnjë bibliotekë e botës, edhe pse i ka futur në përdorim kompjuterët me të cilët hulumtuesi mund të vijë deri te të dhënat, nuk ka hequr dorë nga mënyra e theksuar, klasike e punës: **skedari** (*fischiera*) dhe **skeda** (*kartela*), në të cilat janë shënuar emrat e autorëve, sipas rendit alfabetik, dhe emrat e veprave. (Shih, më hollësisht sythin “Hartimi i bibliografisë së punës “ në librin tim “Si të shkruajmë shqip-Baza të shkrimit akademik”, Botimet Morava, 2013).

Sidoqoftë, sic e thotë edhe M.Shamiq “Sot ka shumë pak hulumtues, që u kanë mbetur besnikë makinave të shkrimit dhe ka shumë pak që nuk dinë t’i përdorin kompjuterët personalë të quajtur PC. Ajo që është vjetruar dhe ka ndryshuar rrënjësisht nga dalja e kompjuterit lidhet me shtypjen e librave si proces.” (Shih: M.Shamiq, *Si shkruhet vepra shkencore*, Logos-A, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2009, f.13.)

R.Bekoni, qysh në shek. XVI ka pohuar se shkenca dhe fuqia njerëzore shkojnë së bashku, paralelisht, se ato në realitet gërshetohen, përshkohen, ndikojnë në njëra-tjetrën në mënyrë të ndërsjellë dhe, qysh atëherë, në shekullin e Rilindjes, ai mahnitej nga shndërrimi që shkencat e ndryshme me zbatimin e vet të shumëllojshëm dhe të shumëfishtë, kanë bërë në jetën e popujve të qytetëruar, të njeriut të kulturuar. (Shih: M.Shamiq, *Si shkruhet vepra shkencore*, Logos-A, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2009, f.13.)

Mjeshtëria e shkencëtarit mund të arrihet më së miri në qoftë se ushtruesi (aspiranti) i saj lexon veprat shkencore dhe doracakët e fushës përkatëse, si dhe me praktikë. Si thotë fjala e hershme latine: *Fit fabricando faber* (Farkëtarit bëhet duke farkuar). E, megjithatë, kjo nuk do të thotë se ekspertit të ri e të papërvojë nuk do t’i ndihmojë vepra në të cilën do të

shtrohen përvojat, mendimet, vërtetimet mbi metodologjinë dhe teknikën e punës shkencore-kërkimore: ato përvoja dhe mendime mund t'i shërbejnë si udhërrëfyes, që t'i lehtësojë kalimin e rrugës që duhet ta shpjerë deri te caku, të cilin duhet ta kalojë; ashtu si hartat dhe busulla ia lehtësojnë udhëtarit kalimin e rrugës së panjohur. Me fjalë të tjera, njohja e metodologjisë dhe e teknikës së punës dhe të kërkimit shkencor do t'i kursejë ekspertit të ri shpenzimin e kotë të kohës dhe të energjisë, do t'i ndihmojë që t'i shfrytëzojë më mirë forcat e veta krijuese dhe aftësitë e punës. Këtë kisha parasysh kur vlerësova tre nga librat shumë të rëndësishëm, që mund të jenë si bazë e si fillesë e mbarë për ata që merren me studime shkencore.

1. Etapat e trajtimit të një teme studimore

Trajtimi i një teme më të gjerë dhe hartimi i punimit shkencor përfshijnë shumë etapa, si: *zgjedhja e temës, mbledhja dhe përpunimi i materialit, organizimi dhe klasifikimi i tij, hartimi i dorëshkrimit, duke pasur kujdes të veçantë në korrektësinë stilistike dhe gramatikore; përpunimin teknik dhe botimin e veprës* dhe, nëse ka të bëjë me tezën (e doktoraturës a të masterit), recensionimin dhe mbrojtjen.

Kryesore për studimin e mirë shkencor janë: *shtruarja e qartë dhe e arsyetuar mirë e problemit, njohja dhe përfillja e duhur e të gjitha argumenteve*, duke shteruar kënaqshëm jo vetëm njohjen teorike e historike të dukurisë, po edhe duke hyrë sa më thellë në nxjerrjen në pah të mundësive e mbërritjeve të reja. Por, ndërkaq, edhe njerëzit që nuk merren me shkencë e studime, por ia dinë vlerën punës e lodhjes së vërtetë, qysh në kohët e vjetra kanë thënë: *"jo shumë e për lumë"* dhe *"më mirë pak, por sak"*.

Gjithmonë, në studimet shkencore është anuar nga shkurtësia, e cila, krahas qartësisë dhe saktësisë, është veçoria themelore e prozës shkencore. Shkurtësinë, si cilësi të vyer të studimeve shkencore, e kërkon edhe vetë tempi e ritmi i sotëm i jetës; njeriu i sotëm nuk ka më shumë durim (dhe sidomos kohë) për të lexuar studime të gjata (dhe sidomos të stërzgjatura). Madje, kjo do të ketë qenë cilësi edhe e njerëzve të shquar të periudhave të kaluara, po të kujtojmë se edhe Volteri ka thënë: *"Trembem nga librat e mëdhenj!"*

Shkurtësia në masë të përshtatshme, ndërkaq, është dëshmi se autori e ka zotëruar lëndën e trajtuar deri në atë shkallë sa që ka qenë në gjendje edhe ta paraqesë atë në mënyrë të ngjeshur, pa zgjatje e hapësira të cekëta të panevojshme. Shkurt: **proza shkencore duhet të jetë e rrjedhshme dhe e shpejtë si lumi i thellë, por asnjëherë si kënetat a uji i ndenjtur në**

moçale. “Më në fund, shkurtësia ka çmimet e veta të veçanta: ajo është shenjë e gjallërisë, fuqisë, qëndrueshmërisë dhe, në të njëjtën kohë, edhe e maturisë dhe shijes së bukur të një autori. E, megjithatë, duhet pasur parasysh se **shkurtësia nuk duhet të shkojë në dëm të qartësisë**: kudo që ekziston, qoftë edhe dyshimi më i vogël se parashpresa nuk do të kuptohet mirë e drejt, duhet të plotësohet dhe të zhvillohet e ndërkaq mendimi të sqarohet më hollësisht.” (Shih: Mid‘had Shamiq, *Si shkruhet vepra shkencore*, Logos-A, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2009, f.35.)

2. Gjetja ose zgjedhja e temës

Qysh në kohët e hershme, populli e ka shprehur se sa i vështirë, po edhe sa i rëndësishëm, është për çdo punë fillimi: *të zanët fill* me thënien urtake: “*Fillimi i mbarë është gjysma e punës*”. Gjermanët, afërsisht të njëjtin pohim e formulojnë me proverbin: “*Aller Anfang ist schwer*.” (Çdo fillim është i vështirë.).

Kështu, në librin vërtet të lëvdueshëm e të vyer të Mid‘had Shamiqit, ndër të tjera, për fillimin e studimit shkencor thuhet:

1. Parashtrimi të mos fillojë nga larg, por të zgjidhet pika që është më e domosdoshme. Sikundër thotë një poet e studiues i njohur shkrimtari i mirë i zgjedh fjalët, si muratori që i zgjedh dhe i gdhend me çekiç gurët e qosheve, duke i latuar me kujdes që ata të jenë në harmoni me njëri-tjetrin, të jenë të një mase dhe të një ngjyre. (Shih: S.Mato, *Arti i të shkruarit*, Guidë në sekretet e letërsisë, Tiranë, 2002, f. 15.)

2. Të mos përfshihet në punim asnjë gjë që nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me temën, sepse dëmtohet njësia a uniteti i trajtimit. Sigurisht, edhe në studimin shkencor, qoftë punim masteri, doktorature a monografi e plotë, mund të bëhet edhe ndonjë prapavështrim (digresion), por gjithmonë me masë dhe duke shfrytëzuar edhe mundësitë e sotme të të shkruarit me kompjuter, d.m.th. duke kaluar edhe në shënime jashtë tekstit-bazë, sidomos me anën e shënimeve në fund të studimit (*endnotes*).

3. Të mos ngarkohet punimi me imtësi të parëndësishme.

4. Të mos ketë përsëritje të panevojshme të gjërave, që mund të jenë thënë më parë. (Shih: Mit‘had Shamiq, *Si shkruhet vepra shkencore*, Logos-A, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2009, f.37.)

5. Të mos teprohet me sqarimin e shpjegimin e gjerë të gjërave që janë të kuptueshme vetvetiu, si dhe të kalohen me pak rreshta ose të mos përmenden fare gjëra krejt të ditura. Lidhur me këtë stilistët e mirë kujtojnë thënien e bukur franceze, që thotë: “*Le secret puor etre ennuyeux c’est de tant dire*” (=Sekreti që njeriu të bëhet i bezdisshëm qëndron në të thënit e gjithçkaje). Këtë e thoshte edhe më mirë Monteskje-ja, sipas të

cilit, fshehtësia e të shkruarit mirë qëndron në atë që “idetë që kuptohen vetvetiu të kapërcehen”.

Hulumtuesi duhet të përpiqet që, pikërisht sepse puna shkencore është e lodhshme dhe e vështirë, për të mos e lodhur lexuesin, parashtrimi i rezultateve të studimit duhet lakmuar të jetë **sa më i qartë, i rrjedhshëm, me tempin dhe një farë ritmi që ta mbajë gjallë vëmendjen e lexuesit**. Siç thoshte Shopenhaueri: “**Kush dëshiron të shkruajë për të gjitha kohët, le të jetë i shkurtër, konciz dhe i kufizuar në atë që është thelbësore: le të mendojë mirë, të jetë i kursyer në çdo fjali dhe fjalë, si ai që, duke e përgatitur valixhen për udhëtim të largët, të çdo imtësi që e vë në të, mendon a ta lërë edhe atë**”.

1.3.Disa kërkesa të tjera të punimit shkencor

Po ashtu, përveç cilësive të përmendura më lart dhe shkurtësisë (koncizitetit) apo të parashtruarit **në mënyrë sa më të thukët**, punimi shkencor duhet të përmbushë edhe disa kërkesa të tjera shumë të rëndësishme e pikërisht:

Uniteti. Çdo punim shkencor me cilësi të mirë (ashtu si edhe çdo hartim a shkrim tjetër me karakter publik) duhet të *ndjekë një parashtrim e paraqitje të atillë ku të shquajë njësia (uniteti)*, të përmbajturit në një **bosht të caktuar dhe të njësishtëm** (unik) që nga hyrja deri në mbyllje a në përfundimet e tij.

Harmonia (koherenca). Të gjitha pjesët e punimit shkencor, që nga kreu deri në mbyllje, duhet të *jenë në harmoni të plotë me njëra-tjetrën për sa i takon boshtit tematik*, po edhe nga aspekti lëndor dhe stili e mënyra e parashtrimit. Së pari, me rëndësi është aty **koherenca logjike dhe lëndore**. Sipas parimit të harmonisë, *secila nga pjesët e një tërësie, e cilitdo rend qoftë ajo, duhet që të jenë në harmoni ndërmjet tyre dhe me vetë tërësinë*. Ajo tërësi, duke u përfshirë në një njësi tërësore të rendit më të lartë, bëhet edhe vetë pjesë që duhet të jetë në harmoni me pjesët e tjera të asaj tërësie të re e më të lartë e kështu me radhë deri te ideja e parë, thelbësore.

Theksimi i pikave kryesore. Pjesët e punimit, sado unik dhe i tërësishëm të dalë ai, nuk mund të kenë të gjitha të njëjtën peshë ideore e të njëjtën rëndësi pragmatike e studimore, prandaj, qysh në renditjen e tyre, në një farë mase, duhet bërë edhe vlerësimi i peshës dhe rëndësisë së tyre, gjë që sjell edhe **atë vijë e mënyrë trajtimi, që përbën theksimin e pikave kryesore**. Theksimi i pikave kryesore duhet të jetë edhe në bazën e përcaktimit të përpjesëtimit a përmasave të secilës pjesë të punimit. Kështu, sikundër vënë re kritikët e mjeshtërisë së të shkruarit, gjithandej, edhe në punimet shkencore lindin pjesë a kapituj, që u ngjajnë “trupave të cilët gjymtyrët janë të hipertrofizuara”, lindin “vepra të çala, të përfryra (obeze)

e të deformuara, që nuk mund të mbahen në këmbë dhe nuk do të mund të jetojnë". (Shih: G.Lanson, *Conseils sur l'art d'écrire*, Paris, Hachette, 1894, f.137.)

Origjinaliteti. Origjinaliteti, sigurisht, është *cilësia që nuk mund të kërkohej qysh në hapat e parë të punës shkencore*, nuk mund të jetë menjëherë cilësim i krijimeve të autorëve fillestarë e të rinj në moshë, po sidomos me përvojë krijuese ende të pakët. Origjinaliteti i plotë, po të duam të jemi të sinqertë me veten dhe me krijuesit që do ta ndjekin udhën e punës shkencore, paraqet përjashtim, kurse të rrallë janë autorët që shquhen si të tillë, prandaj, me të drejtë Gëtja thoshte: *"Gjithnjë flitet për origjinalitet, por çdo të thotë kjo! Qysh kur lindim, bota që na rrethon fillon të ndikojë mbi ne dhe kështu vazhdon deri ne fund. Dhe kjo kudo! E çka mund të themi përveç energjisë, fuqisë dhe vullnetit të quhet e jona! Sikur të mund të tregoja se çka u kam krejt borxh pararendësve dhe bashkëkohësve të mëdhenj, nuk do të më mbetej shumë."* (Sipas J.P.Eckerman, *Biseda me Gëten*, (cituar sipas M.Shamiq, vep.cit. f.40) Sidoqoftë, në fushën e të shkruarit, qoftë të një punimi shkencor, qoftë të një krijimi letrar, sado modest të jetë, ai **duhet të përmbajë diçka të re**, të shquhet për origjinalitet, të sjellë **material të ri** deri atëherë të panjohur ose që, përkundrazi, materiale a të dhëna më parë të ditura, por të pashqyrtuara ashtu si duhet e të papërfillura nga askush, **rimerren në mënyrë origjinale, rivlerësohen e prej tyre fitohet një pamje e re e dukurisë.**

Gjykimi i drejtë. Nga përvoja më e mirë e derisotme ka dalë se, pavarësisht nga tipi a lloji i parashtrimit që zgjedh autori në punimin e tij shkencor, **me rëndësi themelore janë dy cilësi:** 1) që të gjitha pohimet, gjykimet a mendimet të jenë **të arsyetuara e të argumentuara**, përndryshe dalin si pohime arbitrare e pa vlerë; 2) që gjykimet dhe përfundimet të jenë **të drejta**, që të mos i thjeshtojë gjërat, duke marrë parasysh vetëm argumentet që shkojnë në të mirë të tezës së tij, po edhe ato që i dalin kundër tezës së tij, duke gjetur argumentimet dhe shpjegimet e vlefshme; të mos ngadhënjehet nga sipërfaqja e gjërave dhe të mos e marrë të pavërtetën për të vërtetë. Në shkencë qëndron postulati i palëkundshëm, që thotë: *"Të bindemi në vërtetësinë e faktit, para se të fillojmë verifikimin e shkaqeve të tij"*. Edhe në kohën tonë, ndonëse kanë kaluar shumë shekuj qysh në kohën e Dekartit, mbetet e vlefshme porosia urtace e tij që *"në çdo gjë të bëjmë numërime dhe pasqyrime aq të përgjithshme, që të bindemi se si nuk kemi lëshuar asgjë"* dhe asnjëherë të mos lejojmë të biem në paragjykime, **të mos ua përshtasim realitetin mendimeve vetjake, por as të mos shkohet verbërisht mbas pohimeve e mendimeve të autoriteteve.**

Shembullzimi. Në shkencë vlerësohet se *mjeti më i mirë për çdo parashtrësë, qoftë kumtesë e thjeshtë, qoftë artikull a monografi e plotë, është shembullzimi (ekzemplifikimi), që do të thotë mbështetja me shembuj konkretë e asaj që pohohet, mbrohet a kritikohet.* Mbi këtë bazë, studimi nuk mund të jetë kurrë pa shembuj, përndryshe rrezikon të rrëshqasë në pohime e gjykime abstrakte e të pabesueshme. Shembujt, natyrisht, duhet të jenë kurdoherë të faktuar edhe me citimet përkatëse se nga janë nxjerrë (nga dokumentet arkivore, nga librat e botuar, nga mbledhja e materialit në terren, nga anketimet gojore të drejtpërdrejta ose nga anketat me korrespondencë etj.).

Në radhë të parë punonjësi shkencor duhet të ketë **zëllin dhe dashurinë për shkencën**, aftësinë e përgjithësimit dhe të nxjerrjes së përfundimeve me karakter të përgjithshëm, duke u nisur nga prurjet dhe informacionet e veçanta; prirjen dhe përkushtimin për punë sistematike dhe gjakimin për saktësi dhe, mbi të gjitha, të ketë **nderin intelektual**. Lidhur me këtë Rable-ja thoshte me të drejtë: “Shkenca pa ndërgjegje është shkatërrim i shpirtit”. (*Science sans conscience n’est que ruine de l’âme*).

Në vijim dhe në funksion të temës, do të përmend, shkurt, disa prej vlerave dhe porosive të vyera me rëndësi metodologjike nga vepra e akademikut **Kristo Frashëri** e pikërisht:

1. Rëndësia që disa albanologë gjuhëtarë u kanë dhënë vetëm pikave të takimit që kanë vënë re midis disa toponimeve ilire me toponime të sotme shqipe, si dëshmi e vazhdimësisë gjenetike iliro-shqiptare është pa dyshim e tepruar. Vazhdimësia e toponimeve vërteton jo kurdoherë vazhdimësinë gjenetike, por vazhdimësinë e vendbanimit. Po ashtu edhe disa glosa ilire që ka gjuha shqipe nuk dëshmojnë domosdoshmërisht lidhjen gjenetike midis gjuhëve. Kjo për arsye se gjatë shekujve, popujt nëpërmjet kontakteve të shpeshta huazojnë mori fjalësh nga gjuhë të tjera.

2. Huazimet e fjalëve të huaja nëse gjuha që i huazon ia përshtat ligjeve të saj gramatikore dhe fonetike, nuk tregojnë lidhje gjenetike, por vetëm marrëdhënie fqinjësie me gjuhën e fjalëve të huazuara. Gjuha shqipe ka huazuar shumë fjalë nga gjuhët latine, sllave, turke, por askush nuk ka guxuar ta quajë gjuhën shqipe se ajo është bijë gjenetike e latinishtes, sllavishtes apo turqishtes.

3. Etnogjeneza, përveç komponentëve kryesorë (gjuha, territori, kultura) është një proces që pushton shekuj. Si i tillë, ai proces është i lidhur ngushtë me një varg faktorësh historikë, gjeografikë, ekonomikë, etnologjikë, gjuhësorë, antropologjikë dhe kulturorë. Të tri këto grupe faktorësh - identiteti i trungut fisnor, kushtet gjeografiko-ekonomike të atdheut ku u mpiks etnogjeneza dhe kontributi njerëzor dhe kulturor i

popullatave të tjera që u integruan në atë trung - duhen domosdoshmërisht të merren në konsideratë jo veç e veç, por së bashku nëse duam të ndriçojmë në mënyrë sa më të saktë problemin e etnogjenezës.

4. Duket se ka ardhur dita që të hiqet dorë jo vetëm nga disa mendësi të cinguar, por edhe nga disa praktika të gabuara, që janë përdorur deri sot tek ne në fushat e shkencave shoqërore. Për gati gjysmë shekulli që kur pas Luftës së Dytë Botërore morën vrull në Shqipëri shkencat albanologjike, studiuesit e të gjitha disiplinave shkencore të lidhura me të e konsideruan fushën e tyre të punës si një disiplinë parësore, madje edhe të pavarur nga disiplinat e tjera. Gjatë regjimit komunist edhe pse kërkohej respektimi i parimit të pavdekshëm të Aristotelit dhe të Hegelit *se të gjitha fenomenet shoqërore janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën dhe të ndërruarra njëra nga tjetra*, pothuajse të gjithë studiuesit u mbyllën në kafazet e disiplinave të tyre.

Do ta përfundojmë këtë parashtrësë metodologjike, duke mbështetur konkluzionin e arkeologut akad. Muzafer Korkuti, të shprehur në trajtesën e tij me titull *“Parailirët, Ilirët, Arbërit”*, ku ai ai shkruan: *“Në zgjidhjen e problemeve të tilla kaq të ndërlikuara është i nevojshëm bashkërendimi i përfundimeve të fushave të ndryshme të dijes. Të dhënat arkeologjike, antropologjike, gjuhësore, etnografike dhe ato historike, kur ka të tilla, duhet të bashkërendohen për të arritur në përfundime të sakta”*. (Muzafer Korkuti. *Parailirët, ilirët, arbërit. Histori e shkurtër*. Tiranë, 2003.)

New scientific research and the tradition of academic writing

ABSTRACT

In 1917, an Albanian, former student of Harvard University, Kostë Çekrezi, published in Boston (America) the book "Guide to communication" (Models of letters, official and private letters, dictionary). In the same year, in America, a book was published that was "cool" in terms of the subject, with the title "The elements of style" (Elemente de stile) by William W. Strunk. Both of these books, one written in Albanian, by an American Albanian, and the other written in English by an American, resembled each other in terms of content and destination, but would be distinguished by their different fates. I will also deal with the basic ideas of the book by K. Çekrezi and W. Strunk, as well as a good amount of valuable contributions from the presentation of the acad. Kristo Frashëri

Methodical and methodological issues, which in fact opens his book "Ethnogenesis of Albanians" (Historical overview), Tirana, 2013. Knowledge of the methodology and technique of work and scientific research will save the young expert the waste of time and energy, will help him to use better his creative forces and work skills. These very important books, which can be as a basis and a good starting point for those who deal with scientific studies.

Rozana RUSHITI

**PRANIA E FJALËSIT TË XHUVANIT
NË FJALORËT E GJUHËS SHQIPE DHE
FUSHAT E PËRDORIMIT**

Botimi i një *Fjalori të Gjuhës shqipe* nga Akademia e Studimeve Albanologjike¹, me emrin e njërit prej themeluesve të albanologjisë në vendin tonë, vjen bindshëm për dy arsye: së pari, mban për autor një figurë linguisti, veprimtar aktiv prej më se gjysmë shekulli në lëmënj të ndryshëm të studimeve tona filologjike dhe, e dyta, sepse me këtë vepër ndiqet një traditë e hershme leksikografike, nga *Fjalorthi i Ri*, i don Nikollë Gazullit “Fjalë të rralla të përdoruna në Veri të Shqipërisë” dhe *Fjalorit dialektor* – me fjalë e shprehje nga Jugu i Shqipërisë, i Pano Tases, që panë, të dy, dritën e botimit në vitin 1941, si gjerdanë në kolanën e quajtur “Visaret e Kombit”, vëllimet XI dhe XII. Profesor Xhuvani, i mbujtur me një përvojë të gjatë aktive, që nga pjesëmarrja në Komisinë Letrare të Shkodrës, në Kongresin e Lushnjës, largpamës në krijimin dhe mbështetjen e një *gjuhe letrare* qysh para Luftës II Botërore, një vlerësues dhe kritik symprehtë i mjaft fjalorëve dygjuhësh, nga misionarë të huaj, që nga Angelo Leoti² e Fulvio Kordignano³ deri te *Fjalori i Bashkimit* etj., nuk pushoi së mbledhuri gjithë jetën fjalë e shprehje shqipe. Veprimtaria e prof. Xhuvanit u shtri në një periudhë të gjatë, prej më se 55 vjetësh, duke përjetuar e shprehur faza të ndryshme të studimeve tona gjuhësore, duke ndërlidhur, sipas studiuesit Domi⁴, dy etapa të rëndësishme të tyre: gjuhësinë e Rilindjes dhe gjuhësinë së re. Ai kryesoi nismën “*Selectae*” dhe “*Mischellaneo*”, që u hap e vijoi kohë me radhë në shtypin e viteve 1930, ku kontribuoi me diskutimin e çështjeve gjuhësore, deri edhe me etimologji apo disputa të thella shkencore me intelektualë qëllimpirë apo dashamirës të zhvillimit të gjuhës sonë amtare. Xhuvani ka shoqëruar aktivisht disa ngjarje madhore

¹ ASHSH, ASA, *Aleksandër Xhuvani Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2021.

² Aleksandër Xhuvani, *Fjalor i Angelo Leotti-t*, 1931, në “*Studime gjuhësore*”, 1956, f. 179 v.

³ Fulvio Cordignano, *Dizionario Italiano-Albanese*, botim anastatik, Shoqata e Jezuitëve, 1938.

⁴ Mahir Domi, *Aleksandër Xhuvani lëvrues dhe studiues i shquar i gjuhës shqipe*, në “*Studime për nder të Aleksandër Xhuvanit*, IGjL, Tiranë, 1986, f. 52.

në jetësinë e shqipes, nga kodet e ortografisë, të fjalëformimit, të historisë së gjuhës dhe të reformimit të arsimit shqiptar. Tradita e vjeljeve si kjo, për gjuhësinë tonë të re, zë fill në atë masë që kërkohet, në të gjitha studimet tona dialektore, që janë pajisur përherë me fjalësin e arealit gjuhësor të përshkruar; por në vitet e fundit janë realizuar edhe fjalës apo fjalorë krahinorë, si: *Fjalor fjalësh e shprehjesh popullore të Tropojës* nga A. Sula⁵ dhe një tjetër po nga ky areal gjuhësor prej Petrit Elezit; *Fjalori i Ujemirës* i prof. Hajri Shehut,⁶ *Fjalori leksiko-frazeologjik i Devollit*, hartuar prej Ali Jasharit,⁷ dhe vepra tjetër e këtij lloji, *Fjalor leksiko-frazeologjik dhe etnolinguistik i Malësisë së Madhe* nga akademiku, prof. Gjovalin Shkurtaç, që u prezantua para disa ditësh, si vepër e Akademisë së Shkencave⁸. Lidhur me kontributin e tij me çështje konkrete të leksikologjisë shqipe, sjellë edhe përmes këtij fjalori, prof. Domi shkruan se si një *Kristoforidh i ri* ai grumbulloi një material shumë të pasur e të vyer leksikor e frazeologjik që mendonte ta botonte në formën e një fjalori, si plotësim të Fjalorit të njohur të Kristoforidhit, dëshirë e cila nuk u arrit të përmbushej prej tij⁹, ashtu siç nuk mundi ta botonte për së gjalli Fjalorin e vet as Kristoforidhi¹⁰.

Botimi i kësaj vepre, dallueshëm nga fjalorët e tjerë shpjegues të shqipes, pasi fjala e parë e titullit jepet në trajtë të shquar **F j a l o r i** (ndërkohë që të gjithë Fjalorët e shqipes moderne, nga ai i vitit 1954, deri te ky i këtij viti, 2021, dalin në trajtë të pacaktuar), që nga publikimi pjesë-pjesë, është shoqëruar me shënimin: *Ndihmesë në fjalorin e shqipes*, nga revista SF e vitit 1971- 1990. Mund të mendojmë që shënimi ka të bëjë e mbase lidhet me planet e së ardhmes, që ka gjuhësia jonë: hartimin e *Fjalorit-Thesarius*, një perspektivë që do ta ketë ëndërruar ta shihte edhe vetë Xhuvani, me gjallje të tij.

Po, si mund ta klasifikojmë këtë vepër leksikografike të autorit tonë?

Së pari, ajo nuk rreshtohet ndër fjalësit dialektorë, për të cilët shkruam më lart e që përbëjnë një pasuri më vete, prej mijëra e mijëra leksemash, por mund të thuhet se nuk është as një fjalor shpjegues i mirëfilltë i shqipes,

⁵ Avdyl Sula, *Fjalor fjalësh e shprehjesh popullore*, Tiranë, 2009.

⁶ Hajri Shehu, *Fjalor me fjalë e shprehje popullore nga e folmja e Ujemirës, Qarku i Dibrës - I*, Tiranë, 2016.

⁷ Ali Jashari, *Fjalor leksiko-frazeologjik i Devollit*, Korçë, 2016.

⁸ Gjovalin Shkurtaç, *Fjalor leksiko-frazeologjik dhe etnolinguistik i Malësisë së Madhe*, Tiranë, 2022.

⁹ Mahir Domi, *Aleksandër Xhuvani lëvruet dhe studiues i shquar i gjuhës shqipe*, në "Studime për nder të Aleksandër Xhuvanit, IGjL, Tiranë, 1986, f. 52.

¹⁰ Shaban Demiraj, *Aleksandër Xhuvani si vazhdues i veprës së Konstandin Kristoforidhit*, në "Studime për nder të Aleksandër Xhuvanit, IGjL, Tiranë, 1986, f. 128.

përqasur me ata që janë botuar deri më tani. Kemi bindjen se ky Fjalor i Xhuvanit është një vepër *miscellaneo*, me bazë *selectae* – siç janë përzgjedhjet që ka bërë gjuhëtari ynë e që gjenden në brendësi të saj:

- nga vjeljet e fjalëve të rralla, të papërfshira deri në kohën e tij nëpër Fjalorët shpjegues.
- nga fjalë të marra prej Fjalorëve të botuar të shqipes, në mënyrë të veçantë nga ata të vitit 1954 e vazhdim deri kur ai ishte ende aktiv;
- nga qëmtimet që u ka bërë veprave letrare të autorëve të traditës e atyre bashkëkohorë.

Lidhur me përzgjedhjet e sjella nga gjuhëtari ynë, prof. Thomai¹¹ shkruan se Xhuvani u përpoq të kapte në radhë të parë fjalë, kuptime, përdorime e sidomos shprehje që s'figuronin në fjalorët më të njohur të shqipes të asaj kohe dhe që sillnin diçka të re në gjuhë.

Për shembull, në 23 faqe që zë fjalësi i shkronjës “F”, f. 127 – 149, me 534 lema gjithsej, nëse shohim në f.147, do të nxjerrim:

1. Fjalë ku përmendet Kanuni i L.Dukagjinit, Fjalori i Gazullit: me 7 kuptime semantike të leksemës “fur-furem” (var, vjerr, hyj përdhuni etj.) e me 4 lema; Kristoforidhi-marrë nga Buzuku; nga Bibla (Luka I) 1 leksemë; Mitko – 2 leksema; Perderseni – 1 leksemë;
2. Fjalë të vjela nga goja e popullit: Dibra- 1 leksemë; Korça – 2 leksema; Gjirokastra 1 leksemë; Myzeqeja – 1 leksemë; Mirdita – 1 leksemë; Tirana – me 4 leksema; Veri- 1 leksemë dhe mbyllet me termin “Fushëtirë-a, fushë, shesh, nga *it.* piazza, dhe *gr.* πλατεί. Me etimone greke, dëshmohen jo pak fjalë nga Fjalori i këtij autori, i cili ishte formuar filologjikisht në gjuhën helene. Te kjo faqe, gjejmë edhe një etimologji tjetër, si: te kuptimi III i fjalës “furë”- *asht furë kanali – asht mbushur*; por këtu me prejardhje nga *slav. usov*.
3. Fjalë të marra nga Fjalorët e shqipes: 2 leksema.

E njëjta pamje shfaqet edhe në f. 145, ku përveç ndarjeve si më sipër, ndeshim edhe lema të nxjerra nga fjalori i Leotit, i Bashkimit, prej veprave të Budit, të De Radës, të Nolit (nga përkthimet); ndërsa, si vjelje hapësinore, brenda f. 144-145, kemi: nga Luma (Kukës); Tepelena; Korça, Gjirokastra, Gramshi; Skrapari; Myzeqeja; Berati; Dibra; Kosova; Librazhdi; Vlora; Shkodra; Sulova, Puka. Për fjalët nga Fjalori i Bashkimit,

¹¹ Jani Thomai, *Aleksandër Xhuvani si leksikolog e leksikograf*, në “Studime për nder të Aleksandër Xhuvanit, IGjL, Tiranë, 1986, f. 99.

autori vë pranë leksemave edhe termin italisht, si: “Ftikem”- thahem, terem, *it. asciugarsi, secarsi*. Duke i dhënë rëndësi frymës së gjuhës së gjallë, vetë prof. Xhuvani në një shkrim të tij shpjegon: “Nuk mund të krijojmë fjalë të reja mbas qejfit t’“onë ose ashtu si na e pret mendja neve, pa u-pështetë në shëmbëlla të gjalla të popullit¹²”. Shembujt e gjedhet e gjalla të popullit i vështroi historikisht e në gjendjen aktuale për kohën ku u pasqyruan, nga qartësia e strukturës e nga mundësitë fjalëformuese, duke kritikuar disa formime jashtë rregullave të gjuhës ose nën ndikimin e gjuhëve të huaja. Aleksandër Xhuvani ka bërë një punë të madhe hulumtuese. Në mbledhjen e materialit ka bërë një punë serioze, të kujdesshme, të saktë, me durimin e një dialektologu të përgatitur, duke ecur kështu në gjurmët e mësuesit të tij, Kristoforidhit¹³. Në fjalor vijnë si mbështetje edhe krahasimet me gjuhë të tjera, sidomos me gjuhët klasike: latinishte e greqishte dhe këtu me maturi e kujdes, prof. Xhuvani bën kufizime me vend, pasi siç shkruan “S”-asht mbëhi ta shtrijmë analogjinë në çdo punë e të krijojmë fjalë edhe kundër rregullave të gjuhës.”¹⁴

Sa i takon Fjalorit të A. Xhuvanit, na bie në sy se ai është në pajtim a unison me vëllimin që kanë lemat, parë sipas shkronjave të fjalorët tanë, një fakt që u përket përafërsisht të gjithë fjalorëve të gjuhëve natyrore, së paku, fjalorëve dygjuhësh që kemi deri më sot për gjuhët indoevropiane. Kështu duhet të dimë se në anë numerike, peshën e fjalëve të një gjuhe e mbajnë shkronjat: **B/ G/ K/ L/ M/ N/ P/ R/ S/ T/ V**– pra, janë vetëm 11 shkronja që bartin pjesën më të madhe të lemave të mbledhura prej gjuhëtarit tonë të shquar, si në fjalorët shpjegues, nëse i shohim me vëmendje. Po e sjellim këtë shtrirje, jo me leksema, por me numrin e faqeve: Kështu, te germa “**B**” – gjenden 48 faqe; germa “**G**” 30 faqe; te “**K** -ja”, hapësira është me 56 faqe; “**L**-ja” – me 30 faqe; “**M**-ja” me 57 faqe; “**N**-ja” 31 faqe; shkronja “**P**” – 80 faqe; gerrat “**R/Rr**”- me 40 faqe; germa “**S**” – 28 faqe; “**T**-ja” me 27 faqe; “**V**-ja” me 34 faqe. Nëse secila faqe ka rreth 28 fjalë, duket qartë epërsia numerike e fjalësit të këtyre shkronjave.

Një pamje pozitive sjell Fjalori edhe me kuptimet e shumta që u shfaqen fjalëve të ndryshme, si për fjalën “krye -t”, ka një lëndë leksikore prej 2 faqesh, për foljet “kthej-kthhem”- 1 faqe; për leksemën “plang-u” dhe rrjedhojat e saj, rreth 1 faqe; për leksemën “dhunë-a” e formimet prej saj- 1 faqe; po kështu, hapësira për formime nga një temë e përbashkët, ka qenë në vëmendjen e autorit t’i vendosë bashkë me kuptimet e reja, si te

¹² Aleksandër Xhuvani, *Thërmije gjuhe*, 1944, në “Studime gjuhësore”, 1956, f. 67.

¹³ M. Çeliku, A. Xhuvani *për gjuhën e popullit dhe për dialektet e shqipes*, në “Studime për nder të Aleksandër Xhuvanit, IGjL, Tiranë, 1986, f. 134.

¹⁴ Aleksandër Xhuvani, *Thërmije gjuhe*, 1944, në “Studime gjuhësore”, 1956, f. 74.

fjala “dhëmb-i e “dhamb-i” etj. Me shumë interes duhen parë edhe paraqitjet e mjaft leksemave në bazë të cilave vijnë e formohen shprehje frazeologjike e mënyra të thëni me kuptime të ndryshme e me ngarkesë stili të veçantë, si për gjuhën e folur, ashtu edhe për atë të shkruar, si: për foljen “dal-a”, sjellë me 18 kuptime; me këtë shtrirje është trajtuar edhe leksema “dhunë-a”: me 6 kuptime të reja – mbështetur në përdorimet që bëjnë Buzuku e Budi, pa munguar etimoni i saj nga italishtja: *schernire* e greqishtja *ἐμπάζω, σλενάζω*; apo emrin “dhe-u”, me disa kuptime sipas situatave gjuhësore dhe me një varg të gjatë frazemash, midis të cilave nuk mungojnë edhe përjasje krahasuese me idioma të përfarëta nga greqishtja. Te kjo shkronjë gjejmë edhe shfaqje fonologjike të ndërrimit “Dh/V”, si te leksema “dheks” *ft s“ma dheks shpirti, s“ma qas shpirti; më dhekset*, më teket – fjalë që e përmban edhe Fjalori i vitit 1954, edhe Fjalori i Bashkimit (1908), ndërsa Xhuvani sjell vetëm si *fjk* (folje kalimtare) “dhekset”- vjelë në Gjirokastër, me kuptimin “Më teket, më shkon mendja: i u dheks për mish të pjekur, për meze; në shkodranisht: *më dheshket a më veshket*. Në fund, autori e jep si huazim nga greqishtja: *δέλωμαι*. Me një shumësi semantike shoqëruar me frazema të njohura a të panjohura në mbarë shqipen, na vjen edhe emri “Erë-a”- me 8 kuptime në strukturë frazeologjike, pa munguar edhe këtu krahasimi me një shprehje idiomatike të italishtes dhe greqishtes, si te shpjegimi nr. 5: I kanë ra m“erë – e kanë diktuar, përjasur me it. *ebbe sentore* dhe gr. *πήπε*, shtuar këtu edhe fr. *sentir*. Gjithë lënda për shpjegimin e kësaj lekseme është mbledhur: nga Gjirokastra, Dibra, Mallakastra, Noli, Elbasani, Himara, Pashko Babi dhe mbështetur etimologjikisht nga Pedersen. Me 5 kuptime dhe me një trajtim të gjatë e kaq të pasur është sjellë edhe fjala “Faqe-ja”, ku ka dhjetëra shprehje, që nga ato metaforike, si “gropa e faqes”, “faqe muri”, deri tek ngurimet frazeologjike: “i duel në faqe”, “m“erdh faqe e zezë”, “mori faqe buka”, edhe si parafjalë: faqe meje: para meje, në praninë time, etj. etj. Shprehjeve të veçanta me këtë leksemë, autori u vë pranë edhe struktura idiomatike nga disa gjuhë, si: s“kam sy e faqe të flas, s“i dal përpara – *germ. Ich habe nicht den unt, ich schäme mich*; ose, për shprehjen “i duel në faqe”- krahasimi bëhet me gr. *ἐπέησε, δέν επέσε*; me pru një tregim që e qet për faqe: it. *rilevare, mettere in evidenza*.

Në këtë masë janë sjellë në Fjalor edhe leksemat “fill-i” fije-t – me 16 shpjegime përdorimi, me vjelje nga: De Rada, Buzuku, Naimi, Himara, Grigor Gjirokastriti, Kristoforidhi, Korinthe, Budi, Eposi në Visaret e Kombit, e si ndajfolje “fill për pe” - me hollësi nga FGJSh, 1954. Edhe te kjo lemë nuk mungon përjasja etimologjike me greqishten. Mendoj se ndjekja e linjës së krahasimeve me gjuhë të tjera, që bën Xhuvani, do të

ishte me interes për të ravijëzuar ndihmesën e këtij gjuhëtari në lëmë të etimologjisë dhe të krahasimit jo vetëm si prejardhje të fjalëve por, në mënyrë të veçantë edhe për frazeologjinë. Nga kjo germë e Fjalorit, këtu mund të rendisnim edhe leksemat: fjalë-a, fjollë-a, flamë-a, foljet “flas” dhe “fle”, emrat “frikë-a”, “framë-a”, “fyell-“, “fyt-i” dhe “fytirë-a”, një paraqitje që vijon edhe te shkronjat e tjera të fjalësit.

Por fjalorët mund e duhen parë edhe nga një pikëvështrim tjetër: çfarë fushash leksikore përfshin fjalësi i rreshtuar në vepra të tilla, përndryshe, sa janë fjalë të njohura në mbarë shqipen, sa janë të përdorimit të përditshëm, cilat janë nga fusha e diturisë, me kuptime leksikore nga bujqësia, tregtia, peshkimi, zëjtaria, emërtime sendesh e mjetesish përdorake, a ka fjalë të pakuptueshme të cilat mund të jenë isogloza me areal tepër të ngushtë, por që vijjnë e bëhen pasuri për *Thesarius*-in e ardhshëm të gjuhës sonë?

Kjo mund të bëhet shkronjë për shkronjë dhe për çdo lëmë të kësaj vepre, edhe për shkakun që autori nuk ka vënë pranë leksemave shënimet që më të shumtën i vendosin fjalorët shpjegues, si b.f.: mortajë-a-t *usht*. – term ushtarak; mosinteresim-i, mospëlqim-i *libr*. Fjalë librorë nga fusha e diturisë; mukajet-i *bised*. – fjalë bisedore; mushmollë-a-t *bot*. nga fusha e botanikës, etj. Le të shohim, si është kjo përkatësi fushe vetëm te faqet e para të një shkronjë, te “H-ja”, me shtrirje 19 faqe (193 – 211)

HA – *fk*. 1. Hangrën *sa iu frynë sqetullat* dhe vjon me 20 shpjegime e përdorime radhazi, duke e përdorur foljen pothuajse në të gjitha mënyrat në struktura shprehjesh e frazemash: vjelë nga Kruja, J.Vretoja, Luma, dhe nga FGjSh për termin “Ha,-ja”, me kuptimin “ushqim-i”, duke përfunduar me në strukturë proverbi, si: *Kur të hash pulën e tjetrit, tanden lidhepër kambësh*. Folja ka përdorim në fiziologji, ndërsa shprehjet janë të figurshme.

Fjalori vijon me trajtën vv. “hahem”, shpjeguar me shprehjen: *Nuk më hahet muhabeti me të, nuk më shkon, nuk më pëlqen* dhe kalohet menjëherë në krahasimin me gr. *ζεναγωγομαι*; fr. *se débattre*; duke marrë edhe nga A. Dozon-i e duke i sjellë në frëngjisht, si përjasje me shqipen. Mirëpo, në këta dy faqe, ndeshim edhe fjalë të rralla, si: *hafme, haliqem, hallagrap, hagjorisem, hahatem, hajde-hujdi, hajke, i hajthëm, hakatem, hakërrohem (kanosem), hakep (cfurk, Krist.) hakrri* . zool.; *halimi -a, sëmundje kur fëmija s''merr gjirin*.

Gjithashtu, ndeshim fjalë të pakuptueshme, si: *habinim-i, hajere (Ahihere - Gjirokastër), hajmis, jahthi, haku, hakshi-u, haleter, hamadak-u* etj.

Fjalët dhe njësitë frazeologjike janë shoqëruar me emrin e vendit, ku përdoren e për shumë fjalë jepen emrat e më se 50 qendrave të banuara

të të gjithë Shqipërisë, si dhe të Kosovës, të arbëreshëve të Italisë e të Greqisë¹⁵. Megjithatë vetë prof. Xhuvani vlerën e fjalëve nuk e përcakton nga krahina ku flitet ose nga gjerësia e përdorimit, po nga nevoja që ka gjuha për to, nga veçoritë e ndërtimit, nga aftësia e shprehjes e të tjera veçori të vetë fjalës. Prandaj ai këshillon¹⁶ që të shtihen në përdorim çdo fjalë e vlefshme që do të zbulohet, megjithëse ajo mund të mos flitet kudo, por në një vend të vetëm ose në disa. Me këtë bindje profesori ynë nuk e shkëput asnjëherë gjuhën e shkrimit nga gjuha e pupullit. Kjo e fundit, gjuha e gjallë, e popullit shihet si kriter themelor për të zëvendësuar fjalët e huaja me fjalë të reja e për të pasuruar gjuhën letrare.

Nëpërmjet punimit tonë vlen të theksojmë pasurinë e madhe me shembuj të shumtë ilustrues popullorë dhe në krahasim me gjuhët e tjera që mbart Fjalori i Xhuvanit, ku nëpërmjet tyre zbulohet historiku dhe veprimtaria e fjalës në përdorime të shumta në gjuhën e folur e të shkruar, në të folmet dialektore e krahinore dhe në ligjërimi të shkruara, sidomos nga shkrimet e e autorëve të vjetër, nga Letërsia e Vjetër, e Rilindjes, e Pavarësisë, nga gazetatat, nga botimet shkencore etj. Nisur nga ky mision Xhuvani shkruan: “Gjuha është gjë organike e cila...në gojë dhe në mendje të atij që flet ndryshohet, ndërrohet, përfytyrohet, shtëlliset, mirësohet, vdirret pas nevojës që ka njeriu për ditë. Gjuha është një shenjë, e gjallë e kombësisë dhe një vegël përparimi e zhvillimi kombëtar. Naltimi dhe lavrimi i saj shkon baras me zhvillimin e kulturës e kombit, pakujdesia për të, zvetërimi dhe prishja e saj është një shenjë e tatëpjetës edhe të jetës kulturore të kombit,”¹⁷ Por, sipas prof. Xhuvanit, pjesë e pandarë e fondit themelor të leksikut të shqipes janë bërë edhe shumë fjalë të huaja “që nuk i përkthejmë ose nuk i krijojmë dot nga brumi i gjuhës sonë.”¹⁸ Këtu Xhuvani ka parasysh termat shkencorë, si të kimisë, të fizikës, të matematikës, të biologjisë, të filozofisë etj., por gjithashtu po sipas gjuhëtarit tonë nuk mund të zëvendësohen edhe shumë fjalë të jetës ekonomike, politike, të arteve, të kulturës së përgjithshme si fjalët: natyrë, kulturë, plan, talent, demokraci, realitet, kritikë, sistem, program,

¹⁵ M. Çeliku, A. Xhuvani *për gjuhën e popullit dhe për dialektet e shqipes*, në “Studime për nder të Aleksandër Xhuvanit, IGjL, Tiranë, 1986, f. 134.

¹⁶ Shih: Aleksandër Xhuvani, *Për themelim të një gjuhe letrëtare*, 1905, Studime gjuhësore, 1956, f. 7. Citohet: Jani Thomait, *Aleksandër Xhuvani si leksikolog e leksikograf*, në “Studime për nder të Aleksandër Xhuvanit, IGjL, Tiranë, 1986, f. 99.

¹⁷ Aleksandër Xhuvani, *Studime gjuhësore*, 1956. (Citohet: Xhevat Lloshi, Studime filologjike, 1980/1, f. 103).

¹⁸ Aleksandër Xhuvani, *Për pastërtinë e gjuhës shqipe*, 1956, f. 4-5. Cituar nga M. Karapinjalli-Hysen Qosja, A. Xhuvani *për pastërtinë e gjuhës shqipe*, në “Studime për nder të Aleksandër Xhuvanit, IGjL, Tiranë, 1986, f. 140.

analizë etj.

Për Fjalorin e një gjuhëtari të shquar si prof. Xhuvani, për vlerat e tij filologjike, duhet e mund të shkruhet gjatë e më gjatë, duke u nisur nga vështrime të ndryshme që sigurisht mund të realizojnë punime e artikuj të tjerë. Pasuria e begatë leksikore e frazeologjike që shkon te rreth 18.500 njësi (17.000 fjalë dhe 1.500 njësi frazeologjike), puna gjurmuese në gjuhën e folur dhe të shkruar, krahasimi me fjalorët kryesorë të shqipes, shënimet për vendin ku fliten fjalët dhe të dhënat e tjera e bëjnë këtë material të pasur e me vlerë një burim mjaft të mirë për studime leksikologjike, dialektologjike e gramatikore, kontribut të rëndësishëm për fjalorin e përgjithshëm të shqipes, si dhe në dobi të drejtpërdrejtë për praktikën gjuhësore dhe për shkollën tonë në përgjithësi. Siç e thekson edhe prof. Thomai, albanologët e njohur si Jokli e Lamberci e kanë vlerësuar prof. A. Xhuvanin si njohësin më të mirë të visarit leksikor të shqipes, ndërsa prof. Domi e ka cilësuar kontributin e tij gjuhësor të karakterizuar jo vetëm nga një njohje e përpiktë dhe e gjerë e pasurisë leksikore të gjuhës shqipe, por edhe nga thellësia e analizës shkencore, nga qartësia dhe objektiviteti i studimit, nga saktësia e të dhënave dhe nga forca e përgjithësimit¹⁹. Sipas prof. Memishajt²⁰, Fjalori i Xhuvanit do të kthehet në të ardhmen në një enciklopedi të zërave, me informacion jo thjesht gjuhësor, por edhe kulturor, historik, etno-kulturor etj. E këtë vlerësim e prurje të veprës përdoruesi do ta shohë e do ta vlerësojë kur të kontaktojë me veprën e botuar, ndaj merita është vetëm e vetëm e prof. Aleksandër Xhuvanit.

¹⁹ Jani Thomai, *Aleksandër Xhuvani si leksikolog e leksikograf*, në “Studime për nder të Aleksandër Xhuvanit, IGjL, Tiranë, 1986, f. 102.

²⁰ Valter Memishaj, *Fjalori i Aleksandër Xhuvanit, një vepër madhore që i mungonte shqipes*, në Simpoziumin shkencor “Aleksandër Xhuvani në leksikografinë shqiptare”, organizuar nga ASA, dhjetor 2021.

BIBLIOGRAFI:

- ASHSH, ASA: *Aleksandër Xhuvani Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2021.
- ASHSH, IGJL: *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980.
- ASHSH, IGJL: *Studime për nder të Aleksandër Xhuvanit*, Tiranë, 1986.
- Harxhi Artan, Topalli Tefë: *Leksikon (Gjuhëtarë shqiptarë dhe albanologë)*, Shkodër, 2012.
- Jashari, Ali: *Fjalor leksiko-frazeologjik i Devollit*, Korçë, 2016.
- Lloshi, Xhevat: *Aleksandër Xhuvani, Studime gjuhësore, 1956, Studime filologjike, 1980/1*.
- Memishaj, Valter: *Fjalori i Aleksandër Xhuvanit, një vepër madhore që i mungonte shqipes*, Simpozium Shkencor “Aleksandër Xhuvani në leksikografinë shqiptare”, organizuar nga ASA, dhjetor 2021.
- Sula, Avdyl: *Fjalor fjalësh e shprehjesh popullore*, Tiranë, 2009.
- Shehu, Hajri: *Fjalor me fjalë e shprehje popullore nga e folmja e Ujemirës, Qarku i Dibrës I*, Tiranë, 2016.
- Shkurtaj, Gjovalin: *Fjalor leksiko-frazeologjik dhe etnolinguistik i Malësisë së Madhe*, Tiranë, 2022.
- Xhuvani Aleksandër: *Thërmije gjuhe*, 1944, në “Studime gjuhësore”, 1956.

The presence of the dictionary of prof. Aleksandër Xhuvanit in the dictionaries of the Albanian language and the fields of its use

ABSTRACT

The publication of the Dictionary of the Albanian Language by the Academy of Albanian Studies, with the name of one of the founders of Albanian studies in our country, convinces that the author is a linguist, active for more than half a century in various fields of our philological studies. Secondly, with this dictionary of our professor, an early lexicographical tradition is followed. Professor Xhuvani, as a thorough evaluator and critic of many bilingual dictionaries, never stopped collecting Albanian words and expressions throughout his life.

In this paper, we will focus precisely on the values of this lexicographic work and the fields of use, on the lexical and phraseological wealth with about 18,500 units (17,000 words and 1,500 phraseological

units), on the type of classification where it can be aligned for the content and lexical values that it carries, for the lexical fields it includes, i.e. how many words are known throughout Albania, how many are of daily use, which are from the field of knowledge, are there incomprehensible words, etc. For these and other values that this Dictionary carries, it is considered a very good source for lexicological, dialectological, and grammatical studies, as well as an important contribution to the general dictionary of Albanian.

Artan HAXHI
Tefë TOPALLI

TERMINOLOGJIA SI SISTEM

(Fjalor i termave të gjuhësisë)

(vijon)

Aloglot

Aloglot (nga greqishtja e lashtë ἀλλόγλωττος - *allóglottos*, i formuar nga *allo* + *glotto*, që do të thotë “i një gjuhe tjetër”) quhet një person ose popullatë që flet një gjuhë të ndryshme nga ajo e vendit apo e shtetit në të cilin ai gjendet; kryesisht bëhet fjalë për pakicat gjuhësore e shpesh ato kulturore.

Pra, *aloglot* është çdo individ që në të njëjtin territor përdor një gjuhë të ndryshme nga standardi zyrtar i një territori. Në mënyrë tipike, *aloglotë* janë emigrantët, por shpesh ekzistojnë edhe grupe *aloglotësh* autoktonë, që kanë qenë të pranishëm në një hapësirë të caktuar para imponimit të një gjuhe kombëtare, si: sardët dhe ladinët në Itali. Një grup folësish, gjuha - nënë e të cilëve është e ndryshme nga ajo zyrtare e shtetit ku janë qytetarë, quhet *minorancë gjuhësore*. Në Itali ka minorancë gjuhësore *frënge*, *ladine*, *friulane*, *katalane*, *sarde*, *sllovene*, *kroate*, *shqiptare*, *greke* etj., kurse në Shqipëri ka minorancë gjuhësore *greke*, *malaziase*, *maqedonase* dhe *rome*. E ndeshim të përdorur edhe popullsi *aloglote*, *fis (tribu) aloglot*, *ishuj aloglotë*, *zonë aloglote* etj..

Alogjen

Alogjen (nga greqishtja ἀλλογενής - *allogenís*, i formuar nga *allo* + *geno*, pra, “tjetër prejardhje, tjetër racë”) quhet një bashkësi shoqërore që banon në mënyrë të qëndrueshme në një shtet dhe që ka nënshtetësinë e tij, ndërkohë që ka prejardhje etnike ose racore të ndryshme nga ajo e shumicës së popullsisë (pakicat e huaja).

Në një shtet qytetarët me prejardhje (ndoshta edhe me gjuhë ose fe) të ndryshme nga ajo e shumicës dhe që ruajnë individualitetin e tyre kulturor, ndonjëherë edhe atë politik, thuhet se janë *alogjenë* (ose qytetarë të pakicës ose pakicë kombëtare).

Aloglosi-a

Aloglosia është situata e një bashkësie gjuhësore (e quajtur aloglote) që përdor një gjuhë të ndryshme nga ajo që flitet prej elementit demografik mazhoritar të një entiteti shtetëror ose administrativ. *Aloglosia* është një

koncept relativ që varet nga pika e referimit: për shembull, gjermanët e Tirolit Jugor janë në pozitë *aloglosie* në krahasim me popullsinë italiane në tërësi të kësaj zone, por nëse kufizohemi vetëm në krahinën autonome të Bolzanos, ku gjermanishtfolësit përbëjnë shumicë absolute, atëherë mund të themi se këtu *aloglot* është komuniteti italishtfolës.

Alograf-i

Alograf (nga greqishtja *ἄλλος* - *allós* “tjetër” dhe *γράφω* - *gráphō* “shkruaj”) është sinonim i *variant grafik*. Në të shkruar, pra, brenda sistemit grafematik të një gjuhe, termi *alograf* emërton çdo realizim të mundshëm konkret të një grafeme të caktuar që i përket sistemit në fjalë. Ai është paraqitja (ose një nga paraqitjet) konkrete e grafemës. *Alografi* është për grafemën ajo që alofoni është për fonemën. Çdo grafemë është realizuar nga një klasë *alografesh* të inventarizuara ose si variante të lira (të quajtura edhe *idiografema*), ose si variante të vëna në dispozicion nga ana e sistemit (përdorimi i të cilave i përgjigjet herë pas here nevojave shprehëse të diktuar nga situata komunikative), ose, në qoftë se prania e tyre është përcaktuar nga konteksti specifik sintagmatik, si *variante kombinatorë* që i nënshtrohen shpërndarjes plotësuese.

Çdo grafemë mund të ketë një ose disa *alografe*. Karakteristikat formale të tij varen në mënyrë të veçantë nga konteksti. Kështu, në greqisht grafema “*sigma*” (S), ka dy *alografe* që janë në shpërndarje plotësuese: njëri nga të dy (σ) është gjithmonë në fillim ose në mes të fjalëve, tjetri (ς) është gjithmonë në fund: paraqitja e veçantë e njërit apo e tjetrit variant grafik përcaktohet nga konteksti. Po kështu, L e madhe dhe l e vogël janë dy *alografe* të së njëjtës grafemë.

Alokucion

Alokucion (nga lat. *allocutio-onis*, e formuar nga *allōqui* “të flasësh me dikë”), ndyshe akt thirrjeje, është akti me të cilin një folës i drejtohet dikujt tjetër (i quajtur *alokutor*). Pra, është emërtimi i aktit të të folurit përmes të cilit futen gjurmët e folësit (dërguesit) dhe ato të dëgjuesit (marrësit).

Këto gjurmë ndryshojnë në varësi të gjuhës së përdorur, por edhe në varësi të qëllimeve komunikative të folësit. Në zgjedhjen e formulës së *alokucionit* ndikon shkalla e intimitetit (afërsisë) ose e formalitetit të ligjërit, si dhe vetë rregullat e mirësjelljes në gjuhë të ndryshme. Formulatat e *alokucionit* janë edhe formula mirësjelljeje, që shërbejnë për të treguar të gjitha ato mënyra të zgjedhura të foluri në ndërveprimin me persona ndaj të cilëve folësi synon të tregojë respektin e vet.

Një gjë e tillë realizohet kryesisht përmes përdorimit të të ashtuquajturve përemra alokutivë, së bashku me marrëdhënien e tyre kundërvënëse (respektivisht konfidenciale dhe formale).

Alokutiv

Alokutiv ose i lidhur me alokucionin. Quhen kështu ato përemra me të cilët ai që flet ose ai që shkruan i drejtohet drejtpërsëdrejti marrësit të mesazhit, duke manifestuar ndaj tij familjaritet (“ti”) ose distancë apo kortezi (“ju”).

Alokutor

Alokutor është folësi ose ai që dërgon mesazhin.

Alokutar

Alokutar është bashkëbiseduesi ose ndryshe marrësi i mesazhit.

Alomorfe- i

Alomorfe (e përbërë nga greq. *άλλος* - *allós* “tjetër” dhe - *μορφή* - *morphé* “formë”) quhen kuptimet e ndryshme të së njëjtës morfemë. Ky term i ka fillesat në traditën gjuhësore të distribucionalizmit amerikan (Bloomfield, Harris) për të treguar realizimet e ndryshme të një morfeme në kontekste të ndryshme sintagmatike.

Në gjuhën shqipe si *alomorfe* merren ato morfe që përmbushin njëherazi këto kushte :

1. kanë të njëjtin kuptim,
2. nuk mund të përdoren në vend të njëri-tjetrit tek e njëjta fjalëformë,
3. ndryshimet tingëllore ndërmjet tyre janë të kushtëzuara morfologjikisht (janë ndërrime tingujsh me vlerë morfologjike) ose fonetikut.

Kështu, morfet *djeg-*, *digj-*, *dogj-*, si morfe rrënjore, janë bartëse të të njëjtit kuptim leksikor, ato nuk mund të përdoren në vend të njëri-tjetrit (nuk mund të thuhet : unë *digj*, as unë *digja*, as unë *dogjem*, por vetëm unë *djeg*, unë *dogja*, unë *digjem*) dhe përdorimi i tyre është i kushtëzuar morfologjikisht: në të tashmen veprare (me përjashtim të vetës së dytë shumës) *djeg-*, në të kryerën e thjeshtë *dogj-*, në vetën e dytë shumës të kohës së tashme, në të pakryerën dhe në format e kohës së tashme dhe të së pakryerës të pësorës *digj-*. Po kështu mbaresat *-i/-u* të gjinorës, dhanorës e rrjedhore njëjës të pashquar të emrave të lakimit të parë e të dytë do të merren si dy shfaqje të ndryshme të së njëjtës morfemë.¹

Alomorfi- a

Alomorfi është një funksion morfologjik, ku e njëjta morfemë shfaqet në mënyra të ndryshme.

¹ Gramatika e gjuhës shqipe, I, Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe I Letërsisë, Tiranë, 1995, fq. 45.

Alosemë

Alosemë (nga greq. *άλλος* (*allós*) - “tjetër” + *σίμα* (*síma*) - “semë”) është një semë e aftë për realizime të ndryshme në përputhje me mjedisin semantik në të cilin ndodhet. Pra, është njëra nga dy ose më shumë sema alternative. Për shembull, në përdorimet *këmbë e shtrembër* dhe *këmbë karrigeje*, mund të identifikojmë një semë (*këmbe* - pjesa e poshtme, skaji i poshtëm), por kjo semë mund realizohet në formën e *alosemës* (skaji i poshtëm i një frymori), në rastin e parë dhe (skaji i poshtëm i një jofrymori), në të dytin.

Ky ndryshim ka të bëjë me dallimin tradicional midis kuptimit themelor dhe kuptimit figurativ (në shembullin e cituar, *këmbë* do të kishte për kuptim bazë “gjymtyrë e trupit të njeriut” dhe në mënyrë figurative “mbështetja e një mobiljeje”).

Aloton

Alotoni (nga greqishtja *άλλος* (*allós*) - “tjetër” + *τόνος* (*tónos*) - “ton”) është një variant jo i rëndësishëm i një toni ose toneme, i kushtëzuar nga konteksti fonetik. Ndryshe, çdo ton i mundshëm i një toneme. Në një gjuhë tonale *alotoni* është një nga variantet me të cilat paraqitet një fonemë. Kështu, në greqisht një fjalë që ka një theks të mprehtë (´) në rrokjen e fundit, kur ndiqet nga një fjalë tjetër, merr theks të rëndë (`).

Alotrop

Alotropi (nga greqishtja *άλλος* *allos*, “tjetër” + *ηποπορ* (*tropos*), “mënyrë”) është një variant formal sinkronik i një fjale ose i një morfeme tjetër (p.sh. në shqip, *protokalle-ja* dhe *portokall-i*), që përdoret ndonjëherë edhe me nuanca të ndryshme stilistike. Janë *alotrope* fjalë të një gjuhe që, pavarësisht se kanë të njëjtën prejardhje, paraqiten të diferencuara formalisht (shpesh edhe semantikisht) duke qenë të evoluara në mënyra të ndryshme. Ato mund të jenë rezultat i transformimeve fonetike ose morfologjike, apo edhe huazim nga një gjuhë e huaj (p.sh., fjala *restaurant*, e përshtatur nga frëngjishtja *restaurant*).

Alterim

Alterim (nga latinishtja *alteratio* “ndryshoj”) është një term që mund të tregojë lloje të ndryshme të ndryshimit. *Alterimi* është një proces morfologjik prejardhjeje, i cili realizon modifikime formale mbi rrënjën (temën fjalëformuese) me shtimin e një ose më shumë ndajshitesave, që saktësojnë apo përcaktojnë anën semantike konotative të fjalëve. Pra, me *alterim*, në gramatikë, nënkuptohet formimi i fjalëve të reja duke mos i ndryshuar tiparet e tyre themelore; ajo që ndryshon është mënyra në të cilën është konsideruar koncepti.

Në gjuhën shqipe i përkasin kategorisë së *alterimit* format e prejardhura të foljeve intensive, përsëritëse (*ripunoj, rifreskoj, rihyj, rifyrtoj*), që forcojnë semantikën e rrënjës (temës fjalëformuese). Po kështu, janë edhe disa prapashtesa të cilat konsiderohen *alterative*, të cilat përmbajnë gjithmonë një nuancë emocionale, vlera e brendshme e së cilës mund të modifikohet nga konteksti i përdorimit. Pra, *alterimi* është përcaktuar nga qëndrimi i atij që flet. Ai ka të bëjë me gjykimin emocional të folësit (përkëdhelës, përçmues) apo me madhësinë e diçkaje (zvogëluese, zmadhuese). Kështu, prapashtesat *-zë, -th* prodhojnë një *alterat* me vlerë zvogëluese. Me alterimin kategoria leksikore e temës fjalëformuese mbetet gjithmonë e pandryshuar

Alternancë

Alternancë quhet zëvendësimi i një foneme me një fonemë tjetër ose me një grup fonemash brenda së njëjtës morfeme në kushte morfologjike të përcaktuara. Secila prej fonemave pjesëmarrëse në këtë proces quhet *alternante*. Dallojmë *alternancë të zanoreve* (vokalike ose apofoni), e cila ndikon në vokalizmin e elementeve përbërëse gjatë fleksionit (shqip *marr / merr, bredh / brodha* etj.) dhe *alternancë të bashkëtingëlloreve*, të përfaqësuar nga ndryshimi i bashkëtingëlloreve. P.sh. në gjuhën shqipe rotacizmi, palatalizimi etj.. Ndryshimet që janë shfaqur në të kaluarën dhe sot kanë pushuar së vepruari quhen *alternanca historike* (*dashī ~desh*).

Dallojmë gjithashtu edhe *alternancën e kodit* (ose ndërrimi i kodit/code-switching), që është strategji komunikimi me anë të së cilës një individ ose një komunitet përdor në të njëjtën ngjarje komunikative dy varietete gjuhësore qartësisht të dallueshme ose dy gjuhë të ndryshme, ndërkohë që bashkëbiseduesi ose ka kompetencë të mirë gjuhësore në të dy varietetet/gjuhët (*alternanca e kompetencës*), ose nuk ka (*alternanca e inkompetencës*).

Shenja grafike me të cilën shënohet alternanca është (~).

Alternues

Në fazën e parë të gramatikës gjenerative disa rregulla të rishkrimit duhej të ishin të ndara për të mundësuar riprodhimin e dy lloj renditjeve të simboleve (ose të simboleve unike) në të djathtë të shigjetës. Këto rregulla janë quajtur **alternuese**. Mund të marrim si shembull rishkrimin e SV :

RS x (a) : SV → V_i

(Lexo : Rregulli sintagmatik x (a) : SV është për t'u rishkruar në V_i (folje jokallimtare).

RS x (b) : SV → V_t + SN

(Lexo : Rregulli sintagmatik X (b) : SV është për t'u rishkruar një V_t (folje kallimtare) e ndjekur nga një sintagmë emërore.

Alteruar (i, e)

Emrat quhen të ***alteruar*** kur, me shtimin e prapashtesave të caktuara, ata ruajnë të njëjtin kuptim bazë dhe të njëjtën kategori gramatikore, por marrin një ngjyrim (konotacion) të veçantë, që mund të jetë : zvogëlues e përkëdhelë (-th, -zë, -ush, -alec, uke etj. *zë-th, fole-zë, lepur-ush, guralec, vajzuke*), keqësues, nënçmues, pezhorativ (-ac, -acak, -acuk, -alaq, -aluq etj. : *dorac, burracak, verdhacuk, ngordhalaq, shtrembaluq*).

Alveolare

Alveolare (nga latinishtja *alvēus* “zgavër, enë”) është term që lidhet me klasifikimin dhe përshkrimin e bashkëtingëlloreve brenda një gjuhe. Sipas vendit të formimit bashkëtingëlloret e shqipes janë *alveolare* kur artikulojnë në nivelin e alveolave, thënë ndryshe kur janë prodhuar me pengimin e plotë ose të pjesshëm të kanalit vokalik të ndodhur në alveolat e dhëmbëve të sipërm. Në shqip bashkëtingëllore alveolare janë *c, x, s, z, n, l, r, rr*.

Alveodhëmbore

Alveodhëmbore janë ato bashkëtingëllore të cilat realizohen nga kalimi i ajrit në pengesën e krijuar nga pjesa e përparme e gjuhës me hapësirën në mes dhëmbëve dhe mishit të dhëmbëve, pra, realizohen nga prekja apo afrimi i gjuhës me alveolat dhe dhëmbët. Në gjuhën shqipe dallohen tri bashkëtingëllore *alveodhëmbore* : *t, d, ll, n*.

Alveolë-a

Alveolë është term që shënon pjesën të brendshme të gojës prej dhëmbëve të sipërm deri te qiellëza, që shërben si organ pasiv për nyjëtimin e disa bashkëtingëlloreve paragjuhore, të quajtura alveolare. Ndryshe është pjesa e rrudhave në pjesën e sipërme të gojës, prapa dhëmbëve të përparmë. Në gjuhën popullore quhet mishi i dhëmbëve².

Amalgamë

Amalgamë (deformim arab '*amal ab ġam*'^a, nga greqishtja *μάλagma* - “*málagma*” - përzierje, shkrirje) quhet shkrirja e dy morfemave që i korrespondojnë morfemave të ndryshme, duke nënkuptuar një reduktim fonetik (*ma* = *më* + *e*, *ta* = *të* + *e*, *ia* = *i* + *e*, *kal-i*, *pun-a* etj.). *Amalgama* është shkrirja e dy ose më shumë morfemave në mënyrë kaq të pandashme, sa nëse në aspektin e përmbajtjes gjejmë domethënie të ndryshme të secilit element përbërës, në atë të formës kemi vetëm një element, i cili vjen si

² Bardh Rugova, *Leksikon i termave të fonetikës dhe fonologjisë*, Prishtinë, 2019, fq. 23.

rezultat e shkrirjes së dy elementeve përbërës. *Amalgama* është shumë e shpeshtë në latinisht, si në të gjitha gjuhët flektive, por praktikisht mungon në gjuhët aglutinative.

***Amalgamues* (shih *aglutinues, gjuhë*)**

Amalgamuese quhet një gjuhë e cila shpreh marrëdhënie gramatikore dhe sintaksore më shumë përmes përdorimit të ndajshesave se sa të parafjalëve.

Ambiguitet

Ambiguiteti (nga latinishtja *ambiguïtas-atis* “dykuptimësi”) është karakteristikë e një shprehjeje, e cila mund të ketë më shumë se një interpretim. Dallojmë dy lloje *ambiguiteti* (dykuptimësie): *ambiguitet leksikor*, që është më tipiku dhe më i denduri në gjuhë, dhe *ambiguiteti sintaksor* ose strukturor.

Në rastin e parë dykuptimësia lind prej fjalëve të veçanta nisur nga fakti se kanë më tepër se një kuptim, për shembull, në fjalinë *Martini ka goditur me grushta kokën*, nuk merret vesh nëse ka goditur kokën e vet, apo atë të shefit të tij, apo kokën drejtuese të njësisë ku punon Martini.

Në rastin e parë dykuptimësia lind prej fjalëve të veçanta, nisur nga fakti se ato mund kenë më tepër se një kuptim. Për shembull, në fjalinë *Martini ka goditur me grushta kokën*, mund të merret me kuptimin Martini ka goditur me grushta kokën e vet, por mund të merret edhe në kuptimin që ka goditur kokën e shefit të tij apo ka goditur kokën drejtuese të njësisë ku punon Martini.

Përkundrazi, *ambiguiteti* në sintaksë, krijohet vetëm nga faktorë strukturorë, në mungesë të fjalëve dykuptimëshe, bie fjala. Në sintagmën *libra dhe fletore të vjetra*, mbiemri të vjetra mund t’i referohet si emrit *libra*, ashtu edhe *fletore* (krahason: *fletore të vjetra dhe libra*).

Më gjerë, *ambiguiteti*, në sintaksë shtrihet në nivelin e fjalisë, për shembull, njësia kallëzuese: *Kam përshëndetur djalin me lule në dorë*; është ambigue, sepse (pa një kontekst të caktuar, apo pa bërë ende analizën në përbërës sintaksorë) nuk merret vesh nëse lulet në dorë i ka ai që përshëndet një djalë apo djali që përshëndetet prej dikujt.

Një tip tjetër *ambiguiteti* ndeshet edhe tek homonimet, që shkruhen në të njëjtën mënyrë, bie fjala, përemri vetor *ju* - veta II, shumës, përdoret njëkohësisht edhe për vetën e II, njëjës si formë e kortezisë për një person me status më të lartë, të cilin duam ta respektojmë gjatë bisedës sonë. *Ju, zotëri, a mendoni se keni vepruar drejt, duke mbajtur këtë qëndrim.*

Shmangia e dykuptimësisë, duke zgjedhur një nga interpretimet e mundshme, quhet disambiguitet (jodykuptimësi).

(vijon)

BIBLIOGRAFI

- Auger, P. (1988), *La terminologie au Québec et dans le monde, de la naissance à la maturité*. In: *Actes du sixième colloque OLF-STQ de terminologie. L'ère nouvelle de la terminologie*. Gouvernement du Québec: Québec.
- Bache, Carl (1985), *Verbal Aspect: A General Theory and Its Application to Present-Day English*, Odense: Odense University Press, fq. 10.
- Beccaria, G. L. (2004), *Dizionario di linguistica e di filologia, metrica, retorica*, Piccola Biblioteca Einaudi.
- Belluscio, G. & Rrokaj, Sh. (2011), *Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë*, Arbëria, Tiranë.
- Cabré, M. T. (1999) *Terminology: theory, methods and applications*. John Benjamins: Amsterdam / Philadelphia.
- Dubois, J. & Giacomo, M. & Guespin, L. & Marcellesi, Ch. & Marcellesi, J. & Mevel, J. (2001), *Dictionnaire de linguistique*, Larousse, ISBN : 2-03-532047-X.
- Dubuc, R. (1992), *Manuel Pratique de terminologie*. Linguatex: Brossard.
- Dushi, Orjeta, Fjalorth terminologjik e konceptual shpjegues i sintaksës gjenerative, Shkodër, 2011.
- Herbert, Louis (2006), *The Actantial Model*, in Louis Hébert (dir.), Signo [online], Rimouski (Quebec), <http://www.signosemio.com>
- Leka, Ferdinand (2013), *Fjalori i termave të letërsisë*, INFBOTUES, Tiranë, ISBN 978-9928-173-11-9.
- Mita, Josif, *Hyrje në gjuhësinë gjenerative*, Shpresa, Prishtinë, 2005.
- Rugova, Bardh, *Leksikon i termave të fonetikës dhe fonologjisë*, Prishtinë, 2019.
- Vendler, Zeno (1967), Dubuc, R. (1992), *Manuel Pratique de terminologie*, Linguatex: Brossard.
- Vendler, Zeno (1967), *Verbs and times*, in *Linguistics in Philosophy*, Ithaca (New York)
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë (2002), *Gramatika e gjuhës shqipe*, I, Tiranë.

TERMINOLOGY AS A SYSTEM
(Dictionary of linguistic terms)

ABSTRACT

This article comes as a continuation of the articles with the same title which was published in the previous publications. In it, 23 language terms have been explained, which we come across in the field of literature, both in contemporary and traditional one. In our explanations, we have tried to preserve the particular characteristics that often reflect the original value they have, according to different linguistic theories or which might be revised by the Science of Albanian Language to different concepts.

Valbona SINANAJ

MBI NDARJEN NË RROKJE TË FJALËS. RASTI I DIFTONGUT

1. Në shqipe, ashtu si dhe në gjuhë të tjera, ndodh që në kushte të caktuara disa zanore e humbin aftësinë rrokjeformuese. Bashkime të tilla zanoresh formojnë diftongje. Diftongjet mund t'i studiojmë nga pikëpamja fonetike dhe fonologjike. Në lidhje me diftongjet na mungojnë studimet jo vetëm në rrafshin fonetik, por edhe në rrafshin fonologjik.

Ndihmesat e para në studimin historik të tyre u takojnë G. Majerit, H. Pedersenit dhe N. Joklit. Ndër studiuesit shqiptarë janë marrë veçanërisht me diftongjet e shqipes K. Cipo, E. Çabej, Sh. Demiraj, J. Kastrati, K. Topalli, A. Dodi, R. Memushaj, A. Jubani etj.

I. D. Sheperi në "Gramatika dhe sintaksa e gjuhës shqipe" e përkufizon diftongun me termin dyzanor: "dy zërore me radhë në rrënjë të një fjale përbëjnë dyzanor ose diftong"¹ dhe njeh tri diftongje *ua*, *ie* dhe *ye*.

K. Cipoja në tekstin "Gramatika e gjuhës shqipe" pranon se "zanoret *i* dhe *u*, kur nuk kanë theks, shkrihen në shqiptim e sipër, me zanoren paraardhëse dhe formojnë me të një tingull të vetëm që quhet diftong. Pa praninë e këtyre dy zanoreve atone, nuk kemi diftong, sepse vetëm këto dy zanore, nga tërë shoqet e tyre, kur janë jashtë theksit, kryejnë funksionin e gjysmëzanores"².

J. Kastrati në artikullin "Diftongu në gjuhën shqipe"³ shtron problemet se a janë diftongje grupet *ua*, *ue*, *ye*, *ie*, si formohen këto diftongje dhe cilat janë diftongjet me karakter idiomatik? Ai pranon se diftongu në gjuhën shqipe ekziston dhe jep dhe termat diftong dishendentë (zbritës) e ashendentë (ngjitës). "Quhen dishendentë ato diftongje që kanë një zanore të ndjekur nga një gjysmëzanore. Këto janë diftongje të vërtetë. Thirren diftongje ashendentë kur gjysmëzanorja paraprin zanoren"⁴.

¹ Sheperi, I. D. *Gramatika dhe sintaksa e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2001, f. 27.

² Cipo, K. *Gramatikë e gjuhës shqipe*, Departamenti i Gjuhësisë, Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti "A. Xhuvani", Elbasan. Tiranë, 2015, f. 32.

³ Kastrati, J. "Diftongu në gjuhën shqipe", në Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Nr. 2, Tiranë, 1954, f. 70.

⁴ Po aty, f. 71.

E. Çabej në kapitullin “Fonetika Historike”⁵ pranon se “kemi në shqipe diftongje me *i* dhe diftongje me *u* gjysmëvokalike, duke u mbështetur në parimin që diftongu përbëhet prej dy elementesh vokalike që formojnë një silabë të vetme dhe që për pasojë njëri nga këto do të jetë *i* ose një *u* gjysmëvokalike.

Studimet e sipërpërmendura tregojnë përpjekjet e studiuesve për të përkufizuar, analizuar dhe klasifikuar diftongjet. Sheperi përdor termin “dyzanorë” dhe njih tri të tilla. Cipo mohon formimin e diftongut pa ndërhyrjen e zanores atone. Kastrati i njih shqipes katër diftongje. Çabej shton numrin e diftongjeve, duke pohuar se gegërishtja ka prirje për reduktimin e tyre në monoftongje.

Si njësi fonetike të përbëra nga dy elemente, diftongjet vështrohen edhe nga pikëpamja fonologjike. Nga pikëpamja e funksionit, diftongjet e shqipes janë dyfonemëshe. Dy zanoret që formojnë diftongun shërbejnë për ta lehtësuar nga ana e ekonomisë gjuhësore artikulimin, sepse diftongu realizohet më natyrshëm se togu zanor. Treguesi akustik i zanoreve që përbëjnë diftongun është kohëzgjatja e shqiptimit me intensitet të ulët.

Interpretimi fonologjik i tingujve të përbërë ka të bëjë me sqarimin e çështjes: a kanë tinguj të tillë vlerën e një foneme të vetme apo paraqiten si bashkim i dy fonemave të pavarura.

Pyetjes se a ka shqipja standarde diftongje njëfonemëshe, mund t’i përgjigjemi duke u mbështetur në kriteret e përcaktuara nga N. Trubeckoi.

1. Kushti i parë për të pasur diftong është pandashmëria e elementeve përbërëse në dy rrokje, p.sh. dy zanoret në *ku-aj*, *shpi-e* etj. ndahen sepse formojnë togje zanorësh; kurse në *kuo-të*, *shpie-re* kufiri rrokjesor kalon pas dy zanoreve, jo midis tyre. Por ky kusht nuk është i vetëmjaftueshëm për të karakterizuar një diftong si fonologjik.

2. Duhet edhe që dy elementet e diftongut të shqiptohen me rrëshqitje dhe që gjatësia e diftongut të mos e kalojë gjatësinë e fonemave të tjera të gjuhës.

3. Nga pikëpamja fonologjike, duhet që diftongu të funksionojë njëlloj si fonemat e thjeshta, duke hyrë në kundërvënien mungesore me to sipas çiftesh minimale.

4. Nga pikëpamja morfologjike duhet që të dy përbërësit e diftongut të ndodhen në kufijtë një morfeme, d.m.th. që elementet e tij të mos ndahen nga kufij morfologjikë.

⁵ Çabej, E. *Studime Gjuhësore III*, Prishtinë, 1976, f. 122.

“Po t’i shohim nga kjo pikëpamje – thotë Memushaj – diftongjet e shqipes, veç kushtit të parë, të tjerat nuk i plotësojnë. Ato kanë gjatësi më të madhe se fonemat zanore të thjeshta, mes zanoreve të diftongut kalon kufiri morfologjik: *ka-u*, *baba-i*, *i-a dha* dhe nuk dalin në çifte minimale me zanoret e thjeshta. Pra, diftongjet e shqipes janë fonetike”⁶.

Me diftongjet e shqipes është marrë dhe A. Dodi, në tekstin “Fonetika dhe fonologjia e shqipes standarde”⁷ dhe “Diftongjet e shqipes nga pikëpamja fonetike dhe fonologjike”⁸, ku paraqet një inventar të diftongjeve të dialekteve dhe nëndialekteve të shqipes. Dodi pohon se: *Fonetikisht diftongjet e shqipes paraqiten me ndryshime sipas dialekteve dhe të folmeve, dhe problemi i vlerës fonologjike të tyre duhet të zgjidhet veçmas për të gjitha rastet ku vërehen këto ndryshime, e pastaj të shihet se cilat forma janë ngritur ose janë në rrugën e ngritjes në normë në gjuhë letrare*⁹.

A. Jubani¹⁰ është e para fonetikane shqiptare, e cila sjell treguesit akustikë të realizimit të diftongjeve, si: kohëzgjatja, frekuenca themelore, timbri dhe intensiteti. Ajo e përkufizon *j*-në si një tingull aproksimant¹¹, në rolin e një glajdi¹² të një diftongu. Ajo pohon se parametra të rëndësishëm për dallimin e elementit glajd dhe zanores në diftong janë padyshim kohëzgjatja dhe intensiteti.

Diftongje fonologjike që funksionojnë si fonema të thjeshta janë *ié*, *yé*, *uá*, të cilat i gjejmë në ato krahina të toskërishtes, ku shqiptohen gjithnjë, në të gjitha pozicionet e në çdo fjalë që hasen, me theks në elementin e dytë. Këto bashkime zanoresh fonetikisht sot paraqiten si diftongje e historikisht vijnë, si rregull, nga segmentimi i zanoreve të thjeshta¹³.

⁶ Memushaj, R. “Diftongjet e shqipes standarde”, në *Studime gjuhësore* (përmbledhje artikujsh), ASA, IGJL, Tiranë, 2017, f. 139.

⁷ Dodi, A. *Fonetika e shqipes standarde*, ASHSH, IGJL, Tiranë, 2004, f. 70-72.

⁸ Dodi, A. “Diftongjet e shqipes së sotme nga pikëpamja fonetike dhe fonologjike”, Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike, 15-21 nëntor 1962, Tiranë, 1965, f. 195.

⁹ Dodi, A. Vep. cit. f. 202.

¹⁰ Jubani-Bengu, A. *Fonetikë akustike-Analizë e sistemit fonologjik*, Tiranë, 2012, f. 60.

¹¹ Termi i përdorur në anglisht është *approximant*, kurse në shqip për një pjesë të këtyre bashkëtingëlloreve kemi termin *mesore*, pasi siç shpjegon Dodi për nyjëtimin e tyre rryma e ajrit kalon përmes shtegut të rrafshët që formon gjuha me qiellzën e fortë, prandaj *j*-ja quhet bashkëtingëllore mesore. Dodi, A. *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, f. 92.

¹² Termi i përdorur në anglisht është *glide*. Glajdet janë një kategori tingujsh të ndërmjetëm mes zanoreve dhe bashkëtingëlloreve. Kanë tiparet [-vokal, -konsonant], d.m.th. tinguj që nuk mund të formojnë rrokje, po që nuk janë as bashkëtingëllore.

¹³ Po aty.

- A. V. Desnickaja, lidhur me grupet e zanoreve *ua/ue, ue, ie*, ka shkruar se për dialektin toskë *ua* është përhapur kudo dhe dallimet lokale krijohen vetëm në theksin e lëvizshëm *ùa/uà*. Sipas saj, diftongjet e toskërishtes së përgjithshme, *ua, ue, ie*, paraqesin në vete të ashtuquajturat diftongje të vërteta. Diftongu “i vërtetë” shkruan ajo, paraqitet me dy zanore, sepse të dy komponentët gjatë ruajtjes së rrokjes mbeten nga pikëpamja fonetike të barabartë. Në këto diftongje, theksin mund ta mbajë një herë njëri e një herë tjetri element. Në qoftë se nuk ndahen morfologjikisht, diftongjet e vërteta mund të merren si njësi të pandara fonematike¹⁴.
2. Ndarja fonetike e fjalëve në rrokje mbetet një çështje e ndërlikuar në fushën e fonetikës së shqipes. Kur flasim për ndarje të fjalëve në rrokje, duhet të bëjmë dallimin mes ndarjes së fjalëve në fund të rreshtit dhe ndarjes fonetike. Ndarja fonetike e fjalëve në rrokje është e kushtëzuar nga veçoritë e sistemit fonologjik të gjuhës, kurse ndarja e fjalëve në fund të rreshtit është ndarje drejtshkrimore, pra nuk buron nga sistemi.

Gjithmonë ka pasur shumë diskutime mbi temën se çfarë është rrokja, ku krijohet segmentimi në rrokje dhe çfarë është rrokja si njësi fizike. Përgjithësisht, rrokja përkufizohet si njësi më e vogël e pavarur e shqiptimit, ajo është segment minimal i nyjetimit dhe i perceptimit, është konteksti minimal i nevojshëm për realizimin e fonemave. Rrokja është element i rëndësishëm i ritmit gjuhësor, të kuptuar si përsëritshmëri e segmenteve të të folurit. Nga pikëpamja e mënyrës se si përftohet ritmi, gjuhët ndahen në “stress-timed” dhe në “syllabe-timed”. Në të parat, ritmi përftohet nga kombinimi i rrokjeve të theksuara; në të dytat, ritmi krijohet nga të gjitha rrokjet; kjo do të thotë se, izokronia është në varësi të gjuhës. Ritmi i karakterizon të gjitha lëvizjet automatike, si frymëmarrjen, rrahjet e zemrës etj. Sot, falë përparimit të madh në hulumtimin e trurit, shumë nga idetë e ritmit mund të vendosen në një kontekst të ri. Njohuritë e reja lejojnë të supozohet se ritmi gjuhësor është i kushtëzuar neurobiologjikisht. Sipas B. Zellner Keller (2002), struktura kohore e gjuhëve parashikohet më mirë në bazë të të dhënave nga psikolinguistika sesa fonologjia. Sipas saj, “ritmi i gjuhës përcaktohet nga koha e operacioneve mendore. Ritmi i fjalës është rezultat i shumë faktorëve, duke përfshirë proceset neurobiologjike, neurofiziologjike dhe konjitive – mënyra e ndarjes së rrjedhës së ligjërimit

¹⁴ Desnickaja, A. *Gjuha shqipe dhe dialektet e saj*, Prishtinë, 1972, f. 37.

pasqyron proceset mendore që lidhen me prodhimin, kodimin, deshifrimin, kontrollin e prodhimit”¹⁵.

Fonetikani i parë që i kushtoi rëndësi të veçantë rrokjes në historinë e gjuhësisë ka qenë M. Thausing-u (1863), i cili ka ndërtuar themelet e teorisë akustike të rrokjes, në të cilin vendin kryesor e luan dëgjueshmëria (audibility). Këtë teori e ka zhvilluar më tej E. Sievers-i (1893), duke konstatuar faktin e relativizmit të funksionit silabik, që varet nga struktura e gjuhës dhe e tingujve në çdo rast të veçantë. Në vitet në vijim gjuhëtarët e tjerë e kanë studiuar rrokjen në lidhje me cilësitë nyjëtimore ose akustike¹⁶.

Sipas koncepteve moderne, rrokja është strukturë e organizuar në mënyrë binare: ajo përbëhet nga pjesa nistore, ekspiratore (onset) dhe rima (rhyme). Rima përbëhet nga bërthama (nucleus) dhe bishti (coda), i cili në rrokjet e hapura mungon. Lidhja midis bërthamës dhe bishtit është më e fortë sesa lidhja midis fillimit dhe rimës¹⁷.

Në bazë të gabimit si p.sh. [ɟupork] në vend të [ɟujork] (*New York*), Crompton përcakton vendin e rrokjes në hierarkinë e strukturës së gjuhës, duke arritur në përfundimin se rrokja është njësi e të ashtuquajturit program nyjëtimor (njësi të tilla nuk janë as fjalët, as fonemat, as pjesët e rrokjes). Rrokja i lidh dy shtresat e strukturës së gjuhës: rrokja është njësi e nivelit fonologjik dhe, njëkohësisht, njësi e nivelit nyjëtimor, d.m.th. është pjesë e grupit të sjelljeve të caktuara nyjëtimore të rutinës¹⁸.

3. Për ndarjen në rrokje të fjalës në shqipe (rasti i diftongut), do të mbështetemi në teorinë e sonoritetit të rrokjes. Ky qëndrim bazohet në faktin se kryesisht shpërndarja e tingujve në shqipe mbështetet në parimin e sonoritetit relativ.

Teoria e sonoritetit¹⁹, e cila mbështetet në kritere akustike, e zgjidh më mirë problemin e kufijve të rrokjes. Sipas shkallës së sonoritetit, më sonore janë zanoret (dhe midis atyre më sonore janë tingujt më të hapur

¹⁵ Keller, Z. B. “Revisiting the Status of Speech Rhythm”, *Proceedings of Speech Prosody Conference*, 2002, Eds. B. Bel and I. Marlien, Aix-en-Provence. April 11-13, 2002, f. 729.

¹⁶ Sawicka, I., Dargiel, K. *Struktura e rrokjes shqipe*, Prishtinë, 2018, f. 7.

¹⁷ Shih, Fudge, E. C. *Syllables*, *Journal of Linguistics* 5, 1969, f. 253-286; Crompton, A. *Syllables and Segments in Speech Production*, *Linguistics*, vol. 19, nr. 7/8, 1981, f. 663-716.

¹⁸ Sawicka, I., Dargiel, K., vep. cit. f. 13.

¹⁹ Sipas kësaj teorie, rrokja përfaqëson bashkimin e një elementi më tingëllues, me një element më pak tingëllues. Vetë fjala *sonority* përkthehet si zëshmi. Sonoriteti u përgjigjet termave: lartësia e zërit, fuqia, të cilat gjithashtu kanë karakter relativ.

p.sh. [a]), pastaj janë glajdet²⁰ e larta [w], [j], pastaj në radhë sipas shkallës së sonoritetit janë sonantet e lëngëta (anësore dhe dridhëse), e më pak sonoret nga sonantet janë hundoret.

Për të ndarë në rrokje fjalët që përmbajnë diftongje, si: *kuótë*, *kuádër*, *skuádër*, *babái* dhe *diabét*, (të cilat i kemi përdorur dhe për korpusin tonë), nuk mund të mbështetemi në ndarjen drejtshkrimore, e cila, si ndarje marrëveshjesore pranon dy mundësi ndarjeje edhe *ku-otë*, edhe *kuo-të*; edhe *ku-adër*, edhe *kua-dër*; edhe *skua-dër* edhe *sku-adër*²¹.

Rregullat e ndarjes së fjalëve në fund të rreshtit kanë të bëjnë me paraqitjen grafike të fjalës. Në ndarjen e fjalëve në rrokje drejtshkrimi merr parasysh dhe strukturën morfologjike të fjalës, prandaj ndarja drejtshkrimore nuk mund të barazohet as me ndarjen fonetike të fjalëve në rrokje, as me ndarjen morfologjike të fjalës në morfema.

Drejtshkrimi është një sistem rregullash që përcaktojnë: a) shkrimin e fjalëve dhe të morfemave të tyre: b) shkrimin e fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes: c) përdorimin e shkronjave të mëdha: d) ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit. Ndërsa, kur flasim për parimin fonetik në drejtshkrim, kur shkrimi pasqyron normat e shqiptimit letrar.

Midis shqiptimit letrar dhe drejtshkrimit fonetik ka një lidhje të ndërsjellë. Zakonisht shqiptimi letrar i prin drejtshkrimit fonetik, por edhe ky i fundit në disa hallka ndihmon për përhapjen dhe njësimin e normave të shqiptimit, në ato raste kur këtu ka lëkundje²².

Duke qenë se *u*-ja te grupet *uo* dhe *ua* dhe, *i*-ja te grupi *ia* del e patheksuar, ato nuk mund të bëjnë pjesë në shkallën e parë të sonoritetit, që do të thotë se nuk përbëjnë bërthamën e rrokjes, prandaj e vetmja mënyrë është që diftongu në këto fjalë të përfshihet në një rrokje: *kuo-të*, *kua-dër*, *skua-dër*, *ba-bai*, *dia-bet*.

Së bashku me disa studente të masterit profesional në Mësuesi, jemi përpjekur të realizojmë një hulumtim me 260 nxënës të moshës 11-16 vjeç, në 11 shkolla (nëntëvjeçare dhe të mesme) kryesisht: 5 shkolla në Tiranë²³; 2 në Durrës²⁴; 1 në Kavajë²⁵; 1 në Divjakë²⁶; 1 në Ballsh²⁷; 1 në Has²⁸; 1 në

²⁰ Ang. *glides* – zanoret josilabike, ekuivalente josilabike të zanoreve më pak sonore.

²¹ *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1973, f. 163, 98/c.

²² Dodi, A., *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, ASHSH, IGjL, Tiranë, 2004, f. 240.

²³ Shkolla “A. Rustemi”, Tiranë, klasa e gjashtë dhe e shtatë, shkolla “F. Noli”, klasa e tetë dhe e nëntë; shkolla “M. Keta”, klasa e dhjetë, shkolla “L. Poradeci”, klasa e nëntë.

²⁴ Shkolla “Rilindja”, Durrës, klasa e dhjetë; shkolla “Sh. Mazreku”, tre klasa të shtata.





²⁵ Shkolla “M. Babamusta”, Kavajë, klasa e shtatë.

²⁶ Shkolla “K. Sako”, Divjakë, klasa e tetë.

Shupenzë të Bulqizës²⁹. U është kërkuar nxënësve të ndajnë në rrokje në një fletë A4 këto fjalë: *kuotë*, *kuadër*, *skua-dër*, *diabet* dhe *babai*. Duke pasur parasysh gramatikat tradicionale kujtojmë, se sa i takon diftongut dallojmë: 1. diftong ngjitës, kur elementi i reduktuar ndodhet në vendin e parë dhe realizohet gjysmëzanorja; 2. Diftong zbritës, kur elementi i reduktuar ndodhet në vendin e dytë dhe realizohet gjysmëzanorja.

Korpusi që kemi ndërtuar përfshin fjalët *kuotë*, *skua-dër*, *babai* dhe *diabet*, të cilat përmbajnë diftongjet: *uo*, *ua*, *ia* (ngjitëse) dhe *ai* (zbritëse).


Në grafikët e mëposhtëm paraqitet në % puna e nxënësve për ndarjen në rrokje të diftongjeve.



²⁷ Shkolla "D. Hekali", Ballsh, klasa e njëmbëdhjetë.

²⁸ Shkolla "Golaj", klasa e shtatë.

²⁹ Shkolla "I. Daçi, Shupenzë, klasa e shtatë dhe e nëntë.



PËRFUNDIME

Studimi ka synuar përshkrimin në vija të përgjithshme të hulumtimit, kushtëzimet e të cilit i përmendëm që në fillim. Thamë që rrokja është njësia më e vogël e pavarur e të folurit dhe kjo është njësi universale. Ka gjuhë në të cilat rrokja nuk ka përfaqësim të përcaktuar fonologjik, por ka edhe gjuhë në të cilat fonologjikisht rëndësor është vendi i kufirit midis rrokjes (kufijtë e rrokjeve përputhen pa përjashtim me kufijtë e morfemave p.sh. në shqipe *unik* (*u-nik*) dhe *unë iki* (*un-i-ki*). Të dyja teoritë, ekspiratore dhe sonorike janë të vërteta. Për të prodhuar rrokjen duhet forcimi i papritur i rrymës së ajrit (teoria ekspiratore), ndërsa teoria e sonoritetit bazohet në qendrën e rrokjes.

Pra, siç rezulton nga shembujt e analizuar, pavarësisht llojit të diftongut, nxënësit janë të ndërgjegjshëm për pavarësinë relative të diftongut dhe herë e ndajnë gjysmëzanoren nga zanorja e theksuar e herë jo. Edhe shpejtësia e të folurit ka rol në prodhimin e togjeve zanore dhe të diftongjeve. Rritja e gjatësisë favorizon prodhimin e togjeve zanore atje ku normalisht do të kishim diftong.

Duke u mbështetur në teorinë e sonoritetit, duhet ta pranojmë se rregulli për kufirin rrokjesor të fjalës në rastin e diftongut duhet të qartësohet dhe të thjeshtësohet dhe në praktikë. Për këtë është e rëndësishme të bëhen studime eksperimentale.

BIBLIOGRAFI:

- Cipo, K. *Gramatikë e gjuhës shqipe*, Departamenti i Gjuhësisë, Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti “A. Xhuvani”, Elbasan. Tiranë, 2015.
- Desnickaja, A. *Gjuha shqipe dhe dialektet e saj*, Prishtinë, 1972.
- Dodi, A. “Diftongjet e shqipes së sotme nga pikëpamja fonetike dhe fonologjike”, Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike, 15-21 nëntor 1962, Tiranë, 1965, f. 195-204.
- Dodi, A. *Fonetika e shqipes standarde*, ASHSH, IGJL, Tiranë, 2004.
- *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1973, f. 163.
- Çabej, E. *Studime Gjuhësore III*, Prishtinë, 1976.
- Jubani-Bengu, A. *Fonetikë akustike-Analizë e sistemit fonologjik*, Tiranë, 2012.
- Kastrati, J. “Diftongu në gjuhën shqipe”, në Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Nr. 2, Tiranë, 1954.
- Memushaj, R. “Diftongjet e shqipes standarde”, në *Studime gjuhësore* (përmbledhje artikujsh), ASA, IGJL, Tiranë, 2017, f.139-140.
- Sawicka, I., Dargiel, K. *Struktura e rrokjes shqipe*, Prishtinë, 2018.
- Sheperi, I. D. *Gramatika dhe sintaksa e gjuhës shqipe*, Tiranë 2001.
- Topalli, K. *Fonetika historike e shqipes*, Tiranë, 2006.
- Polak, V. *Casopis pro moderin filologji*, 1955 dhe *Studii si cercetari lingvistice* 1960.
- Keller. Z. B. “Revisiting the Status of Speech Rhythm”, *Proceedings of Speech Prosody Conference*, 2002, Eds. B. Bel and I. Marlien, Aix-en-Provence. April 11-13, 2002, f. 727-730.

**In the division of syllables of the word.
The diphthong case**

ABSTRACT

In Albanian as well as in other languages, it may happen that in specific scenarios some vowels might lose their syllable-forming skill. Such vowel combinations create the diphthongs. Diphthongs can be studied through the phonetic and phonological point of view.

There are specific languages where the syllable has a specific phonological representation, but there are also languages where the phonological order is the border between syllables (syllable's border

complies with no exception with the morpheme's border, for example *unik* (*u-nik*) and *unë iki* (*un-i-ki*). Both theories, expiratory and sonority are true. To produce syllables, the strengthening of the air current (expiratory theory), while the sonority theory is based in the syllable center.

Relying on the sonority theory, we must admit that the rule for the syllable border of the word in the case of diphthong must be clarified and simplified in practice as well. It is important to do experimental studies.

Orjeta BAJA

FIGURAT E STILIT

(Fjalor terminologjik shpjegues)

- vijon -

litot/ë, -a f. nga gr. *litótes*, “thjeshtësi, pakësim” (*fr.* litote, *it.* litote)

Figurë sintaksostilistike përmes së cilës jepet pohimi i një koncepti duke mohuar të kundërtën, p.sh.: “*Ishte koha kur shteti komunist shqiptar sapo i kishte bërë mjaftë marrëdhëniet me Republikën Popullore të Kinës dhe, me sa duket, nuk qe fort punë me mend t'i vazhdoje komentet.*” (S. Çapaliku). E kundërta: **hiperbola**.

metabola shih **sinonimi, -a**

metafor/ë, -a f. nga gr. *metaphorá*, “mbartje” (*fr.* métaphore, *it.* metafora)

Figurë semantostilistike (një nga tropet kryesore) që përftohet nga përdorimi i figurshëm i emërimit të një sendi a dukurie për një tjetër, nëpërmjet krahasimit sipas ngjashmërisë materiale apo morale, p.sh.: “**qesh natyra**”, “**vullnet i çeliktë**”, “**ditë e bardhë**” etj., apo shprehja metaforike: **Je një dhelpër!**, që del si një shkurtim i similitudës: *Je dinake si një dhelpër!*. Metafora, e quajtur “mbretëreshë e tropeve”, përdoret gjerësisht në veprat letrare, duke prekur drejtpërdrejt ndjenjat dhe imagjinatën e lexuesit apo dëgjuesit. Shpesh metafora është parë si krahasim eliptik. Thuhet: Metaforë e thjeshtë. Metaforë letrare (gjuhësore).

metonimi, -a f. nga gr. *metonymía*, “emërtim ndryshe” (*fr.* métonymie, *it.* metonimia)

Figurë semantostilistike (një nga tropet kryesore) që përftohet nga përdorimi i figurshëm i një fjale a i një shprehjeje në vend të një tjetre, duke u mbështetur në raport afrie a fqinjësie që kanë sendet e dukuritë në hapësirë e në kohë, në lidhjet e tyre sipas lëndës, sipas funksionit etj.; rezultat i kalimit të kuptimit nga një send apo dukuri në një tjetër, p.sh.: “**tryezë e pasur**” në vend të “gjellë a të ngrëna të shumta”, “**u rreshtua klasa e tretë**” në vend të “nxënësit e klasës së tretë”, “**u nis i tërë fshati**” në vend të “fshatarët”, “**me hekur e me zjarr**” në vend të “me shpatë e me zjarr” etj. Midis tyre ka lidhje të karakterit fizik, moral apo simbolik. Një lloj metonimie është **metalepsa**: figurë me të cilën mësohet shkaku duke

shprehur pasojën, p.sh.: “**Po e qajnë**” për “Ka vdekur”. Thuhet: Metonimi gjuhësore (letrare).

neologjizëm, -mi m. nga gr. *néos* - i ri dhe *logos* - fjalë, “fjalë e re” (fr. néologisme, it. neologismo)

Figurë leksikostilistike që lidhet me krijimin e një fjale të re. Për stilistikën, neologjizmi ka interes për sa kohë e ruan perceptimin si diçka e re. Fjalët ndihen si të reja për një periudhë, pastaj ato kthehen në leksema të zakonshme ose dalin nga gjuha. Vëmendjen e stilistikës e tërheqin ato krijime (neologjizma) që përfshihen në tekst jo sepse mungon fjala përkatëse për të emërtuar diçka, por sepse kërkohet të arrihet një efekt shprehës, p.sh., në vargjet: “*E vjen te praku i dritores / një foshnje **krelart** / me shtë e shkruem e me faqet e kuqe / aq të kuqe sa thue / ja ngjue e ama me buzët e lyeme. / E largon ajo tek e shef e trembun / tue kqyrë me bisht të synit. / Por një infermjere qi kalon / një **belzhdërvjelltë** gjatoshë si tue vallzue / ka më guxim e ndalet.*” (A. Pipa).

oksimoron, -i m. nga gr. *oxýmoron*, “budallallëk i mprehtë” (fr. oxymoron, it. ossimoro) → **oksimori**

Figurë semantostilistike që konsiston në afrimin e dy fjalëve antonime me lidhje gramatikore me përshtatje ose me varësi, që bazohen në një kontradiktë logjike, p.sh.: “*Sa e trishtuar qenka / të shohësh një jetë të rrënuar / **një heshtje klithëse** / nën një qiell të kthjellët.*” (Xh. Spahiu). Këto fjalë me kuptim të kundërt, të cilat duket sikur kundërshtojnë njëra-tjetrën, në të vërtetë i japin shprehjes një gjallëri dhe efekt të posaçëm. Këtë figurë e ka futur për herë të parë në shkrimet shqipe Faik Konica, me këto raste: “*Këto tru të pazhvilluara **çiliminjsh pleq** ...*”, apo “*Tani dëgjoni **zgjuarsinë e budallait** çfarë bëri ...*” (F. Konica). Ndeshet ndonjë rast ku oksimoroni është shprehur edhe me një kompozitë të vetme, p.sh.: “*Moj e hequra si bari / e kulluara si ari / **gëzimzeza** që s’gëzove / jetën s’e trashëgove.*”

onomatope, -ja f. nga gr. *onomatopoiá*, “tingullimitim” (fr. onomatopée, it. onomatopea)

Figurë fonostilistike që përftohet nga imitimi i tingujve në natyrë për qëllime të caktuara stilistike, si: *bau - bau, tik - tak* etj. Onomatopetë mund të shprehin idenë e një veprimi e të luajnë funksionin e një kallëzuesi, p.sh.: “*Unë prit ty e ti **shllap e shllup** nëpër dëborë (ec zvarrë)*”; “*Për një çast dhelpa **pjauf** midis pulave (u hodh, ra)*”.

paradoks, -i m. nga gr. *parádoxon*, “opinion i kundërt” (fr. *paradoxe*, it. *paradosso*)

Figurë semantostilistike që konsiston në një pohim, i cili duket i kundërt me kuptimin e mirëfilltë; mendim që bie në kundërshtim me mendimin e përgjithshëm e që është pranuar përgjithësisht si i vërtetë; ide pak e çuditshme në vështrimin e parë, që duket se bie në kundërshtim me arsyen e shëndoshë, por që mund të jetë e vërtetë, p.sh.: “*Kush ecën ngadalë, shkon larg*”. Paradoksi shprehet shkurt, në mënyrë lakonike, në formë të mprehtë e të gjallë. Thuhet: Flet me paradokse.

parafraz/ë, -a f. nga gr. *paráphrasis*, “përshkrim, shprehje përshkruese” (fr. *paraphrase*, it. *parafrasi*)

Figurë sintaksostilistike që përftohet nga paraqitja e përmbajtjes së një teksti me fjali a shprehje që japin në mënyrë përshkruese, me qëllim shpjegimi, kuptimin e një fjale a të një shprehjeje të caktuar, p.sh. “*ajo që e ka lindur e rritur*” në vend të “*e ëma*”. Gjithashtu, parafraza lidhet me shpjegimin e përmbajtjes së një veprë, të një teksti të vështirë, me fjalë të ndryshme, si: sinonime etj.

paragog/ë, -a f. shih **epitez/ë, -a**

paraleliz/ëm, -mi m. nga fr. *parallélisme* (it. *parallelismo*) → **hipozeuks**

Figurë sintaksostilistike që konsiston në përsëritjen e një grupi frazor të ndërtuar në mënyrë të ngjashme e me vëllim të ngjashëm; figurë e bazuar në puqjen dhe lidhjen e dy sintagmave, dy frazave a të dy vargjeve ndërtuar në mënyrë të ngjashme, p.sh.: *Ironia vret, humori shëron*. Kjo figurë, që i jep gjallëri të veçantë gjuhës poetike, takohet dendur në poezinë popullore e artistike, si në vargjet: “*Turp e marre! faqe e zezë! / Kaq u-bana, kët hatá / s’e kam ndi, as s’e kam pá! / Kupe Danja llafepaku / tha një fjalë, e ndjeu sokaku: / “S është për burr me ngucë çarçafë, / me i rá kot të vofnit n’ qafë!”* (A. Pipa). Thuhet: Paralelizëm i figurshëm.

parambol/ë, -a f. shih **parantez/ë, -a**

parantez/ë, -a f. nga gr. *paréntesis*, “shtojcë” (fr. *parenthèse*, it. *parantesi*) → **parambola**

Figurë sintaksostilistike që përftohet nga prishja e zhvillimit linear të një fraze apo mbingarkimi i saj nga ndërftja e një sintagme të dorës së dytë, për të sqaruar a precizuar më mirë një ide. Paranteza është veti e gjuhës së shkruar; tradicionalisht ajo shënohet tipografikisht me kllapa apo

viza. Në gjuhën e folur është vështirë të vihet në dukje qartë me mjete jashtëgjuhësore, si, përmes: pauzave, ritmit, intonacionit. Parantezat përdoren brenda frazave (fjalive) në dy pozicione: në mes dhe në fund të njësive kumtuese, dhe, tepër rrallë, në fillim të tyre, p.sh.: “*Ema ishte mbështetur në dritare (ajo qëndronte shpesh aty: dritarja, në provincë, zëvendëson teatrin dhe shëtitjen).*”.

paratakas/ë, -a f. nga gr. *parátaxis* “rend” (fr. parataxe, it. paratassi)

Figurë sintaksostilistike që konsiston në puqjen e fjalive pa fjalë lidhëse, të cilat do të formulonin më qartë raportin sintaksor të nënrenditjes apo të bashkërenditjes që i bashkon, p.sh.: *Leka pi duhan, Gimi zemërohet*. Ndërsa hipotaksa ka një raport varësie mes njësive, në parataksë njësitë qëndrojnë në të njëjtin rrafsh. E kundërta: **hipotaksa**.

paronomazi, -a f. nga gr. *paronomasia*, “aludim në një emër tjetër, afëremërtim” (fr. paronomase, it. paronomasia)

Figurë fonostilistike që konsiston në përqasjen e fjalëve me formë e tingëllim të ngjashëm, por me kuptim të ndryshëm, brenda një fraze ose një vargu; raporti mes dy a më tepër paronimeve, p.sh.: “*Të derdhni gjakun / me grushte plot! / po kurrë lot! / as sot, as mot!...*” (M. Kuteli). Apo fjalë të tilla: *mishërim - mëshirim, afro - ofroj, zgjedhje - zgjidhje, sesion - seksion - sezon, drita - dita, mali - malli* etj.

perifraz/ë, -a f. nga gr. *períphrasis*, “përkthim, ligjërim rreth diçkaje” (fr. périphrase, it. perifrasi)

Figurë sintaksostilistike që përftohet nga një shprehje a grup fjalësh që përdoren për të shpjeguar më mirë një koncept a për të evituar të shprehurit në mënyrë të drejtpërdrejtë të emrit të një njeriu, të emërtimit të një sendi, të një dukurie etj., duke nxjerrë në pah tipare të qenësishme, veti a cilësi, që paraqesin në mënyrë më të gjallë e artistike figurën e tyre, p.sh.: “*Këngëtari i Lahutës*” për Fishtën, “*Luani i Krujës*” për Skënderbeun, “*Vendi i shqiponjave*” për Shqipërinë. Kjo figurë takohet më tepër në stilin e lartë oratorik. Thuhet: Fol qartë, pa shumë perifriza!

personifikim, -i m. nga lat. *personificazione*, “personifikim” (fr. personification, it. personificazione) → **prozopopeja**

Figurë që përftohet në rastet kur i mvishen një gjëje pa shpirt vetitë e qenieve të gjalla. Objektet, dukuritë e natyrës, ndjenjat njerëzore, nocionet abstrakte paraqiten sikur të kishin cilësi, veprime, emocione njerëzore. Një personifikim të goditur kemi në vargjet në vazhdim, ku poeti

e ka paraqitur Shqipërinë e dikurshme si një grua të ve që kërkon ndihmë nga të bijtë: “Ç’thot ajo e ve e gjerë / - Mbretëreshë pa kurorë - / Faqe-çjerrur, lesh-lëshuar / Shpirt e zemër përvëluar / Gjysm’e vdekur: “O shqiptarë / Nënës mos ia bëni varrë!” (F. Noli).

përkalim, -i m. nga fr. *l’enjambement*, “përkalim, kapërcim” (it. enjambement)

Figurë sintaksostilistike që përftohet kur ka kalim në vargun pasues të një a disa fjalëve që plotësojnë mendimin e vargut përpara. Kjo dukuri bën që pauza midis dy vargjeve - mbajtur nga ritmi - të shmanget disi nga sintaksa, duke marrë si funksion të mahnisë pritjet e marrësit. Në këto raste, ku metri e sintaksa nuk përputhen - ndërsa pritjet që kuptimi i frazës të mbarojë me vargun -, ndjehet që pauza ritmike ndërpret befas fillin e diskursit (ligjërimin), i cili vazhdon në vargun vijues, p.sh.: “U dynd Gruda, s’ cilles zâni / Larg i vojt per kah tagâni / U dynd Hoti t’ cillit Zoti / I ndihmon per kah agzoti” (Gj. Fishta).

përsëritje, -a f. nga lat. *iteratiōne*, “përsëritje” (fr. *itération*, it. *iterazione*)

→ **epizeuksi, reduplikacioni, konduplikacioni**

Figurë sintaksostilistike që krijohet nga përsëritja disa herë me radhë ose në distancë të vogël e së njëjtës fjalë ose frazë, për të shprehur një mendim ose një koncept që duam ta vëmë në dukje me efekt të veçantë shprehës, p.sh.: “Krujë, o qytet i bekuar / **Prite, prite** Skënderbenë.”, “Është **shumë shumë pak**.” etj.

pleonaz/më, -ma m. nga gr. *pleonasmós*, “tepri” (fr. *pléonasme* it. *pleonasma*) → **ridondanca**

Figurë semantostilistike që shënon një koncept që karakterizohet nga prania e një apo më tepër elementeve sinonime, që nuk i shtojnë asgjë kuptimit të një fjale a shprehjeje, por që shërbejnë për të përforcuar shprehjen e idesë brenda një fraze, p.sh.: “Ishte **shumë plak, i vjetër, i thyer**.” Duket se për herë të parë në shqip këtë term e ka shpjeguar Justin Rrota (Sintaksi i shqipes: 1942): *Pleonazma* - (tepri) *perbahet tue shtuem fjalë të panevojshme*, p.sh. *Mue s’ma muer librin aspak. Na e ka lanë ne punën krejt*. Pleonazmë përmbajnë edhe shprehjet tautologjike, si: *E kam dëgjuar me veshët e mi; Ulu poshtë* etj. Pleonazmi përdoret mjaft në poezinë popullore.

poliptot/ë, -a f. nga gr. *polyptotos*, “e shumë rasteve” (fr. *polyptote*, it. *poliptoto*)

Figurë morfostilistike që konsiston në përdorimin e së njëjtës fjalë me disa forma gramatikore në një fjali (për foljet: variacione të mënyrave, kohëve, vetave etj; për emrat: kundërvënie të numrit, gjinisë etj.); variante morfologjike të së njëjtës fjalë, p.sh.: *Unë, **plaku**, bisedova me një **plak** mbi rininë.*

polisindet, -i m. nga gr. *polysýndetos*, “shumicë lidhëzash” (fr. polysyndète, it. polisindeto)

Figurë sintaksostilistike që konsiston në përsëritjen e lidhëzave bashkërenditëse (këpujore ose veçuese) me tepri, përpara disa emrash, mbiemrash o foljesh, me qëllim që, duke u lidhur bashkë, e gati duke u ngjeshur idetë njëra pas tjetrës, t’i japin më tepër forcë shprehjes, p.sh.: “*Për ty flet nata **e** dita / **e** dimni acar **e** zhegu / **e** vala e argjendtë **e** bregu / **e** vesa kur çel drita.*” (Gj. Fishta). E kundërta: **asindet**.

pretericion, -i m. nga lat. *praeteritione*, “kalim përtej, pa përmendur” (fr. *prétérition*, it. *preterizione*)

Figurë që përftohet në rastet kur ai që shkruan ose flet, pretendon se do ta kalojë në heshtje gjoja diçka, të cilën, në të vërtetë, e shpreh qartë dhe me forcë, p.sh.: “*Nuk dua të zë në gojë këtu sjelljen e tij të keqe me shokët, por po përmend vetëm ...*”

prozopope, -ja f. shih **personifikim, -i**

pyetja retorike (fr. *question rhétorique*, it. *domanda retorica*)

Figurë sintaksostilistike që lidhet me mënyrën e të adresuarit të pyetjeve dëgjuesit a bashkëbiseduesit, pyetje që nuk kërkojnë përgjigje, por e nënkuptojnë atë. Kjo figurë përdoret si mënyrë prezantimi më tërheqëse, si një ndërhyrje emocionale, p.sh.: “*A s’ të vjen të pëlcasësh?*”, “*Nuk ta bën borxh ky?*”. Apo në vargjet: “*Ç’sjell ndër mend ashtu, o qen i urtë? / Mos kujton atë që e deshe shumë? / Mos kujton atë të shkretën bushtër / Që ia flakën bijtë e saj në lumë?* (D. Agolli).

BIBLIOGRAFI:

Belluscio, Giovanni – Rrokaj, Shezai:

-*Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë* (shqip - italisht - frëngjisht - anglisht), “Arbëria”, Tiranë, 2011.

Dubois, Jean – Giacomo, Mathée – Guespin, Louis – Marcellesi, Christiane – Marcellesi, Jean-Baptiste – Mével, Jean-Pierre:

-*Dictionnaire de linguistique*, “LAROUSSE”, Paris, 2001.

Patota, Giuseppe (Direzione scientifica):

-*Il Dizionario medio Garzanti della lingua italiana*, Dizionario Interattivo Garzanti, De Agostini Scuola S.p.A., “Stabilimento di Lavis (TN)”, 2010.

Baja, Orjeta:

-*Terma të përbashkët të gjuhësisë me letërsinë (në funksion stilistik)*, në revistën “Buletini shkencor”, nr. 9-3, Ulqin (Mal i Zi), 2017.

Topalli, Tefë – Baja, Orjeta:

- *Glosar - (100 terma gjuhësorë-stilistikë e retorikë)*, në revistën “Buletin shkencor” (Seria e shkencave shoqërore), nr. 58, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, 2008.

Leka, Ferdinand:

-*Fjalor i termave të letërsisë*, “INFBOTUES”, Tiranë, 2013.

Zheji, Gjergj – Xhafka, Natasha:

-*Fjalor enciklopedik letrar*, “Mihal Duri”, Tiranë, 2001.

Fromilhague, Catherine:

-*Les figures de style*, “Nathan”, Paris, 2000.

Kane, S., Thomas:

-*Si të shkruajmë shqip* (redaktor: Xh. Lloshi), “Qendra për Arsim Demokratik”, Tiranë, 2010.

Lloshi, Xhevat:

-*Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, “Albas”, Tiranë, 2005, 2012, 2015.

Reboul, Olivier:

-*Introduction à la rhétorique*, “PUF”, Paris, 1998.

The figures of the style
(Explanatory terminological dictionary)
(L, M, N, O, P)

ABSTRACT

Also in this issue of the magazine, I continue the presentation of the dictionary “**The figures of the style**” (with figures belonging to the letters **L, M, N, O, P**), aiming at the explanatory type, with theoretical and practical extension, in order to clarify the conceptual aspects of the terms.

This terminological explanatory dictionary is considered useful as a consulting tool to better understand the content of these terms, and to be mastered by a wide range of users, such as writers, publicists, teachers, researchers and students.

Evalda PACI

RRETH LIBRIT KISHTAR TË SHTYPUR NË GJUHËN SHQIPE: EKZEMPLARË HERSHMËRIE DHE NDIKIMESH KULTURORE NË SHEKUJT XVII-XVIII

Në historinë e kërkimeve mbi qarkullimin dhe origjinën e modeleve të caktuara librare, ndër të cilat dallojmë në veçanti ato të ekzemplarëve që shënuan dhe shkrimin shqip e periudhat më të hershme të dëshmimit të tij, spikasin dhe sprova për të evidentuar ecurinë e veprimtarisë së iniciatorëve që mbështetën botime me vlerë për kohën e po aq të vyera për shekujt në vijim. Të përmendur për një sërë iniciativash në pikëpamje të promovimit të librit të liturgjisë, të traktateve që trajtonin tematika të rëndësishme për periudhën e Reformës dhe Kundërreformës, për përpunimin e tipeve të shkronjave që do të shërbenin për të shënuar dhe tipare grafike të gjuhëve të tjera në të cilat do të shtypeshin doracakë liturgjikë e doktrinarë, tipografët, por dhe botuesit e shekujve XVI-XVII janë pjesë e pandarë e një historie të tërë zhvillimesh kulturore. Për më tepër, një histori e tillë komplekse dëshmoi ndër të tjera se pikërisht individët që i kushtonin përhapjes së librit një vëmendje të veçantë, në atë shkallë sa ta konsideronin themelore në pikëpamje angazhimi, u bënë shkak që dhe të kishin përparësi botime të caktuara të Biblës dhe të klasikëve, ndërkohë që marrëdhëniet me hierarkitë përkatëse shtetërore përbënin një tjetër faktor për t'u marrë në konsideratë. Përtej konsiderimit të rolit që patën të tillë iniciatorë të përrurimit të shtypshkrimit në shekujt që lidhen me ngjarje të rëndësishme në zona të veçanta të arealit evropian, vetë konteksti kulturor i kohës u duk se ndikohej nga të tilla prirje, që i jepnin librit të shtypur një rëndësi të posaçme, aq më tepër që ky fakt bënte të mundur një qarkullim më të lehtësuar idesh, pikëpamjesh dhe variantesh për t'u lexuar e më tej diskutuar. Në vëzhgimet tona mbi historikun e jo pak ekzemplarëve që dëshmojnë dhe një larmi konceptimesh në pikëpamje të përmbajtjes, por dhe mënyrës së transmetimit, duket qartë që vëmendje të madhe patën variante tekstesh me një paracaktim ndaj praktikës së liturgjisë e që mund të qarkullonin dhe në trajtë vëllimesh apo fletoresh, por dhe vepra që evokonin klasicitetin dhe kulturën antike, sidomos atë greke dhe latine. Në mënyrë të njëkohshme me zhvillimet në fushë të teknografisë në shekujt

XV-XVI, por dhe më tej me evoluimin e teknikave që dallonin për nga preferencat e përzgjedhjet tipografë apo editorë të caktuar, edhe çështja e qarkullimit të teksteve ndjek njëfarë ecurie zhvillimi, në veçanti në raste të përfshirjes së tyre në vëllime të një tematike të paracaktuar.¹

Në dekadat që pasojnë përmbylljen e punimeve të Koncilit të Trentit (1545-1563), ndërkohë që bëheshin përherë më konkrete pritshmëri në lidhje me dekrete e vendime të parashtruara në këtë ngjarje me rëndësi për shumë rrethe kulturore, edhe libri i shtypur liturgjik e më saktë, libri i paracaktuar të ishte funksional në procese shërbesash e praktikash të shpeshta, ishte një ndër objektet kryesore të vëmendjes së rishikimit apo të riorganizimit përmbajtësor nga ente institucionale *ad hoc*.

Për vetë përparësinë që do të kishin në të tilla procese tekstet biblike e më tej, variante të paracaktuara të Vulgatës latine, tekste të Breviarit e të Ofices së vogël që paraprinte tradicionalisht vepra më të plota për nga ndërtimi dhe konceptimi, ndërmendja e tyre në indeksat e librave që do të rishikoheshin, ridimensionoheshin apo riktheheshin në vëmendje të censorëve të kohës, do të ishte krejt e natyrshme. Flet qartë për një fakt të tillë një dokumentacion i pasur, që u bë gjerësisht objekt vëmendjeje kohët e fundit, pikërisht kur dhe përafrimi ndaj këtij të fundit u bë më konkret për studiues dhe historianë të periudhës.

Shkrimi i Shenjtë dhe më tej, tekstet biblike të transmetuara në gjuhët e vendeve evropiane evokojnë një argument mjaft të diskutuar në traditën e studimeve që përqendrohen në përrurimin e shtypshkrimit në Evropë, në zhvillimet që shoqëruan lindjen e ideve të Reformës e më tej të Kundërreformës. Janë dekada të shënuara nga ngjarje që dhe pse të veçuara në konkretizimin e tyre, janë qartësisht të lidhura me këto zhvillime e ndryshime, që në të vërtetë dëshmuar se gjuha dhe pasuria komplekse e saj përbën një faktor të pazëvendësueshëm në evoluimin e kulturës së receptimit të librit në këtë periudhë kohore.²

Variantet biblike të përpiluara në gjuhë si ebraishtja, greqishtja e vjetër, por dhe vetë Vulgata latine janë pjesë e një trashëgimie të pasur në forma, ndërtime, elemente të një leksiku historik të bëra gjithmonë objekt

¹ Braidà L., *L'editoria umanistica tra la fine del „400 e il primo „500*, në *Stampa e cultura in Europa*, Editori Laterza, Bari, 2020, f.58-68.

² Braidà L., *Il libro di larga circolazione: repertorio e caratteristiche materiali*, në *Stampa e cultura in Europa*, Editori Laterza, Bari, 2020, f.53: *L'uso del volgare fu un fattore che avvicinò al libro a stampa anche una parte di lettori meno familiarizzati con il latino rispetto ai letterati tradizionali. Gli stampatori tedeschi seppero sfruttare per primi la potenzialità di questo tipo di libro, puntando anche sulle illustrazioni, che potevano, più ancora del testo, contribuire allo successo delle edizioni.*

studimesh e hulumtimesh që ceknin dhe aspektin antropologjik të konteksteve që përcilleshin në pjesën më të madhe të teksteve që përmbaheshin në to.

Reflektimi ndaj leximit dhe receptimit të tyre përbën dhe një ndër argumentet qendrore të një diversiteti pikëpamjesh mes ithtarëve të Reformës dhe më tej, mbështetësve të Kundërreformës, të cilët në një masë të madhe mbështetën konsiderimin e zyrtaritetit të Vulgatës latine dhe të gjuhës përkatëse në mesharët, breviarët dhe librat e lutjeve. Ky fakt i fundit nuk mënjanoi këto objekte të praktikës kishtarë nga nevoja për reformim dhe rishikim përmbajtësor, çështje që nuk u zgjidh lehtë dhe as për një kohë të shkurtër.

Si në pikëpamje të vetë paracaktimit të tyre si mjete të një përdorimi specifik në lidhje me praktikën e liturgjisë, ashtu dhe në atë të përmbajtjes së teksteve themelore për nga rëndësia dhe referencialiteti, mesharët, breviarët, librat e psalmeve dhe të lutjeve u morën në shqyrtim si në proces të zhvillimit të Konkilit të Trentit (1545-1563), ashtu dhe më tej, në dekadat që pasuan përmbylljen e këtij të fundit.¹

Diskutimi mbi receptimin e tekstit biblik në gjuhët e vendeve si Gjermania, Franca, Spanja, por dhe që paraqiteshin në dialekte të dallueshme brenda lokalitetetesh të afërta, mbetet i lidhur ngushtë me atë të vlerësimit të larmisë së disponimit të varianteve që ofronte një mundësi e tillë, aq më tepër që me kalimin e kohës zhvillimet përkatëse do ta mbështetnin natyrshëm një dukuri të kësaj natyre. Krahas tekstesh zyrtare që përfaqësonin në thelb pjesë të një rëndësie kanonike e që tradicionalisht transmetoheshin në gjuhën latine, edhe këngë që ruanin elemente të latinitetit në përbërje të tyre, përçoheshin gjithashtu në gjuhë të tjera, siç është mes tyre dhe rasti i gjurmimit konkret për disa variante të kësaj natyre në gjuhën shqipe.²

¹ Mbetet për t'u sqaruar nëse ndërthurja e modeleve dhe e teksteve që gjejmë në përbërje të librit të Gjon Buzukut ka qenë në vijimësi përdorimi dhe në kohë të proceseve të rishikimit tekstor dhe përmbajtësor që u ndërmor mbas përfundimit të punimeve të Konkilit të Trentit (1545-1563). Vetë zgjatja e pazakontë në kohë e këtij të fundit ndërlikon ndër të tjera çështjen e evidentimit të modeleve që mbizotëronin në praktikën e liturgjisë së krishterë në vise dhe lokalitete në të cilat ndihej fuqishëm ndikimi i Kishës së Romës.

² Meshari, botim kritik i përgatitur nga E.Çabej, *Pjesa e dytë (faksimile dhe transkribim fonetik)*, Tiranë, 1968, f.27. Teksti në gjuhën shqipe, variant i himnit *Ave maris stella* cilësohet si *Hymno* nga përpiluesi në paratekstin përkatës në kreun e cituar më sipër. Si një nga tekstet më të cituara dhe të studiuara për nga brendia, referencialiteti ndaj Marisë dhe më tej, për nga kërshtëria që ka zgjuar çështja e autorësisë së tij, ky i fundit përbën dhe në pikëpamje të shkallës së shqipërimit dhe pranisë së elementeve leksikore me

Historiku i njohjes së teksteve kishtare e në veçanti të atyre me një destinacion të qartë praktik e funksional nuk mund të ndahet lehtë nga vepra që për nga brendia paraqiten me një pasuri të spikatur trajtesash e hyrjesh të zgjeruara në fushë të mendimit teologjik e filozofik. Edhe në shekujt që u ndërmendën më sipër për arsye të zhvillimeve themelore në kulturën e librit të shtypur, të tilla traktate ishin pjesë e regjistrave të shumtë të tematizuar, të përpiluar nën qëllimin për të reflektuar në masë të madhe botimet e kësaj tematike, bashkë me shënimin e elementeve të brendisë dhe të evidentimit të indiceve tipografike përkatëse.

Pikërisht, në disa prej tyre do të mund të gjurmohen të dhëna mbi pikënisjen e përpilimit të teksteve himnodike, që kishin një impakt të gjerë në masat e besimtarëve, por që ruanin qartësisht dhe përmasën e elementit teologjik, siç mund të ilustruhet me këngët fetare që i kushtoheshin Marisë, Amës së Zotit.³

Në historinë e shkrimit shqip trajtohen përherë si monumente të hershme shkrimore copëza tekstesh që sërish na orientojnë ndaj përpilimesh më të plota që lidhen me traditën e njohjes së Ungjillit dhe paraqitjen e tij në ditë të përcaktuara në liturgjinë e përvitshme.

Nga ana tjetër, dhe kur bëhet fjalë për vepra që dallojnë si nga paracaktimi tematik dhe në pikëpamje përdorimi, ashtu dhe për elemente që do të duhej të dispononim në të mirë të një njohjeje më konkrete përmbajtësore, referimi ndaj një tradite preekzistuese mbetet një premisë më se e kuptueshme, aq më tepër që në këto rasa, modele thellësisht të përcaktuara dhe të dallueshme nga të tjerat, jo përherë mund të gjinden apo të citohen.

Rimarrja e elementeve të ngjashme në libra që i shërbejnë së njëjtës praktikë, por që ndërkohë paraqiten me ndërthurje komplekse tekstesh që mund të jenë objekt i përdorimit në kontekste të një përditshmërie që shfaqet si ciklike e në funksion të një kalendari vjetor, bën që pikërisht në pikëpamje modelesh të mund të ndërmendim disa prej tyre, por duke pasur parasysh dhe referentin më të shpeshtë e më themelor në aspektin

prejardhje latine a latino-romane një nga pjesët më me interes në vështrimin studimor tekstologjik.

³ Në veçanti, nëse i referohemi tekstit me titull *Ave maris stella*, do të vërejmë se historiku i tij e ka pikënisjen disa shekuj më parë dhe fakti që gjindet i shqipëruar dhe në përbërje të librit të Gjon Buzukut përforcon idenë se njohja dhe ngulitja e tyre në traditën popullore ishte mjaft më e hershme në kohë. Ky historik ngërthen një panoramë të pasur qasjesh tekstore, por dhe hulumtime mbi origjinën dhe autorësinë, për të cilën është folur dhe shkruar gjerësisht në studimet mbi tekstet kishtare të shekujve të parë të shfaqjes së krishtërit.

përmbajtësor dhe formal.⁴

Historiku i njohjes së librit kishtar në arealin evropian merr një orientim të veçantë me përparimin teknologjik që u shënua nga përrurimi i shtypshkrimit dhe më tej nga rritja e vetëdijes se të tilla risi do të mund të shoqëroheshin me një numër më të madh ekzemplarësh dhe të teksteve e korpuseve biblike, në pjesën më të madhe të shkruara në gjuhën latine.

Çështja e reflektimit të tekstit biblik në variante gjuhësore të ndryshme nga gjuha latine përbën një prej argumenteve më të diskutuara në traditën studimore mbi Reformën dhe Kundërreformën dhe nga ana tjetër, vetë dallimet që mund të bëheshin mes botimeve të Vulgatës dhe sprovave për të përkthyer Besëlidhjen e Vjetër dhe atë të Re në gjuhë të tjera, mbeten gjerësisht të diskutueshme në pikëpamje filologjike, por dhe të perspektivës përkatëse në kuadrin historik të sipërcituar. Pesëqinda në veçanti shënohet mirëfilli nga të tilla sprova, që falë daljes në dritë të shtypit qenë shtysë dhe për të shpënë më tej diskutimet mbi variantet përkatëse, aq më tepër që me punën me burimet referenciale, jo pak përpilues apo përkthyes nxitën natyrshëm dhe polemika apo shprehje pikëpamjesh jo përherë të njëjta mbi argumentin në fjalë.

Dhe pse nuk mund të konstatohet një linearitet i mirëfilltë në zyrtarizimin e varianteve biblike në gjuhën latine dhe pas shtypjes së Biblës së Gutenbergut e më konkretisht, mbas sinodesh apo koncilesh që nuk e kanë lënë jashtë vëmendjes një çështje të tillë, në historinë e botimit të këtyre të fundit shënohen dhe të tjera modele, që përmbajnë qartësisht elemente të gjuhëve të vendit.⁵

Një fakt i tillë mund të verifikohet dhe në rasi të botimit të varianteve tekstore që nga titulli përkatës duket që përmbajnë tekste psalmesh, të cilat gjerësisht përdorshin në praktikën e liturgjisë së

⁴ U jemi referuar dhe në punime të mëparshme mbi një tematikë të ngjashme librave të orëve që në shekujt që i paraprijnë përrurimit të shtypshkrimit dhe më tej, doracakëve liturgjiarë që përmbanin tekste biblike e ungjillore, por dhe himnodike me një referim të qartë ndaj traditës popullore që i njihte dhe i përdorte këto të fundit. Në librat e orëve ka mjaft mundësi hulumtimi për të tilla tekste, ndërkohë që dhe në atë pjesë të librit të Gjon Buzukut që lidhet me këtë model të përveçëm gjinden pjesë të kësaj natyre, që celebrjnë figura të rëndësishme në liturgji dhe teologjinë e krishterë.

⁵ Tekste të transmetuara në gjuhët popullore e që u referohen figurave të rëndësishme në historinë e besimit në vende të caktuara kanë hyrë e janë bërë pjesë dhe e mesharëve apo breviarëve, që në përgjithësi që në elementet konstitutive, siglat e incipitet, por dhe ndarjet përkatëse në kuadër të brendisë së tyre ruajnë lidhjet me gjuhën latine dhe kulturën kishtarë përkatëse. Dhe pse referenciale ndaj kulturës popullore që i ruan dhe i konsideron pjesë të traditës, përfshirja e tyre në të tilla modele të ndërthurura përbën një fakt të gjurmueshëm dhe në veprat e letërsisë së vjetër shqipe.

krishterë, ndërkohë që në vështrime më të thelluara të përmbajtjes do të mund të gjurmohen dhe të tjera pjesë, me një referim të qartë biblik apo teologjik.

Në një optikë komplekse do të mund të vëzhgohen si modelet që përbënin variantin mbizotërues në shekuj të caktuar në lidhje me praktikën e liturgjisë, ashtu dhe me gjuhën në të cilën kryesisht përpiloheshin a shkruheshin këta të fundit.

Terminologjia e emërimit të tyre përbën një tjetër premisë nga e cila mund të kenë pikënisjen jo pak trajtesa, në më të shumtën e rasteve me objektivin për të përafruar me përmbajtjen e këtyre librave një masë lexuesish që për nga kureshtja e interesi studimor kanë përfshirë në hulumtimet e tyre dhe veprat e letërsisë së vjetër shqipe. Rreth një argumenti të tillë mund të orientohen një sërë objektivash për gjurmime të mëtejme, aq më tepër që në lidhje me të mund të gjejnë reflektim jo pak kompetenca, mbi të gjitha ato të brendësimit tekstor dhe përmbajtësor, që bën të mundur të dallohen e përveçohen dhe kuptime të ndërtimeve e përdorimeve themelore të kësaj fushe specialistike.

Libri liturgjik ka përshkuar një rrugëtim të gjatë në shekuj, që është shënuar nga veçanësi të përmbajtjes e të konceptimit përkatës në varësi të periudhave e të historikut të urdhrave kishtarë, por dhe nga faktorë historikë që pikërisht në lidhje me këtë të fundit u bënë dhe ndikues në njëfarë mënyre. Sa i përket vlerësimit të varianteve mirëfilli zyrtare në çështje të praktikës së liturgjisë së krishterë dhe hershmërisë së përdorimit të gjuhëve të vendeve në të tilla procese, duhet vënë në dukje që rimarrja në konsideratë e dobisë së këtij faktori përbën një argument themelor në historikun e studimeve mbi librat liturgjikë dhe tekste të veçanta të tyre.

Çështja e gjuhës në të cilën shkruheshin libra të tillë ka qenë objekt studimesh që dhe rimerrnin në pikëpamje hulumtimi krejt rrugëtimin dhe luhatjet në vendime e dekrete konciliare që në raste të caktuara merrnin në konsideratë dhe faktin që një pjesë e tyre mund të shkruheshin dhe në gjuhë të tjera. Gjithsesi, prania e elementit latin në librin e liturgjisë është një konditë përherë e pranishme, aq më tepër që tekste të një rëndësie bazike për liturgjinë që në titull bartin shprehje e ndërtime në këtë gjuhë, me solemnitetin karakteristik dhe koncizitetin që e dallon këtë të fundit. Një fakt i tillë konstatohet qartë dhe në sigla e tituj krerësh në veprat e letërsisë së vjetër shqipe, e kjo dukuri rimerret rregullisht në rasa emërtime apo ndërtimesh që janë tipike të regjistrimit të liturgjisë e të himnodisë.

Në vetvete, historiku i një sërë modelesh të librit të liturgjisë është i lidhur me procese që kanë të bëjnë me praktikën dhe ritet e ushtrimit të saj, qofë dhe në pjesë të caktuara të vitit, në të cilat kjo e fundit merrte një

rëndësi të veçantë për nga realizimi dhe bashkëndarja. Në procese të tilla, në të cilat gjuha, tekstet, lutjet, këngët e himnet nënvizonin dhe rëndësinë e festiviteteve liturgjik, dhe për libra të caktuar shënohet inicimi apo nënvizohet mundësia e përdorimit në vijim në të njëjtat kontekste.

Në veçanti, breviarët, të cilësuar shpesh për rëndësinë e tyre dhe në procese të reformimit të librit kishtar që në Pesëqindën e në Gjashtëqindën ndoqi zhvillime të ndjeshme, mbeten më të ndërmendurit dhe në pikëpamje të teksteve që përmbanin dhe dallimeve me të tjera modele, që në momente të caktuara mund të përdorëshin bashkë me këta të fundit. Revizionimi i këtij të fundit vihet në vëmendje të vijueshme të autoriteteve kishtarë, ndërkohë që dhe vetë zhvillimet mbas Konkilit të Trentit i jepnin udhë natyrshëm këtij fakti, si në pikëpamje të përmbajtjes e të përpjesëtimimit mes tekstesh të veçanta, ashtu dhe në zyrtarizimin e modeleve të përdorimit që nuk u përqaftuan njëherësh dhe në të njëjtën mënyrë në të gjitha viset.

Koncili i Trentit (1545-1563) dhe hapat e mëtejme që përfshinë pikërisht të tillë libra mbetet një moment vendimtar dhe në pikëpamje të vështrimeve historiografike që mund të kryhen në lidhje me të njëjtin argument. Pavarësisht rolit të këtij të fundit dhe ndikimin përkatës në ecurinë e zhvillimeve të mëvona në receptimin dhe reformimin e librit kishtar, përfshirë atë të praktikës së përditshme, një fakt i tillë bashkë me nënçështjet që përfshin në vetvete, kishte kohë që flitej a pritej të bëhej më konkret. Në vetvete, vetë çështjet që prisnin të merrnin diskutim të hapur dhe më tej të shpinin drejt vendimesh konkrete të lidhura pikërisht me përdorimin e mëtejme të librit kishtar, janë bërë gjerësisht objekt në proces të zhvillimit të këtij koncili, duke qenë të parashtruara dhe para mbajtjes së tij në kushte të parashtrimit të pikëpamjeve tashmë të ndryshme mes përkrahësve të Reformës dhe atyre të Kundërreformës.

Breviari mbetet një prej modeleve më të rëndësishme në një praktikë që nuk humbet rregullsinë kronologjike dhe vëmendjen ndaj një festiviteteve vjetor që rimerrej me një gradualitet të caktuar. Në këtë aspekt, qasja ndaj *Mesharit* dhe elementeve të ngjashme në përmbajtjen e këtij të fundit përbën një orientim që nuk duhet të mbetet jashtë vëmendjes dhe në rastin e evidentimit të veçorive përmbajtësore të librit të Buzukut, i cili në pjesë të caktuara mund të krahasohet dhe me Breviarin dhe tekstet e tij. Një lehtësim metodologjik në këtë vështrim besoj se mund ta për afrojë dhe ndarja përkatëse që brendisë së këtij libri i bëhet në botimin kritik të përgatitur nga N. Ressuli (Romë, 1958), në të cilin mund të veçohen në bazë të emërtimeve të përdorura dhe këto elemente që mund t'i përkasin

përkatësisht Breviarit, Ritualit, Mesharit.⁶

Dhe pse me kohën kanë mbijetuar jo pak variante kësombllash e modele të Breviarit, Ritualit, Mesharit, apo dhe të librave të Orëve e të Offices, edhe në harkun kohor të të njëjtit shekull paraqitet e vështirë të mund të gjindet një model i vetëm i këtyre të fundit, aq më tepër që dhe pas Konkilit të Trentit dhe institucionalizimit të komiseve që mbikëqyrnin daljen në dritë të shtypit të tyre vëmendja ndaj kompaktësisë tekstore dhe besnikërisë ndaj kanoneve gjuhësore e kishtare konsiderohej i një përparësie të madhe. Modele të ndryshme, prirje të njëjta, funksione dhe zhvillime të përafërta i vënë të tillë libra dhe realizime në një plan vështirimesh, të cilat duke u përqendruar në aspekte të përmbajtjes, bëjnë të mundur të vihen në dukje përkime dhe mospërkime të shpjegueshme me një sërë arsyesh.

Larmia e modeleve të vëna në përdorim veçanërisht në shekullin XVII siguron dhe një panoramë të gjerë tekstesh të reflektuara në to, përfshirë lutjet, psalmet, që zinin një vend të posaçëm në korpuse që ishin parashikuar të përfshinin dhe pjesë të Offices, dhe të librave të tjerë të përdorimit praktik e të përditshëm. Është e qartë që tekste të përveçme, sidomos ato himnodike që i gjejmë në pjesën e parë të librit të Buzukut janë pjesë e një tradite që vlerësonte të tilla pjesë, me një përmbajtje të qartë shprehësie poetike, me lidhje po aq të qartë me gjininë e vjershërimit, me një historik të lidhur me një nga figurat më të ndërmendura në historinë e tekstit liturgjik, por dhe të praktikës së liturgjisë.

Të tilla tekste janë ndër më jetëgjatat në historinë e përpilimit të pjesëve dedikatore, por dhe liturgjike, e ndërkohë, në shekujt në vijim, u bënë pjesë vëllimesh më vete të orientuara ndaj shpjegimit përmbajtësor dhe kontekstualizimit të tyre në përbërje librash të paracaktuar për liturgjinë dhe observimin e saj.

Përtej faktit që këto tekste ndërtojnë kolonën vertebrale të pjesëve të rëndësishme të librave të liturgjisë, çështjet e autorësisë dhe të përkthimit të tyre në gjuhë të tjera ngërthejnë natyrshëm dhe variantin e sjellë në gjuhën shqipe në librin e Gjon Buzukut, si një ndër pjesët më domethënëse që gjurmohen në pjesën e Offices së Zojës. I pasur në modelet që janë përfshirë në të, të shpjegueshme si me koherencën ndaj librave që përdoren në atë kohë, në procese të një praktike të përditshme, por dhe rituale, ky libër

⁶ Ressuli N., *Il "Messale" di Giovanni Buzuku, riproduzione e trascrizione*, Biblioteca Apostolica Vaticana, 1958. Pjesa e veprës që i përket *Mesharit* fillon në f.77 të këtij botimi të cituar. Është me vend të vihet në dukje që nënvizohen ndarjet mes Ritualit dhe Mesharit pikërisht në elementet teknografike të ndërtimit të këtij botimi.

reflekton dhe rëndësinë që u jepej teksteve himnodike, që me shumë mundësi ishin të ngulitura në kujtesën celebrative të besimtarëve, fakt që përforcohet dhe nga mbijetesat e gjatë e këngëve të njëjta në zona në të cilat besimi i krishterë vijon të jetë i fortë dhe i pranishëm. Në këtë pikëpamje, pikërisht në lidhje me tekste të tilla, mund të argumentohet vijimësia e tyre nga botimi në variante të përmirësuara apo të ruajtura mirë në të përkohshmet në gjuhën shqipe që u përruan disa shekuj më vonë, por që pasqyrojnë pikërisht këtë vazhdimësi të motivit dhe të përmbajtjes, bashkë me elemente të tekstit që dëshmojnë mbi të gjitha ndikimin nga bota latine e krishterë.⁷

Në pjesën më të madhe të rasteve, kur ndërmerret shpjegimi i tyre dhe në shekujt që pasojnë periudhën e reformimit postridentin të mesharëve dhe breviarëve, varianti në gjuhën latine përbën referentin më të parë në vështirimin e autorëve të doracakëve në të cilën këta të fundit rimerren dhe zbërthehen në elemente të brendisë dhe të ndërtimit tekstor.

Çështje të autorësisë dhe të transmetimit në gjuhën shqipe të teksteve specifike me natyrë celebrative e që duket qartë që kanë mbetur gjatë në kujtesën historike përkatëse janë argumente trajtimi që mund të shihen të lidhura dhe me historikun e urdhrave kishtarë në vendin tonë, ngulitja e të cilëve është bërë jo pak objekt gjurmimesh dhe në fushë të historiografisë sonë.

Vetë historia e letërsisë së vjetër shqipe, e përfaqësuar me një sërë realizimesh që dallojnë në vetvete që në elementet e përfaqësimit në ballina e çështje të paracaktimit tematik, ruan në prirjet e saj një lidhje të qartë me zhvillimet në një botë të afërt si ajo evropiane, e një afërsi e tillë nuk mund të shpjegohet vetëm me lidhjet e mundësuar nga faktori gjeografik. Kërkime më të imëta mund të shpien dhe në gjetjen e elementeve të tjera, që mund të konkretizohen dhe përmes qasjesh me realizime të ngjashme në arealin ballkanik. Ndërkohë, vetë tekstet që u morën si shembuj ilustrimi dhe në këtë trajtesë tonën përbëjnë një dëshmi të qartë të ndikimit të latinitetit të krishterë në praktikën e liturgjisë në gjuhën shqipe, e cila konkretizohet dhe përmes doracakësh që u botuan dhe u ribotuan më se një herë në shekujt që pasojnë mbajtjen e Kuvendit të Parë të Arbënit (1703).

⁷ Do të ruhen në vijimësi dhe prirjet në lidhje me tekste kaq specifike, fakt që dëshmohet dhe në të përkohshmet e iniciuara në dekadat e para të shekullit të kaluar, siç është dhe rasti i revistës *Zëni i Shna Ndout*, që paraqitet natyrshëm si një tribunë e përrimit të vlerave të tilla tekstore dhe himnodike. Shih gjithashtu dhe Paci E., *La Madonna del Buon Consiglio, fonte ispiratrice di componimenti poetici nella tradizione letteraria albanese*, në *Il Velro*, Rivista della civiltà italiana, Romë, 2019, f.207-218.

BIBLIOGRAFI

- Bogdani P., *Cuneus prophetarum* (Çeta e profetëve), botim kritik përgatitur nga A.Omari, ASHSH, Tiranë, 2015.
- Bonifati G., *Dal libro manoscritto al libro stampato* (Sistemi di mercato a Bologna e a Firenze agli albori del capitalismo), Rosenberg & Sellier, Torino, 2008.
- Braidà L., *Stampa e cultura in Europa tra XV e XVI secolo*, Editori Laterza, Bari, 2020.
- Dal Zotto A., *Richerche sull'autore dell'Ave maris stella*, në *Aevum*, v.25/6, Milano, 1951.
- Dallasta F., *Condanne e carriere: inquisizione e censura libraria a Parma nel Settecento*, Edizioni Clori, Firenze, 2018.
- Diddi C., *L'edizione del Messale croato-raguseo della Biblioteca Apostolica Vaticana: risultati e prospettive di ricerca*, në *Europa orientalis*, v.23, n.2, 2004.
- Chiesa M., *Poemi biblici fra Quattro e Cinquecento*, në *Giornale storico della letteratura italiana*, CLXXIX, 2002.
- Fragnito G., *Zurai non legger mai più*, në *Le sentiment national dans l'Europe méridionale aux XVI et XVII siècles (France, Espagne, Italie)*, *Études réunies et présentées par A.Tallon*, Casa de Velázquez, Madrid, 2007.
- Fragnito G., *La Bibbia al rogo: La censura ecclesiastica e i volgarizzamenti della Scrittura*, Il Mulino, Bologna, 2015.
- Fragnito G., Tallon A., *Hétérodoxies croisées. Catholicismes pluriels entre France et Italie (XVI et XVII siècle)*, Publications de l'Ecole Française de Rome, 2015.
- Genesin M., Matzinger J., *La pubblicazione dei primi testi in lingua albanese nel contesto dell'attività editoriale della Polyglotta*, në *L'Albania nell'Archivio di Propaganda Fide*, a cura di A.Ndreca, Urbaniana University Press, Romë, 2017.
- Infelise M., *I padroni dei libri : Il controllo sulla stampa nella prima età moderna*, Editori Laterza, Bari, 2014.
- Landi S., *Stampa, censura e opinione pubblica in età moderna*, Il Mulino, Bologna, 2011.
- Monter V., *Heresy executions in Reformation Europe: 1520-1565*, në Grell O.P., Scribner R., *Tolerance and intolerance in the European Reformation*, Cambridge University Press, 2002.
- Nadin L., *Albania ritrovata* (recuperi di presenze albanesi nella cultura

e nell'arte del Cinquecento veneto), traduzione in albanese di P.Xhufi, Onufri, Tiranë, 2012.

- Nuovo A., *Il commercio librario nell'Italia del Rinascimento*, Franco Angeli, Milano, 2003.
- Ongania F., Castellani C., *L'arte della stampa nel Rinascimento italiano (Venezia)*, F.Ongania editore, Venezia, 1894.
- Ottone A., *Il privilegio del Messale riformato. Roma e Venezia fra censura espurgatoria e tensioni commerciali*, në *Privilegi librari nell'Italia del Rinascimento*, Franco Angeli, Milano, 2019.
- Paci E., *La Dottrina Cristiana del Bellarmino in una versione del gesuita Giuseppe Guagliata*, në *L'Albania nell'Archivio di Propaganda Fide*, a cura di A.Ndreca, Urbaniana University Press, Romë, 2017.
- Paci E., *Studime mbi tekstet e vjetra shqipe*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2017.
- Paci E., *La Madonna del Buon Consiglio, fonte ispiratrice di componimenti poetici nella tradizione letteraria albanese*, në *Il Velro*, Rivista della civiltà italiana, Romë, 2019.
- Prosperi A., *L'inquisizione romana : letture e ricerche*, Edizioni di Storia e Letteratura, Romë, 2003.
- Reggio O., *Spiegazione del Catechismo fatta agli scolari del Collegio di Palermo*, Palermo, per S.Amato, 1728.
- Ressuli N., *Il "Messale" di Giovanni Buzuku, riproduzione e trascrizione*, Biblioteca Apostolica Vaticana, 1958.
- Ricci S., *Inquisitori, censori, filosofi sullo scenario della Controriforma*, Salerno Editrice, Romë, 2008.
- Roques M., *Recherches sur les anciens textes albanais*, L.O.P.Geuthner, Paris, 1932.
- Saggini R., Ramagli P., *Libri antichi tra Savona e Albenga (Inventari cinquecenteschi e catalogazioni di due diocesi liguri)*, Edizioni Forum, Udine, 2020.
- Squassina E., *I privilegi librari a Venezia (1469-1545)*, në *Privilegi librari nell'Italia del Rinascimento*, Franco Angeli editore, Milano, 2019.
- Tallon A., *La France et le Concile de Trente (1518-1563)*, École française de Rome, 1997.
- Zardin D., *Bibbia e letteratura religiosa in volgare nell'Italia del Cinque-Seicento*, në «Annali di storia moderna e contemporanea», n. IV, 1998.

**About the books published in Albanian: exemplars of antiquity
and cultural influences**

ABSTRACT

In the current observations on the history of the printed books in the Albanian language, we have focused on the issues regarding the phenomena of the inauguration of the printing technology in Europe, as well as on specific appearances of the concretization of this phenomenon. In an attempt to connect the appearance of the Albanian book with the relevant developments in Europe and the realization of the most important works in the Albanian written literature of the XVI-XVII centuries, we have focused on some examples and elements of content that lead to clear conclusions in terms of structure and coordination of literary features. In particular, texts of a literary and hymnodic nature, also found in the book of Gjon Buzuku, reinforce the idea of their transmission in the languages of the countries as an element of faith and culture of its preservation.

Suela KASTRATI
Manjola ZAÇELLARI

NJË VËSHTRIM GJUHËSOR PËR POETIKËN PRIMO SHLLAKUT (DASHUNIA FILLON PREJ GJYSMËS)

Hyrje

Sipas studiuesit A. Apolloni, Primo Shllaku është një solist që heshti gjatë gjithë regjimit. Dialekti të cilit i përkiste ai, ishte heshtur arbitrarisht në vitin 1972, prandaj dhe idiolekti i tij nuk përshtatej me korin e standardit...Kur ra regjimi, poeti nuk priti që të binte edhe gjuha e atij regjimi, por e ringjalli gjuhën “e vdekur”, duke publikuar librat “Lule nate” (1994), “Hana e njelmët e ditës” (1995) dhe “Edhe fjalët shkojnë në ferr” (2005).¹ Shkruan mjeshtri Apolloni se P. Shllaku është prijatar i rikthimit të gegnishtes në letërsinë shqipe, natyrisht jo për të mohuar dialektin e jugut, por për të mos e pranuar vdekjen e shpallur të dialektit të veriut. Shllaku është një spartan i gegnishtes i cili më parë pranon të hajë darkë në ferr sesa të ushqehet nga sofra e varfër e Standardit.²

Pa hyrë në përmbajtjen e kësaj paraqitjeje e pa u zgjatur për qëndrimin tonë ndaj idiomës së autorit, ne do t’i përmbahemi synimit që kemi vënë në ballë të këtij shkrimi, për ta parë gjuhën e aritit poetik të autorit, si shprehësi dhe efekt kumtues mbi lexuesin, me funksione estetike, emotive dhe dekorative.


Gjuha e artit poetik të autorit

Kur thuhet se përqafimi i krijimtarisë në vargje të lira nga poetët, marrë si një largim nga kanonet e rrepta të metrikës klasike, duhet kuptuar si një veprim drejt lirisë së shprehjes poetike, kurse në planin semiologjik,

¹ Po aty, A. Apolloni në parathënien “Ringjallja e fjalës”, f. 6. [Duam ta sjellim të plotë këtë zë kaq të veçantë ndër kritikët shqiptarë: “Natyrisht, në vitet e para poeti me këtë gjuhë jepte përshtypjen në një të ringjalluri biblik, apo të një Konstandini baladik, por me kalimin e kohës lexuesit e panë që poezia e tij kishte vlera, pavarësisht asaj gjuhe (sipas disave), apo, pikërisht për shkak të asaj gjuhe (sipas të tjerëve)”, f. 6 – 7].

² Po aty, po ai, f. 7.

do të ishte mohim i një strukture për të pranuar një tjetër. Për shembull, poezisë me 7 vargje “Këpucët”, e cila vjen në trajtë kornize, ku titulli bëhet pjesë gjymtyrore- si subjekt – i fjalisë së parë dhe asaj të fundit, i mungon struktura që mund të paraqiste një hark kohor, ku autori ka gëzuar aq pak (veç një çast), por njëherësh vjen e pranohet struktura e dhënë me simbolin e këpucëve (ai mund të jepej nëpërmjet rrobave, të ushqyerit, flokëve, fundi, edhe me anë të vetë këmbëve etj.), me të cilat ka ecur një jetë të tërë njeriu. Nga skema kuptojmë se e para njësi drejtuese “Këpucët më vrisnin” nuk pëson “thyerje sintaksore”, kurse njësia II vjen me rend të përmbysur të njësive, “janë vjettrue”; ndryshe njësia III drejtuese u prin dy fjalive të varura homogjene; kështu, në këtë strukturë fraze me 3 njësi drejtuese, e para dhe e treta u prijnë bashkimeve me hipotaksë, kurse e dyta, merr ndërtim tjetër. Gjithashtu, meqenëse këtu flitet për jetë, kohë, moshë, që rrjedh, foljet dalin në të pakryerën, edhe dy mbiemrat antonimikë “të reja” – “të vjetra” përcaktojnë kohë-moshën e njeriut që i ka bartur këto këpucë. Vetë kjo kohë foljore në gjuhët natyrore del e papërcaktuar dhe gjithë vjersha sikur mbahet ndërmjet antonimeve “të reja – të vjetra”:



Poetizimi


Si dukuri stili, fjala në vargje, hyn në lidhje të ndërlikuar, të përvuara e me ngjyrim të reja, me peshë e pavarësi më të madhe brenda stilems.³ Te P.Shllaku na tërheq kjo anë që në titullin e përmbledhjes termi “gjysmë-a”, jo si lemë fjalori shpjegues, por se na kujton një fjalë që për shqipfolësit lidhet me jetën e respektuar në çift: burri apo gruaja, *është gjysma ime*. Ngado që ta kapësh, thënia qëndron në vërtetësinë e një

³ Xhevat Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Albas, Tiranë, 2012, f. 273.

njësimi familjar të patrandshëm. Kurse, tek poezia “Dyshi”, f. 17, dalin stilemat: *jeton në shtjerrje/ jeton në zgrip*, në të cilat sintagmat foljore (SV) kanë në përbërje nga një SP (respektivisht: *në shtjerrje/në zgrip*); themi se poeti ynë ka poetizuar dy fjalë jo aq të përdorura, megjithëse gjenden në Fjalorin e vitit 2006: e para në semantikën e foljes “shtjerr - shtora, shtjerrë,” (shtjerrje-a”),

Prejardhur nga folja “shtjerr”- zdredh fillin, shthur diçka, shtjell, çmbledh; *kund.* tjerr shtjerr; ndërsa e dyta, si lemë më vete tek shkronja përkatëse “zgrip-i”, ka kuptimin: buza e një diçkaje, skaji i një sendi, *zgripit i pullazit*; pakicë, kursim, fundi, mbarimi i një diçkaje; edhe si ndajfolje: pak rrëshqitas etj. Janë dy fjalë tipike geqe, të cilat autori i gjeneron edhe në fjali:

Botë që shtjerret/Botë që rri në zgrip. Po kështu, përdorim stilemor marrin edhe fjalët “fityrë” dhe “shpinë”, kur vijnë e lidhen me leksemën “dashuri”: Dashuria ka fityrë – kur është e pranishme dhe lulëzon, por ajo (dashuria) ka vetëm “shpinë”, kur ikën dhe s’është më e pranishme! Tek *poetizimet* kanë vend edhe sintagma stilemore, si: *tokë me barrë* (tokë e mbjellë), *peizazh film i djegun, dush i shiut, pemë nudo* (pemë e zhveshur), *ideal ere, njollë e hijes, burgos hapin, fjalë grumbull* (krhs. grumbull fjalësh), *arna bore, troku epsharak, çetë e kërrusun hijesh, shpend i nxehtë* (që vjen në stinën e verës), *shtati kokërr, iu rritën krahët, hana e krehte, gjilpana thijash, dielli i radhës, rrinin të papranishëm, shkurti xhelat, thertore e luleve, leson shpirtin, varmale kangësh, kënetë kangësh, gastare e ndryshkun, kangtare e heshtjes, të varen deri në vjetrim, ballë vertikal, reja epshore, tingulli i shurdhët, ishull pa det e brigje, rrethoj me shqisa, katarakt i ngathët, supat e malit, ethet e vigjinisë, karvan megjullash, harron hanën ndezë, akullnajë çarçafësh, diell prendues, zaje fëminije, gjuhë e dritës, trotuare trishtimi, anije e ngurosun, ra në një kapele* (gjeti një kapele), *fjalë të pupulta* (të lehta, pa peshë, si pupël), *breshkë me paruke, zhegu i gojës, start i gojës, rrëzohen fjalët, manmikin deledash, vorrezë fjalësh, shterr sytë, rrokje të drujta, tinguj protezash, andërr e lagun*, etj. etj. Por nuk mungojnë tek poeti Shllaku edhe vargje atributive të cilësive të larta karakterizuese të një sendi apo koncepti, si në dy strofat në vijim:



Efekte stileme japin edhe strukturat fjali, ku këpuja mund të dalë edhe e paparanishme, siç del në vargun II:

...Nata asht dasma,
mueji i mjaltit. (f.51)

...Ky ishte shëj se fjalët
nëse s"kishin mbarue,
ishin kah mbarimi.(f.50)

Gjithë jetën të fshehun
gjithë jetën pa diell
gjithë jetën pa dashuni. (f.51)

Shprehësia poetike jo rrallë, në vjershat e P.Shllakut, ngrihet edhe mbi baza antonimie leksikore, si në shembujt që vijojnë, ku fjalët antonime poetizohen në strukturë fjalie, si bie fjala:

B e s o j a

...Jetojnë nën tokë.
Vdesin nën tokë. (f.51)

...se dashunia ikë,
se dshunia vjen.(f.17)

Po të kisha unë fillim,
ti nuk do të kishe fund.(f.38)

Në stilistikën e vargjeve shkruhet edhe për rastet e përsëritjes së fjalëve, edhe të fjalive të njëpasnjëshme, një dukuri që shkakton *obsesion ligjërimor*, sidomos kur kjo shfaqje gjuhësore kalon tek një *kondensat* mes

kapitujve⁴. Tek poetika e P.Shllakut, përsëritja vjen mjaft e dendur, duke qenë dy llojesh: *fjalë e vargje të njëjta dhe grupe fjalësh me pak ndryshime* dhe *fjali të njëjta ose me ndonjë leksemë të ndryshme*, si në shembujt më poshtë, por në tërësinë e strofës apo gjithë tekstit poetik në tërësi, autori ka arritur “ta zbusë” dukurinë me anën e “rrethimit sintaksor”, si b.f.:

Dashunia i beson të gjitha.
Dashunia i shpreson të gjitha.
Dashunia i “ha” të gjitha.
Dashunia i fal të gjitha.
Dashunia banon te duert... (f.28)

Ai vend i supit tim nën mjekërr
asht nxi
asht mahisë
asht shogë
asht kalbë... (f.45)

Herë-herë, përsëritja poetike shpërndahe përgjatë vargjeve në mënyrë simetrike, si p.sh.:

Ti je një ishull mes gockash të vdekuna,
 i gjatë sa mendimi yt për veten.
 Ti je një ishull pa det e brigje,
 i gjanë sa mendimi yt për mue.
 Ti je një ishull
 me t’vetmin banor vetveten
 i thellë sa mendimi yt për ne të dy. (f.22)

Ndonëse rrallë, me shprehësi të veçantë, autori sjell struktura strofash sindete, sidomos në bashkimet me parataksë, si në fjalinë pyetëse retorike, ku 5 vargjet organizohen vetëm nga një folje, si f.v.:

<i>Gjithë jetën të fshehun,</i> <i>gjithë jetën pa diell,</i> <i>gjithë jetën pa dashuni</i> (f.51)	<i>E zhegun e gojës,</i> <i>e grepat e gojës,</i> <i>e breshkat me paruka,</i> <i>e kurvat me zharretiera</i> <i>kur do t’i them me fjalë?</i> (f.33)	<i>Flisnim për ditën që shkurtohet.</i> <i>Flisnim për freskun e darkës.</i> <i>Flisnim për gjoksin e Maries.</i> (f.49)
--	--	---

Por këto bashkime me parataksë, në vjershat e këtij vëllimi i gjejmë edhe me lidhëza të tjera që u prijnë njësive funksionale, në rastet e homogjenisë sintaksore, si tek poezia “Njeriu i kurrave”:

“Kurr s’kishte pasë dashnore”

që t’ia prishte gjumin
 që t’ia ngatronte orarin

që t’ia turbullonte oreksin
 që t’ia zvirldhte* gruen...

⁴ Po ai, po aty, f. 269. [Për poezinë, do të thoshnim mes strofave, kur ajo nuk del në monokolonë.]

Si njohës i mirë i letërsisë së huaj, në poetikën e P.Shllaku nuk mund të mungonte një shfaqje e përsëritjes përgjatë një teksti të tërë poetik, një model *alla Kipling*,⁵ tek poezia “Kushtore”, f. 38, një vjershërim, që, në vështirimin sintaksor, nis e vazhdon në 20 vargjet, sipas skemës: *dhjetë çifte* frazash-me ndërtim të zhdrejtë “njësi predikative e varur/njësi drejtuese”, duke na shfaqur mundësi të larta shprehjeje të sistemit foljor të gjuhës sonë. Në raste me struktura si këto, janë autorët ata që ia arrijnë të ruajnë masën: der në çfarë pike duhet shtrirë kjo përsëritje, sa duhet zgjatur, me synimin që të ruhet teksti nga monotonia, tepria dhe rënia e përgjithshme e stilit, por njëherësh gjenerim sipas një sintakse të drejtpeshuar për të ruajtur ritmin e poezisë, rendin e kërkuar dhe theksat. Nëse te Kipling-u i flet babai djalit, këtu kushtorja ideore është për të dashurën.

Kushtore

Po të kisha krahë,
do të doja në ty qiellin.
Po të isha deti,
do të doja në ty krypën.
Po të kisha shpirt,
do të doja në ty lirinë.
Po të isha gjallë,
do të doja në ty jetën.
Po të isha qorr e shurdh,
do të urreja terrin e heshtjen.

Po të kisha një sÿ vetëm.
për ty do ta kisha vetëm.
Po të kisha dy sÿ,
do ta shifja në ty botën.
Po të më doje ti,
unë ty kisha më të zhgënjeje.
Po të më zhgënjeje ti,
unë ty kisha më të dashtë.
Po të isha unë fillim,
ti nuk do të kishe fund... (f.38)

Me një lexim të vëmendshëm, mund të hetohet se si poeti, me anë të ndërkëmbimeve leksikore, “e zbut” dukurinë që e quajtmë *kondensat* nëpërmjet raportit të disa fjalëve; së pari, tek njësitë predikative drejtuese: *po të kisha₄/po të isha₄*, autori sjell edhe *po të më doje₁ / po të më zhgënjeje₁*; kurse për njësitë vartëse, ndër dhjetë vargje-fjali me folje në kushtore, poeti ka vënë: *do të doja₄ / do të urreja₁ / do të kisha₄ / do ta shifja₁*. Nga ana tjetër, limitin apo spikune vjershës, autori e shënon edhe me mjete leksiku, si me fjalën “fund”.

Parë me syrin e veprës së U.Eco-s, veç kësaj mundësie stilistike (ndërkëmbimit), siç është obsesioni, poetët kanë edhe një mjet tjetër: kombinimin e fjalëve gramatikore me ato jogramatikore, që rrjedhin nga nyjëtimi i dyfishtë i gjuhëve natyrore, shkruan semiotisti i madh tek sythi

⁵ Rudyard Kipling, **Sikur**, Shtëpia Botuese “Arbri”, Tiranë, 1996. [R.Kipling, 1865-1936, jetoi sa në Indi, ku dhe lindi, aq edhe në Angli. Shkroi në poezi dhe në prozë: përralla, tregime, romane. Veç tjerash, u bë i njohur me vjershën “**IF**”, *sikur*. Kipling është laureat i çmimit “Nobel”, më 1907.]

struktura si sistem që me praninë e fjalëve shënuese dhe i atyre shërbyese, arrihet kohezioni i brendshëm i tekstit: “Rrymat e ndryshme në gjuhësinë bashkëkohore pranojnë një nyjetim (artikulim) të dyfishtë të gjuhës. Në gjuhë nyjtohen në mes tyre njësi të nyjetimit të parë, që kanë kuptim (monema, morfema) që mund të njësohen me fjalën, kombinime të ndërsjella krijojnë njësi më të mëdha që quhen sintagma. Njësitë e nyjetimit të parë, që siç e tregojnë fjalorët, gjenden me shumicë në gjuhë, krijohen me kombinime të njërive të nyjetimit të dytë, fonemat, të cilat janë pa kuptim, por kanë vlera dalluese.”⁶

Fraza poetike të vjershërimit të Primo Shllakut

Nuk mund të kërkojmë e të gjejmë tek poetika e P. Shllakut dukurinë që ndeshet në shumë poezi të metruara e me rimema të rregullta sipas strukturave klasike; kjo vjen si rrjedhojë e vargjeve të lira, me të cilat thuhet vjershërimi i autorit tonë, si në shembujt më poshtë:

Kapa kryet me duer,	4	Gjurmët e tyre të murrme	1
i dhashë fort përpjetë,	nj	e vijat e rrotave	nj
e shkula prej vendit	ë	janë poezia ime e fundit	ë
dhe e përplasa në kalldrëm.	si	për këtë sezon.	si



Që në fillimet e tij (para më se një shekulli), formalizmit rus, përveçse një kredoje letrare, iu përgjigj edhe deviza gjuhësore; ashtu siç shkruante V.Shkllovski në traktain “Ringjallja e fjalës” (1914) se *historia e artit na tregon që gjuha e poezisë nuk është një gjuhë e kuptueshme, por gjysmë e kuptueshme*.⁷ Është e zakonshme që në krijimet e kësaj shkolle (edhe asaj të surealizmit) të shtrihen vargje të tëra pa folje, elipsa të shpeshta, cungime dhe devijansa sintakse, pa shumë ndërmjetime e bashkime njësisht kallëzuesore të shkallëshkallshme, në lidhje hipotaktike. Megjithatë, proza e Shllakut, ngjizja e saj në njësi frazore e superfrastike, dallohet brenda stilit të tij për një *ekonomi gjuhe*, çka shihet edhe si karakteristikë e prozës së tij dramatike e tregimtare. Le të vëmë përballë dy fraza në masë të njëjtë vargësh:

⁶ U Eco, **Struktura e papranishme**, Prishtinë, Dukagjini, 1994, f. 58.

⁷ Primo Shllaku, **Dashunia fillon prej gjysmës** (poezi), Bard Books, Prishtinë, 2019, f.5.[Ndoshta prej këtij gjykimi rrjedh edhe titulli i përmbledhjes poetike të P.Shllakut “Dashunia fillon prej gjysmës”...gjysmës që kuptohet...!]

Mbas shiut që binte vazhdimisht
mes klimës tande
e klimës sime
rrija me trup e zemër tjetërkund
dhe sytë ktej,
kurse karvani i mjegullave të ngrohta
të natës,
hipun në devet e reve të shpërlame
të ditës,
lente mbrapa shkretinën e bardhë
të shtratit tonë të paprishun.(f.24-26)

Dhe ndërsa ngjitesh në majë të flokëve
të erës,
më kujton dallndyshet që ulët fluturojnë
në rrugicë
dhe baltën e çerdhës njomin
me ujin e verdhë të gjurmës
që të pabarabartë e len
gjithkund mbi ballin tonë
çdo gja që shkon e s'kthehet,
çdo gja që kthehet pa shkue kurr,
çdo gja që as shkon, as kthehet.



PËRFUNDIME

Në mbyllje të kësaj paraqitjeje të shkurtër, duhet thënë se, kur shkruajmë për krijues si Primo Shllaku, që lëvron me sukses si poezinë ashtu dhe prozën, që është njëherësh edhe përkthyes, pra gjuhëtar filolog, do të kemi në vëmendje se verbi i tij i takon përgjithësisht variantit të shkruar, të zgjedhur, të traditës së autorëve të veriut, por ai ka mjaft veçori që e dallojnë jo vetëm nga shkrimtarë të traditës geqe të para Luftës II Botërore, por edhe nga ata pak poetë a prozatorë që kanë hartuar vepra letrare në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar edhe në ditët tona.

1. Mund të themi se prodhimi letrar i P.Shllakut në poezi e tejkalon nga cilësia e figurave dhe e stilit, krahasuar me narrativën apo gjuhën dramatike që ai na ka dhënë deri më sot.
2. Gjithashtu, mendojmë se gjuha poetike e krijimtarisë në vargje të P.Shllakut ngjason apo përafrohet me artin poetik të Martin Camajt.

3. Vjershëria e P. Shllakut, qoftë edhe duke u mbështetur në përmbledhjen që sollëm këtu për një vështrim gjuhësor, na vjen mjaft e pasur si në leksik, shprehësi stili dhe me lëndë kaq interesante në ndërtimet sintaksore.
4. Variantet tematike dhe motivet e vargjeve të P.Shllakut në këtë vëllim shoqërohen në masë mjaft të madhe me gjallërime e rigjallërime, sidomos me çpoetizime të fjalës, një kusht i parë për thurjen e poezisë.
5. Duke pasë punuar fort në lëmë të përkthimit, themi se poeti Shllaku ka mundur të sjellë në vjershat e këtij vëllimi mjaft modele gjuhe që i takojnë artit poetik, që e bëjnë atë të njohur në ballë të krijuesve më të mirë të letërsisë sonë.
6. Varianti gegë që përvijon ai, është krejt i pranueshëm në lëmë të letrave shqiptare, me përjashtim se këtij varianti i mungon një kod shkrimor, të cilin autori ynë përpiket ta mbajë në mënyrë të pandryshuar.

BIBLIOGRAFI

- Primo Shllaku, **Dashunia fillon prej gjysmës** (poezi), Bard Books, Prishtinë, 2019.
- Ag Apolloni, **Parathënia e librit** të P.Shllakut, 2019.
- Xhevat Lloshi, **Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika**, Albas, Tiranë, 2012.
- Rudyard Kipling, **Sikur**, Shtëpia Botuese “Arbri”, Tiranë, 1996.
- Umberto Eco, **Struktura e papranishme**, Prishtinë, Dukagjini, 1994.
- ASHSH, IGJL, **Fjalor i gjuhës shqipe**, Tiranë, 2006.
- ASHSH, IGJL, **Gramatika e gjuhës shqipe II**, Tiranë, 1996

A linguistic review of Primo Shllaku's poetics” (Dashunia fillon prej gjysmes)

ABSTRACT

In this paper, we have made the object of linguistic research a collection of poems included in the most recent edition published by the author, in the series called "Libellum", where no more than 22 poems are lined up, which, we think, are in the measure right to judge about a plane of the linguistic (syntactic) structure of Primo Shllak's verses. The matter is followed by the poeticization of separate words and syntagms, in the order of the components of the sentence and the structure of the phrase in relation

to the units of the stanza and the poetic text as a whole, the field of style that studies the art of language. On the other hand, the paper takes a look at the system of word classes, in other words, of parts of speech, as numerical wholes, and as clauses of verses. A separate space, here, is dedicated to the construction of periods, their boundaries and the placement of components in the fabric of this unit.

Keywords: poetics, poetic art, P. Shllaku, syntactic structure

Leonora LUMEZI
Hatixhe SEJDINI

INTEGRIMI I AFTËSIVE TË INOVACIONIT NË MËSIMDHËNIEN E GJUHËS SË HUAJ

Hyrje

Në një kohë kur shumë mësues të gjuhës angleze, në kontekstin e mësimit të saj si gjuhë e huaj, vazhdojnë ende përpjekjet e tyre për të zbatuar me efektivitet qasjen e aftësive të integruara (të lexuarit, të dëgjuarit, të folurit, të shkruarit), një pjesë e mirë e tyre gjenden tashmë përpara një sfide të re: promovimi i aftësive të shekullit të 21-të. Koncepti i aftësive të shekullit të 21-të lindi dhe u zhvillua fillimisht në SHBA në vitin 2007 nëpërmjet ndryshimit apo modifikimit të rezultateve të të nxënit, si një përpjekje për t'i përgatitur më mirë qytetarët e këtij vendi që t'i përgjigjeshin kërkesave të reja të tregut të punës në shekullin e ri. Duke kuptuar se sa të dobishme janë këto aftësi për studentët dhe mësuesit dhe sa të rëndësishme janë ato për karrierën e tyre profesionale shumë vende të tjera, ndër to edhe Shqipëria, filluan ta përmirësojnë sistemin e tyre arsimor duke integruar në kurrikulat e tyre aftësitë e reja të njohura si aftësitë e inovacionit. Kujtojmë këtu se në këtë kuadër në vitin 2014 Ministria e Arsimit dhe e Sportit (MAS) e Republikës së Shqipërisë ndryshoi kornizën kurrikulare të arsimit parauniversitar në të cilën jepen orientimet dhe udhëzimet thelbësore për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës së arsimit parauniversitar shqiptar dhe këtu përfshihen: qëllimi i arsimit, kompetencat kyçe të të nxënit, rezultatet e të nxënit, nivelet e të nxënit, mësime me në qendër nxënësin etj. Ky ishte një hap i rëndësishëm drejt një arsimi më cilësor dhe reflektiv ndaj ndryshimeve dhe kërkesave të kohës. Megjithatë mbetet shumë punë për të bërë për implementimin me sukses të të mësuarit mbi bazën e kompetencave.

Artikulli ynë përqendrohet në aftësitë e të nxënit dhe inovacionit që i përmendëm më sipër (mendimi kritik, komunikimi, bashkëpunimi dhe kreativiteti). Ato iu referohen proceseve mendore që kërkojnë për t'u përshtatur e për të ecur përpara në tregun modern të punës. Këto katër aftësi janë të nevojshme për t'i përgatitur studentët për të ardhmen e tyre sepse ato po pranohen gjithnjë e më shumë si kompetenca që diferencojnë studentët që janë më të përgatitur për jetën dhe tregun e punës nga ata që

nuk i zotërojnë ato. Edhe pse shumica e mësuesve të gjuhës angleze i njohin elementet e aftësive të sipërpërmendura, shumë prej tyre janë ende të paqartë në lidhje me to sepse integrimi i tyre në procesin mësimor është një koncept relativisht i ri. Artikulli në fjalë analizon disa ide dhe studime që aktualisht janë dominuese në sferën e arsimit mbarëbotëror, si një përpjekje për t'i njohur më mirë aftësitë e inovacionit dhe për t'i integruar ato në mësimin e gjuhës së huaj (angleze). Fillimisht do të përqendrohemi në natyrën e veçantë të këtyre aftësive dhe do të hedhim një vështrim të shkurtër mbi qasjet që mbështesin integrimin e tyre në procesin mësimor.

1. Aftësitë e integruara

Mësimi i aftësive të integruara është qasja që bazohet në katër aftësitë gjuhësore (dëgjimin, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit) për të zhvilluar kompetencat komunikuese të nxënësve dhe aftësimin e tyre për ta përdorur gjuhën angleze si gjuhë e huaj në situata të vërteta jetësore. Kjo qasje është frymëzuar nga pikëpamja filozofike se përdorimi i një aftësie të vetme gjuhësore është shumë i rrallë në jetën reale, pasi komunikimi i përditshëm kërkon që njerëzit t'i përdorin të gjitha aftësitë gjuhësore njëherazi. Ky përfundim ka përforcuar idenë e shumë studiuesve, psikologëve e mësimdhënësve, që prej viteve 1980, se integrimi i të katërta^{ve} aftësive gjuhësore në mësimdhënien e gjuhës, duke përfshirë edhe gjuhën e huaj, është një domosdoshmëri. Ndryshe nga qasja tradicionale e të mësuarit të aftësive gjuhësore të ndara nga njëra-tjetra, qasja në fjalë mbështet mësimin e të gjitha aftësive gjuhësore njëkohësisht, në mënyrë që, përveç njohjes së gjuhës që ata po mësojnë, nxënësit të jenë në gjendje edhe ta përdorin atë në komunikimin real. Sipas Hinkel (2010), modelet aktuale të mësimdhënies së integruar të aftësive gjuhësore synojnë zhvillimin e rrjedhshmërisë, saktësisë dhe shkathtësisë në komunikim të nxënësve.

Qasja e ndarë e aftësive gjuhësore dominoi mësimin e gjuhës deri në fund të viteve 1970 për shkak të mbizotërimit të metodave tradicionale të mësimdhënies së gjuhës, të tilla si: Metoda e Përkthimit Gramatikor (GTM), Metoda Audio-Linguale, Qasja Strukturore, Metoda Direkte etj. Nën ndikimin e GTM-së, për shembull, mësimi i gjuhës së huaj përqendrohej kryesisht në analizën e rregullave gramatikore dhe tekstet letrare përktheheshin nga gjuha e synuar në gjuhën amëtare të nxënësit. Për këtë arsye, nxënësit nuk ishin të përgatitur ta përdornin gjuhën si mjet komunikimi në jetën e përditshme. Si pasojë e qasjeve tradicionale, nxënësit njihnin elementet dhe rregullat gjuhësore të gjuhës së synuar, por nuk mund ta përdornin atë për të komunikuar.

Në fund të viteve 1970, qasja e ndarë e aftësive gjuhësore u sfidua nga metoda komunikative e mësimit të gjuhës së huaj (*angl.* Communicative Language Teaching). Sipas saj, për ta përdorur gjuhën e synuar me kompetencë, nxënësit duhet të zhvillojnë si aftësitë pasive (të lexuarit dhe të dëgjuarit) ashtu edhe ato aktive (të folurit e të shkruarit) dhe kjo mund të bëhet në mënyrë efektive duke i mësuar të katërta aftësitë gjuhësore në mënyrë interaktive. Hersan (1988: 22) thekson se për t'u dhënë mundësi nxënësve të përdorin anglishten për të komunikuar, aftësitë në gjuhën angleze "duhet të mësohen të integruara në mënyrë që të mbërrihet lehtë e natyrshëm në komunikim". Sipas qasjes së integruar, të mësuarit e një aftësie ndihmon në mësimin e një ose më shumë aftësive të tjera.

Studime të shumta janë kryer kohët e fundit mbi zbatimin e qasjes së aftësive të integruara në kontekstin e mësimit të gjuhës së huaj në përgjithësi e asaj angleze në veçanti. Një numër syresh që kanë në qendër qëndrimet e nxënësve dhe mësuesve ndaj qasjes së integruar, theksojnë se kjo qasje është e dobishme jo vetëm për nxënësin, por edhe për mësuesin.

Aftësive të integruara në mësimdhënien e gjuhës duhet t'u shtohen edhe aftësitë e inovacionit të shekullit të 21-të të cilat duhet të zotërohen nga nxënësit për të qenë të përgatitur për jetën pas shkollës së mesme. Siç e përmendëm edhe më lart, ato janë komunikimi, bashkëpunimi, mendimi kritik dhe kreativiteti. Këto janë aftësi që individët mund t'i mbartin me vete kurdoherë, nga një projekt në tjetrin, nga një profesion në tjetrin. Bazuar në rezultatet e disa studimeve bashkëkohore, shumë vende e kanë përqaftuar idenë se këto aftësi duhet të integrohen plotësisht në mësimdhënie për të formuar qytetarë dhe profesionistë të përgatitur për t'u përballur me sfidat e shekullit të 21-të.

2. Komunikimi

Meqë gjuha është në thelb një mjet komunikimi dhe objektivi kryesor i mësimit të një gjuhe është të aftësojë nxënësin të komunikojë me anë të saj, mjedisi (klasa) ku mësohet gjuha e huaj konsiderohet si mjaft i rëndësishëm në përmirësimin e aftësive komunikuese të nxënësve. Metoda komunikative e mësimdhënies së gjuhës së huaj, e cila u prezantua në vitet 1970 dhe u bë mbizotëruese më vonë, ishte një përgjigje ndaj nevojës për ta arritur këtë objektiv. Megjithatë ajo është e pamjaftueshme. Komunikimi në kontekstin e aftësive të shekullit të 21-të përfshin një dimension më kompleks sesa ai i shekullit të 20-të. Miller (1996) thekson se edhe në shekullin e 21-të komunikimi vazhdon të jetë "magnet" shoqëror që mban të lidhur kombet, korporatat, disiplinat shkencore e familjet, dhe disa

aspekte të tij, si komunikimi me gojë edhe ai me shkrim, nuk kanë ndryshuar. Por, në shekullin e 21-të, përdorimi gjithnjë e më i madh i teknologjive të reja, si p.sh. video-konferencat, multimediat dhe interneti, kanë ndryshuar në mënyrë rrënjësore komunikimin, i cili përkufizohet ende si aftësia për të ndarë mendimet dhe idetë nëpërmjet të folurit, të shkruarit dhe komunikimit ndërpersonal, por përdorimi në rritje i teknologjive e bën komunikimin e sotëm të pandashëm nga Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (*angl.* ICT). Partneriteti për Aftësitë e Shekullit të 21-të (Partnership for 21st Century Skills (2011b)) thekson se kompetenca e komunikimit në shekullin e 21-të përfshin komunikimin digjital, atë ndërpersonal, komunikimin me shkrim e me gojë, si edhe njohuritë, vlerat, qëndrimet dhe synimet për të kryer një sërë funksionesh, p.sh. për të informuar, udhëzuar, motivuar e bindur, duke përdorur një shumëllojshmëri formash, kontekstesh dhe mjedisesh të ndryshme (si shumëgjuhësinë dhe multikulturalitetin). Prandaj, përveç zhvillimit të aftësive tradicionale të komunikimit me gojë e me shkrim, mësuesit e gjuhës së huaj duhet të promovojnë gjithashtu edhe aftësitë komunikuese të nxënësve me anë të teknologjisë, gjë që kërkon përdorimin e teknologjisë si mjet mësimor. Në procesin e mësimdhënies dhe të nxënësve, aftësitë komunikuese mund të integrohen me aftësitë gjuhësore nëpërmjet qasjes së mësimdhënies me në qendër nxënësin, e cila mundëson bashkëpunimin e bashkëveprimin mes tyre duke i përfshirë në detyra ose projekte. Nxënësit punojnë së bashku të ndarë në grupe për të përfunduar një detyrë, për të zgjidhur një problem, ose për të krijuar një produkt të caktuar. Të mësuarit bashkëpunues u jep studentëve mundësinë të bisedojnë me bashkëmoshatarët, të paraqesin dhe të mbrojnë mendimet e tyre, të shkëmbejnë ide të ndryshme, të vënë në pikëpyetje koncepte të caktuara e të përfshihen aktivisht. Të mësuarit bashkëpunues mund të zbatohet duke përdorur metodat që përmendëm më sipër, veç e veç ose të kombinuara.

3. BASHKËPUNIMI

Në kuptimin e përgjithshëm, bashkëpunim do të thotë të punosh së bashku me persona të tjerë për të arritur një qëllim të përbashkët. Ai përbën një nga rezultatet kryesore të të nxënësve pasi sot organizatat dhe bizneset po operojnë gjithnjë e më shumë në mjedise pune që bazohen tek puna në grup (Dede, 2009). Ndryshe nga shumica e arritjeve të shekullit të 20-të që mbështeteshin në kapacitetin individual, suksesi në shekullin e 21-të bazohet tek puna në grup. Që ajo të ketë themele të forta, është e nevojshme që aftësitë bashkëpunuese të pjesëmarrësve të jenë të larta me qëllim unifikimin e njohurive e përvojës së secilit.

Bashkëpunimi në thelb është pranuar gjerësisht si një qasje mësimdhënieje që ka gjetur zbatim në ndarjen në grupe ose në çifte të nxënësve për të përfunduar një detyrë, për të zgjidhur një problem dhe u jep atyre mundësi të shumta për të mësuar nga njëri-tjetri. Pra, ajo është në përputhje me qasjen socio-kulturore e cila e sheh mësimin si një proces social që ndodh nëpërmjet ndërveprimit midis nxënësve në kontekste të caktuara (Ortega, 2009). Megjithatë, studime të ndryshme (Othman & Murad, 2015) theksojnë se, edhe pse nxënësit e kuptojnë që puna në grup ofron disa avantazhe, si pasurimi i ideve, përmirësimi i arritjeve, dhe rritja e ndërveprimit shoqëror, disa prej tyre ngurrojnë të marrin pjesë aktive në kryerjen e detyrave të ngarkuara dhe disa të tjerë priren të mos përfshihen pothuajse aspak.

Duke kuptuar rëndësinë gjithnjë e më të madhe të bashkëpunimit në shkollë e punë, është e nevojshme të kuptohet që ai nuk duhet kufizuar vetëm tek nxënësit që kanë marrëdhënie të mira shoqërore me njëri-tjetrin ose që punojnë mirë në grup, por duhet të synojë përfshirjen e të gjithë nxënësve. Në çdo punë në grup, nxënësit duhet të mësohen të bashkëpunojnë në mënyrë efektive e të angazhohen sipas udhëzimeve përkatëse për të plotësuar objektivin e vendosur. Në botën globale të shekullit të 21-të, bashkëpunim në procesin mësimor do të thotë që studentët të shfrytëzojnë maksimalisht mundësitë për bashkëveprim gjatë mësimit për të fituar njohuri të reja së bashku.

4. Të menduarit kritik

Koncepti i mendimit kritik është pranuar fillimisht nga Sokrati rreth 2,500 vjet më parë kur ai prezantoi procesin e marrjes në pyetje, i njohur më vonë si Metoda Sokratike, një qasje që synonte rritjen e aftësive arsyetuese të njeriut. Koncepti u rimor nga Dekarti në shekullin e 17-të dhe u zhvillua dhe u nxit nga Xhon Djuj (*angl.* John Dewey) për t'u bërë një komponent i rëndësishëm në programet arsimore perëndimore që nga mesi i shekullit të 20-të (Pardede, 2019b). Megjithëse fillimisht ishte një koncept perëndimor, mendimi kritik tani pranohet si një aftësi thelbësore e edukimit të shekullit të 21-të në mbarë botën dhe rekomandohet edhe si një alternativë pedagogjike për të përmirësuar mësimin e gjuhës. Promovimi i mendimit kritik në mësimin e anglishtes si gjuhë e huaj bëhet edhe më emergjent nëse marrim në konsideratë rezultatet e disa studimeve aktuale si Sadli (2002), Rashid & Hashim (2008), Rujivanarom (2016), Rear (2017), etj., të cilat tregojnë se shumicës së nxënësve që studiojnë gjuhën angleze si gjuhë e huaj, veçanërisht në Azi dhe Afrikë, u mungojnë aftësitë e nevojshme të të menduarit kritik.

Meqenëse mendimi kritik është një proces mendor kompleks që përfshin aftësi njohëse të ndryshme dhe shumëdimensionale, ai është interpretuar ndryshe nga studiues të ndryshëm. Megjithë ndryshimet në këndvështrim, të gjitha përkufizimet përfshijnë elementet kryesore të menduarit kritik, si: të kuptuarit, kujtesa, analiza, vlerësimi, krijimi, interpretimi, deduksioni, shpjegimi e vetëreflektimi.

Nxënësit duhet të zhvillojnë mendimin kritik sepse ai i ndihmon të jenë individë aktivë dhe të mësojnë në mënyrë efektive gjatë gjithë jetës, të arrijnë të kuptojnë e të vlerësojnë qasje të ndryshme, të përmirësojnë aftësinë e tyre për të zgjidhur problemet, të kontrollojnë mendimet e tyre dhe të zhvillojnë kriteret dhe standardet e duhura për të analizuar të menduarit. Studiuesit theksojnë se nxënësit e gjuhës së huaj duhet të zhvillojnë të menduarit kritik, sepse ai rrit aftësitë e tyre për të pyetur, analizuar, kritikuar, reflektuar e sintetizuar. Në kontekstin e mësimit të gjuhës së huaj, studiues të shumtë kanë arritur në përfundimin se integrimi i të menduarit kritik rrit ndjeshëm aftësitë gjuhësore të nxënësve.

Literatura ofron teknika dhe strategji të ndryshme për të integruar mendimin kritik në mësimin e gjuhës së huaj. Klynhout (2018) sugjeron përdorimin e pyetjeve që nxisin mendimin, të tilla si: „Pse mendoni se...?“, „Si e dini që...?“, „Çfarë ju thotë...?“, për të zhvilluar të menduarit kritik gjatë gjithë procesit të të mësuarit. Prandaj, pyetjet me një përgjigje të vetme, ose që mund të marrin përgjigje me një Po ose Jo të thjeshtë, duhen shmangur. Pyetjet që nxisin të menduarit u japin mundësi nxënësve të shfaqin të kuptuarit saktë të një situate a koncepti dhe të promovojnë analizën dhe interpretimin. Trajnimi i nxënësve për të bërë pyetjet e duhura për të rritur aftësitë e tyre për të reaguar në mënyrë kritike me anë të tregimeve të shkurtra, eseve e faqeve të internetit, (Brown & Keeley, 2007) është gjithashtu një strategji efektive. Pyetjet e duhura mund të nxisin aftësitë e nxënësve për të gjykuar fjalime, për të formuar argumente, për të shkruar ese kritike dhe për të nxitur aftësitë e leximit dhe shkrimit duke i lënë nxënësit të flasin mbi një temë, të lexojnë ose shkruajnë rreth saj. Për më tepër, ndarja në grupe e nxënësve për të diskutuar ose debatuar mbi një temë, për të zgjidhur problemet e jetës reale, për të diskutuar ese, reklama ose medime të tjera, ose për të kryer një projekt, mund të përmirësojë në mënyrë të përsosur mendimin kritik të studentëve.

Një aktivitet që nxit të menduarit kritik mund të jetë, për shembull, shfaqja e posterave me citime apo aforizma frymëzuese në klasë. Kjo mund t'i nxisë nxënësit të diskutojnë e të debatojnë në mënyrë kritike. Në këtë kontekst, mësuesi duhet t'i inkurajojë nxënësit të analizojnë e të diskutojnë domethënien e çdo mesazhi dhe t'u kërkojë atyre shembuj të

aplikimit në situata reale. Disa thënie i nxisin drejtpërdrejt nxënësit të shpalosin fantazinë e tyre. Ndërsa angazhohen në aktivitete të tilla, nxënësit zhvillojnë gjithashtu edhe aftësitë e tyre të integruara gjuhësore për të bërë kërkim, për të lexuar tekste, për të nxjerrë informacion real, për të mbajtur shënime, për të shkëmbyer ide, për të dëgjuar mendimin ndryshe, për të mbrojtur pikëpamjet e tyre e për të bindur shokët të marrin pjesë aktive në grupin e punës.

5. Kreativiteti

Edhe pse kreativiteti shpesh sinonimizohet me mendimin krijues, ato janë dy koncepte të ndryshme. Kreativiteti përfshin proceset ose ndërveprimet që gjenerojnë ide, mendime dhe produkte të reja, ndërsa mendimi krijues i referohet aftësive të të menduarit të cilat i mundësojnë një individ gjenerimin e ideve, mendimeve dhe produkteve origjinale ose të reja. Literatura jep përkufizime të ndryshme të kreativitetit. Sternberg (2001) e përkufizon atë si një numër aftësish që janë të nevojshme për të prodhuar ide sa origjinale aq edhe të vlefshme. Për Koestler (1964), kreativiteti ka të bëjë me të krijuarit, por nuk duhet të konceptohet gjithmonë si krijimi i diçkaje nga asgjëja. Është më e përshtatshme ta konceptojmë atë si një akt riorganizimi apo rigrupimi të elementëve ekzistues. Ai thekson se krijimtaria “zbulon, zgjedh, riorganizon, kombinon dhe sintetizon faktet, idetë, aftësitë ekzistuese. Sa më të njohura të jenë pjesët, aq më e goditur është e gjithë e reja” (f. 120). Këto përkufizime tregojnë se krijimtaria është e lidhur me risinë, efektivitetin dhe etikën në përdorimin e ideve, produkteve, proceseve, analogjisë ose mjeteve.

Bota e shekullit të 21-të karakterizohet nga konkurrenca globale dhe automatizimi i punëve. Në një botë të tillë kërkohet gjithnjë e më shumë një frymë krijuese dhe aftësi inovatore për sukses personal dhe profesional. Trendet e fundit pohojnë nevojën për kreativitet në vendin e punës. Gjithnjë e më shumë, kreativiteti po bëhet kërkesë e nevojshme për çdo lloj pune. Shumë nga kompanitë botërore më të mëdha, si p.sh. Google, kërkojnë që punëtorët e tyre të shpenzojnë deri në 20% të kohës duke menduar në mënyrë krijuese për mundësi të reja biznesi. Për të përballuar sfidën, është e domosdoshme që mësuesit e sotëm të ushqejnë fantazinë tek brezat e rinj. Robinson (2011) ka theksuar se “kreativiteti në arsim është po aq i rëndësishëm sa edhe shkrim-leximi dhe ne duhet ta trajtojmë atë me të njëjtin status.”

Elementet e tij - risia, efektiviteti dhe etik - e bëjnë kreativitetin të shkojë krah për krah me të mësuarit, sepse të menduarit krijues përputhet

shumë mirë me teorinë konstruktiviste e cila e sheh mësimin si një proces të krijimit të kuptimit dhe njohurive nëpërmjet përvojës dhe reflektimit mbi të. Duke i parë nga ky këndvështrim, të mësuarit dhe të menduarit krijues janë dy procese prodhuese. Në mënyrë të ngjashme me një mendimtar krijues që gjeneron diçka të re, një nxënës që mëson duke përdorur metodën konstruktiviste është gjithashtu krijues aktiv i dijes e jo pritës pasiv i njohurive. Si krijues, ai pyet, eksploron dhe vlerëson aktivisht atë që di gjatë procesit të të mësuarit. Me pak fjalë, të menduarit dhe të mësuarit krijues janë dy procese të mbivendosura që përforcojnë njëri-tjetrin.

Për të nxitur kreativitetin tek nxënësit mund të përdoren detyra e aktivitete të ndryshme. Një aktivitet mjaft interesant e i dobishëm mund të ishte edhe krijimi i një skenari imagjinar sipas të cilit nxënësit duhet të mendojnë në mënyrë krijuese për ta kaluar atë me sukses. E tillë mund të jetë p.sh. një situatë imagjinare sikur dikush gjendet i izoluar në një ishull dhe duhet të mbijetojë pa asnjë ndihmë, për të paktën tri ditë. Ka një sasi të kufizuar ushqimi dhe uji dhe duhet të ndërtojë një strehë me mjete rrethanore. Klasa ndahet në grupe. Mësuesi duhet t'i inkurajojë nxënësit të punojnë së bashku dhe të dëgjojnë me vëmendje çdo nxënës që ka një ide se si mund t'ia dalë mbanë në mënyrë sa më të sigurt.

Kërkimi shkencor ka vërtetuar gjithashtu se të mësuarit e një gjuhe të huaj rrit në mënyrë të konsiderueshme kreativitetin e një nxënësi dhe anasjelltas, integrimi i kreativitetit në mësimdhënie rrit aftësinë gjuhësore të studentëve. Mësimi i EFL¹-së në një nivel të avancuar zhvillon në mënyrë të konsiderueshme aftësitë krijuese të të menduarit. Studimet kanë treguar gjithashtu se dygjuhësia është e lidhur me rezultate të ndryshme njohëse, si p.sh. rritjen e kontrollit të vëmendjes, forcimin e kujtesës, ndërgjegjësimin metalinguistik dhe aftësive abstrakte dhe simbolike të ligjërimit. Nga ana tjetër, kreativiteti përmirëson edhe mësimin e gjuhës së huaj. Vasudevan (2013) arriti në përfundimin se të menduarit e të mësuarit krijues, mësimdhënia krijuese, qëndrimi dhe angazhimi i mësuesve ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në aftësitë e gjuhës së huaj të nxënësve.

6. PËRFUNDIME

Duke u nisur nga analiza e mësipërme arrijmë në përfundimin se zhvillimet e reja ekonomike e shoqërore diktojnë ndryshimin dhe përmirësimin e shumë aspekteve të sistemit arsimor. Ndër to është edhe

¹ EFL, akronim në gjuhën angleze: English as a Foreign Language (Anglishtja si Gjuhë e Huaj).

mësimdhënia e cila duhet t'i përgjigjet kërkesave të kohës. Meqenëse fokusi i vëmendjes sonë është mësimdhënia e gjuhës së huaj, kryesisht asaj angleze, u ndalëm në nevojën për të integruar në këtë proces aftësitë e të nxëniet dhe inovacionit ose aftësitë e shekullit të 21-të, që përfshijnë komunikimin, bashkëpunimin, të menduarit kritik dhe kreativitetin. Duke përkufizuar dhe shpjeguar secilën prej tyre theksuam rëndësinë e integritit të tyre në mësimdhënie. Kjo është një kërkesë emergjente e kontekstit të ri të të nxëniet në shekullin e 21-të i cili e bën domosdoshmëri përfshirjen e aftësive të inovacionit krahas atyre tradicionale në mësimdhënien e gjuhës së huaj, për të pajisur nxënësit e studentët tanë me aftësitë e nevojshme për jetën.

BIBLIOGRAFI

- Avila, H. A. (2015). Creativity in the English class: Activities to promote EFL learning.
- Bloom, B. S. et al (1956). *Taxonomy of educational objectives: The classification of educational goals. Handbook I: Cognitive domain*. New York: David McKay Company.
- Borhany, M., Tahriri, A. & Tous, M.D. (2015). The Impact of Explicit/Integrated Instruction of Listening Comprehension Strategies on EFL Learners' L2 Listening Comprehension and their Overall Strategy Use. *Journal of Applied Linguistics and Language Research*, 2(8), fq.128-144
- Brown, H. D. (2001). *Teaching by principles: An interactive approach to language pedagogy (2nd Ed.)*. New York: Pearson Education.
- Brown, M.N. & Keeley, S.M. (2007). *Asking the right questions: A guide to critical thinking*. Pearson Prentice Hall: New Jersey.
- Cropley, A.J. (2001). *Creativity in education and learning: a guide for teachers and educators*. London: Kogan Page Ltd.
- Dede, C. (2009). *Comparing frameworks for "21st century skills."* In J. Bellance & J. R. Brandt (Eds.), *21st century skills: Rethinking how students learn* (fq. 51–76). Bloomington, IN: Solution Tree Press.
- Harmer, J. (2007). *The practice of English language teaching*, Pearson Longman, Harlow.
- Hersan, M. Z. (1998). *The integration of reading and writing through pair and group work*. A Master's Thesis, Hacettepe University, Ankara.
- Hinkel, E. (2010). Integrating the four skills: Current and historical perspectives. In Kaplan, R.D. (Ed.), *Oxford handbook in applied linguistics* (fq. 110-126). Oxford: Oxford University Press.
- Klynhout, M. (2018). *A concrete example of how to add a layer of 21st-*

century skills to lesson plans. Marrë nga <https://whatifspirit.com/en/a-concrete-example-of-how-to-add-a-layer-of-21st-century-skills-to-lesson-plans/>

- Miller, C. R. (1996). *Communication in the 21st Century: The original liberal art in an age of science and technology*. Center for Communication in Science, Technology, and Management of North Carolina State University.
- Othman, H. G. & Murad, I. H. (2015). *A Study on Kurdish Students' Attitudes to Group work in the EFL Classroom*. *European Scientific Journal*, 11(11).
- Pardede, P. (2007). *Developing Critical Reading in the EFL Classroom*. Marrë nga https://www.researchgate.net/publication/329557401_Developing_Critical_Readin_g_in_EFL_Classroom
- Pardede, P. (2011). *Using Short Stories to Teach Language Skills*. *Journal of English Teaching*, 1(1), 14-27. DOI: <https://doi.org/10.33541/jet.v1i1.49>
- Pardede, P. (2019). *Integrated Skills Approach in EFL Classrooms: A Literature Review*. In: *PROCEEDING English Education Department Collegiate Forum (EED CF) 2015-2018*. Jakarta: UKI Press, 147-159
- Pardede, P. (2019). *Using Fiction to Promote Students' Critical Thinking*. *Journal of English Teaching*, 5(3), 166-178. DOI: <http://dx.doi.org/10.33541/jet.v5i3.1309>
- Pardede, P. (2019). *Pre-Service EFL Teachers' Perception of Blended Learning*. *Journal of English Teaching*, 5(1), 1-14. DOI: <https://doi.org/10.33541/jet.v5i1.955>
- Partnership for 21st Century Learning. (2011a). *Framework for 21st Century Learning*. Marrë nga <http://www.p21.org>
- Partnership for 21st Century Skills. (2011b). *Communication and Collaboration*. Retrieved from <http://www.p21.org>
- Rashid, R.A. & Hashim, R.A. (2008). *The relationship between critical thinking and language proficiency of Malaysian undergraduates*. EDU-COM 2008 International Conference. Marrë nga ro.ecu.edu.au/ceducom/36/
- Rear, D. 2017. *Reframing the Debate on Asian Students and Critical Thinking: Implications for Western Universities*. *Journal of Contemporary Issues in Education*, 12(2), 18-33.
- Rujivanarom, P. (2016). *School system's failure to teach logical thinking linked to low PISA scores*. *The Nation*. Marrë nga <http://tinyurl.com/l68ugux>.
- Sadli, S. (2002). *Feminism in Indonesia in an international context*. In K. Robinson & Bessell, S. (Eds.), *Women in Indonesia: Gender, equity, and*

- development* (pr. 8092). Singapore: Institute of Southeast Asian Studies.
- Sternberg, R. J. (2001). *What is the common thread of creativity? Its dialectical relation to intelligence and wisdom*. *American Psychologist*, 56(4), 360–362. <https://doi.org/10.1037/0003-066X.56.4.360>
 - Vasudevan, H. (2013). *The Influence of Teachers' Creativity, Attitude and Commitment on Students' Proficiency of the English Language*. *Journal of Research & Method in Education (IOSR-JRME)*, 1(2), 12-19
 - Day, C., (2002). *Developing Teachers: The Challenges of Lifelong Learning*, Palmer Press, London.
 - Fullan, M. (2001). *Kuptimi i ri i ndryshimit në arsim*. CDE. Edualba. Tiranë.
 - Instituti i Studimeve Pedagogjike (2003), *Hartimi dhe vlerësimi i teksteve shkollore*, Tiranë.
 - Llambiri, S., Abdurrahmani, T., & Mulla, A., (2011). *Analiza krahasuese e kurrikulës aktuale të arsimit bazë me atë të vendeve të tjera*. Ministria e Arsimit dhe Shkencës & Instituti i Zhvillimit të Arsimit, Tiranë, Shqipëri.
 - Mehmeti, S. & Buleshkaj, O. (2017). *Përdorimi dhe zbatimi i programeve mësimore të hartuara në bazë të kurrikulës së bazuar në kompetenca*. Kërkime Pedagogjike, 2017 përmbledhje punimesh nr.6, fq 10-50. Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë.
 - Musai, B. (2014). *Metodologji e mësimdhënies*, bot.2, CDE, Tiranë.

Integrating innovation skills in foreign language teaching

ABSTRACT

In the 21st century, rapid globalization and digitization are increasingly changing our way of life, interaction, learning and working. As a result, to be successful today, apart from some basic knowledge and skills, our students should also be armed with the innovation skills, already known as the four skills of the 21st century, which include communication, collaboration, critical thinking and creativity. In the context of foreign language teaching and learning, to meet the new challenges, teaching should not only focus on developing students' language skills, but also integrate the four above-mentioned skills. This article sheds light on the ideas and results of scientific research with regard to learning skills such as communication, collaboration, creativity and critical thinking, and emphasizes the importance of integrating them into teaching to prepare

students for a successful professional career and equip them with civic values.

Key words: innovation skills, integrated skills, learning context, communication, collaboration, critical thinking, creativity

Alfred ÇAPALIKU

POEMA E PARË E KOLË THAÇIT*“Kolë Thaçi e bgatë leksikologiën e gjûhës shqype.”***Gjergj Fishta****PROLOG**

Kolë Thaçi (Shkodër 2 dhjetor 1886 - Tiranë 14 korrik 1941), përmes pseudonimeve “**Sh. P.**” dhe “**Dora e harrueme**”, botoi katër poema epiko - lirike gjatë intervaleve 1916 - 1917 - 1918 - 1921 dhe një poemë lirike në intervalin disi më të largët të vitit 1937 në Shkodër. Profili si poet, i skicuar krejt në vagëllim tek tri vjersha heroiko - komike të vitit 1916 dhe mjaft kalimthi tek gjashtë poezi lirike gjithnduersh të segmentit kohor 1936 - 1937 në atë qytet, realizohet i plotë si portret ekspresiv te pesë poemat e tij përfaqësuese, ku:

“ ... nuk flitet vetëm për veprimet dhe qëndrimin e personazheve, për ngjarjet në të cilat ata marrin pjesë, por paraqiten edhe përshtypjet e ndjenjat që i linden vetë poetit nga rrethanat e jetës, nga personazhet dhe veprimet e tyre. Kështu fluturimet lirike gërshetohen me paraqitjen epike, tregimtare të ngjarjeve.”¹

Poemat e Kolë Thaçit formojnë pesë kolana arti kushtuar ngjarjeve aktuale filtruar në memorie apo atyre të rikujtuara plot emocion. Duke pasur një frymëmarrje më të gjerë sesa motivet e tubës së poezive, ato japin:

Së pari, dallgët e fuqishme të Luftës së Parë Botërore dhe mbijetesën në shkullmin e tyre të popullit shqiptar.

Së dyti, përjetimet drithëruese shpirtërore nga ringritja madhështore e Tempullit të Shën Marisë.

Së treti, himnizimin personal e glorifikimin masiv të Ditës së Lume të Pavarësisë. Së katërti, lartësimin e figurave historike kombëtare, si roje të Shqipes së Flamurit. Së pesti, vallzimin e Zanës mitologjike në jubileun XXV të ardhjes së lirisë.

Profesor Selman Riza në një triptik monografish albanologjike, të botuar në Tiranë në vitin 1944, përshkruan sfondin kulturor kombëtar ku Qarku i Veriut krijoi një:

¹ Ferdinand Leka: *Fjalor i termave të letërsisë*. Tiranë, 2013, f. 235.

“... hart klasiçizues, estetiçizues.”²

Ndërsa eseisti Gazmend Krasniqi në sprovën antologjike rreth poezisë shqiptare, të botuar në Tiranë më 2003, i specifikon cilësitë e ligjëritimit klasik në këtë mënyrë:

*“Kemi një art të shprehjes, jo të shpikjes: fjalët rrotullohen në syprinë sipas një sqime elegante e zbukuruese. Ato ne i pëlqejmë nga formulimi që i bashkon...”*³

Poetizmi tradicional i Kolë Thaçit është shfaqje e neoklasicizmit në pikëtakimin e letërsisë romantike me atë realiste shqiptare, sidomos tek pesë poemat e tij epiko – lirike që shpalosin ide. Të pesta paraqesin rrëfime poetike me shfrime ndjenjash, përmes një shtrirjeje të gjerë ndër variacione strofash dhe kombinime metrash.

“SJELLA E MOTMOTIT” (1916)

Ndër më të vonët e Letërsisë së Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe ndër më të parët e Letërsisë së periudhës 1912 - 1939, autori Kolë Thaçi debutoi si poet tek revista “Perparimi” në Shkodër, në janar 1916, me një poemth epiko - lirik depërtues në psikën e lexuesve, titulluar “Sjella e motmotit”. Ai reflektoi aty shkulmet e Luftës së Madhe, që flakëroi qiellin, tokën dhe detin evropian. Në të nuk ka dualizëm mes imagjinatës dhe realitetit, gjithçka që përfytyron poeti vjen nga i njëjti burim që është si shkulm nga gjaku i tij. Krijimi i spikatur me sistemin e gërshetuar të eksklamacionit, pyetjes retorike, antitezës, simbolit, metaforës, metonimisë, epitetit, krahasimit, paralelizmit figurativ, sinekdokës, enumeracionit, anaforës, inversionit, mbartjes së mendimit, asociacionit poetik, është organizuar në pesëmbëdhjetë strofa fort të rralla në prozodinë shqiptare. Secila prej tyre ka nëntë vargje të rimuara me kombinime të njëmbëdhjetë e shtatërrokëshit në skemën A B A B C D E D E . Vargu i pestë i strofës së parë, rimues me **të pestin e të tjerave**, formon kadencën imitative të përsëritjes së tmerrit çdo ditë dhe natë:

*“Shife topitë nder çeta shkencetare
Mënden e naltë, e shife
Tuj pluskue zëmren neper lâmbë barbare
Nen t” pergjakta kadife;*

² Selman Riza: *Tri monografia albanologjike*. Tiranë, 1944, f. 142.

³ Gazmend Krasniqi: *Sprovë antologjike*. Tiranë, 2003, f. 11.

*E aty kû mizoria
Mâa e rrebtë gjimon, â tuj u trêmë natyra,
Kaq permî bjeshkë, mî fusha
Kaq kafshave me mndêr i ndrroj krejt ftyra
Robi t'' u grîi porsi me ulâj harusha."*

Vargjet 55 - 63.

Lufta e Parë Botërore (1914 - 1918), e zhvilluar mes Marrëveshjes Tripalëshe dhe Fuqive të Antantës, mobilizoi 74 milionë ushtarë e pati pasojë vrasjen e 10 milionë njerëzve. Poeti zbulon dhimbjen e njerëzve të plagosur në shpirt nga humbja e të dashurve fundnatës së 1916-ës, kur trokiste me predha vdekjeje Viti i Ri 1917:

*"Ah nuk â pûnë me ndîi gazmënd kuer vjeta
Âsht tuj prendue kso dore,
E djelmeve t'' Europës i kputet jeta
Me furîi kaq mizore..."*

V. 73 - 76.

Ndër 135 vargjet e ritmuara jambike, daktilike, trokaike, përmes ulje - ngritjeve të monologut të ndërprerë nga llava shfarosëse e luftës, heroi lirik i mishëruar me autorin e përjeton përgjakjen. Por shpirti i tij i copëtuar e mposht tronditjen kur:

*"Ushtria
E qillorve me mâall rrin tuj prigue..."*

V. 122 - 123.

Heroi lirik shpreh besimin e fortë se dora e Zotit do ta ekuilibrojë botën në paqe, me ardhjen e motmotit të ri. Urimi vjen me nota lutëse dhe përgjëruese universale:

*"Deh sbutu o Perëndii! Jo mâ e fajtorit
Krejt e helmueme luta
Zêmren t'' a thejnë saa vigmat e gjallnorit
Qi fmîin e pshtuellë nder futa;
I mêen paa prâa fuqia
Vejushës per foshnje edhë ja then me grîma
Bukën e thaat tuj britë:
Deh sbutu, o Perëndîi ! : qe saa jetima
Prej Tejet per mot t'' rîi paq jânë tuj pritë !!!"*

V. 127 - 135.

Poemthi epiko - lirik "Sjella e motmotit" i shkruar me stilin neoklasicist u parapri në botim nga shënimi pohues dhe mjaft entuziast i redaksisë së revistës "Përparimi", i shprehur përmes pendës së drejtuesit At Francesco Genovizzi SJ :

“Qe një poezi që difton, sesi mundet gjithë e jonë m’u perdorur bukur mirë edhe për shllime e mendime t’ nelta. Njikë kangë lirike është si jehona e dishireve t’ popujve marë që lakmojnë me baa lum e lum për t’ ardhun t’ pagjes s’ dishrueme mas luftes s’ madhe që a tuj pergjakun t’ tanë Evropën. Kjo poezi e pershkruen motmotin si me thënë n’ vetvedi a spekulativisht ; masandej n’ lidhni me ndollina a rasa që e ngelisin e e caktojnë n’ historinë t’ pergjithshme t’ jetës ; e n’ e mrâm mas pikpamjet moralishte t’ veprimeve, vjerrë shpnesen për një motmot maa t’ lum e t’ kândshem shi përmi Atë, që tuj e pasë krejt n’ dorë me rasa e ndollina, ja sjell komeve t’ dheut n’ permâse t’ drejtë me meritim t’ veprave t’ tyne .”⁴

“Cirka” në Shkodër, revistë politike, kulturore, folklorike, satirike, e ribotoi poemthin “xhevahir” të Thaçit më 1939, me një shënim redaksional afirmues të drejtorit Cuk Simoni:

“Po botojmë një poezi, që për idë të këthellta që përmban, për shvillim lirik me të cillin a gershetue, për stilin e naltë e për tekniken e persosun me të cillen a shkruet, xën një vënd të posaçem në letërsinë t’onë.”⁵

Rikthimi i poemthit “Sjella e motmotit” të Kolë Thaçit tek lexuesit e rinj mbas rreth një çerek shekulli dëshmon për vlerat konkurruese artistike edhe në stinën e një kohe tjetër poetike.

ABSTRACT

The first poem of Kolë Thaçi: „The change of the year“

Especially the re-publication of the poem of Kolë Thaçi „The change of the year“ - “Sjella e motmotit” in the magazine “Cirka” No. 56 - 57 in 1939 in Shkodra show that this work was requested by the public, even after twentyone years of his appearance for the first time in the press. The poem is the best evidence of the success as the mentality of the literature work of Kolë Thaçi. The poem reflect step by step the historical development of Albanian Language. His signature, even hidden behind the pseudonym, gives the reflex to the pearl of literary art tradition. The lack of signature of Thaçi’s work makes that one cog misses to the precious values that belong to “30-s of twentieth century.

Ars longa, vita brevis.

⁴ Shënim i redaksisë: (Pa titull). Rev. “Perparimi”. Shkodër, 1916. Nr. 1, f. 4.

⁵ Shënim i redaksisë: “Fletë të harrueme të shkrimtarëve t’ onë”. Rev. “Cirka”. Shkodër, 29 janar 1939. Nr. 56 - 57, f. 3.

Arben PRENDI
Valbona KARAKAÇI

BALADA SHQIPTARE E RINGJALLJES, PËRKIME ME TRADITËN ZAKONORE

Baladat janë ndër llojet më të pasura dhe më të arritura artistikisht në epikën gojore shqiptare. Ato kanë njohur një përhapje të gjerë në të gjithë territoret ku jetojnë shqiptarët: në Shqipërinë e sotme, në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi, në Çamëri dhe tek Arbëreshët e Italisë. Pavarësisht pikave të takimit që ato kanë me simotrat e tyre ballkanase dhe botërore është e dallueshme se në to është shprehur bota morale, zakonore e popullit shqiptar. Në baladat shqiptare me motivin e ringjalljes, të flijimit të njeriut apo me motivin e rinjohjes. Në këto këngë, sikurse në krijimet tjera gojore (në përshkrimet, personazhet dhe subjektet e tyre) parësore është kjo botë. Në baladat shqiptare me motivin e ringjalljes, të flijimit të njeriut apo me motivin e rinjohjes, mund të identifikojmë disa tipare që kanë të bëjnë me botën e familjes tradicionale shqiptare dhe traditën zakonore shqiptare, si: besa, nderi, martesë, përkujdesja dhe nderimi për anëtarët e familjes, marrëdhëniet mes nënës dhe fëmijëve, vëllait e motrës, burrit dhe gruas, vëllait me vëllanë etj.

Krahas motiveve universale shprehen motive dhe norma zakonore të lidhura specifikisht me botën tradicionale shqiptare. Kështu në baladën e flijimit të njeriut, pothuajse në të gjitha variantet shqiptare, krahas motivit universal të flijimit në themelet e një ndërtimi të ri, kemi motivin e mbajtjes së fjalës së dhënë dhe besën. Madje në aspektin përmbajtësor, motivi i dytë del në pah dhe merr peshë kuptimore po aq sa flijimi i njeriut. Arsyeja është e qartë për një audiencë e cila deri në gjysmën e parë të shekullit XX e ka këtë normë të traditës zakonore ende aktive në jetën e përditshme, madje një nga parimet bazë të kësaj jete, e cila, gradualisht prej krijimit të shtetit shqiptar (1912) e më tej do të zëvendësohet nga ligjet e shkruara. Baladat shqiptare të sipërpërmendura kanë karakter të theksuar legjendar, ahistorik, edhe në ndonjë rast ku hyn ndonjë element historik, ai është thjesht një shtesë dhe përshtatje e krijuesit gojor me rrethanat e reja jetësore.

Besa

Me po këtë peshë kuptimore na del *besa* edhe te këngët me motivin e ringjalljes së njeriut, prej së cilës, në letërsinë gojore shqiptare njihen rreth 100 variante dhe dallohen tre grupime të saj: *Kënga e Halil Garrisë*, *Kënga e Dhoqinës* dhe *Kënga e Kostandinit dhe Garentinës*¹. Kur premtimi, fjala e dhënë, besa, i jepet nënës, është nëna ajo që duke qarë e vajtuar ia përmend atë djalit të vdekur. Në këto variante nëna është në pozitën e prindit dhe të drejtueses së familjes, por nuk mund ta ndalojë vendimin e vëllezërve apo të Kostandinit/Halil Garrisë për të martuar të motrën larg. Siç është vënë në dukje nga studiuesi Fatos Arapi: “Te shqiptarët vajtimi i motrës dhe i nënës mbruhën edhe me besën”². Lotëve, vajtimin, mallkimit që gjenden edhe në variantet ballkanike, këtu u është bashkëngjitur edhe “besa”.

Në këngët shqiptare motivi i ringjalljes dhe motivi i besës marrin të njëjtën peshë kuptimore. Kostandini nuk ringjallet për të provuar si është ringjallja dhe mundja e vdekjes, nga dëshira për t’u rikthyer në jetën e të gjallëve, apo për të kërkuar të jetë i pavdekshëm, por për të mbajtur besën/fjalën e dhënë nënës dhe motrës sa ishte gjallë. Me ta kryer këtë detyrë ai kthehet menjëherë në botën tjetër pa as më të voglin hezitim për bukurinë e botës së gjallë. Duket se krijuesi popullor dhe audienca e tij, me kalimin e kohës e ka pranuar se ringjallja thjeshtë për të qenë i pavdekshëm është një aventurë pa kuptim, por merr kuptim ringjallja afatshkurtër për të kryer një detyrë për të cilën ai do të hyjë në këngë, domethënë në kujtesën popullore. Madje ai është krejt i ftohtë ndaj ringjalljes, nuk e tërheq më asgjë, ndërsa nuk takohet as me të ëmën. Edhe kur motra në ndonjë variant përpiket ta mbajë për dore ndërsa hyn në varr, kapaku i tij mbyllet përjetësisht³.

Si njeri, heroin e shqetësojnë lotët e nënës dhe motrës, ndërsa si shqiptar tradicional e shqetëson përmendja e besës së dhënë, ndaj ringjallet për ta mbajtur atë dhe për të qetësuar lotët e nënës dhe motrës. Në këto këngë, sikurse e kanë komentuar edhe studiues të tjerë shqiptarë dhe të huaj, është bashkëngjitur në motivin universal, *ringjalljen*, një element i rëndësishëm për botën morale zakonore shqiptare, *besa e shqiptarit*. Heroi edhe pse gjindet në të gjitha baladat ballkanike dhe kryen të njëjtin veprim, ringjalljen, me mbitheksimin e besës ai shpreh botën dhe mentalitetin e shqiptarit tradicional për të cilin “besa” deri në kohën moderne ka luajtur një rol të rëndësishëm në të jetuarit me dinjitet në rrethin e tij familjar e

¹ Velaj, Olimpi. *Balada nga oraliteti në letërsi*. Tiranë, 2020, f. 162.

² Arapi, Fatos. *Këngë të moçme shqiptare*. Tiranë, 1986, f. 30.

³ Zoto, Vladimir. “Motra me shtat vllazen” në *Balada shqiptare*. Dasara, 2006, f.86.

shoqëror, por edhe në raport me kombësitë e tjera. Besa “*është një fjalë e nderit, që jep njeriu, një betim, një zotim ose një armëpushim. Në kulturën shqiptare, besa është vështruar si diçka e shenjtë dhe shkelja e saj as nuk çohet ndër mend. Në të drejtën dokësore shqiptare besa ishte jo vetëm një virtut moral, por edhe një institut me rëndësi të veçantë...Me gjithë ndonjë teprim e përjashtim, besa shqiptare është një institucion që, deri vonë, në përgjithësi është respektuar nga shqiptarët dhe me të cilin ata mund të krenohen edhe sot*”⁴.

Në *Kanunin e Lek Dukagjinit* jepet “besa” edhe në rastet e vrasjeve. Vrasësi merr pjesë në varrimin e të vrarit kur ka besën e familjes së viktimës; *neni 122 “Besa”*⁵. Mbajtja e besës për Kostandinin/ Halil Garrinë është çështje nderi dhe dinjiteti, lidhet edhe me emrin e mirë pas vdekjes. Sipas *Kanunit, Libri 8 Ndera, kreu 17, Ndera vehtjake*⁶.

Në disa variante të vdekurin e ngre nga varri vetëm mallkimi i nënës: “Kostandin të ardhhtë gjëma,/martove Dhoqinën larg”⁷. Në variante të tjera nëna e djegur nga malli për vajzën i kujton djalit të vdekur Kostandinin: “Kostandin, o bir, o djalë çish më the kur jesh gjallë? ...Ku është besa që më dhe?”⁸. Tjetërkund nëna qan djemtë e vdekur e mallkon të birin Kiçon/ Kostandinin: “Mos u treç, o Kiço,/ martove Dhoqinën larg e larg në Misir/ dëshiroj ta shoh me sy”⁹. Në një variant tjetër nëna ndez qirin dhe qan mbi varret e djemve, ndërsa në varrin e Kostandinin ndez dy qirin e vajton dy herë duke i kujtuar: “Kostantin, o biri im,/ ku është besa që më dhe,/ se do t’ m sillnje Garentinën” ... “Besa jote ndënë dhe”¹⁰. Duke qarë mbi varrin e Kostandinin nëna edhe në variante të tjera i përmend atij: “Pran te varri i Kostantinin/ vate e klajti e, më të shëmbur,/ tha tri herë: “O biri i jim!”/ tha tri herë: -“O Kostantin!/ Kostantin, o birti i jim,/ ku është besa që më dhe?”¹¹.

Në grupin e këngëve ku nëna është figura kryesore *problemi* është martesë larg, ndërsa në grupin e këngëve ku figurë kryesore del motra, vëllezërit janë betuar që motrën të mos e martojnë fare, por ajo të jetojë me ta në të njëjtën shtëpi sa të jetë gjallë.

⁴ Elsie, Robert. *Leksiku i kulturës popullore shqiptare*. Skandebegbooks 2005, f. 32.

⁵ Gjeçovi, Shtjefën. *Kanuni i Lek Dukagjinit*, Shkodër, 2010, ribot. Botime Françeskane, f.83.

⁶ Po aty, f. 65.

⁷ Zoto, V. *Balada shqiptare*. “Kënga e Dhoqinës”, f.55.

⁸ Po aty, “Kostandini e Dhoqina”, f. 37.

⁹ Po aty, “Qe një mëmë”, f. 60.

¹⁰ Zoto, V. *Balada shqiptare*. “Kostantini e Garentina”, f.62-63

¹¹ Zoto, V. *Balada shqiptare*. “Doruntina”, f. 67.

Në variante të grupit të këngëve të Halil Garrisë, të vdekurit, Halil Garrisë i përmendet “besa” nga motra e cila qan nën një mollë dhe përmes një zogu të verdhë që shfaqet papritur: “Ku e kie besën ç’i m’ke dhanë?”¹². Në një variant tjetër motra bisedon me një zog dhe i thotë të shkojë t’i kujtojë të vëllait: “Ku e laë besën, q’i m’ke dhanë?”; “T’ka zanë vorri me besë të dhanë”¹³. Por edhe më herët përmendet “besa”, kur vëllezërit lidhin besë që të mos e martojnë kurrë motrën. Kur Halil Garria pas udhëtimit që ka bërë në vise fqinje u thotë vëllezërve dhe motrës se ka shkëlur betimin e bërë dhe ka dhënë fjalën për martesën e saj e kupton peshën e veprimit dhe për ta kompensuar atë i betohet motrës ose nënës se bashkë me vëllezërit do ta sjellin motrën herë pas here tek nëna. Pra shkelja e besës shlyhet vetëm me besë: “Hajt, mo’j motër!” i ka thanë:/ se për ket besë, q’i t’a kém dhânë/ Kur t’i mbushish plot nandë javë/ “Vjen Halili e të shef me sy”¹⁴.

Martestat larg. Subjekti bazë lidhet me martesën e motrës, madje martesën larg. Në baladën e Kostandinit/Halil Garrisë, motra martohet shumë larg, në kohë, tre ose shtatë¹⁵ nëntë ditë larg¹⁶, nëntë muaj¹⁷ ndërsa në distancë tre male larg¹⁸ deri në nëntë male larg, matanë detit tre ditë larg¹⁹, në Misir²⁰, shumë larg²¹, andidherash²² në Krajli²³ etj. Në traditën zakonore shqiptare martesat larg bëhen për të shmangur lidhjet me ndonjë të gjakut të tyre sepse vendbanimet tradicionale shqiptare organizoheshin mbështetur në lidhjet me një të Parë (stërgjysh) të përbashkët dhe deri në katërqind vjet ata konsideroheshin se kanë lidhje gjaku me njëri-tjetrin, ndaj martesat mes tyre ishin të ndaluara, siç përshekruhen edhe në *Kanunin e Lek Dukagjinit*, Krye 19, *Gjaku e gjinija, vllaznimi e kumbarija në kanu të maleve. Nye njëqindeparë. Gjaku e gjinija e breza Shqyptarësh*²⁴. Martesa larg e motrës/vajzës nga droja se po e martojnë me ndonjë të gjakut të saj përkon me kapitullin e tretë, të Kanunit të Lek Dukagjinit, neni 16,

¹² Zoto, V. *Balada shqiptare*. “Kanga e Halil Garrisë”, f.74.

¹³ Palaj, B.; Kurti, D. Visaret e kombit. Vëllimi 2. Kângë Kreshnikësh dhe Legenda.

“Nikaj” 1937, ribot. Botime Françeskane 2010, f. 253.

¹⁴ Zoto, V. *Balada shqiptare*. “Halil Garrija”, f. 253.

¹⁵ Zoto, Vladimir. *Balada shqiptare*. “Kostandini e Dhoqina”, f.57.

¹⁶ Po aty, “Halil Garria”, f.79.

¹⁷ Po aty, “Motra me nanë vllazën” f. 87.

¹⁸ Po aty, “Kënga e Dhoqinës” f.55.

¹⁹ Po aty, “Kur kanë kjenë shtatë vllazën” f.92.

²⁰ Po aty, “Qe një mëmë” f.60.

²¹ Po aty, “Kostandini e Garentina”, f.62.

²² Po aty, “Doruntina” f.66.

²³ Po aty, “Kanga e Halil Garrisë” f.73.

²⁴ Gjeçovi, Shtjefën. Kanuni i Lek Dukagjinit, f. 14.

*Fejesa*²⁵. Të gjitha kërkesat e këtij neni realizohen nga martesë në baladë e vajzës sa më larg, madje edhe me një mashkull të një kombësie tjetër/ të një krahine tjetër.

Fejesa, martesë

Meqenëse në baladë mungon figura e babait, patriarkut të familjes atëherë sipas Kanunit të drejtën për të menduar për martesën e vajzës në familje e kanë vëllezërit apo kushurinjtë²⁶. (Në *Kanunin e Lek Dukagjinit*²⁷, libri i tretë “Martesë”, neni 11, “Përcaktimi dhe mënyrët e martesës”, neni 12 “Tagri i djalit e i vajzës”. Në *Kanunin e Skanderbegut*, Fejesa e martesë, art. I Fejesë; art. II Martesë; art. III Të drejtat dhe detyrët e të zotët të shpisë²⁸). Vajza, sipas traditës zakonore shqiptare është e detyruar të pranojë atë që vendosin prindërit, kryesisht babai, në mungesë të tij vëllezërit. Kështu ndodh në baladë, vëllezërit një herë janë betuar se nuk do ta martojnë motrën e tyre kurrë: “besa besë vllaznit ishin lidhë/ kurrkun motrën mos me e martua/dumë me e lanë me ne me dekë”²⁹; por pastaj kur Kostandini/Halil Garria, vëllai më i vogël ka zënë një *mik të ri*, vëllezërit bien dakord për ta martuar, gjithsesi pa e pyetur vajzën, e cila është e detyruar të pranojë vendimin e vëllezërve, pavarësisht se në disa variante ajo i mallkon për së gjalli për këtë vendim, dhe ky mallkim ndonjë herë del edhe si ndëshkim që sjell vdekjen e vëllezërve të saj. Në ndonjë variant tjetër, bie dakord edhe motra për të mos u martuar: “Edhe besën motra ja u ka dhan:/gjithmon bashkë na kem me ne”³⁰. Në traditën zakonore shqiptare është e njohur edhe martesë për të lidhur miqësi, apo për pajtim të dy shtëpive në armiqësi³¹.

Halil Garria del në Krajli “me zanë miq e probatina,/me zanë shokë edhe kumarë; ...ka zanë miq edhe kumarë,/ka zanë shokë edhe jaranë”³²; “me zanë miq e probatina”³³. “Vëllai më i vogël” në baladë e jep motrën për të lidhur miqësi me një fisnik të panjohur.

Pra, në variantet shqiptare të baladës kemi martesën për miqësi, aleancë me tjetrin, i cili është një i huaj. Për shembull, në Dukagjin ky lloj miku që zë Halili njihet si: “Miku i zemërs ase miku jaran” i cili ka lidhje

²⁵ Gjeçovi, Shtjefën. Kanuni i Lek Dukagjinit, f. 12.

²⁶ Kurti, Donat. Zakone e doke shqiptare, f. 11.

²⁷ Gjeçovi, Shtjefën. Kanuni i Lek Dukagjinit. Ribotim Shkodër 2010, f.10-11.

²⁸ Illia, Frano. Kanuni i Skanderbegut. Ribotim Shkodër 2019, f. 26.

²⁹ Zoto, V. “Kënga e Halil Garriës” f. 70.

³⁰ Po aty, “Motra me shtat vllazën”, f.83.

³¹ Kurti, Donat. Zakone e doke shqiptare. Botime françeskane 2010, f.58.

³² Zoto Vladimir. Balada shqiptare, f.70

³³ Po aty, “Motra me shtatë vllazën” f.83.

me një pjesëtar të familjes dhe çmohet e nderohet prej të gjithë anëtarëve të tjerë të saj, pavarësisht se këta nuk kanë lidhje me të. Ai konsiderohet më shumë se një anëtar familjeje, ndërsa vetë ai është i gatshëm edhe të sakrifikohet për gjithçka për mikun dhe familjen e tij. Miqësia me mikun “jaran” mund të forcohet edhe më tej përmes martesave, duke dhënë ose duke marrë³⁴. Në raste të tjera kemi edhe “mik krushqie”³⁵ pra mik i zënë thjesht përmes martesës duke dhënë ose duke marrë. Madje në traditën tonë zakonore për forcim miqësie ka ndodhur që fëmijët janë premtuar për fejesë ende pa lindur, nga burrat që i kanë pasur njëkohësisht gratë shtatzana³⁶. Në baladën e ringjalljes, megjithëse vajza nuk mund ta kundërshtojë vendimin e vëllezërve për martesë sepse i njeh pasojat që burojnë më tej nga tradita zakonore, nuk ngurron të shfaqë hapur pakënaqësinë e saj për martesën në vetvete si dhe për martesën shumë larg familjes. Por ka ekzistuar edhe kundërshtimi i martesës nga ana e vajzës, me kusht që ajo heq dorë nga martesa e saj përjetë, - *fenomeni i vigjineshave, burrneshave*. Vajza në këtë rast nuk mund të martohet kurrë, përndryshe *çon gjak* në shtëpinë e saj dhe ndërkohë ajo ka detyrim ruajtjen e nderit, pastërtinë, virgjërinë. Ose ajo nuk mund të martohet askund sa kohë që i fejuari i refuzuar ishte gjallë edhe pse ai mund të ishte martuar³⁷.

Në disa variante shqiptare del se momenti martesës shënon kalimin nga kohët pagane kur motra “martohet” në familjen e saj, vëllezërit betohen se nuk do ta martojnë askund, madje as ata vetë nuk do të martohen, edhe vetë motra ndjehet e lënduar në sedër për vendimin e Kostandinit/Halil Garrisë dhe shprehet se edhe sikur ta kishin mbajtur me bukë në vend të shegertit do të kishte qenë më e kënaqur, veç të qëndronte në familje³⁸. Në ndonjë variant tjetër ajo i akuzon vëllezërit se u është dhimbsur buka që i kanë dhënë; në rast tjetër vajza ankohet se edhe sikur të kishte bërë nga një kopil në vit, nuk duhet ta kishin larguar nga familja³⁹.

Baron Franc Nopça na jep të dhënë për një fragment rrëfimi në të cilin flitet për martesën mes vëllait e motrës në Malësitë e Veriut të Shqipërisë përfshirë malësitë që tani gjenden në Malin e Zi. Si duket tregimi ishte i origjinës pagane dhe kisha e kishte ndaluar (mallkuar)

³⁴ Kurti, Donat. *Zakone e doke shqiptare*, f.43-44.

³⁵ Illia, Frano. *Kanuni i Skanderbegut*. Ribotim, Shkodër, 2019, f. 52.

³⁶ Kurti, Donat. *Zakone e doke shqiptare*. Botime françeskane 2010, f. 58.

³⁷ Kurti, Donat. *Zakone e doke shqiptare*. Botime françeskane 2010, f. 162-163; Gjeçovi, Shtjefën. *Kanuni i Lek Dukagjinit*, nye 17, Sheji, f. 13.

³⁸ Zoto, V. *Balada shqiptare*. “Kënga e Halil Garrisë” f. 73.

³⁹ Po aty, “Motra me nandë vllazën”, f. 103.

përhapjen e tij⁴⁰. ”Në fillim vëllai më i madh u martua me motrën më të vogël dhe motra më e madhe u martua me vëllain më të vogël dhe këta janë prindërit e parë të njerëzimit”⁴¹.

T’pana (Vizita e nuses në gjini)

Sipas traditës zakonore shqiptare, nusja pas dasmës, martesës, ka të drejtë të shkojë në gjini për vizitë, “në të panë”, për të parë familjen e saj dhe të afërmit. “Kur t’i mbushish plot nândë ditë,/Vjen Halili e të shef me sy;/Kur t’i mbushish plot nândë javë,/Vjen Halili e t’merr në t’pam”⁴². Afati në ditë caktohet nga ana e familjes së burrit që në ditën kur ajo del nuse. Familja e nuses cakton një mashkull i cili ka për detyrë të shkojë ta marrë dhe ta sjellë në familjen e saj, në të cilën, pasi qëndron disa ditë do ta dërgojë përsëri në shtëpinë e burrit.⁴³ Kjo përkon me disa variante të baladës shqiptare ku Kostandini/Halil Garria, premton se duke qenë 9 vëllezër apo 7 ata do të shkojnë herë pas here për ta marrë motrën në të panë. Pra, ata e kanë për detyrë zakonore ta sjellin motrën e tyre menjëherë pas martese në gjini. Sipas traditës zakonore shqiptare, personi që shkon për ta marrë duhet të flejë një natë aty, pastaj të niset nesër në mëngjes herët. Në variantin “Motra me nandë vllazën”⁴⁴ Halili i ringjallur së vdekuri fle një natë tek shtëpia e motrës dhe në mëngjes nisen për rrugë, sipas përshkrimit të traditës zakonore shqiptare.

Një përrallë e bukur shqiptare duket se e plotëson dhe ka lidhje me këtë moment të marrjes së motrës së baladës në “të panë”, përralla “Mâ i vogli vlla, ma i dhimbshmi vlla”⁴⁵. Si në këtë baladë edhe këtu janë 3 vëllezër që kanë vetëm një motër. Ajo ishte bërë për fejesë. Vëllezërit diskutojnë për fejesën e saj: vëllai më i madh thotë se po ta martojnë një ditë larg, e kanë afër dhe mund ta shohin shpesh, vëllai i mesëm thotë se edhe dy ditë larg s’prish punë se shkon ai vetë për ta parë, kurse vëllai i vogël thotë se më mirë ta martojnë tre ditë larg se e gjejnë mikun më të mirë. Pra motivi i martesës së motrës larg nga vëllezërit, sikurse edhe motivi i ringjalljes së të vdekurit, (*I dekuni në dasëm*⁴⁶ *Kush bân mirë gjên mirë*⁴⁷, *I vdekuri mirënjohës*⁴⁸) është i pranishëm edhe në përrallat

⁴⁰ Nopça, Franc. *Pikëpamje fetare, doket dhe zakonet e Malcisë së Madhe*. Tiranë, 2012, f.54.

⁴¹ Po aty, f.54.

⁴² Palaj, B.; Kurti, D. *Visaret e kombit. Vëllimi 2. Kângë Kreshnikësh dhe Legenda*.

“Nikaj” 1937, ribot. Botime Françeskane 2010, f. 253.

⁴³ Kurti, Donat. *Zakone e doke shqiptare*, f. 91.

⁴⁴ Zoto, Vladimir. *Balada shqiptare*, f. 103.

⁴⁵ Kurti, Donat. *Përralla kombëtare I*. Ribotim Shkodër, 2005, f. 26.

⁴⁶ Kurti, Donat. *Përralla kombëtare II*, Ribotim, Shkodër, 2005, f.58.

⁴⁷ Zoto, Vladimir. *Balada shqiptare*. “Kënga e Halil Garrisë” f. 75.

shqiptare. Kjo mund të flasë në dobi të hipotezës se baladat shqiptare me këto motive mund të kenë moshën e përrallave. Në këtë përrallë vëllezërit nuk vdesin, por shkojnë me radhë për të marrë motrën e martuar në “paasi”. *Miku* ua punon dy vëllezërve duke i lënë pa ngrënë dhe duke mos i dhënë leje motrës për të shkuar me ta, ndërsa vëllai më i vogël ia punon atij duke e lënë pa ngrënë dhe duke marrë motrën në të pame.

Në baladat shqiptare të këtij motivi përshkrimi i familjes së re është shumë i turbullt. Në një variant përshkruhen fëmijët që luajnë para pallatit, dhe fakti se motra ka shkuar në një festë me valle në qytet. Por çuditërisht familja e re dhe burri nuk janë të pranishëm. Në një variant motra përballë kërkesës së vëllait për t’u nisur menjëherë për rrugë, i përgjigjet se duhet ta lajmërojë burrin e saj për këtë largim të papritur dhe nuk ka sesi. Vëllai e qetëson se mund t’i shkruajnë një letër, për t’i shpjeguar arsyen e largimit⁴⁹.

Familja

Atmosfera e baladës është ajo e familjes shqiptare. Në disa variante të baladave shqiptare familja ka 7 ose 9 vëllezër një motër dhe nëna, në disa të tjera 12 vëllezër, me 12 gra me nga një fëmijë secila, motra dhe nëna Numri djemve dhe nuseve ndryshon, por vajza është gjithmonë një. Familja tradicionale shqiptare⁵⁰ deri në gjysmën e parë të shek. XX, por edhe më vonë ka qenë familje me shumë anëtarë. Në të gjitha variantet mungon babai. Në ndonjë variant vajza shprehet se babain nuk e mban mend⁵¹. Megjithëse nëna është një figurë e nderuar dhe e respektuar, në disa variante cilësohet edhe si “zonja mëmë” ajo nuk pyetet nga djemtë për martesën e vajzës, por sigurohet me nderim prej tyre se ata do t’ia sjellin vajzën sa herë të ketë nevojë, për të mirë e për të keq. I gjithë veprimi lëviz brenda familjes pa u përfshirë vendi ku vajza është martuar, i cili të shumtën e rasteve edhe kur ka ndonjë emër konkret, mbetet i mjegulluar.

Halili/Kostandini në shumicën e rasteve është vëllai më i vogël, por duket se ai ka një rol udhëheqës në familje, sepse në kundërshtim me betimin e bërë me vëllezërit, vendos papritur të lidhë një miqësi të re përmes martesës së motrës. Sipas “Kanunit të Lek Dukagjinit”, *Familja, Kreu 2, Ndertimi i familjes, Neni 9 Tagri, perlimi e detyra e të zotit të shpis*, përcaktohet se sundimi i shpis i përket më të vjetrit nën kulm ose vëllait më të madh, por nëse ata nuk i kanë cilësitë e duhura për drejtim

⁴⁸ Nopça, Franc. *Pikëpamje fetare, doket dhe zakonet e Malcisë së Madhe*. Tiranë, 2012, f.58-59.

⁴⁹ Zoto, Vladimir. *Balada shqiptare*. “Kënga e Halil Garrisë” f. 75.

⁵⁰ Kurti, Donat. *Zakone e doke shqiptare*, f.105.

⁵¹ Zoto, Vladimir. *Balada shqiptare*. “Kënga e Halil Garrisë” f.74.

atëherë bashkërisht zgjidhet ai që është më i mençur dhe që kujdeset më mirë për mbarëvajtjen e familjes. Madje zot shpije mund të bëhet edhe një i pamartuar⁵² siç është rasti këtu me vëllain e vogël Kostandinin/Halil Garrinë.

Pothuaj në të gjitha variantet shqiptare, vëllai më i vogël është ai që kryen aktin e ringjalljes. Ai është një personazh i njohur edhe në krijimet tjera gojore shqiptare, madje edhe në baladën e flijimit dhe në shumë përralla i njohur si “ma i vogli vlla, ma i miri vlla”, “qeli”, “qerosi” etj. Në këto krijime ai është mbajtës i besës, por edhe sakrifikues për familjen. Ndërsa në traditën zakonore shqiptare prindërit zakonisht zgjedhin të jetojnë me djalin më të vogël. Gjithashtu në shumë balada të tjera tregohet për dashurinë dhe sakrificat e motrës për vëllanë, si pjesë e botës morale të familjes tradicionale shqiptare, për shembull në baladën “E motra e Agës Hasan Agë bahet qyqe”⁵³ ku motra bëhet qyqe nga dhimbja për humbjen e vëllait të plagosur në pyll, në këngën epike “Gjergj Elez Alija”⁵⁴ ku motra prej nëntë vitesh i shërben pa u ankuar vëllait të plagosur etj.

Namët

Në disa variante nëna, por më shumë motra i *namë* vëllezërit në momentin kur, Halili, vëllai më i vogël, i tregon se e ka fejuar diku larg. Nga *nama* e motrës vëllezërve u vjen vdekja. Kjo tregon për bestyninë e ngulitur që ka pasur malësori shqiptar për forcën shkatërruese e ndëshkuese të *namës*. Deri vonë në malësitë shqiptare *namja* e tjetrit nuk pritej mirë prej të adresuarit e gati përjetohej si një sulm ndaj tij sepse aty shprehet gjithë dufi i hidhërimit dhe inatit ndaj personit që mund t’i ketë bërë keq. Shumë prej këtyre namëve ishin me tepri dhe të egra, njëra më kërcënuese se tjetra⁵⁵, si për shembull në disa variante të baladës: “Ka marrshi rrugën me ardhë,/ t’shtati shoqi shoqin vrashi”⁵⁶; “U rafshin vlla, shtatë murtajë!/ Shtatë murtajë n’mos u rafshin/ ju të shtatë vedin vrafshi”⁵⁷ “T’madhen motra paska brit,/Ka qit vllaznit e i ka nem:/ Shtat murtaj zoti ja u çoft,/ t’tan pr’i her n’dhe u shtisha”⁵⁸.

⁵² Gjeçovi, Shtjefën. *Kanuni i Lek Dukagjinit*, f.6.

⁵³ Zoto, Vladimir. *Balada shqiptare*, f.163.

⁵⁴ Palaj, Bernardin; Kurti, Donat. *Visaret e kombit II. Kangë kreshnikësh dhe legjenda* f. 42.

⁵⁵ Kurti, Donat. *Zakone e doke shqiptare*, f. 175.

⁵⁶ Zoto, Vladimir. *Balada shqiptare*. “Ishnjn shtatë vëllazni”, f.101.

⁵⁷ Po aty, “Kur kanë kjenë shtatë vllazen”, f.92-94.

⁵⁸ Arapi, Fatos. *Këngë të moçme shqiptare*. Tiranë 1986. “Motra me shtatë vllazen”, f.236.

Duke e njohur fuqinë e *namës* vëllezërit i luten motrës që të mos i nëmë aq fort: “Mos na nam, motër, aq fort,/ se krye jave vij e t’shoh”⁵⁹. Në disa variante të tjera ajo që e nëm Kostandinin është e ëma: “Kostandin të ardhhtë gjëma,/ martove Dhoqinën larg”; ndërsa kur Dhoqina i thotë se ka ardhur me Kostandinin e ëma e nëm “Ç’Kostandin, moj të ardhhtë gjëma!/ Kostandin i vdekur/Ç’bën tre vjet pa tretur?”⁶⁰.

Ringjallja

Përveçse në këtë baladë, motivin e ringjalljes së njeriut, të udhëtimit të të vdekurit në botën e gjallë apo të gjallit në botën e përtejme, e kemi edhe në eposin shqiptar të kreshnikëve dhe në disa përralla popullore. Pra, udhëtimi i të gjallit në botën e përtejme dhe i të vdekurit në botën e këtijme është rregull në krijimet gojore shqiptare: “keni par” e s’“keni parë/ shkon një zogëz bishtbardhë/ i vdekuri me të gjallë”⁶¹. Në këngët e eposit gojor shqiptar: “Muji mbas deket”⁶² “Halili mbas deket”⁶³ në përrallat “Qerozi”, “I vdekuni në darsëm”⁶⁴ *Kush bân mirë gjën mirë*⁶⁵, *I vdekuri mirënjohës*⁶⁶ shumë situata përkojnë me ringjalljen e Kostandinit/Halil Garrit në baladë etj. Te “Muji mbas deket” Muji vdes nga një dhimbje e fortë, por e porosit Halilin që ta mbajë të fshehtë vdekjen e tij që armiqtë të mos e marrin vesh. Kalojnë shtatë vite dhe ndihet mungesa e trimërive të tij ndaj një baloz i zi e kupton se Muji ka vdekur dhe ia gjen varrin në bjeshkë ndërsa e dhunon duke ia rrahur varrin dhe duke e thirrur të vdekurin për mejdan. Muji përmes një qyqeje, si në baladë, i çon fjalë Halilit se çfarë po i ndodh. Halili vret bajlozin e zi dhe e gjen Mujin kambëkryq në varr mbasi Zanat e kishin ringjallur. Të dy heronjtë nisen për në Jutbinë, i gjalli dhe i ringjalluri si në baladën e përmendur. Edhe tek kënga “Halili mbas deket” përsëritet e njëjta situatë, shkau me treqind veta i trazon qetësinë e varrit dhe ai i dërgon fjalë Mujit përmes qyqes. Edhe këtu i vdekuri flet me qyqen dhe përmes saj dërgon mesazhe për të gjallët. Në përrallën “Qerozi” i gjalli shkon në botën e përtejme dhe mbetet atje për disa kohë, ndërsa del vetëm përmes ndihmës magjike të një shqiponje e cila e nxjerr në botën e sipërme.

⁵⁹ Arapi, Fatos. Këngë të moçme shqiptare, “Halil Garrija”, f.250.

⁶⁰ Haxhihasani. Q. *Balada popullore shqiptare*. Tiranë, 1982, f. 32-34.

⁶¹ Zoto, Vladimir. *Balada shqiptare*, f.56.

⁶² Palaj.B.; Kurti.D. *Visaret e kombit II. Kangë kreshnikësh dhe legjenda*. Ribotim, Shkodër 2010, f.234.

⁶³ Po aty, f.237 .

⁶⁴ Kurti, Donat. *Përralla kombëtare II*. Ribotim, Shkodër, 2005, f.58.

⁶⁵ Po aty, f. 150.

⁶⁶ Nopça, Franc. *Pikëpamje fetare, doket dhe zakonet e Malcisë së Madhe*. Tiranë, 2012, f.58-59.

Edhe më e afërt me baladën është përralla “I vdekuni në dasëm”. Dy miq të ngushtë që shkonin kudo sëbashku, lidhin besën që kur të martohen mos me ba dasëm pa thirrë njëri-tjetrin. Ndërsa njërit i erdhi dita të martohet, tjetri kishte vdekur prandaj për të përmbushur betimin e bërë shkon në varreza dhe i thërret mikut të tij për të ardhur në dasëm. Kthehet në shtëpi dhe pas disa minutash i vdekuri vjen në dasëm duke frikësuar të pranishmit. Pra sikurse në baladë të vdekurit i kujtohet betimi dhe ai e mban atë duke u paraqitur në dasëm sa për urim, sepse nuk mund të qëndrojë më shumë. Por nga ana tjetër i gjalli për t’i bërë shoqëri dhe për të parë si është bota tjetër vendosë të shkojë me të vdekurin për një orë e cila del e barabartë me tre vjet. Dasma prishet dhe të gjallët e kujtojnë të vdekur. Vetëm nusja e pret tre vjet derisa sa dhëndrri i gjallë kthehet.

Në traditën zakonore shqiptare ka një kujdes të përhershëm për të përmbushur amanetet apo borxhet që mund të ketë lënë i vdekuri, në mënyrë që shpirti i tij të jetë i lirë nga çdo detyrim tokësor⁶⁷. Madje edhe nëse të afërmit e tij nuk janë në dijeni të detyrimeve apo borxheve të tij dhe dikush me betim mbi gurin e varrit⁶⁸ të të vdekurit pretendon për një gjë të tillë, atëherë të afërmit dhe familja do t’ia shlyejnë atij detyrimin e të vdekurit. Kostandini/Halil Garria nuk ka të afërm të tjerë, vëllezërit i kanë vdekur, e ëma është plakë dhe e verbuar. Motra dhe e ëma i përmendin besën e dhënë dhe ai duhet të ngrihet nga varri për ta mbajtur atë, për t’u çliruar nga ajo dhe për të gjetur qetësinë e përfundimtare.

Në përrallën “Kush bân mirë gjën mirë”⁶⁹ i gjalli paguan borxhin e një të vdekuri të cilin po e rrihnin për këtë shkak, ndërsa i vdekuri i shfaqet më vonë duke u bërë mik me të gjallin, duke e mbrojtur nga rreziket dhe duke e ndihmuar atë të bëhet i pasur, madje edhe të martohet. Në shenjë nderimi i gjalli sipas kërkesës së të vdekurit, ia gjen varrin dhe kur hyn atje sheh bukuritë e botës së përtejme.

Ndërkaq në traditën popullore shqiptare ekzistonte kulti i të vdekurve⁷⁰ dhe plot bestytini që lidhen me të vdekurin dhe “rrezikun” e ringjalljes apo të ngritjes lugat. Në Shqipëri, të vdekurit deri në gjysmën e dytë të shek. XX i vendosej një monedhë në gojë ose në dorë, për të paguar

⁶⁷ Kurti, Donat. *Zakone e doke shqiptare*, f.257.

⁶⁸ Kurti, Donat. *Zakone e doke shqiptare*, f. 173-174.

⁶⁹ Kurti, Donat. *Përralla kombëtare II*. Ribotim Shkodër, 2005, f. 150.

⁷⁰ Palaj, Bernardin. *Bota e maleve shqiptare*. Botime Françeskane, Shkodër, 2018, f. 193; Nopça, Franc. *Pikëpamje fetare, doket dhe zakonet e Malcisë së Madhe*. Tiranë, 2012, f. 172; Kurti, Donat. *Zakone e doke shqiptare*. Botime françeskane, Shkodër, 2010, f.243-258.

rrugëtimin nëpër botën e përtejme apo për të paguar truallin e varrit⁷¹. Në bestytnitë shqiptare është i pranishëm besimi se shpirti i të vdekurit sillet rrotull shtëpisë së tij, madje duhet lënë një dritë ndezur, një enë me ujë, dritaret hapur për të⁷². Gjithashtu deri vonë është ruajtur një traditë e nderimit të të vdekurit me vaje e gjamë për ta bërë më të lehtë kalimin e shpirtit të tij në botën tjetër.

Vëllavrasjet

Në disa variante vëllezërit vrasin sho-shoqin sipas mallkimit të motrës. Por mund të kemi këtu gjurmë të vëllavrasjeve të vërteta në familjet tradicionale shqiptare. Te “Halil Garria” shkaku i vdekjes së vëllezërve është vëllavrasja: “Por n’at natë që qi ki’n ardhë krushqit,/ Shtat sahat motrën e ki’n përcjellë,/ Kur ki’n kthye n’oborr t’sarajit,/ Të nândë vllaznit vrán shosho’jn”⁷³. Në Kanunin e Lek Dukagjinit, neni 133, Kush vret vedin shkon gjakhupës. 960. Po vrau i vllai të vllan, gjakhupës shkojn⁷⁴. Motivin e vëllavrasjes e kemi edhe në baladen “Dy vllazënt”⁷⁵.

Veshja për mort e për dasëm

Në të gjitha variantet kur Kostandini/Halil Garrija ngrihet nga varri dhe shkon tek e motra ajo zakonisht e pyet si duhet të vishet: për gëzim apo për hidhërim, për mort apo për dasëm, çka kuptohet qartë se ajo vijon ta ruajë traditën e saj zakonore shqiptare. Kjo flet për traditën e ngulitur të veshjes sipas zakoneve të traditës popullore.

Si përfundim, në variantet shqiptare të baladës të ringjalljes që bëjnë objekt këtu, krijuesi gojor shqiptar ka theksuar atë çka është e vendit, atë çka përputhet me traditën, me botën e tij shpirtërore dhe morale dhe në këtë rast veçuan: besën, fejesën dhe martesën larg, të panën, namët, gjurmë të vëllavrasjeve, strukturën familjare dhe marrëdhëniet mes pjesëtarëve të kësaj familjeje, ritualin i vdekjes dhe bestytnitë shqiptare për të vdekurin, praninë e motivit të ringjalljes edhe në epikën tjetër legjendare dhe në përralla ku udhëtimi i të gjallit në botën e përtejme dhe i të vdekurit në botën e ketejme, ose i të dyve bashkë është dukuri e zakonshme. Shumë

⁷¹ Podgorica, Fadil. *Fjalori etnofolklorik*. “Monedha e të vdekurit”. Shkodër, 2004, f.276.

⁷² Jankaj, Zef. *Krijimtari gojore*. “VIII. Për të dekun”. Malësi 2007, f.310-311; Kurti, Donat. Zakone e doke,”Kreu XVIII Dergjë e dekë” f.243-258.

⁷³ Palaj, B.; Kurti, D. *Visaret e kombit. Vëllimi 2. Kângë Kreshnikësh dhe Legenda*. “Nikaj” 1937, ribot. Botime Françeskane 2010, f. 253.

⁷⁴ Gjeçovi, Sh. *Kanuni i Lek Dukagjinit*, f. 90.

⁷⁵ Palaj, B.; Kurti, D. *Visaret e kombit. Vëllimi 2. Kângë Kreshnikësh dhe Legenda*. “Nikaj” 1937, ribot. Botime Françeskane 2010, f. 246.

prej këtyre elementëve përkojnë me botën morale, traditën zakonore dhe kanunet tradicionale shqiptare.

LITERATURA:

- Arapi, Fatos *Këngë të moçme shqiptare*. Tiranë, 1986.
- *Çështje të folkorit shqiptar* nr. 1 Tiranë 1982; nr.2 Tiranë, 1986.
- Gjeçovi, Sh. *Kanuni i Lek Dukagjinit*, ribotime Botime Françeskane, Shkodër 2010.
- Haxhihasani, Q. *Balada popullore shqiptare*. Tiranë, 1982.
- Illia, Frano. *Kanuni i Skanderbegut*. Ribotim, Botime Françeskane, Shkodër, 2019.
- Kurti, Donat. *Zakone e doke shqiptare*. Botime françeskane 2010,
- Kurti, Donat. *Përralla kombëtare I, II*. Ribotim Shkodër, 2005.
- Neziri, Zeqirja. *Epika gojore shqiptare*. Shkup, 2010.
- Nopça, Franc. *Pikëpamje fetare, doke dhe zakonet e Malcisë së Madhe*. Tiranë, 2012.
- Palaj, B.; Kurti, D. *Visaret e kombit. Vëllimi 2. Këngë Kreshnikësh dhe Legenda. "Nikaj" 1937*, ribot. Botime Françeskane 2010
- Palaj, Bernardin. *Bota e maleve shqiptare*. Botime Françeskane, Shkodër, 2018.
- Podgorica, Fadil. *Fjalori etnofolklorik*. Shkodër, 2004.
- Velaj, Olimbi. *Balada -nga oraliteti në letërsi*. Tiranë, 2020.
- Zoto, Vladimir. *Balada shqiptare*. Dasara 2006.

The moral and customary world in the Albanian oral ballads, its coincidences with the old codes

ABSTRACT

Ballads are among the richest and most artistically accomplished types in the Albanian oral epic. Regardless of the meeting points they have with their Balkan and world sisters, it is distinct that the moral, customary world of the Albanian people is expressed in them. In the Albanian ballads featuring the motif of resurrection, human sacrifice or the motif of recognition, we can identify some features that have to do with the world of the traditional Albanian family and the customary Albanian tradition. In addition to the universal motifs, motifs and customary norms specifically related to the traditional Albanian world are expressed. Thus, in the ballad of human sacrifice, in almost all Albanian versions, in addition to the universal motif of sacrifice in the foundations of a new construction, we encounter the motif of keeping one's word and keeping „besa” (one's promise). Even in terms of content, the second motif stands out and takes on as much meaning as the human sacrifice. The reason is clear to an audience which until the first half of the 20th century has this norm of

customary tradition still active in daily life, even one of the basic principles of this life, which, gradually since the establishment of the Albanian state (1912) and onwards will be superseded by written laws. The above-mentioned Albanian ballads have a pronounced legendary, non-historical character, even in any case where a historical element comes into play, it is simply an addition and adaptation of the oral creator to the new life circumstances.

In conclusion, in the Albanian version of the resurrection ballad we treated here, the Albanian oral creator has emphasized what is typical of the country, what is consistent with tradition, with its spiritual and moral world, and in this case we singled out: *besa* (the promise, the given word), betrothal and marriage far away; the bride's first visit to her tribe after her wedding; curses, traces of fratricide, the family structure and relations between the members of this family, the ritual of death and Albanian superstitions about the dead, the presence of the motif of resurrection in other legendary epics and in tales where the journey of the living to the afterlife and of the dead in this world, or both together is a common occurrence. Many of these elements coincide with the moral world, customary tradition and traditional Albanian codes.

Alma HAFIZI

**SANTORI SI PARARENDËS I SHKRIMTARËVE
SHQIPTARË QË SHKRUANJNË NË ITALISHT.
(REFLEKTIM MBI ROMANIN *IL SOLDATO ALBANESE*)**

1. Lindja e një romani me frymë romantike

Pas një ekzistence njëqind e pesëdhjetë e shtatë vjeçare në dorëshkrim, sheh dritën e botimit romani i Françisk Anton Santorit, *Il soldato albanese per l'Impero Ottomano del 1420*¹, editio princeps.

Botimi i romanit nën kujdesin e studiueses Merita Sauku Bruci dhe profesor Oreste Parise, është një ndër detyrimet që kritika letrare dhe studiuesit i kanë letërsisë arbëreshe. E konsideruar si degë e fuqishme e letërsisë shqiptare, ajo lindi e mori udhë jashtë zhvillimeve letrare të tokës mëmë, ashtu sikundër edhe nga ato të vendit pritës. Kjo letërsi spikati veçanërisht në mesin e shekullit XIX me zgjimin e vrullshëm romantik, jehona e të cilit u ndie fort përtej detit, në Shqipërinë që ende vuante nën zgjedhën osmane². Ky shkulum letrar, krahas emrave të ndritur të De Radës, Gavril Darës i Riu, Serembes, solli edhe shkrimtarin me talent origjinal, Anton Santorin.

Botimin e paraprin një prezantim hyrës i profesor Italo Costante Fortino, “Santori; un’opera in italiano”, një përshkrim në linja të përgjithshme i veprës së Santorit, i vlerësuar si epigon i De Radës. Ai ka ndikim në poetikën letrare të arealit italo-shqiptar, pasi është i pari poet që krijon shembullin e stilit të ngritur në poezi, larg gjuhës së folur popullore. Për prozën, Santori zgjedh gjuhën italiane, si kanali gjuhësor më komunikues e gjithëpërfshirës ndaj një kategorie më të gjerë lexuesish, duke praktikuar në këtë mënyrë bilinguizmin në lëtrësinë e shkruar.

Prezantimi hyrës i Fortino-s ndiqet nga studimi i thukët i profesor

¹ Francesco Paolo Santori, *Il soldato albanese per l'Impero Ottomano del 1420*, Editio Princeps da un manoscritto inedito a cura di Merita Sauku Bruci, Oreste Parise, Aracne Editore, ISBN - 9791259941053, Roma, 2021.

² Robert Elsie, *Histori e Letërsisë Shqiptare*, përkthimi nga anglishtja Abdurrahman Myftiu, Botues Dukagjini, Tiranë-Prishtinë, 1997, në “Letërsia arbëreshe në shekujt XVIII e XIX”, fq.129-134.

Oretse Parise-s “La nascita di una letteratura”, me fokus qendror romanin “Il soldato albanese”, autori i të cilit cilësohet nga studiuesi si urë lidhëse mes dy kulturave për kontributin e dhënë në prezantimin e botës arbëreshe përmes veprave të shkruara kryesisht në italisht. Të dhënat e dokumentuara mbi jetën e tij janë shumë të kufizuara. Ajo çfarë dihej për Santorin dhe veprën me autorësinë e tij në momentet e vdekjes është fare e papërfillshme me çfarë u zbulua në vazhdimësi. Romani në fjalë as që përmendej deri vonë në biografinë e tij letrare, ç`ka e bëri atë një margaritar të munguar të kulturës arbëreshe e shqiptare për shumë kohë. Autori i kësaj analize ndalet në elementët kohorë e tematikë të veprës, rëndësisë që ka për diasporën arbëreshe, për kontekstin që sjell, kohën kur mund të jetë konceptuar romani si edhe inkuadrimin e tij në shkollën romantike që përfshiu Evropën në fillimet e viteve Tetëqind, të cilës iu qas edhe letërsia arbëreshe me elementin e saj utopik. Ky kontekst përligj edhe vizionin onirik të shkrimtarit ëndërrimtar mbi episodin e treguar në roman.

Nuk mund të mungonte një studim i imët filologjik e editorial i veprës, i cili mban firmën e studiueses Merita Sauku Bruci, tashmë e njohur edhe për sjelljen e romanit pararendës të Santorit *Sofia e Kominateve*. Analiza bazohet në tri dorëshkrime të romanit me të dhëna të sakta mbi gjendjen fizike të tyre, numrin e faqeve për secilin, çfarë dëshmon se autori e ka ripunuar e zgjeruar romanin deri në dorëshkrimin e tretë, që rezulton të jetë më i ploti. Koha e punimit të dorëshkrimit të tretë mund të jetë viti 1864 ose një vit më pas, nisur nga alfabeti i përdorur nga Santori, i njëjtë me atë të veprës *Emira*.

Romani me transkriptimet dhe shënimet përkatëse ndiqet nga një shtojcë që përmban tekstin e plotë të rapsodisë popullore *Antica ballata albanese*, me përkthimin italisht në krah, nga e cila është frymëzuar Santori për romanin në fjalë.

Prodhimtar e lëvrues në shumë gjini, si poezi, romancë në vargje, prozë, dramë, përkthime, figura e Santorit është ende e panjohur në të gjithë dimensionin poliedrik, pasi disa prej veprave në autorësi të tij presin akoma dritën e botimit. Prandaj edhe libri që sollën dy përkujdesuesit e botimit merr vlerë të dyfishtë. Së pari pasuron profilin krijues të Santorit me krijime të reja në gjininë e prozës, së dyti, sjell të dhëna të reja për fillesat e prozës në letërsinë shqipe, duke rezultuar deri më tani romani i parë i shkruar në gjuhë të huaj (1864)³, megjithëse pagëzuesi i prozës të shkruar

³ *Il soldato albanese* i paraprin romanit të Sami Frashërit *Taaşuk-u Tal'at ve Fitnat* (Stamboll, 1872) dhe romanit të Pashko Vasës *Bardha de Temal, scenes de la vie albanaise* (Paris, 1890).

në gjuhën shqipe mbetet po i njëjti autor me romanin *Sofia e Kominiatëve*⁴.

2. Romani si identitet

*Vatani më vdiq
dhe e varrosën në zjarr*

*Po jetoj
në mëmëdheun tim
në fjalë*⁵

Raporti i lexuesit me librin fillon që nga ballafaqimi i parë fizik. Që nga kopertina e librit kam djerë personalisht frymën vëllazërore që arbëreshët e kanë konkretizuar aq bukur tek thënia “gjaku ynë i shprishur”. Krijohet kjo klimë që me bashkëpunimin e dy përkujdesuesve, njëri këndej në Shqipëri e tjetri matanë detit, në Itali, vazhdon me historinë e një ushtari shqiptar, e mbetur larg në shekullin XV përballë bregut ku ndodhet rrëfimtari, për t’u përmyllur me aforizmën e Nënë Terezës, “dashuria fillon në shtëpi”, apo me vargjet e Odisesë, simbol i udhëtimit rrethor me kthimin në shtëpi, e ku shtëpia në vetvete është simbolikë e fortë e identitetit të përbashkët.

Romani lind nga rapsodia popullore *Il Giovane Recluta*, si pjesë e një projekti të ideuar nga Santori që mëtonte rikrijimin e rapsodive popullore në formën e romanit, i ndikuar nga idetë e Romantizmit, rryma që, siç shprehej prof.Çabej “zgjoi, sidomos tek popujt e vegjël të kontinentit, dashurinë për gurrat e freskëta të kësaj poezie, e më të bashkë edhe dëshirën për të mbledhur visaret e saj kudo të ishin”⁶.

A mjaftonte vetëm klima letrare e Romantizmit si shtysë për botimin e romanit, apo autori ndjen nevojën për të treguar, rrëfyer një copëz histori, e transmetuar brez pas brezi me mangësitë që prodhon koha? Pse jo në gjuhën e “zemrës”, por në atë të “bukës”? Perveç faktit që gjuha arbëreshe ishte e palëvruar në të shkruar dhe e paaftë për shtrirjen e një kompozicioni në formë proze të gjatë, nuk mund të përjashtohet

⁴ Santori, Francesco Antonio, *Sofia e Kominiatëve. Editio Princeps, studio introduttivo di Italo Costante Fortino ; prolegomeni, trascrizione e apparato critico di Merita Sauku Bruci, Università degli studi di Napoli L'Orientale, Dipartimento di studi dell'Europa Orientale (Napoli), 2011.*

⁵ Rose Ausländer, *Mëmëdheu*, përkthyer nga Hans Joachim Lunksch, <http://defekt-teknik.com/memedhe-rose-auslander-perkthyer-nga-hans-joachim-lunksch/>

⁶ Çabej, E., *Në botën e arbëreshëve të Italisë(përmbledhje studimesh)*, Tiranë, “8 Nëntori” 1987, fq.112.

hamendësimi i një përpjekje të autorit për t'ua rrëfyer të tjerëve historinë e komunitetit ku bën pjesë, ndryshe prej tyre. Nga ky këndvështrim, Santori është një i mërguar në shtetin fqinj, ashtu sikundër një valë e tërë shqiptarësh, afro dy shekuj e gjysmë më pas, të cilët i dhanë jetë një prodhimtarie letrare në gjuhën italiane dhe që mori vëmendjen e shumë studiuesve në fushën krahasuese. Është fjala për atë që kryesisht quhet *letërsi e emigrimit*. Pavarësisht motiveve për të cilat e braktisën tokën amë, ata i përbashkon nevoja për t'u rrëfyer në gjuhë të huaj mbi atë përvojë jete të lënë pas, matanë, brigjeve shqiptare. Ndjejnë nevojën për të denoncuar paaftësinë për të shijuar lirinë, pasi barriera të tjera të padukshme e vështirësojnë jetën e tyre prej mërgimtarësh. Andaj që të perceptohen si komunitet me të gjitha të drejtat e barabarta në realitetin e ri kanë nevojë të shpjegojnë, qoftë edhe me nota të vakëta autobiografizmi. Motiv dhe subjekt i letërsisë së tyre është *kufiri*, konvencional apo i padukshëm, që ndan, por edhe bashkon.

Është e vështirë për të përcaktuar kuptimin e fjalës *kufi*; metaforë e eksodit, e udhëtimit, e emigrimit, apo edhe shtrirje konceptuale në kohë e hapësirë. Komunitetet italo-shqiptare kanë qenë të ndërgjegjshme për brishtësinë e identitetit të tyre duke mos mundur të afirmohen në tokën pritëse qoftë politikisht, ashtu edhe kulturash, apo të komunikojnë me tokën amë për kushtet në të cilat ndodhej Shqipëria nën pushtimin turk, prandaj janë kapur fort pas dy komponentëve që qëndrojnë në themel të AND-së, figura e heroit kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe aspekti fetar, riti grek-bizantin. Janë pikërisht këto dy shtylla mbi të cilat ka ndërtuar rrëfimin Santori.

3. Një ndodhi befasuese

Pas përshkrimit të peizazhit (të kujton *incipit* tek *I Promessi sposi* e Manxoni) ku ngrihet fshati i Fulgarias⁷, imagjinatë e autorit, me koordinata gjeografike mes Krujës dhe Malit të Skënderbeut në Shqipëri, pranë lumit Mat dhe degëzimit të tij, që në realitet përkojnë me territorin ku ndodhej zemra e Arbërisë në kohën kur autori ka vendosur ngjarjet, ai zbret në detajimin arkitekturor të banesave të fshatit ku veçon atë të Kastriotëve, (nuk mungon glorifikimi i kësaj familjeje fisnike), e shtëpi pas shtëpie ndal vëmendjen tek ajo e Albencio Toarsonit (anagramë e emrit Santoro), biri i

⁷ Santori, A., *Il soldato albanese...*, vep.cit., fq.87-96.

Zara Likanora Ubron dhe bashkëshorti i Sterea Kardemos. Tek ky personazh Santori ka mishëruar natyrën luftarake të ushtarëve të Skënderbeut, edhe pse ai rekrutohet në ushtrinë turke, kalorës dhe shpatar i zotë (ai përzgjidhet për të stërvitur të rektuarit e tjerë në dyluftime), trim dhe besnik ndaj fjalës së dhënë, virtyte për të cilat ishin ftuar fillimisht parardhësit e Santorit në territoret e Italisë së Jugut.

Ata erdhën me arsenalin e tyre kulturor dhe fetar, që autori i ka dhënë jetë tek prifti i fshatit, Papas Jinovago. Është figurë e rëndësishme për zhvillimet e ngjarjes, pasi ai është syri, veshi dhe mendja e kudondodhur në jetën e fshatit. Gëzon respekt e nderime për hir të asaj çfarë përfaqëson paçka se personaliteti, qëndrimet e tij lënë vend për të dëshiruar në disa situata (i sertë ndaj së bijës jetime nga e ëma që e vogël, grykësia e tij për të zhvatur sa më shumë bashkëfshatarët, sjellja sipas interesave vetjake). Që nga kisha që ai drejton, marrin udhë të gjitha veprimet, propozimet, realizimet ose dështimet e besimtarëve. Për t'i dhënë veçantinë e duhur kësaj figure nga priftërinjtë e kishës katolike autori i vë shpeshherë në gojë shprehje të liturgjisë greke.

E në fakt Skënderbeu kishte qenë karta e integritit të shqiptarëve në vendin pritës, por frika nga rreziku i shpërbërjes, u kishte imponuar lidhjen e ngushtë brenda komunitetit, ruajtjen me fanatizëm të një modeli jetësor, që kishin trashëguar nga të parët, me norma e ligje arkaike, aq sa pa e kuptuar ishte krijuar një mur ndarës mes tyre dhe të Tjerëve, komunitetit pritës. Këto ishin rrethanat që u lejuan atyre të krijonin modele kulturore dhe antropologjike të pavarura nga ato të atdheut të adoptuar, duke e portretizuar veten në të njëjtën kohë në terma kulturorë autonomë⁷.

Santori merr përsipër të kapërcejë këtë barrierë, të shpërfaqë botën arbërore, të rrëfejë pa dorashka jetën primitive të këtij komuniteti në fshatin e vogël të Fulgarës, jeta sociale e të cilit është e tëra e përqendruar në dyqanin e Gjino Elmistës (Mastro Gjino), njëherësh rrobaqepës, banakier, shitës i mallrave të konsumit, pak nga të gjitha. Aty grumbullohet e gjithë burrëria e fshatit, sehirxhi të pashoqë si Stigonao Olmadeli, kronikani i ngjarjeve të ditës, mbartës i antivlerave të cilit i kundërvihen Mastro Gjino, Kostantini, Kiriako.

Konflikti qendror i romanit rreth të cilit sillen të gjitha fijet e veprimit ideohet dhe strukturohet po aty. Është Stigoano ai që zbulon për bashkëfshatarët dhe lexuesin njëkohësisht se Albencio Toarson ishte martuar me një grua jo nga derë e fisme sikundër e donte zakoni, por me

⁷ Di Miceli, Francesca, "Identità e autoidentità albanese - Il mito di Skanderbeg", në *Il mito in Sicilia*, Carlo Saladino Editore, 2007, Palermo.

bijen e një bujari, çfarë shihej shtrembër nga vejusha Zara, arsye për të cilën e urrente të renë. Indiferenca e të pranishmëve ndaj një detaji të tillë, parë që mes çiftit të ri Toarson kishte harmoni e dashuri, e ngacmon Stigonaon e mllëfosur të tentojë me detaje të tjera që përfshijnë Papas Jinovagon, i cili, sipas Stigonaos, flet keq në meshë për Sterean, për të arritur një qëllim prindëror (ndarjen e çiftit Toarson dhe lidhjen në martesë të bijës së vetme Orsës me Albencion). Shpërfillet me heshtje nga të pranishmit e kundërshtohet mes debatit e replikash nga Mastro Gjino.

Po në dугanjën e Gjinosa diskutohet lajmi i thirrjes për ushtar të Albencios e mbahen qëndrimet pro e kundër vajtjes së tij në luftë. I vetmi që e shihnte të pamundur përjashtimin e tij nga shërbimi ushtarak ishte Stigonaos, që prej kohësh kishte filluar të hidhte shikime provokuese ndaj nënës së tij, në këmbim të të cilave ai fitoi lidhjen jashtë martesore me Zarën me çmimin e lartë që pagoi Sterea, rikthimin në familjen prindërore, humbjen e foshnjës, frytit të dashurisë mes saj e Albencios.

Ky i fundit i rikthyer pas nëntë vitesh nga lufta, kur pak kush e mendonte të mbijetuar, me të mësuar për turpin që kishte pllakosur mbi familjen e tij, vret pa hezitim Zarën dhe Stigonaon, i vetëshpallur zot i shtëpisë Toarson.

Gratë e fshatit janë qenie që projektohen në hijen e personazheve burra. Naresite prezantohet në veprim përmes bëmave e thashethemeve të Stigonaos, Zeruilka, nepërka e gojëliga e fshatit po ashtu, si personi që mund të nxirrte zbuluar planet e tij djallëzore. Jeta e grave lidhet vetëm me mirëmbajtjen e kushteve në familje, janë pjellë e mendësisë sipas së cilës “dhuna dhe forca e mbysin arsyen, thirrjen për drejtësi”, prandaj mbetet vetëm për t’iu nënshtruar fatit.

Burimi jetësor në Fulgarë është blegtoria. Kushtet në të cilat jetojnë pjesa më e madhe e familjeve janë tejet primitive (njerëzit e bagëtisë ndajnë të njëjtën çati), e megjithatë asgjë nuk ka mundur të tkurrë tërësinë e vlerave morale të komunitetit të Fulgarës. Qëndrimi i priftit ndaj ngjarjes së rëndë në familjen Toarson e dëshmon:

Drejtësia e Zotit s`mund të vihej ndryshe në vend. Një nënë e përdalë, e padenjë, që kërkon të shkatërrojë birin e saj, pa asnjë arsye, por vetëm për instinkte epshore[...] Albencio, ti ke vepruar si burrë i denjë dhe i ndershëm. [...] e megjithatë s`duhet të krenohesh se ke bërë diçka të mirë.[...] ai është gjaku i një nëne, e cila sado e keqe të ketë qenë, aq sa s`mund të merret me mend, ishte gjithherë mëma jote, brenda së cilës u krijove, dhe me gjakun e së cilës, të shndërruar në qumësht, u mëkove, u

rrite e u burrërove.⁸ Nga ana tjetër Albencio, me bamirësitë e tij, u kishte dhënë jetë tri familjeve, pasi kishte martuar tri vajzat e të ndjerës Emerenciana dhe ishte kujdesur për vëllanë e vogël të tyre, Pietruçon. Ndërsa ky i fundit kishte si armë më të fortë mirënjohjen për bamirësin e tij, Albencion.

Kjo është pra historia, një nga të shumtat, me kontekst familjar, me një ngjyrim të lehtë autobiografik, referuar mbiemrit të protagonistit Toarson, që nuk është tjetër veçse anagramë e mbiemrit të Santorit. Po ashtu, zgjedhja e një personazhi rrobaqepës si Mastro Gjino përmes së cilit autori risjell figurën atërore që ushtronte po të njëjtin profesion, a mos ndoshta përjeton një fragment personal jetësor, kur, i sapo kthyer në vendlindje pas daljes nga manastiri françeskan, shtynte ditët me një jetë modeste “si mësues dhe shitës i një vegje të bërë me duart e veta me tri apo katër fije”⁹.

3. Ftesë për lexim...

Një ndodhi familjare që zhvillohet në kontekstin historik të vendit, në të gjithë spektrin e jetës shoqërore, me intrigat, denigrimet, zilitë që shpërfaqen në dyqanin e Gjino Elmistës, me protagonistë nga e gjithë struktura shoqërore, në prerje horizontale dhe vertikale.

Historia që sjell Santori është e natyrës rrethore, ku përfshihet historia dhe kultura e një populli në emigrim, me kujtesën e së shkuarës dhe thirrjen e së tashmes. Faktet e epokës së Skënderbeut me toponimet përkatëse, përshkrimi i personazheve të aktualizuar sipas kohës së Santorit, me traditat, aspektet antropologjike dhe sjelljet zakonore, shndërrohen në kujtesë historike identitare, ku spikat figura e heroit Gjergj Kastrioti.

Fragmente historie arbërore, shqiptare, të sjella në gjuhë italiane nga një shkrimtar italo-shqiptar, të spostuara në një hapësirë mes Shqipërisë dhe Italisë, ku e shkuara dhe e tashmja bashkëjetojnë. Santori ka ndryshuar gjuhën e komunikimit me lexuesin, duke dashur të transmetojë mesazhe. Po kujt? Dhe përgjigjen e gjejmë në fund të romanit, “kureshtarëve, paraardhësve, përdoruesve të antikuarëve, për të mirën e shqiptarëve”¹⁰. Me gjasë, kureshtar është lexuesi italian që s`mund të depërtojë dot në botën e komunitetit italo-shqiptar, sa nga vetëmbyllja e tij aq edhe nga lënia në

⁸ Santori, A., *Il soldato albanese...*, vep.cit., fq.259.

⁹ Elsie, Robert, vep.cit., fq.124.

¹⁰ Santori, A., *Il soldato albanese...*, vep.cit., fq.262.

“Io qui la registro per comodo maggiore dei curiosi, e per maggiore chiarezza degli antecedenti, e per uso di qualche antiquario, e per utilità soprattutto degli albanesi.”

harresë. E për të shkundur pluhurin e harresës ngjarjet duhen kujtuar në mënyrën dhe formën e duhur, për të depërtuar në psikikën e tjetrit ashtu siç ekzistojmë, me virtytet dhe të metat që na karakterizojnë.

Rrugëtimin fizik të arbëreshëve, me tërë historinë që mbartin prej shekujsh mbi supe, Santori e ka shndërruar në një udhëtim letrar, në një gjuhë kulturalisht e letrarisht shumë më të sprovuar, siç është ajo italiane, për të ngacmuar mendjen dhe prekur zemrën e lexuesit italian, ndryshe nga gjaku i tij i shprishur. Është kjo forca e shkrimtarit emigrant, që ndikon mbi komunitetin e tij kësaj, duke i orientuar këndvështrimin jo vetëm matanë detit, por edhe nga pjesa tjetër e shoqërisë, në këtë rast italiane.

Si duhet ta lexojmë librin e Santorit *il soldato albanese*? Titulli sikur përshtjellon paksa dhe lë të aludohet për një roman historik, që lidhet me një episod të rëndësishëm të qëndresës identitare të një populli, me rrëfimin e elementeve më të qenësishme të saj, por e kundërta është e vërtetë. Romani rrëfen një histori tejet intime, me sfond familjar, i fokusuar tek aspektet më të thjeshta të jetës komunitare, të identifikuar në një *koinè* gjuhësore dhe kulturore e cila ka farkëtuar dhe përcaktuar kufijtë e përkatësisë së atij komuniteti.

Romani *Il soldato albanese* i bën nder kulturës mbarë shqiptare, fondit të letërsisë italiane, e jo më pak aktorëve që e mundësuan botimin e tij, profesor Italo Fortino me parathënien prezantuese, profesor Oreste Parise e Merita Sauku-Bruçi për studimet e dorëshkrimeve dhe transkriptimin e romanit.

BIBLIOGRAFIA

1. Cabej, E., *Në botën e arbëreshëve të Italisë*(përmbledhje studimesh), Tiranë, "8 Nëntori" 1987.
2. Di Miceli, Francesca, *Il mito in Sicilia*, Carlo Saladino Editore , 2007, Palermo.
3. Francesco Paolo Santori, *Il soldato albanese per l'Impero Ottomano del 1420*, Editio Princeps da un manoscritto inedito a cura di Merita Sauku Bruçi, Oreste Parise, Aracne Editore, ISBN - 9791259941053, Roma, 2021.
4. Hafizi A., *Il nostro «sangue sparso»*. In *viaggio tra gli albanesi della Grecia e dell'Italia*, në « Tra Adriatico e Ionio. Itinerari culturali e turismo sostenibile », a cura di Giulia Dell'Aquila, Collana Polysemi (Studi e testi di letteratura odepórica di area adriatico-ionica), fq.353-377, CACUCCI Editore, Bari, 2020.

5. Hafizi A., *La letteratura migrante come diario*, në “Studia universitatis hereditati “ 7(2019), nr.(2), fq.57-67, E-ISSN 2350-5443, Università del Litorale Capodistria, Slovenia.
6. Robert Elsie, *Histori e Letersise Shqiptare*, përkthimi nga anglishtja Abdurrahman Myftiu, Botues Dukagjini, Tiranë-Prishtinë, 1997.
7. Santori, Francesco Antonio, *Sofia e Kominiatëve*. Editio Princeps, studio introduttivo di Italo Costante Fortino; prolegomeni, trascrizione e apparato critico di Merita Sauku Bruci, Università degli studi di Napoli L'Orientale, Dipartimento di studi dell'Europa Orientale (Napoli), 2011.

**Santori as a forerunner of the Albanian italographer writers.
(Reflection on the novel *The albanian soldier*)**

ABSTRACT

Il soldato albanese per l'Impero Ottomano del 1420, editio princeps, written in Italian, circa 1864, is the second novel of the Arbëresh writer Françisk Anton Santori to be published recently, after the one titled *Sofia e Kominiatëve*. This piece is considered by the critics as a link between the two cultures, Arbëresh and Italian, for the context it brings and being framed in the school of romanticism that involved Europe in the beginning of the years eight hundred, to which the Arbëresh literature answered with its utopic elements.

The novel comes into being by the folk rhapsody *Il Giovane Recluta*, as the need of a community to be identified with its culture, tradition and history, through the literary fable shifted artistically in the glorious time of the main national hero Skanderbeg and geographically positioned between Albania and Italy, where the past and the present of this migrating community coexist. The novel does not display a historical nature, on the contrary it intertwines intimate stories, with a familiar background, with a cyclic nature, where events repeat, just like history repeats itself. By doing so the novel strikes a reader different from them, throughout an artistically cultivated language, such as the Italian language. In this way, Santori uncovers a group of Albanian

writers who write in Italian, many years before migratory literature as a phenomenon caught the attention of global critics.

Ermira ALIJA

KONTRIBUTI I PROF.DR. MIASER DIBRËS NË STUDIMIN E TRASHËGIMISË KULTURORE E LETËRSISË DHE NË DREJTIMIN E SISTEMIT AKADEMIK SHQIPTAR

Prof. Miaser Dibra nisi punën si pedagoge pranë Universitetit të Shkodrës në vitin 1984. Studimet e botuara në *Buletin shkencor* të këtij universiteti deri në vitet '90, lidhen me fushën e saj të studimit që është letërsia për fëmijë. Temat: *Pasqyrimi i tregimit shqiptar për fëmijë në tekstet e leximit letrar të shkollës tetëvjeçare*¹, *Mbi ligjërimin artistik në tregimet për fëmijë*², *Mbi disa veçori të tregimeve për fëmijë të shkrimtarit Nasho Jorgaqi*³, *Zhvillimi i tregimit fantastiko-shkencor në letërsinë tonë*⁴, *Mbi traditën në tregimet për fëmijë*⁵, apo *Tregimet për fëmijë të Naum Priftit*⁶, tregojnë qasjen e saj si studiuese. Ajo i sheh fenomenet letrare gjerë dhe në detaje, në pikëpamje tipologjike e historike, si dhe në pikëpamje artistike e sociale.

Mbas viteve '90, objekti i studimit të prof. Miaserit zgjerohet me letërsinë shqipe të viteve 20-30. Në një numër të konsiderueshëm artikujsh shkencorë, ajo trajton tema të tilla, si: *Mbi stilin në prozën e shkurtë të Koliqit*⁷, *Prozat e shkurtra të Koliqit*⁸, *Zhvillimi i letërsisë në trevën e Shkodrës në vitet '20-'30*⁹, *"Simfonia e shqipeve" e Ernest Koliqit*¹⁰, *Poetët shkodranë në vitet '20-'30*¹¹, *Probleme të stilistikës në veprën "Letratyra shqipe" të Justin Rrotës*¹², *Soneti në letërsinë shqiptare të viteve '30*¹³,

¹ Buletini Shkencor i Universitetit të Shkodrës, nr.2, 1988, fq.56-67.

² Buletini Shkencor i Universitetit të Shkodrës, nr.1, 1989, fq.89-103.

³ Buletini Shkencor i Universitetit të Shkodrës, nr.2, 1989, fq.46-65.

⁴ Buletini Shkencor i Universitetit të Shkodrës, nr.1, 1990, fq.78-89.

⁵ Buletini Shkencor i Universitetit të Shkodrës, nr.2, 1990, fq.88-101.

⁶ Nëntori, nr.10, Tiranë, 1990.

⁷ Studime Shqiptare 1, 1994, fq.46-51.

⁸ Shkodra në shekuj, botim i Simpoziumit I Ndërkombëtar, 1994, fq.309-313.

⁹ Studime Shqiptare 2, 1995, fq.68-73.

¹⁰ Studime Shqiptare 3, 1995, fq.52-56.

¹¹ Buletini Shkencor i Universitetit të Shkodrës, seria e sh. shoqërore, 1995, fq.53-65.

¹² Studime Shqiptare 4, 1995, fq.26-30.

¹³ Letërsia si e tillë, botim i Akademisë së Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe letërsisë, Tiranë, 1996, fq.195-201.

Ndikime të letërsisë klasike të “Lahuta e Malcisë”¹⁴, Studimet e Prof.Giusepe Gradilonës në Romë për ndikimet e letërsisë klasike në letërsinë tone¹⁵, Prof.Çabej për disa çështje të letërsisë¹⁶, Rritja e shprehshmërisë së nxënësve përmes teksteve të gjuhës shqipe në shkollën 8-vjeçare¹⁷, Meditime mbi Ernest Koliqin¹⁸, Poetika dhe realiteti në vargjet e Arshi Pipës¹⁹, Poetika në veprat letrare të Pashko Vasës²⁰, Dialogu dhe rrëfimi në prozën e Koliqit²¹, Teksti tregimtar, përvetësimi i vetëdijshëm dhe veprues i tij²² ...etj.

Në kapjen e trajtimit të këtyre temave që zgjasin afërsisht deri rreth viteve 2000, vëmë re se kristalizohen edhe me një pjesë të mirë të qasjeve dhe trajtimeve tipologjike të saj si studiuese. Kështu vërehet se studiuesja fokusohet në:

- lidhjen e pazgjidhshme me vendlindjen, tipat dhe karakteret, raportin e shkrimtarit me teorinë më të reja psikologjike, marrëdhënien e shkrimtarit me lexuesin, tonin e veprës, gjuhën;
- klimën kulturore në zhvillimin e letërsisë: jaret, bejtet, karnavalet ... skenat e teatrit, bandën, orkestrinat ... tregon se shumica e shkrimtarëve janë universitarë (me kulturë të gjerë); citon shoqëritë botuese, larminë e shtypit dhe shumëllojshmërinë e tipologjisë së veprave, ku vë në fokus tekstet e letërsisë, përkthimet e sidomos botimet folklorike ... risitë që sjellin autorët letrarë;
- risitë metrike në krahasim me gjithë sistemin rimor shqiptar, tregohet integrimi i artit popullor me atë klasik, bashkëjetimi i retorikës popullore dhe asaj klasike, studiohet këndvështrimi i Çabejt në raportin: mes lindjes e perëndimit, për të vijuar në dallimin e bazamentit të kombit dhe shpirtit estetik të tij, fokusohet mbi pikëpamjet e Sartrit për letërsinë dhe konceptet bashkëkohore të komunikimit letrar;
- dialogun dhe rrëfimin (si element forme), raportin e letërsisë me komunikimin, në këndvështrimin e estetizmit, sipas Sartrit, tregon

¹⁴ Botim i Akademisë së Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, “Seminari XVIII.

Ndërkombëtar për gjuhën, let. dhe kulturën shqiptare”, Tiranë, 1996, fq.1035-1039.

¹⁵ Studime Shqiptare 7, Shkodër, 1997, fq.61-65.

¹⁶ Studime Shqiptare 9, Shkodër, 1998, fq.154-160.

¹⁷ Studime Shqiptare 10, Shkodër, 1998, fq.133-137.

¹⁸ “Studime 4”, Akademia e Shkencave dhe e arteve e Kosovës, Prishtinë, 1998, fq.351-358.

¹⁹ Buletini Shkencor i Universitetit të Shkodrës, seria e shkencave shoqërore, 1999.

²⁰ Shkodra në shekuj, botim i Sem. III Ndërkombëtar, Shkodër, 2000, fq.125- 131.

²¹ Studime Shqiptare 11, 2001, fq.71-77.

²² Buletin Shkencor i Universitetit të Shkodrës, seria e shk. didaktike, 2001, fq.47- 53.

domosdoshmërinë e integritit të thellë të gjuhës me letërsinë apo nxitjen e shprehshmërisë së nxënësve përmes teksteve.

Nëse do të sintetizonim edhe më tej tipologjinë e qasjeve dhe trajtimeve, do të vinim re që prof. Miaseri:

- e studion letërsinë në marrëdhënie të gjerë kulturore me vendin ku lind (tek e cila shkrimtarët shkodranë dhe Shkodra kanë një vend të veçantë);
- e sheh letërsinë në raport me traditën dhe me risitë, ku përpiqet të gjejë bazamentin e kombit;
- e sheh letërsinë si komunikim dhe si formë, duke sjellë këndshikime të reja të teorive letrare në studimin e tekstit letrar (të cilat filluan të hynin në Shqipëri vetëm pas 91-it).

Afër viteve 2000, prof. Miaseri fillon të botojë artikuj me objekt folklorin, si: *Llojet e vargjeve në këngën popullore qytetare shkodrane*²³. Puna në Tiranë, si studiuese e folklorit në Akademinë e Shkencave (Instituti i Kulturës Popullore, Departamenti i Folklorit), në Qendrën e Studimeve Albanologjike apo në Akademinë e Studimeve Albanologjike (Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, Departamenti i Folklorit), bën që prof Miaseri ta fokusojë punën specifikisht mbi folklorin. Ajo do të botojë një sërë studimesh, brenda (rregullisht në *Kultura popullore*) dhe jashtë Shqipërisë, ku bie në sy kërkimi i gjerë dhe i thellë. Për shembull, këngët folklorike të dasmës prof. Miaseri i studion duke kërkuar edhe në përmbledhjen e muzikologëve Tonin Zadeja e Tish Daija: *250 këngë qytetare shkodrane*, edhe në përmbledhjen A. Xhagollit e R. Bogdanit, *Letërsi folklorike*, Prishtinë, 1996; edhe të I. Alibalit: *Në Shkodër të gjithë këndojnë*; edhe të Kolë Gurashit: *Shkodra e baballarëve*; edhe të Gjon Kujxhisë: *Valle kombëtare, Dasëm shkodrane*, Firenze, 1943 etj. Ky kërkim shtrihet edhe jashtë Shqipërisë me disa artikuj, ku bie në sy: *Gjurmim në bibliotekën e Grotta Ferratës në Romë, përkthim, përshtatje dhe botim për herë të parë në Shqipëri i veprës së arbëreshit Francesco Argondizza "Këngë popullore të mbledhura në Shqipëri, Romë 1927"*²⁴.

Ky kërkim i gjerë karakteristik që bie në sy edhe tek një artikull impenjues bibliografik në 2013-ën, me temë: *Mendimi kritik i studiuesve shkodranë në vitet 1939-1944*²⁵ për letërsinë arbëreshe, hap ura komunikimi dhe ndërton stil pune të prof. Miaseri gjë që do ta çojë atë në hartimin e shumë librave monografikë:

²³ Buletini Shkencor i Universitetit të Shkodrës, seria e shk. shoq., 2001, fq.103- 119.

²⁴ "Kultura Popullore", botim i Institutit të Kulturës Popullore Tiranë, 1-2/2005, fq.219-232.

²⁵ Buletini Shkencor i Universitetit të Shkodrës, seria e shk. shoq., 2013.

- **Vlera poetike te viteve '20-'30', Shkodër, 1996**

Është një përmbledhje studimore, me rreth 187 faqe, botim i Universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës. Në këtë monografi përmbledhen të zgjeruara shkrimet mbi letërsinë e viteve '20-'30 që përmendëm më sipër, por edhe disa shkrime të tjera, ku bien në sy ato karakteristika që kemi cilësuar më sipër.

- **Ceremoniali i dasmës në qytetin e Shkodrës, Tiranë, 2004**

Në këtë monografi dasma shihet si një spektakël, ku vihet re sinkretizmi i hershëm antik, kurse këngët e dasmës, prof. Miaseri i quan *një prej relikteve të një tradite e kulture mijëra vjeçare ... e simbol të hyjnizimit të jetës*. Ajo i sheh ato të lidhura me melosin, tekstin, ritin, me etapat e ritualit martesor: fejesa, përgatitja për dasëm dhe martesa. Studimi paraqitet si vazhdimësi e punës së folkloristëve, si: Zef Jubani, Vinçenc Prennushi, Kasem Taipi, Kolë Gurashi etj.

Pavarësisht se libri fokusohet në ceremonialin e dasmës shkodrane, autorja përpiket ta krahasojë me atë të Beratit, Matit, Elbasanit, Vlorës, Gjirokastrës, Myzeqesë, Prishtinës, Pejës, Gjakovës, Çamërisë etj., duke shfrytëzuar çdo botim të studiuesve lokalë e kombëtarë të folklorit, gjë që i jep studimit gjerësi gjeografike.

Kurse përmbledhjet dhe opinionet e mbledhësve të folklorit, si: Zef Jubani, Thimi Mitko, Dozon, Kasem Taipi etj., prof Miaseri i studion duke kërkuar dhe gjetur ngjashmëri e ndryshime mes këngëve folklorike, gjë që i jep studimit edhe thellësi diakronike historike.

Tekstet shihen si reflektim i zakoneve që lidhen me pajën, veshjen, me kulturën e mbjelljeve e të prodhimit, të zejtarisë, punës së dorës, tregtisë, arkitekturës, të rangjeve sociale etj. Në një prej pjesëve në libër prof. Miaseri tregon edhe për disa sulle më 1878, me anë të të cilave u përcaktuan 4 rangje shoqërore dhe u ndalua të kapërcehej shpenzimi mbi rregullat e përcaktuara për zënien e vajzës, pajën e saj etj, gjë që u shënua në protokollin e kryefetarëve të besimeve.

- **Paralele folklorike ndërkufitare, Alfred Çapaliku, Miaser Dibra, Shpresa Rama; Camaj-Pipa, 2005**

Ky libër shkencor është zgjerim i objektit të kërkimit të “Këngët e dasmës”, pasi paralelet e këngëve të dasmës kërkohen tani në bashkautorësi edhe me dy kolegë të tjerë në zonën e shqiptarëve në Mal të Zi (që shoqërohet edhe

me një antologji të tyre) si dhe me këngët e dasmës tek malazezët (gjë që shoqërohet edhe me një antologji të tyre). Gjithashtu objekti i studimit në libër zgjerohet, pasi fokusohet edhe mbi ninullat që ekzistojnë tek shqiptarët e Malit të Zi dhe tek ninullat që këndohen nga malazezët (të cilat përsëri shoqërohen me antologji).

Zgjerimi i studimit shfrytëzohet për të treguar veçori origjinale të folklorit shqiptar, gjë që në një mënyrë të tërthortë, jep material për studime teorike më të thelluara mbi tezat e poligjenezës apo jo të folklorit, si dhe të motiveve etnike të ndryshme.

- “Shkodra, vlera tingëlluese”, album, Shkodër, 2006

Ideja e të parit të folklorit në sinkretizmin e hershëm antik, të tekstit të lidhur me melosin, ritmin, etnokulturën e veshjeve, të zejtarisë, punës së dorës, etj., është ajo që e shpie prof. Miaserin së bashku me disa kolegë, specialistë të fushave përkatëse, të jetë pjesë e një projekti të koordinuar nga ish- drejtori i Muzeut Historik të Shkodrës, prefekti i qarkut të Shkodrës, z. Maxhid Cungu, për të krijuar një album që promovonte vlerat gjeografike, historike, kulturore, etnografike e ekonomike të Shkodrës. Albumi ka një strukturë prej nëntë seksionesh, ku rreth 70 për qind të tij e zënë fotot dhe pjesa tjetër e tekstit shqip përkthehet edhe në gjuhën angleze. Albumi synon nxitjen e vetëdijes qytetare dhe prezantimin e vlerave para organizmave të ndryshme partnere, duke i parë ato si faktorë të zhvillimit rajonal.

- Metafora në këngët popullore shqiptare, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, 2007

Ky studim i gjerë është motivuar nga ideja e autores që shprehet se ... *pak monografi, të shkruara pas viteve “70 në Shqipëri dhe në Kosovë ... kanë trajtuar drejtpërdrejt apo kanë si pjesë të konsiderueshme të përmbajtjes së tyre studimin e mjeteve shprehëse stilistikore në folklor ...* (fq. 9).

Libri është i një natyre të fortë teorike, por edhe i mbështetur mbi një bazë shumë të gjerë dhe të pasur folklorike (studimi është mbështetur në mijëra skeda). Është ndoshta ndër veprat më të thella të autores, ku janë harmonizuar më së miri dy fazat e punës dhe angazhimeve sipas dijeve: e para në Universitetin e Shkodrës, ku prof. Miaseri ka dhënë leksione mbi stilistikën dhe e dyta në Akademinë e Shkencave, ku është marrë gjerësisht me folklor.

Paraqesin interes këndshikime të tilla, si: organizimi strukturor i

metaforave në këngët popullore, poetika e metaforës në këngët popullore dhe në poezinë e shkruar, metafora dhe vizioni estetik, mëvetësia dhe ndërveprimi i metaforës në sistemin figurativ etj.

- **“Studime për autorë të ndaluar”, botim i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, QSA, Tiranë, 2008.**

Në kuadrin e rivlerësimit të letërsisë shqiptare të gjysmës së parë të shekullit XX, kjo vepër mbart kontributin e prof. Miaserit (në bashkautorësi me kolegët) në sjelljen e mendimeve dhe të opinioneve bashkëkohore mbi autorët e ndaluar gjatë komunizmit në Shqipëri dhe bën përpjekje për të lidhur kritikën evropiane të fillimshekullit XX me kritikën bashkëkohore shqiptare dhe për të krijuar kohezion me të.

- **Emigracioni në këngët popullore shqiptare, QSA, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, Tiranë, 2010**

Kjo monografi ka për objekt analizën e gjerë profesionale të këngëve të kurbetit, si lloj që nuk ka krijuar shképutje nga tradita dhe si poetikë që karakterizohet nga ndërthurje llojesh e zhanresh, si rrallë ndonjë pjesë tjetër e folklorit tonë gojor. Studimi bëhet me objektiv për të zbuluar vetëdijen e thellë të individit, për të hedhur dritë mbi psikologjinë sociale, mbi veçoritë dhe mundësinë e jetëgjatësisë së këngëve folklorike dhe të transformimit gjinor apo tipologjik të tyre, duke u përqendruar në shekujt XIX-XXI.

Interes të veçantë paraqet studimi i këngëve të emigracionit shqiptar mbas viteve ‘90 dhe raporti i tyre me historinë e zhanrit, të artformimit e të qarkullimit folklorik. Është shfrytëzuar për literaturë pothuajse çdo gjë: Arkivi i Folklorit të shkruar, Arkivi Etnografik, Arkivi audio-vizual, botimet me material folklorik të bëra me fondet arkivore, materiale të mbledhura në terren, Arkivat e Radio Tiranës dhe të Televizionit Shqiptar, fondet e shtëpive diskografike, materialet e botuara ose jo të Festivaleve Folklorike Kombëtare dhe veprimtarive të tjera folklorike të njëzet viteve të fundit; janë shfrytëzuar libra e artikuj me këtë temë të botuara në Romë, Milano, Firenze, Shkup, Ohër, Prishtinë, Sarandë, Vlorë, Shkodër, pa folur për studiuesit e albanologët e huaj klasikë, si: Rainhold, Majer, Erber, Petrotta, Dozon, etj

Studiuesja nxjerr një konkluzion interesant njerëzor, kur thotë që ... *mendimi artistik popullor nxjerr në plan të parë gjëra shumë më të rëndësishme se vlerat monetare...*

Libri është i shkruar me emocion dhe ndjenjë, duke e parë fenomenin si shqiptare, si studiuese, si nënë dhe si njeri me zemër të ndjeshme dhe të ndikuar edhe nga përvoja personale e bashkëqytetare, pavarësisht se siç thotë ajo bota është bërë më e vogël, më e kapshme dhe më e mundshme për t'u vizituar.. e megjithatë ajo shkruan "... e përjetoj ritualin e pritjeve-përcjelljeve në kohë festash ... në kohën kur portet, aeroportet, pikat kufitare janë mbushur plot ... I dalloj shpesh makinat e emigrantëve që kthehen me valixhe të mëdha ... më duket se katër rrotat lëvizin me mundim nga pesha tek sjellin ç'të mundin për të gëzuar të afërmit...Kam frikë se do të jetë një ritual në vijim pa cak, por të paktën në një botë ku nuk ka kufij që pengojnë...Dhe kënga popullore do vazhdojë të prekë telat e zemrave të drithëruara, të malluara..."

- Studime për estetikën e folklorit, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe i Studimit të Artit, Tiranë, 2016

Studimin mbi estetikën e folklorit, studiuesja e quan fushë të hapur. Janë studimet e gjashtëmbëdhjetë viteve: 2000-2016, të mbledhura dhe të ripara në këndvështrime interesante: Universalizmi i heronjve të epikës sonë legjendare; E bukura, e mira, e dobishmja, koncepte bazore estetike në krijimin e heronjve legjendarë; E madhërishmja si kategori estetike në karakteret heroike të eposit; E bukura në elementet mitologjike... etj. Një kapitull i veçantë me interes është edhe: *Folklori dhe letërsia e shkruar artistike*.

- Këngë dasme, antologji 1, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, Tiranë, 2017

Punë që është realizuar gjatë disa viteve. Prof. Miaseri duket e dashuruar me këngët e dasmës. Vëllimi konsiderohet çuarje përpara e punës së bërë në vëllimet "Visaret e Kombit" XV, Tiranë 1944 dhe "Këngë dasme" I,II, botim i Institutit Albanologjik të Prishtinës (1980, 1981) dhe plotësim i një vëllimi bashkëkohor, dedikuar vetëm dasmës. Vëllimi nuk përsërit lëndën antologjike të botuar më herët... nuk tenton të jetë shterues ... por boton materiale të pashfrytëzuara me këtë tematikë të ruajtur në arkivat shkencore të Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe të Studimit të Artit (IAKSA), pranë QSA Tiranë. ... ky libër sjell vlera kulturore të gjurmë në terren ndër disa dhjetëvjeçarë dhe i referohet njësive të arkivuara në dy arkiva: në Arkivin e Prozës dhe Poezisë Popullore dhe në Arkivin e Muzikës të

IAKSA-së dhe është një punë thuajse shtruese për këtë tematikë në këto struktura drejtuese (fq. 7)

Puna që është bërë është voluminoze (mbi 1000 faqe), është profesionale, pasi klasifikimi i fondit realizohet sipas etapave të ceremonialit të dasmës, është një punë e sqaruar metodologjikut, duke pasur parasysh lexues elitarë dhe amator të folklorit. Autorja i quan këngët *pasaportë kulturore e patjetërsueshme*... Ajo vë në dukje edhe interesin gjuhësor, duke tërhequr vëmendjen për fjalë dialektore, krahinorizma apo zhargone.

- Studime mbi folklorin shqiptar, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe i Studimit të Artit, Tiranë, 2020

Libri përfshin artikuj që rimerren dhe klasifikohen në tri ndarje:

A. Studime teorike mbi folklorin letrar (ku mbeten me interes: Kujtesa sociale mbi Skënderbeun, model artistik për konceptimin e luftëtarit në këngët epike të shek.XIX; Lirika popullore në bashkëkohësi...; Analiza e fjalës artistike në folklor...; Metodika dhe kriteret e kërkimit folklorik në terren... etj

B. Personalitete të folkloristikës shqiptare. Autorja ka marrë në shqyrtim figura dhe personalitete të tilla, si: Lef Nosi, Gjon Kujxhia, Kolë Gurashi, Kasem Taipi, Vinçens Prennushi, Thimi Mitko, De Rada etj.

C. Këngët popullore shkodrane në një këndvështrim studimor.

Kjo punë intensive për folklorin e shpie prof. Miaserin në dëshirën normale për ta servirur atë edhe në një opinion më të gjerë evropian. Ajo boton në bashkautorësi në anglisht: "Intangible heritage and its trends", studime për etnokulturën, Tiranë, 2011. Dy vite më vonë, po në bashkautorësi në anglisht: "Albanian Intangible Cultural Heritage", Tiranë, 2013, album. E pas tre viteve në gjermanisht: "Deutsch-Albanische Wissenschaftsbeziehungen hinter dem Eisernen Vorhang", Gjermani, 2016. Ky botim në Gjermani ka në fokus studimin e plotë të materialeve që u mbledhën në terren nga albanologë shqiptarë dhe gjermanë në vitin 1957, gjatë një ekspedite dymujore nëpër të gjithë Shqipërinë. Është botuar si pjesë e një vëllimi me në fokus studimet e albanologëve gjermanë për Shqipërinë.

Tetë monografi individuale, gjashtë monografi të botuara në grup dhe një sërë artikujsh studimorë, si dhe nga ana tjetër, puna për dy herë radhazi si Dekane e Fakultetit të Shkencave Shoqërore të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" (1993-2000), për rreth dhjetë vjet si Drejtore e Institutit

të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit e po ashtu si kryeredaktore e revistës shkencore “Kultura popullore” si dhe kryeredaktore e pesë vëllimeve studimore të IAKSA-s në vitet: 2008-2017 në Tiranë e përfshijnë prof. Miaser Dibrën, si një nga figurat e çmuara intelektuale në radhën e studiuesve, në rang kombëtar.

LITERATURË

- Studime shqiptare” (1993-2016).
- Buletin shkencor i Universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës, seria e shkencave shoqërore (1989-2012).
- Buletin shkencor i Universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës, seria e shkencave didaktike (2001).
- “Shkodra në shekuj” (1994-2003).
- “Kultura Popullore”, botim i Institutit të Kulturës Popullore (2001-2016).
- Soneti në letërsinë shqiptare të viteve “30, Letërsia si e tillë, botim i Akademisë së Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe letërsisë, Tiranë, 1996, fq.195-201.
- Meditime mbi Ernest Koliqin, “Studime 4”, Akademia e Shkencave dhe e arteve e Kosovës, Prishtinë, 1998, fq.351-358.
- Paralele shqiptaro-malazeze në ceremonialin e dasmës, Botim i përmbledhjeve të kumtesave të Kongresit IX të Studimeve të Evropës Juglindore, 2004.
- Përkime të “Lahutës së Malcisë” me vargje të këngëve epike popullore, Revista “Çështje të folklorit shqiptar 9”, botim i IKP, Tiranë, 2006, fq.282-332.
- Tregimet për fëmijë të Naum Priftit, Nëntori, nr.10, Tiranë, 1990.

Libra:

- Ceremoniali i dasmës në qytetin e Shkodrës, Tiranë, 2004, 276 fq.
Paralele folklorike ndërkuftare, Alfred Çapaliku, Miaser Dibra, Shpresa Rama; Camaj-Pipa, 2005.
- Emigracioni në këngët popullore shqiptare, QSA, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, Tiranë, 2010.
- Këngë dasme, antologji 1, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, Tiranë, 2017.
(Vëllimi dytë është menduar si notizim melodik)
- Studime mbi folklorin shqiptar, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe i Studimit të Artit, Tiranë, 2020.
- Metafora në këngët popullore shqiptare, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, 2007.
- Studime për estetikën e folklorit, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe i Studimit të Artit, Tiranë, 2016.

*ABSTRACT***The contribution of prof. dr. Miaser Dibra in the study of cultural heritage and Literature as well as in the directing of the Albanian Academic System**

The bibliographic work has as its object the scientific activity of prof. Miaser Dibrës, in the field of folklore and literary studies, an activity that has been crowned with eight monographs, six monographs in a group of authors as well as a number of study articles.

The article tries to shed light on the typology of the approach and treatments of prof. Miaser in the entirety of her studies as well as trying to frame this activity with her role as a leader in the capacity of Dean of the Faculty of Social Sciences at the University of Shkodra and Director of the Institute of Cultural Anthropology and Art Studies in Tirana and especially as editor-in-chief of the magazine scientific "Popular culture" and five study volumes of IAKSA (2008-2017). This next contribution of Prof. Miaser Dibrën is one of the precious intellectual figures in the ranks of researchers at the national level.

Veron DOBROSHI

FENOMENE LETRARE DHE KULTURORE NË DISKURSIN KRITIK TË KRIST MALOKIT

Mbi kritikën letrare shqipe

Kritika letrare shqipe lindi në periudhën e modernizmit shqiptar dhe lidhet ngusht me emrin e Faik Konicës dhe revistën *Albania*. Konica ishte nismëtar i kritikës shqipe duke theksuar karakterin subjektiv të saj dhe duke ndarë letërsinë didaktike nga letërsia me vlerë estetike. Letërsia sipas tij e ka të domosdoshme kritikën letrare sepse kritika është kusht që letërsia të ketë një vlerë më të lartë estetike. Konica krijon sisteme vlerësimi duke e parë kritikën si një gjykim të vlerave mbi një metodë dhe kritere të përcaktuara. Elementet kryesore të kritikës letrare të Konicës shfaqen me shkrimin (teorizimin) mbi kritikën “Kohëtore e letrave shqipe” (1906). Pas Konicës shfaqen autorë të tjerë që merren me kritikën letrare. Midhat Frashëri u bë i njohur si kritik me monografinë për Naim Frashërin duke nxjerrë në pah vlerat kombëtare të tij, kryesisht fokusuar mbi kontekstin kulturo-historik. Studiuesi Eqrem Çabej në kritikën letrare u shfaq me studime të ndryshme me vlerë të posaçme. Ai botoi “Mbi poezinë e Lasgush Poradecit” duke zbuluar karakteristikat thelbësore të poezisë moderne të poetit, pastaj boton *Elemente të gjuhës e të literaturës shqipe, Për gjenezën e literaturës shqipe* etj. Çabej zhvillon teorinë e qarqeve letrare dhe përmes një syri të mprehtë kritik studion letërsinë shqipe edhe në raport me gjeografinë e historinë e vendit. Fan Noli në kritikën shqipe njihet me *Introduktat* e tij mbi vepra të ndryshme të letërsisë botërore. Ndër to veçohen tragjeditë e Shekspirit, *Don Kishoti* i Servantesit, lirikat e Khajamit etj. Kuteli në botën kritike letrare u shfaq me studimet mbi poezinë e Lasgush Poradecit të vitit 1937 dhe mbi poezinë e Fan Nolit (1943). Kuteli në të njëjtën kohë ishte i pari që botoi libër me kritika në *Shënime letrare* (1944) duke trajtuar fenomene të ndryshme mbi poetikat e autorëve të ndryshëm shqiptarë, por edhe të huaj. Dhimitër Shuteriqi boton kritikë që shënjonte një dimension më ndryshe, synonte një letërsi që kishte si bazë letërsinë sociale. Ernest Koliqi gjithashtu boton ese të ndryshme kritike, Arshi Pipa boton shkrime të përqendruara kryesisht në domenin teorik dhe filozofik të shkrimit. Përmendim këtu esetë e tij “Për një kritikë

letrare” (1941) dhe “Shpirti Kritik” (1944). Një rol me rëndësi të madhe në kritikën letrare shqipe luajnë edhe studimet teorike mbi kritikën të Ibrahim Rugovës që bëhen një nyjë sistematike në opusin e krijimtarisë së tij. Veçojmë studimet “Kah Teoria”, “Strategjia e kuptimit”, “Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare”, “Refuzimi estetik”. *Kritika letrare e dijetarit Rugova është një katror i dijes letrare. Ai e mendon kritikën të lidhur me letërsinë, nga e cila edhe buron. Kritika letrare nuk është mësim, por aktivitet interpretues i hapur, që atribuon kuptime. Kjo është kritika moerne, e cila buron së pari nga vepra letrare moderne.*¹ Studime tjera të rëndësishme në fushën e kritikës letrare shqipe janë edhe studimet e Justin Rrotës “Letratyra shqipe”, Luigj Gurakuqit, me studimin e tij të njohur mbi metrikën “Vargënimi në Gjuhë Shqipe” etj. Përmendim këtu edhe emra të tjerë që kanë dhënë kontributin e tyre të rëndësishëm me studimet e tyre kritike, si: Aleksandër Xhuvani, Kostaq Cipo, Skënder Luarasi, Namik Resuli, Qemal Draçini Sabri Hamiti, Kujtim Rrahmani, Rexhep Qosja, Mensur Raifi, Aurel Plasari etj. Kritika letrare shqipe u zhvillua duke aplikuar metodat e ndryshme, si: subjektive, kulturore, biografike, historike, formale, psikanalitike etj. *Shumësia e metodave kishte një kushtëzim të brendshëm, nisjen e modernitetit letrar, ku dominojnë poetikat individuale e jonormative, dhe një kushtëzim të jashtëm, njohjen me rrymat letrare e mendore të shekullit bashkëkohës. Metodot e kërkimit shenjojnë paradigmën teorike të kërkuesit dhe janë provë e insistimit apo e sistematikës së kërkimit.*² Një studiues i cili ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në kritikën letrare shqipe është edhe dijetari Krist Maloki (1900-1972), i shkolluar në Austri dhe njohës i fushave të ndryshme shkencore e kulturore. Kritika e tij letrare është edhe objekt trajtese i këtij studimi.

Disa fjalë për Krist Malokin

Krist Maloki ka lindur më 1900 në Prizren dhe qysh si fillorist u shqua për zgjuarsinë dhe dashurinë e tij të madhe për dijen. Ndoqi shkollën e mesme në Austri si bursist dhe më pas studion filozofinë dhe muzikën. Në vitin 1929 doktoron në filozofi ndërsa nga po ai vit fillon edhe studimet në drejtësi, ku merr edhe një doktoratë në shkencat juridike më 1934. Punoi si profesor i Akademisë Tregtare të Gracit dhe profesor në Universitetin e

¹ Kujtim Shala, *Zbulesa e modernitetit*, Fondacioni Ibrahim Rugova, Prishtinë, 2017, fq. 189.

² Kujtim Shala, *Zbulesa e modernitetit*, Fondacioni Ibrahim Rugova, Prishtinë, 2017, fq.191.

Gracit për letërsinë shqipe e ballkanike. Krist Maloki boton disa shkrime në revistën “Hylli i dritës” duke nxitur polemika e debate të ndryshme. Maloki hyn në kritikën letrare shqipe si nismëtar i një kritike psikanalitike duke dëshmuar një njohuri të thellë kulturore e letrare mbi fenomene të ndryshme. *Maloki është kritiku që shpall e që ndjek një metodë kërkimi, me rrënjë në teoritë kulturore e në estetikë dhe me degëzime në psikanalizë. Insistimi metodologjik është shenja e profilit të një dijetari sistematik. Hapja para dijeve e përcakton rrjetin e shenjave të profilit të një kritiku letrar dijetar.*³ Studimet e tij më të njohura janë: *Naim Frashëri* (1925), *Asht poet Lasgush Poradeci?* (1938), *Oriental apo Okcidental* (1937), *Diktaturë apo Demokraci, Literatura shqipe* etj. Studimet e Malokit karakterizohen nga analiza e thellë psikologjike, burimet e fshehta të motivimit të shkrimtarit, duke u përqendruar a priori te personi, më pas te krijimi letrar.

Studimi mbi Naim Frashërin dhe Lasgush Poradecin dëshmon këtë metodë studimi ku përveç analizës psikologjike Maloi ngjall edhe debate mbi vlerat letrare duke polemizuar edhe me studiues dhe studime tjera. *Maloki kërkonte një kritikë objektive, e cila do t'i zhbënte gjykimet e skajshme për autorët e për tekstet letrare shqipe, duke u mbështetur në vlerat e vërteta të tekstit letrar e duke i anashkaluar gjykimet a paragjykimet si derivat i pashmangshëm ambientat. Ai vlerësonte që kritika e mirëfilltë është kritikë krijuese dhe prodhuese, shkrim kritik i cili mbështetet në shkrimin letrar.*⁴

Studimi mbi Naim Frashërin

Ky studim fokusin kryesor e ka në analizën mbi personalitetin dhe psikologjinë e autorit duke kërkuar prapavijat dhe duke synuar një kritikë objektive mbi letërsinë e Naimit. Si referencë merr studimin biografik të Midhat Frashërit (Lumo Skendo) që sipas Malokit është studimi i vetëm biografik mbi Naimin, por ka mungesa për shkak se nuk e paraqet anën psikologjike të tij. Maloki dëshiron që ta diferencojë Naimin si njeri dhe si dijetar: *qëllimi yn asht ma tepër të fiksojm personën si njeri, jo si dijetar, një qenje këjo që shum herë s'ka lidhje me shpirt e karakter. Dijetari ma i madh i kësaj bote “mund” të jet dhe ma i poshtmi dhe ma i fllligshti i botës. Encyklopedija asht një vehikel e ngordhun, po s'u tërhoq nga shpirti i cili*

³ Kujtim Shala, *Zbulesa e modernitetit*, Fondacioni Ibrahim Rugova, Prishtinë, 2017, fq.194.

⁴ Vehbi Miftari, *Kritika dhe moderniteti*, AIKD, Prishtinë, 2008, fq. 48-49.

mbas vetiënave(dishireve) të veta e çon përpjet a-tatëpjet. Maloki dialogonte me metodat tematologjike e psikanalitike, duke e paracaktuar edhe tipin e kërkimit, kritikën e kodeve tematike, që e njihte ideologjinë e lexuesit e të tekstit, përmes kërkimit psikobiografik të shkrimtarit. Kritika tematike e sfondit romantik dhe kritika psikobiografike e Frojdit i nënshtroheshin kriterit të ideologjisë nacionale. Nga ndërdija kalohet në vetëdije, për t'iu kthyer përherë e gjithnjë kërkimit të frymës nacionale në letërsi, si preferencë edhe për farën e letërsisë: letërsi e frymës nacionale.⁶ Maloki ndalet edhe te panteizmi në veprën e Naimit duke cituar edhe poezi të tij. Ai sheh tek Naimi shenja të budizmit duke e lidhur këtë me fenomenin e metempsikozës (kalimi i shpirtit prej një gjëje në një gjë tjetër).

Ahistorikja te Naimi

Një pjesë të konsiderueshme të studimit mbi Naimin e zë pjesa mbi çështjen e ahistorikes te vepra e Naimit. Maloki e konsideron Naimin si ahistorik në krijimtari duke e mbështetur konstatimin e tij në disa aspekte. Maloki pretendon që vepra e Naimit nuk trajton ngjarje në vijë kauzale, ngjarjet dhe njerëzit mbeten përherë në një vijë të njëjtë dhe koloriti është i ndarë arbitrarisht në dy plane: bardh dhe zi. Ai kritikon Naimin për mungesën e paraqitjes së individuale tek shqiptarët, mungesën e koloritit kombëtar dhe mospërkimin me karakterin e vërtetë shqiptar. Poezinë e Naimit e krahason edhe me *Lahutën e Malcës* të Gjergj Fishtës ku e favorizon Fishtën dhe zbulon mungesat e Naimit. Poezitë e Naimit sipas Malokit nuk kanë fillim e mbarim, kanë ngjyrim melankolike, mungesë kompozicioni dhe stili, nuk kanë as harmoni dhe as kënaqësi estetike. Vargun e tij e karakterizojnë edhe përsëritjet e shpeshta duke e lidhur këtë fenomen edhe me aspektin psikologjik të autorit si karakteristikë tipike e motivuar nga jeta e budistëve dhe të dervishëve, gjë e cila ka pasur një rol me rëndësi dhe me ndikim në jetën dhe krijimtarinë e Naim Frashërit.

A asht poet Lasgush Poradeci?

Ky është një nga studimet më të njohura të Malokit jo vetëm për faktin e natyrës së studimit, por edhe polemikës dhe debatit që ka shtruar në kritikën letrare shqipe. Studimi ndahet në dy pjesë dhe ka karakter polemizues me një studim tjetër mbi poetin Lasgush Poradeci, atë të

⁵ Krist Maloki, *Orienta apo okcidental*, Plejad, Tiranë, 2003, fq.83.

⁶ Vehbi Miftari, *Kritika dhe moderniteti*, AIKD, Prishtinë, 2008, fq. 86.

Kutelit. Maloki përmes studimit të tij shpreh pakënaqësinë dhe kritikon studimin e Kutelit duke kontestuar vlerat letrare të Poradecit. Malokin nuk e befasonjë aq ovacionet për Poradecin sa fakti se nga kush bëhen ato lavde, duke e vlerësuar lart Kutelin si dijetar. Maloki kritikon shkrimin e Kutelit edhe për nga metoda që përdor, duke e konsideruar si kritikë të gabuar dhe jo të mirëfilltë. Maloki nuk gjen te studimi i Kutelit një analizë të pastër letrare, analizë mbi tekstin, por një kritikë të bazuar në epitete të larta që nuk i përmbushin kriteret e një kritike të pastër letrare. Këtë e bën që në titull të studimit të tij duke e vënë në pikëpyetje vlerën e Poradecit si poet. Maloki kritikon Kutelin për qasjen subjektive dhe mungesën e objektivitetit në studimin e tij pasi që lë anash emrat e poetëve shqiptarë me vlera letrare duke i vendosur të gjithë prapa Lasgushit. *Maloki pranon Kutelin si dijetar. Ai konteston atë lidhur me Lasgushin, më saktësisht lidhur me zgjedhjen e Poetit nacional. Kuteli zgjedhjen e vet e mbështet te modeli, te poetika e Poradecit. Maloki kërkon literaturën në funksion nacional, pra literaturën që mban e afishon esencat nacionale.*⁷ Qasjen e njëanshme dhe skajshmërisht subjektive të Kutelit, Maloki e lidh edhe me aspektin biografik të shkrimtarëve. Kuteli e Poradeci janë të dy nga Pogradeci dhe të dy kanë studiuar në Bukuresht. Maloki ndalet te përkufizimi i poezisë së mirëfilltë duke bërë dallimin mes poezisë dhe poetit dhe divergjencave në gjykimet letrare mbi thelbin e kuptimit të artit. Këtë ai e bën përmes referencave të shumta nga mendimtarë të shquar të fushave të ndryshme artistike.

Një “Dichter” shqiptar

Maloki në studimin e tij sqaron kuptimin e fjalës gjermane *Dichter*, fjalë me të cilën populli gjerman vlerëson një person të lartë, një prijës, një hero të kombit, një lloj profeti. *Poeti i vërtetë asht pasqyra e shpirtit të kombit dhe asht lajmtari dhe kasneci i gjithë dishireve, andrimeve, shpresave dhe brengave ma të fshehta të tija; ma fort: poeti i vërtetë asht njaj instrument i perëndijshëm, nëpër të cilin tingllon dhe zhungllon, si një sinfoni e gjallë, e gjithë qenja e kombit qysh nga kohënat ma të herëshme e të kalueme, plot lot e përvajtme. Shka e cilëson poetin “Instrument të Perëndis” asht njajo zotsi e tij: me mendue e me dishrue me Kombin e me hjekë keq e me vuejtë për të deri në fundin e shpirtit të vet.*⁸

Duke u nisur nga zbërthimi i fjalës “Dichter”, Maloki mundohet ta

⁷ Kujtim Shala, *Zbulesa e modernitetit*, Fondacioni Ibrahim Rugova, Prishtinë, 2017, fq. 177-178.

⁸ Krist Maloki, *Oriental apo Okcidental*, Plejad, Tiranë, 2003, fq. 38.

vendosë Lasgushin brenda filtrave të këtij nocioni, por nuk gjen attribute dhe vlera të cilat e barazojnë poetin shqiptar me vlerat e vërteta të fjalës Dichter. *Lasgushi asht ndoshta njëfarë poeti, por jo në kuptimin e nalt të fjalës "Dichter". Sepse shka i mungon Lasgushit në një mënyrë fort të çuditëshme, por edhe të dukëshme, asht njajo lidhni e ngushtë dhe njajo vuejtje e përbashkët me kombin e vet.*⁹

Ai vë në pah që te poeti shqiptar mungon bashkëvuajtja me kombin, paraqitja e ngjarjeve dhe fenomeneve kombëtare përveç në disa vjersha me përmbajtje të përgjithshme kombëtare shqiptare, por që në syrin e kritikut tonë janë nga poezitë më të dobëta të poetit, sepse nuk kanë frymë të vërtetë poetike nacionale. Për ta thelluar edhe më tepër konstatimin e tij mbi mungesën e koloritit nacional në vargun e Lasgushit, Maloki përmend dhe njëherësh edhe krahason varfërinë e vargut të poetit në aspektin tematik dhe atë të frymëzimit kombëtar me veprat e Fishtës, Asdrenit, Çajupit, Mjedës, A.Asllanit, Koliqit, V.Prendushit etj. Maloki zbulon në poezinë e Lasgushit mungesën e thellësisë së mendimit, paraqitjes së hollësishme të ndjenjës kombëtare dhe me ngjyime puro shqiptare.

Në pjesën e dytë të këtij studimi, Maloki zbërthen termin „kolorit“ duke e ilustruar me shembuj nga veprat e mëdha letrare e artistike në botë dhe ndryshimet mes tyre brenda domenit të koloritit. *Koloriti asht era e atmosfera e duhunë ku merr frymë dhe gjallon një vepër e vërtetë artistike. Dhe koloriti duhet të jetë i përshtatun, apor adekuat me personat, zemrat, shpirtent, natyrat etj., që marrin frymë aty mrenda sepse përndryshe u del fryma dhe veprat artistike mbesin të zbeta, apor edhe të vdekuna.*¹⁰ Maloki pretendon që te Poradeci ka nuanca të koloritit, por që janë esencialisht shqiptare. Poezia e tij përmban një kolorit dekadence. Si poetin më të pasur me kolorit e sheh Koliqin. Maloki i referohet poetit gjithnjë me emrin e tij artistik Lasgush Poradeci e jo si Lazar Gusho, duke e përforcuar tendencën e tij që të mos merret asgjë si personale. Maloki dëshiron që t’i japë fund diskutimit dhe t’i largojë dilemat mbi vlerën e Lasgushit si një “Dichter” shqiptar apo me ekuivalentet e termit në shqip si “Vjershëtor i kombit”, “Poet kombëtar”, “Prijs” etj.

⁹ Krist Maloki, *Oriental apo Okcidental*, Plejad, Tiranë, 2003, fq. 38-39.

¹⁰ Krist Maloki, *Oriental apo Okcidental*, Plejad, Tiranë, 2003, fq. 50.

Poetika e Lasgushit

Maloki në studimin e tij ndalet edhe në çështjet kryesore të poezisë së Lasgushit duke zbuluar mungesat, dobësitë, vlerat dhe aspekte të lidhura me vargun e poetit. Maloki pranon që Lasgushi ka disa poezi të pavdekshme si *Kroj i fshatit tonë*, *Poradeci*, *Kënga pleqërishte*, *Zog i qiejve* etj. Në aspektin përmbajtësor, poezinë e tij e konsideron si popullore dhe diskursi i tij përqendrohet në unin lirik me elemente të theksuara individualiste dhe egocentrike. Poezinë e tij e sheh si lirizëm të dendur dhe me shprehje ndjenjash e përmallimesh si idila të dashurisë, paraqitje peizazhistike si dhe kontemplacione filozofike dhe religjioze. Sipas Malokit, poezia e Lasgushit nuk ka objekt konkret, mirëpo edhe në rastet kur evidentohet një objekt i tillë, ai nuk njeh përshkrime karakterizuese dhe vetë objekti e humb madhështinë, zbehet dhe rrjedhimisht zhduket. Poezia e tij e zhvesh objektin dhe qëndiset me mjete estetike duke paraqitur impresione dhe përmes saj synon përjetimin estetik, por pa një skelet poetik të qëndrueshëm dhe thellësi të mendimit. Maloki ndalet edhe te aspekti metrik i vargut të Lasgushit, ku specifikon mungesën e përdorimit të vargut heksametrik apo pentametrit klasik dhe përdorimin vetëm të vargut trokaik apo jambik duke mbetur në vargun e njëjtë, pa kombinime të ritmit. Metrikën e tij e konsideron si të thjeshtë dhe të frymës popullore.

Oriental apo Okcidental (1937)

Ky është një studim tjetër i rëndësishëm në diskursin kritik të Krist Malokit ku kritiku trajton armiqësinë midis okcidentalizmit dhe orientalizmit shqiptarë si një problem të kombit shqiptar. *Maloki, lucid si rrallë kush, e dinte se dy gjymtyrët e sintagmës, oriental e okcidental, shënjojnë identitete, meqë burojnë e reflektojnë frymë e kulturë sjelljeje, madje punë, veprim. Përgjigjja e tij e atëhershme për oksidentalën si njeri të vyeshëm, i cili e kryen detyrën që ka, si njeri i përgjegjshëm, është e gjallë edhe sot. Përgjigjja e tij e provon se, përkundër njësisë, d.m.th. Konstantave, identiteti nuk është e dhënë e natyrës, por shenjë e kulturës, e historisë, e jetës, madje e emocioneve dhe e psikologjisë, në fund, ndoshta në fillim, zgjedhje e përcaktim politik (politean, civilizues).*¹¹ Maloki në këtë studim krahason raportin intelekt/karakter duke vënë theksin se jo çdo evropian me shkollë ka edhe karakter të lartë, relativizon faktin që shkolla

¹¹ Kujtim M. Shala, *Identiteti i pa/zbuluar* (Letërsi e identitet), Mitrush Kuteli në 100 vjetorin e lindjes (tryezë shkencore), Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2007, fq.20.

evropiane e bën një person detyrimisht okcidental. Në studimin *Oriental* apo *Okcidental*, Maloki dëshmon e argumenton se këto koncepte nuk lidhen me gjeografinë e kulturave të Lindjes a të Perëndimit, por me mentalitetet shqiptare të kohës. Ai mendon se *Oriental* është pseudo-krijuesi perëndimor, ashtu siç është *Oksidental* vendësi që kryen detyrën dhe obligimin ndaj atdheut.¹² Studimi *Oriental* apo *Okcidental* ka një vlerë të pamohueshme në kritikën letrare jo vetëm të Krist Malokit, por edhe në arealin e kritikës letrare nga fillimet saj e deri në kërkimet e sotme.

Literatura shqipe

Maloki në këtë studim ndalet tek të metat e letërsisë shqipe duke zbuluar mangësitë dhe dobësitë e autorit shqiptar në përgjithësi. Ai kritikon thellësisht poetët që shkruajnë poezi pas poezie duke mos u ndalur në kërkimin e vërtetë të vlerës letrare duke e bërë prioritet masën/vlerën para sasisë. *S'asht çudi që, në barazim me "veprat" e sotshme "literare" naltsohen e ngrehen deri në qiell do shkrimtarë e poetë të hershëm, të cilët, relativisht me literaturën evropjane, nuk kalojnë as shkallët ma t'ulta.*¹³ Ai kritikon numrin e madh të poezive dhe forcon mendimin e tij mbi vlerën letrare duke nënvizuar që ajo vlerë gjendet në thellësinë e mendimit ku edhe një faqe e vetme poezie mund ta bëjë një poet të pavdekshëm. Fenomenin e dëshirës për të shkruar shumë Maloki e sheh si dobësi të poetët shqiptarë. Pjesa më e madhe e studimit ka për bazë raportin mes sasisë dhe cilësisë në veprën letrare, esencialisht në poezi. Sepse ajo çfarë ka rëndësi sipas kritikut është inspirimi dhe ndjenja e thellë që na çon drejt përkthimit të ndjenjave në fjalë, tinguj, vargje poetike të zjarra dhe vetëm atëherë mund të kemi një poet të mirëfilltë pavarësisht numrit të poezive të shkruar.

Mbi besën, nderin dhe krizën shqiptare

*Na përgjithësisht e kemi zakon me folë e me propague për me u ba "kombtar", pse jemi mësue me e vue fjalën "kombtar" ma nalt se fjalën "shqiptar". Por pra përndryshe qëndron puna; duhet të mendojmë se kombtar mund të jetë edhe njëri që s'asht Shqiptar. Idea e kombtarsis ashtë një punë e mendjes kurse idea e shqiptarsis një punë e zemrës.*¹⁴ Kështu e sheh Maloki dallimin mes termave kombëtar dhe shqiptar. Sipas tij duhet

¹² Sabri Hamiti, *Letërsia moderne shqipe*, UET-Press, Tiranë, 2009, fq. 434.

¹³ Krist Maloki, *Oriental apo Okcidental*, Plejad, Tiranë, 2003, fq. 74.

¹⁴ Krist Maloki, *Oriental apo Okcidental*, Plejad, Tiranë, 2003, fq. 137.

bërë dallimi fundamental midis këtyre shprehjeve ngaqë kombëtarizmi dhe shqiptarizmi janë dy çështje të ndryshme. Maloki sqaron kuptimin e idesë shqiptare duke e vendosur në filtra që karakterizohet me tri cilësi kryesore: besën, nderin dhe burrninë. Këto janë elementet që e formojnë idenë shqiptare të Malokit. Mesazhi i tij është i qartë, ta nxisë të riun shqiptar që ta njohë dhe kuptojë palcën e identitetit shqiptar, vetitë kryesore të një shqiptari të vërtetë duke proklamuar bashkimin me njëri-tjetrin dhe se ndryshimi do të arrihet vetëm atëherë kur reflektojmë fillimisht tek vetja dhe më pas me shembullin tonë të ndikohet në vetëdijësimin e tjetrit. Përmes kësaj filozofie Maloki e sheh dritën në fund të tunelit për popullin shqiptar. Populli shqiptar ballafaqohet edhe me krizën e cila përfshin një zinxhir krizash e jo vetëm atë financiare. Maloki krizën shqiptare e sheh si fryt të zhvillimit historik, të trashëguar brez pas brezi e jo vetëm të njëkohshëm. Këtë problem e sheh më të thellë dhe më larg ndër vite, duke i gjetur burimet që nga viti 1912, vit i pavarësisë së Shqipërisë. Varfëria shpirtërore kombëtare ka bërë që sot populli shqiptar të ketë krizë të shumëfishtë. Si karakteristikën kryesore e sheh mungesën e besimit dhe pesimizmin e skajshëm. Sipas Malokit, tek shqiptarët dominojnë fjalët dhe mungojnë veprimet, mungon ideali kombëtar, ndjenja kolektive si dhe mungesa e besimit te njëri-tjetri, gjë e cila determinon pasojat e rënda në sfera të ndryshme përfshirë kapitalin, patriotizmin, inferioritetin ndaj të huajve etj. Këtë e sheh si një minus të madh edhe për imazhin shqiptar në botën perëndimore. Maloki vlerëson lart ndihmën dhe përkrahjen morale të shqiptarëve në mërgim, të cilëve edhe realiteti i hidhur socio-politik në Shqipëri nuk ka arritur që t'ua zbehtë dhe t'ua zhdukë dashurinë për vendin dhe idealin kombëtar.

LITERATURA

- Krist Maloki, *Oriental apo Okcidental*, Plejad, Tiranë, 2003.
- Ibrahim Rugova, *Strategjia e kuptimit*, Rilindja, Prishtinë, 1980.
- Ibrahim Rugova, Sabri Hamiti, *Kritika letrare*, Rilindja, Prishtinë, 1979.
- Kujtim Shala, *Zbulesa e modernitetit*, Fondacioni Ibrahim Rugova, Prishtinë, 2017.
- Kujtim M. Shala, *Identiteti i pa/zbuluar* (Letërsi e identitet), Mitrush Kuteli në 100 vjetorin e lindjes (tryezë shkencore), Akademia e Shkencave dhe e arteve e Kosovës, Prishtinë, 2007.
- Sabri Hamiti, *Albanizma*, Akademia e shkencave dhe e arteve e Kosovës, Prishtinë, 2009.
- Sabri Hamiti, *Letërsia moderne shqipe*, UET-Press, Tiranë, 2009.
- Vehbi Miftari, *Kritika dhe moderniteti*, AIKD, Prishtinë, 2008.

**Literary and cultural phenomena in the critical discourse
of Krist Maloki**

ABSTRACT

Krist Maloki is one of the most prominent Albanian critic and scholar and who has an extremely large role in Albanian literature and culture. Malok's critique is distinguished for the depth of thought, the critique focused on the author's psychoanalysis and the author's psychological effects in relation to his work. Our study will focus on his critique of Naim Frashëri and Lasgush Poradeci, as two important figures in Albanian literature where the profiles of writers are studied and their literary value is discussed. Other studies on certain literary and cultural phenomena of the author will be included, such as Albanian literature, the essay "Oriental or Occidental" and some other aspects of the Albanian people which Maloki has studied extensively and knows well. The study aims to make a general analysis of the most important critiques of Krist Maloki, which are needed to be studied and evaluated by Albanian literary critics. Among other things, these are special studies which have become a source of debate and various interpretations in the field of criticism. Maloki's critique proves a great intellectual strength of the author and a sharp analysis on certain phenomena related to the Albanian people, its literature and culture.

Keywords: criticism, psychoanalysis, culture, literature, Albanian.

Ermira YMERAJ

LETËRSIA BOTËRORE SI URË DIALOGU MES KULTURAVE TE “HYLLI I DRITËS”; “LEKA” E “FRYMA”

Si revista letrare ato shfaqen të rëndësishme se rrokën dinamikën letrare të një kulture, sollën ide letrare-kritike, filologjike apo filozofike, dhe u bënë tregues të saktë të një klime të shëndetshme kulturore jo vetëm nacionale. Grupimet e emrave të mëdhenj përreth tyre si novatorë, realizuan njohjen, përthyhen idetë, stilet, kahjet e tendencat letrare-artistike, që më vonë u bënë sunduese dhe përcaktuese me ndikimin e tyre.

Komunikimi ndërnjerëzor dhe njohja e letërsisë së tjetrit, përgjatë historisë, ka luajtur një rol përcaktues në qytetërimin kulturor të njeriut. Letërsia e tjetrit përçon mesazhe treguese e sakrale dhe shërben për të zhvilluar mendësinë e kulturës vendase.

Së pari kjo letërsi është një hap drejt zhvillimit mental, qytetërues të një grupi e pastaj përmes përkthimit ajo përcillet dhe në kulturën e tjetrit, duke krijuar mundësitë për ndërtimin e një shoqërie të qytetëruar dhe me vlëra. Nga “Convivencia” apo “bashkëjetesa” e Institucionit mesjetar të Spanjës si pikëtakimi i përkthimit të veprave arabe, greke, hebraike në gjuhën latine, vijmë te periodikët e gjysmës së parë të shek. XX, si “Hylli i dritës”, “Leka” e “Fryma”, që shfaqen si bashkëjetesë e ura dialogu mes letërsive.

Studiuesi *Shaban Sinani* vëren se për herë të parë në letrat shqiptare dhe veçanërisht në veprën “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet” e Sami Frashërit, kemi një risi në konceptin për “tjetrin”, në vështrimin e “tjetrit” jo si një antagonist të përjetshëm¹. Traktet ideologjike kombëtare të fqinjëve të drejtpërdrejtë të shqiptarëve kanë pasur një karakter të tillë përjashtues ndaj “tjetrit”, sa që për një kohë të gjatë nuk janë pranuar zyrtarisht as nga vetë shtetet e tyre.

Së dyti: Autorët / përkthyes të letërsisë së tjetrit, u bënë autorë që thyen muret ideologjike e politike mes vendeve, duke lidhë botën shpirtërore e mendore të lexuesit të djeshëm me krijimin letrar të tjetrit.

Ndërsa sot ato janë memorie kulturore - historike - psikologjike e shoqërore

¹ Sinani, Shaban.; “Koncepti për “tjetrin” në veprën “Shqipëria ç’ka qenë ç’është dhe ç’do të bëhet”, Perla, 4, Tiranë, 1996, f 34. Shprehet se “Mendimtarët e sotëm federalist, që e shohin të ardhmen e popujve nën një çati të përbashkët, ku ideja e barazisë është kthyer në një mit, kanë të ideologjia e Samiut një pararendje të shkëlqyer”.

për lexuesin, dhe urë ndërkomunikimi mes kohëve. Periodikë të tillë letrarë patën forcën të trajtojnë dukuritë letrare, fenomenet kulturore e historike që shoqërojnë letërsinë, gjithmonë nën një stil letrar.

Ky shtyp, me veprimtarinë e tij publicistike dhe atdhetare është historikisht një lidhës e fuqishme mes Shqipërisë dhe perëndimit duke përcjellë frymën e pranimi të kulturës së tjetrit.

Në vitet më të vështira ky shtyp e shpëtoi Shqipërinë, dhe nuk mendoi vetëm përndritjen e mendjes së kombit, lëvrimin e gjuhës sonë kombëtare, por dhe për zhvillimin kulturor, bashkimin shpirtëror dhe përparimin kombëtar. Ndikim shumë të madh këto tri revista patën edhe në formimin e moralit njerëzor e atij shoqëror, në zhvillimin dhe edukimin e një breznie me ideale të larta dhe krenari shqiptare, gjë që e bënë jo vetëm përmes artikujve problemorë mbi realitetin shqiptar, po dhe përmes përkthimeve të veprave të tilla e autorëve të tillë me ndikim të drejtpërdrejtë në mendësinë njeriut.

Në përkthimet e revistës “Leka” vijnë e shtjellohen idetë se “Qëllimi i kombit asht ruajtja e zhvillimi i kulturës dhe i qytetnimit kombëtar në dobi të vehtes njerëzore, ndërsa shteti ka qëllim të mirën e përbashkët të nënshtetasve”.

Së treti: Periodiku kulturor në Shqipërinë e viteve 1913-1944 nuk përjetoi rrudhje dhe nuk kishte fatin e periodikëve që “lindin të vdekura”. Detyrë e tyre ishte: *Drejtimi i botës lexuese me gjet difrim e zbavitje, e me bashkjetu shpirtnisht.*² Ato pohuan se “Ndër ne ka rrokë sëmundja e shekullit: ethja e reklamit dhe nxitimi”. Ndaj ata i vunë vetes detyrë: *Të krijojmë botën lexuese, sepse mendonin se Hartisti mund të lindi kudo, edhe në një botë të ngushtë, të vorfën, si kjo e jona, mjafton që të jetë i pasur dhe i gjanë shpirtnisht dhe ta pajisnin lexuesin shqiptar me: Një raft librash - me udhëheqës të mendësisë kombëtare.*

Metodologjia e punës në këtë monitorim u bë mbi emrat e autorëve³ të letërsisë së huaj dhe mbi tematikat që iu qasën lexuesit shqiptar përmes këtyre revistave. **Objekt** i vëzhgimit është: 1. Hapësira që i kushtohet letërsisë së huaj të “Hylli i dritës”, “Fryma” e “L.E.K.A”. 2. Vendi që zë kritika, mbi përkthimet. 3. Burimet. 4. Përzgjedhja e autorit.

² “Fryma”, nr. 2. Ndoci, Filip: *Letratyra e jonë, problem që do shvillue – shfaqje e mendësis s’onë*. f. 53 - 58.

³ Krasniqi, Nysret: *Autori në letërsi*, AKD 2009. f. 71. Autori është njeriu i cili radikalisht e absorbon pse – në e botës, për ta kthyer atë në si shkruhet ajo”. Kur përmendet emri i autorit nënkuptohet vepra e jo jeta e tij, nënkuptohet hetimi i zërit diskursiv (Blanshe) të qenësisë së tij (autor funksion dhe autor – diskurs (Fuko) të shenjës plus në diskurs (Derrida) të implikimeve autoriale si evidencë tekstuale e personale.

1. Për sa i takon **Hapësirës** që i caktohet letërsisë së përkthyer në këto periodikë, publikimi bëhej në mënyra të ndryshme:

a. **Përmes artikujve kritikë**⁴ mbi çështje që kanë të bëjnë me tematikën e përkthimit, çështjeve që kanë të bëjnë me autorë të veçantë dhe çështjeve që kanë të bëjnë me problemet e artit. Sipas qëllimit të vetë hartuesve të revistës vihet re se letërsia duhet të kishte harmoni qendrore në një drejtim, qëllimi i saj ishte të paraqiste kombin në idealin e vet pranë popujve të tjerë e të vihej në njohuri të plotë me ndjeshmërinë e qytetërimit të përbotshëm. Kështu letërsia shkon me të gjitha kohët, frymëzohet me të kaluarën i flet të tashmes, e krijon të ardhmen. Letërsia bashkon popujt në ide që të vijoje në aktet e përbashkëta drejt ndërtimit të njerëzores.

b. **Përmes rubrikës: Bibliografi**⁵

c. **Përmes përkthimit të autorëve** më me zë në hapësirën artit botëror. Përkthimi i letërsisë botërore sipas studiuesit Filip Ndocaj: *është diskutuesja vendimtare, është një çansuese e skajtë e kohëve të djeshme n''kohët moderne, është e adhureshme dhe e padhuneshme*.⁶ Ndërsa sipas Qemal Draqinit⁷: *S''duhet të harroni që të përkthejmë don të thotë të bajsh punë nofta më të vështirë se të kompozosh vepra origjinale. Pasunimi i kulturës tonë me nektarin e kulturës së huej, për të çënë përkthyes i mirë lypen disa cillsi, sikur për çdo aktivitet tjetër menduer e trupuer, cillsi që konkretizohet në këtë rasë: 1. Njohje e thellë e mirë e gjuhës nga e cila përkthehet. 2. Njohje e mirë të gjuhës shqipe dhe e natyrës së saj, dhe 3.*

⁴ "Fryma", Vjeti I. Shkodër, Kallnuer 1944. Nr. 1. f. 10. *Harti në vedveti nuk ka të ndame asht një frymë e shpirtit njerzuer qi snjef kufi gjuhësh. Literatura lindore ka dukje fragmentare, trajtë të thjeshtë, frymëzime të leta e ndiesi të holla. Me letraturën moderne në atë të mbas Revolucionit francez, fillon të jetë "un -i" shpirti i letraturës.*

⁵ Rubrika "Bibliografi", "Fryma", Vjeti I. Shkodër, Kallnuer 1944. Nr. f. 40. Në këtë hapësirë bëhej pasqyra titanike e angazhimit kulturor të mendimit të atëhershëm për t''i përcjellë lexuesit të vet, veprat dhe autorët më të rëndësishëm në historinë e letërsisë botërore si: William Shakespeare me "Hamleti – Princi i Danemarkës", shqipëruar nga Fan Noli. "Makbethin", Omar Khajam e shqipëruar nga R. B. Gramshi, "Nën hijen e hurmave", "Prralla t''Arabis", shqipëru nga Faik Konitza, Emilio Salgari, "Mbreti i Maleve", shqipëruar nga Kol Marashi (Tiranë 1943), "Plutarku" përkthyer nga S. Paparisto, Mark Twain, Luigi Pirandello, Gi de Monpassant, Oschar Wilde etj. "Herriet Beccher Stowe, "Kasollja e Xho – Tomit", roman i përkthyer nga Sterio Spasse. Molieri, "Kopraci ose Dorështërnguesi" përkthyer nga Enver Fico.

⁶ "Fryma", Vjeti I. Shkodër, Kallnuer 1944. Nr. 2. f. 13. prof. Ndocaj, Filip E.; *Pra njëherë na duhet të kemi përpimë gjith at material të palatuem t''popullit tonë, trashigimin e breznivet të shkueme: mandej me u lshue rrymës së hartit botnuer. Edhe ndër ne mund të lindë sublimiteti i hartit, pse, si thotë Croce: harti i njëmendet asht ndiesi ngufuese qi asht ba krejt shfaqje e kulluet, "ose një dëshrim i ndryem në rrethin e një shfaqjes".*

⁷ "Fryma", Vjeti I, Shkodër, Fruer 1944, Nr. 2. f. 4. Draqini, Qemal.; *"Për një sistemim të përkthimeve".*

Pajisja e përkthyesit me një farë përvoje në këtë vështrim.

2. Vendi që zë kritika mbi përkthimet

Të tri revistat kishin një faqe të posaçme të titulluar “Bibliografi”. Kjo rubrikë shoqërohej me recensë për përkthyesit dhe librin e përkthyer, duke promovuar sipas vlerës, përkthimin dhe përkthyesit⁸ në rrugën e tyre të vështirë sepse: *Mjeshttrat e letraturave qenë udhëheqsat e popujve, shpeshherë edhe ndërtesat e shoqnisë së tyre si shtet.*⁹

Në këtë mënyrë këto recenca vlenin si një mekanizëm i domosdoshëm dhe i pazëvendësueshëm për lexuesin.

E dallueshme bëhej kjo rubrikë, jo për nga sasia e përkthimeve, por nga cilësia e përkthimit¹⁰. Libri i përkthyer kalonte në një filtër kritike, duke shmangur çoroditjen e lexuesit dhe duke mos kompromentuar besueshmërinë e revistës. Ajo çfarë bie në sy dhe vlen të theksohet është, se përgatitja e kësaj rubrike bëhej nga emrat më me zë në lëmin e kritikës, përkthimit, shkrimit dhe artit. Këta emra zotëronin njohuri specifike që kërkonte kritika letrare.

3. Burimet. Janë “Thembra e Akilit”. Në këtë kuptim çdo botim identifikohet duke mos lënë shteg për dyshime, njëanshmëri dhe reagim. Përkthimi¹¹ botohej mbasi citohej dhe vlera e veprës nga ku është marrë,

⁸ “Fryma”, Vjeti I, Shkodër, Fruer 1944, Nr. 2. f. 3. Draçini, Qemal.; “Për një sistemim të përkthimeve”, autori citon se “Mbas veprave origjinale, përkthimet janë padyshim pilastrat ma i randësishëm i prodhimit kulturor të një vendi. Kur mandej asht fjala për një kulturë të varfër e të pashvillueme si duhet, sikur asht kjo e jona, përkthimet bahen edhe ma të rëndësishme e ma të nevojshme. Kemi përkthi atë shi u quejt “industri e kalemit”. E para se nde ne ka mungue një inisjativë supreme e nonji shpije botuese private, që të bëhesh kshtu një pune e kordinueme e sistematike, dhe e dyta se ka mungue edhe në përkthyesa shqiptar. Problemi sot mund të rrahet në kto dy pika kryesore. 1. Në përkthimet që ne lypim dhe 2. Në cillësite e përkthyesit tonë.

⁹ “Fryma”, Vjeti I. Shkodër, Kallnuer 1944. Nr. 1. f. 13. prof. Ndocaj, Filip E.

¹⁰ Klosi, Ardian: “ABC e vogël e përkthimit letrar”, Tiranë 2011. f. 16. *Shkrimtari ndërton imazhe, shkrimtari transmeton kuptime, shkrimtari krijon gjendje shpirtërore. Këto tri shtylla të çdo veprë letrare e sidomos të prozës diktojnë vetiu cilësitë që duhej të ketë dikush për t’u bërë përkthyes letrar. Që të jesh i aftë të mbartësh një imazh nga gjuha e nisjes në atë të mbërritjes duhet të kuptosh detajet më të imta të tij, (kjo vlen për çdo përkthyes) dhe të kesh gjithë aftësinë e duhur imagjinatave për të rindërtuar në gjuhën nënë.*

¹¹ Klosi, Ardian: “ABC e vogël e përkthimit letrar”, Tiranë, 2011. f. 18. *Luteri te mesazhi për përkthimin kërkonte që “të shihej populli në buzë”, pra të përkthehej ashtu siç flet gjermani, në disa pasazhe të përkthimit të Biblës kërkon të jetë aq besnik sa “të cënojë gjuhën gjermane, por të mos shmanget nga fjala”. Kurse Goethe te “Shënime për*

kur është shkruar, nga kush është përkthyer¹² dhe me komentat¹³.

4. Përzgjedhja¹⁴ e autorit¹⁵

Lind pyetja: Përzgjedhje nisur nga emri i autorit, problematika e veprës që mbart, rëndësia e epokës apo shijeje personale?

Të përkthesh sipas Filip Ndocajt do të thoshte të shihje problemet e autorëve edhe brenda rrymës që i prodhoi këto shkrimtarë. Ai pohonte se “Në të zhvilluemt e letraturës botnore kemi të ndame qi shkojnë si mbas trajtave të gjinivet letrare, rrymës estetiko- hartistike e shijes së kërkesës së kohnavet të njerëzimit”.

Mbulimi është vertikal¹⁶, që do të thotë se veprat e përzgjedhura¹⁷ nuk

divanin perëndim-lindje, ngulmonte për një afri të së huajës tek e vendit, të së njohurës me të panjohurën. Umberto Eco: ishte me mendimin se “përkthimi duhet të ngjallë të njëjtin efekt që synonte të ngjallte origjinali”. “Dire quasi la stessa cosa”, Milano 2001, përktheu në shqip, Ymeri, M; Ylli, A.; “Të shkruash gati të njëjtën gjë”, Tiranë 2006, f. 99.

¹² Në rubrikën **Bibliografi** njoftohen në f. 148, “Fryma”, Nr. 3. Mars 1944, në rubrikën “Përkthime”, Lays Zilahi, Pranverë e vdekshme, përkthimi i Çesk Beranit.

¹³ “Hylli i Dritës”, Nr. 5 Maj 1944, “Fausti” i përkthyer nga D. L. Shantoja f. 42. Wagneri – asht typi ma i bukur i pedantit të thatë, gërmues e të ndërgjegjshëm qi njeh letërsia botërore. Përkthimi ndihmon në mpohjen e vretjes, begatohet kujtesa, zhvillohet fantazija dhe përgjithësisht zhvillohet mendja.

¹⁴ A. Walji (1759-1824), “Njerëzimi i sotëm do të bjeri shumë poshtë, në qoftë se rinija nuk kalon nga tempulli i qetë i koheve e njerzve të moçëm, të medhenj, para se të hyjë në arenën e jetës. Citon Gabriel. P. Meksi.

¹⁵ Krasniqi, Nysret: “Autori në letërsi”, AKD 2009. f. 19. *Letërsia, vepra, poezia e pse jo edhe autori janë jo vetëm banorë të gjuhës, sepse të gjitha këto relacione arrijnë në pikën e heshtjes, në pikën e mosqenies, në pikën e vdekjes, pikërisht në gjuhë dhe duke iu falënderuar gjuhës. Për Blanshenë nuk është Letërsia, Poezia e as Krijuesi ai që flet, por është vetë gjuha që e shfaq vetveten si prani dhe si mungesë.*

¹⁶ Fryma”, Vjeti I. Shkodër, Kallnuer 1944. Nr. 1. f. 11. Sipas tij: *Kah mesjeta, kena për të diktue ndër ta ndonji fare evolucioni nga të diskutuemt e librave të shejt, nga lufta e moralit themeltar me atë të njerëzimit përpjekë në kulturë klasike. Klasicismi asht “harmonija ma e brendshme e konceptit me fantazinë dhe e përmbajtjes me trajtën . “Kush thotë romantizem thotë hart modern, dmth mbrendi, spiritualitet, ngjyrë, dëshrim kah të pamatunt shprehë me të gjitha mjetet qi zotoj.*

¹⁷ “Fryma”, Vjeti I. Shkodër, Kallnuer 1944. Nr. 1. f. 9. Shih studimin e Filip Ndocajt: *Letratyra ç’asht, si asht e si duhet të jetë.* Autori argumenton: *E cila letratyrë, nonse e pakët kah vëllimi ndryen, neomos për ne, vizare të rralla harti. Deri tash nuk asht studjue në një trajtë organike – shkoqitese, perse a kufizue në “sagji” mbi ket e at shkrimtar a poet. Carducci thotë se letratura asht se bashku me gjuhë “ afshi” e rrezitja shpirtnore e një populli, pse nëpër anë të këtij veçohet Zani shpirtnuer i një populli.*

kishin thjesht karakter deskriptiv, por karakter analitik e kritik për kohën. Nga këto tri revista përzgjidheshin pikërisht ato autorë¹⁸ të cilët kishin luajtur një rol të rëndësishëm në shoqëritë përkatëse, të lexuesi, në mendësinë e tij dhe në formimin e tij.

PËRFUNDIME:

Autorët / përkthyes jetojnë brenda tekstit si strukturues, zbulues, krijues e komentues. Si strukturues ato përcaktojnë autorin dhe përkthejnë ato vepra që si etnitete të pajisura me kapacitetin determinues angazhohen në veprime sipas një qëllimi e ideali të lartë. Si krijues zgjedhin ligjërimin e duhur, ku kuptohet *si-ja*, mënyra e rrëfimit në krahasim me çfarë, duke e artikuluar emocionin dhe ligjërimin autorial. Me veprat e përkthyer ato regjistruan kohën, historinë, refleksionet dhe emocionet e ngjarjeve monumentale.

Te tri këto revista shënjuan një periudhë të ndritur në historinë e periodikëve sepse identifikuan funksionin misionar të shtypit shqiptar në funksion të hapjes, vlerësimit të vlerave dhe bashkëjetesës ndërkulturore¹⁹ me tjetrin. Ato sollën një kontribut që dëshmuar krenari krahasuese përballë shtypit ballkanik dhe atij evropian, jo vetëm në nivel dijesh e profesional të hartuesve të periodikëve shqiptarë, por më së shumti ato u shfaqën si një shkollë tipike e raportimit dhe informimit, mbi kritere dhe veçanti jo vetëm njohëse. Në harkun kohor nga vitet 1913 deri në vitin 1944, në shtypin shqiptar spikati një tendencë e qartë e qasjeve të ideve që zgjerorin konceptin lirisë në shije ndjenjash, ideologjike dhe kulturore mbi artin. U identifikua një sasi e re dijesh dhe informimi nga elita e vendit, jo vetëm për ekzistencën e një hapësire tjetër artistike²⁰, por më së shumti dhe

¹⁸ “Fryma”, Vjeteri I. Shkodër, Kallnuer 1944. Nr. 1. f. 12. *Mjeshttrat e letraturave qenë udhëheqsat e popujve, shpeshherë edhe ndërtesat e shoqërisë së tyre si shtet. Gurra e çdo letrature kërkohet në popull ose në vedvedë, letratura s’asht tjetër porse zani i qartë e i pacensuruem i shpirtit të një populli. Letratura e mallit të atmes, ose letratura e psherëtimave, e kushtrimit, e rilindjes e më mbramë ajo që nisi provat e para të hartit me endë ndër ne.*

¹⁹ Kessing, Roger M. Stranther, Andrew I.: Antropologjia kulturore: “Një Perspektivë Bashkëkohore”, Tiranë, 2007, përkth. nga anglishtja: Gerda Dalipaj, Amanda Hysa, Olsi Lekaj. *Kultura përbëhet jo nga ngjarje dhe gjëra që ne mund të vëzhgojmë, numërojmë dhe marrim, ajo përbëhet nga ide dhe kuptime të përbashkëta.* f. 28.

²⁰ Berisha, Anton: “Retorika dhe letrarësia”, *Teksti i Bogdanit*, Gjon Buzuku, 2005. f. 18. *Teksti letrar është konceptuar si një entitet i ndërtuar në dy akse: në aksin paradigmatic (të seleksionimit) dhe aksin sintagmatik (të kombinimit). Çdo vepër artistike është një shenjë*

për një sistem kulturor i cili ishte në kontrast me natyrën e artit në shoqërinë shqiptare. Detyrimi rrjedh nga vetë natyra e shoqërisë njerëzore, pasi njerëzit kudo që janë komunikojnë mes tyre dhe gjatë këtij komunikimi transmetohen vlerat më të mira që një komb ka krijuar gjatë ekzistencës së vet, vlera të cilat mbarten dukshëm tek kultura e tij. Gjuhët sado të ngjajnë, asnjëherë nuk janë të njëjta, prandaj edhe përkthimi ka në vetvete një shmangie apo një lloj tradhtie që në të shumtën e rasteve është subjektive dhe që lidhet drejtpërdrejt me përkthyesin.

Kështu revistat prodhuan tekste dinamike, afirmuan identitete kulturore dhe i dhanë një tjetër përmasë Shqipërisë.

The world literature as a bridge dialogue between cultures in "Hylli i dritës", "Leka" and "Fryma"

ABSTRACT

In the world of Albanian literature, the literary and cultural magazines "Hylli i dritës"; "LEKA" (Connection-Education-Culture-Entertainment) and "Fryma", have crowned the efforts at elite and original brain, to reflect the theory of two revolutions on their nation at the reader. In these magazines, Fishta, Harapi, and other names, have show another quality of their cultural formation, in journalism, history, literature, folklore, ethnography, linguistic studies, politics as renaissance with their own cultural identity. There have been dozens of literary, political, pedagogic and polemic articles that have given another dimension to Albanian culture. In their thematic content, topics from the heritage of popular tradition were dealt with, they were put into the research and publication of the cultural-oral identity, such as the Canon of Leka and Skënderbeu. They dealt with topics from the ethnographic background, from the life and times concerns. They have collected our legendary epic, have published debates with scientific truths, have published the scientific interests of foreign albanologists like Myjer, Nopça, and

autonome, e cila përbëhet nga: 1. "Vepra-objekt" e cila funksionon si një simbol shqisor; 2. "Objekti estetik" i cili është i vendosur në ndërgjegjen kolektive dhe funksionon si "domethënie".

Albanian researchers like Çabej, Mjeda.

Key words: literary dynamics, literary ideas, bridges dialogue, coexistence.

Ilir SALLATA
Rita LOLOÇI

SHTYPI BOTËROR MBI EKONOMINË E CENTRALIZUAR SHQIPTARE NË VITET 1970-1973

Fillimi i viteve 1970 e gjen Shqipërinë të lidhur ngushtësisht me Republikën Popullore të Kinës. Ekonomia si faktor i rëndësishëm i politikave shtetërore, ishte orientuar tërësisht nga ndihmat e kreditë Kineze. Në pamjen e përgjithshme, ekonomia e këtyre viteve duket se ka arritur disa rezultate.

Ekonomia socialiste bazohej në pronën shtetërore e atë kooperativiste. Kjo formë prone që administrohej nga shteti deklarohet si pasuri e gjithë popullit.

Një nga shtyllat e ekonomisë shqiptare ishte bujqësia. Strukturat bazë të saj ishin kooperativat dhe fermat bujqësore e blektorale. Punëtorët dhe kooperativistët punonin me orë të zgjatura kundrejt një pagese modeste. Në industri, ishte punësuar një pjesë e madhe e popullsisë qytetare. Shumë ndërmarrje industriale, fabrika, uzina etj., u ndërtuan brenda e në periferi të qyteteve. Ato ishin pajisur me makineri të modelit sovjetik e kinez. Vëmendje e veçantë iu kushtua industrisë së rëndë. Shqipëria shquhej për nxjerrjen e përpunimin e mineraleve. Edhe industria e lehtë e ushqimore, megjithëse në plan dytësor, kishte shënuar disa arritje, por pa arritur plotësimin e kërkesave në rritje të popullsisë, e cila sa vinte e shtoej.

Gazeta amerikane "The New York Times"¹ e datës 25.10.1970 boton një artikull nga korrespondenti Tillman Durdin nga Hong Kongu me titull "Pekini nënshkruan marrëveshje për ndihma me afat më të gjatë" në të cilin ndër të tjera thuhet: "*Marrëveshjet e reja me afat të gjatë të nënshkruara nga Kina me Shqipërinë dhe Korenë e Veriut për shkëmbim mallrash dhe ndihmë ekonomike tregojnë se Pekini pret një periudhë stabiliteti ekonomik dhe politik. Këto marrëveshje janë të parat të kësaj natyre që nga ngjarjet e Revolucionit Kulturor Kinez*".

Marrëveshja e nënshkruar me Shqipërinë përfshin një periudhë pesëvjeçare (1971 – 1975) dhe parashikon një hua pa interes dhe pajisje complete dhe materiale të ndryshme nga Kina. Janë parashikuar gjithashtu

¹ Gazeta "The New York Times" 25.10.1970.

shkëmbime prodhimesh dhe marrëveshje pagesash.

Periodha e nënshkrimit të marrëveshjeve të reja përkon me vitet e planit pesëvjeçar kinez dhe supozohet se në këto marrëveshje kinezët kanë parashikuar materialet që do të eksportohen e importohen.

Me datë 7 dhjetor 1970, Radio Austria ² transmetoi një koment nga Herbert Luchti, ku ndër të tjera thekson se Shqipëria mori kredi përsëri nga Kina, për investimin e veprave të 5 - vjeçarit të ardhshëm, që fillon në vitin 1971. Kryetari i Komisionit të Planit të Shtetit, Abdyl Këllezi, gjatë vizitës në Kinë, nënshkroi një sërë marrëveshjesh. Këtë radhë ndihma kineze mendohet të arrijë shumën mbi 400 milionë dollarë. Kina me kredinë pa interes që i akordon Shqipërisë kërkon të ketë aleaten e vet, të paktën në aspektin propagandistik.

Nga vend agrar në vend bujqësor industrial

Sipas gazetës turke “Yeni Gyn”³, kolektivizimi në Shqipëri filloi në vitin 1946, dhe shkalla e tij arriti në 90%, pas Kongresit V të Partisë së Punës së Shqipërisë (1-8 nëntor 1966). Në Shqipëri, ku vetëm 28% e tokës është e punueshme, shteti i kushton rëndësi të madhe zhvillimit të bujqësisë, nga ku të ardhurat janë rritur në 11,5%.

Në 1970 funksiononin 33 ndërmarrje bujqësore shtetërore dhe 643 kooperativa bujqësore. Në ndërmarrjet shtetërore gjithçka është e shtetit, tokat, ndërtesat, traktorët, mjetet mekanike të çdo lloji, bagëtitë etj. Kurse në kooperativa, shteti i përkasin tokat dhe makineritë e mëdha, ndërsa mjetet dhe depozitat e vogla i takonin kooperativës. Anëtarë i kooperativës punon njëjloj si punëtori i ndërmarrjes shtetërore, vetëm se i pari kohën e lirë e kalon në pronën e tij të vogël private. Kjo përfshin shtëpinë e tij, një kopësht me rreth 1000 m², deri në 2 lopë e 10 dele. Të paktën kështu propagandohet për shtypin perëndimor.⁴

E veçanta e këtij sistemi, qëndron në faktin se të gjithë paguhen njësoj, shkruan gazeta rumune “Skentea”.⁵ Sipas saj ky fakt e ul interesin e individëve për të shtuar prodhimin ose për të tejkaluar normën. Eksperienca ka treguar se pa stimul nuk ka përparim. Ka vetëm stimul moral, ku klasa punëtore e fshatarësia shpërbleheshin me titullin “Sulmues të Planit Pesëvjeçar”.

Ndër objektivat kryesore në bujqësi janë: rritja e numrit të fermave shtetërore; përparësi në kërkimet shkencore për një seri problemesh;

² Radio Austria, 7.12.1970.

³ Gazeta Yeni Gyn, Stamboll, 11.2.1971.

⁴ Revista L “informatore Agrario, Romë, 1972, “Bujqësia në Shqipëri” Alberto Rizzoti.

⁵ Gazeta Skentea, Varshavë, 23.7.1970, “Kërkimet shkencore në bujqësinë shqiptare”.

përmirësimi i terreneve të punueshme; vënia në shfrytëzim e sipërfaqeve të reja bujqësore; futja e kulturave të reja; mekanizimi i mëtejshëm i punimeve etj.

Këto dhe të tjera objektiva përbëjnë detyrën e parë të Institutit të Kërkimeve Bujqësore dhe Stacioneve Eksperimentale. Aty përfshihen një numër i madh punonjësish të fushave përkatëse. Janë marrë hibride të duhanit rezistente ndaj dëmtuesve. Synohet prodhimi i disa varieteteve të reja pambuku, të kualitetit e prodhimitarisë së lartë. Puna shkencore kërkon të realizojë lloje të grurit me rendiment të lartë 40-50 kv për hektarë, kurse për misrin 60-80 kv për hektarë.

Në Institutin e Lartë Bujqësor të Kamzës, afër Tiranës, i pajisur me një ndërmarje që ka afro 2 mijë hektarë, përgatiten teknikë të të gjitha gradave, me kurse të periudhave të ndryshme sipas kualifikimit të kërkuar. Këta udhëheqin ndërmarrjet shtetërore e shumë kooperativa të mëdha.⁶ Sipas gazetës italiane “Bari-Licata”⁷, të janarit 1971, vlera e prodhimit bujqësor në Shqipëri, në fund të vitit 1970 është rritur 30% në krahasim me vitin 1965. Në jetën e fshatarësisë, vihet re një lloj rritje e mirëqenies materiale. Orari i punës në ferma është 8 orësh. Puna fillon në 6 e 30 të mëngjesit e deri në orën 5 të pasdites, me një pushim në drekë. Meshkujt punojnë nga 16-60 vjeç, kurse gratë nga 16-55 vjeç. Kur një grua ka më shumë se 6 fëmijë, ajo e merr pensionin që në moshën 40- vjeçare. Një fermë e nivelit të lartë prodhon qumësht, drithëra, fruta dhe rreth 40 lloje zarzavatesh.

Për mbarëvajtjen e bujqësisë rëndësi i kushtohet dhe vaditjes. Kanalet vaditëse janë shtrirë në 62% të sipërfaqes totale të tokës së punueshme, punime të cilat përfshijne 54% të të gjithë sipërfaqes së kultivuar. Në zonat kodrinore janë hapur mjaft liqene të vegjël, për të krijuar rezerva uji në stinën e verës. Megjithatë duhet përmendur që këto teknika janë mjaft të prapambetura në krahasim me vendet e tjera. Ujitja me anë të kanaleve kërkon një forcë të madhe krahu punëtor, i cili duhet të merret vetëm me këtë punë. Nuk janë futur ende metodat e vaditjes me anë të tubacioneve të komanduara. Gruri përfaqëson bazën ushqimore. Në mungesë të varieteteve të mira në vend, janë futur farëza të zgjedhura nga disa vende të huaja, që po japin produktivitet të lartë. Nuk mbetet prapa dhe misri, por me një veçanti, sepse ai sa vjen dhe po pakësohet si ushqim për njerëzit, ndërsa për kafshët po shtohet gjithnjë e më shumë. Përsa i

⁶ Revista *Agri-Forum*, Romë, 12.7.1972, “Mbi bujqësinë në Shqipëri”.

⁷ Gazeta *Bari-Licata*, Bari, 8.1.1971, “Bujqësia në Shqipëri” Enzo Magit.

përket blegtorisë, janë futur disa raca të reja lopësh, për qumësht dhe mish, për të cilat nuk mungojnë bimët foragjere.

E veçantë dhe e pashmangshme në Shqipëri është puna e detyrueshme fizike për të gjithë shqiptarët. Të gjithë janë të detyruar që një muaj në vit të punojnë, kryesisht në bujqësi, duke pretenduar që kështu ndihmohej fshatarësia dhe përgatitej e kalitej dhe “njeriu i ri”. Kjo gazetë paraqet këtë tabelë mbi ecurinë e bujqësisë.⁸

Vitet	Prodhime vegjetale (tregues)	Traktorë (njësi)	Makina shirëse- korrëse (njësi)
1950	119	359	-
1960	172	4510	349
1970	309	10900	890

Ashtu si çdo fushë tjetër e ekonomisë edhe industria zhvillohej në bazë të planeve Pesëvjeçare ku përcaktohej se çfarë, si, sa, dhe ku do të prodhohej. Pra gjithçka ishte e centralizuar dhe e komanduar.

Gazeta turke “Başkent”⁹ e Në kuadër të Planit Pesëvjeçar, synohet që prodhimi bujqësor të rritet rreth 50-55%. Vëmendje të madhe u kushtohet qumështit, duhanit, pambukut, lulediellit, panxharsheqerit, patateve, perimeve e frutave. Gjatë këtij pesëvjeçari kopshtaria do të pasurohet me 6 milionë rrënjë të tjera, pemë frutore, 2.4 milionë rrënjë ulliri, 66 mijë rrënjë agrume si dhe 5 mijë ha. vreshta.¹⁰

Vihet re, që direktivat për zhvillimin e bujqësisë, synojnë një shumëllojshmëri prodhimi. Kjo për vetë faktin që Shqipëria duhet të arrijë shkallën e zhvillimit me forcat e veta dhe pa ndihmë nga jashtë.

Gazeta turke “Başkent”¹¹ e nëntorit 1970, boton një artikull me titull “Shqipëria një vend bujqësor industrial”. Me një paraqitje disi dogmatike, në një tabelë paraqiten disa të dhëna mbi zhvillimin industrial:

Vitet	Prodhimi i përgjithshëm industrial
1955	43,5%
1965	56,6%

Në vazhden e këtij artikulli mjaft “dashamirës” ndaj Shqipërisë, ecën dhe shtypi Gjermano-Lindor, sipas të cilit prodhimi industrial, që kryhet vetëm në sektorin socialist të ekonomisë, ka arritur nivele të larta. Përveç numrit të madh të uzinave, u zhvilluan edhe degë të reja të industrisë, si: industria e qeramikës, qelqit, e përpunimit të naftës, industria minerare e kimike.

⁸ Revista *Agri-Forum*, Romë, 12.7.1972, “Mbi bujqësinë në Shqipëri”.

⁹ Gazeta *Başkent*, Ankara, 28.11.1970, “Shqipëria një vend bujqësor industrial”.

¹⁰ Gazeta *Rynki Zagraniczne*, Varshavë, 29.9.1972.

¹¹ Gazeta *Başkent*, Ankara, 28.11.1970, “Shqipëria një vend bujqësor industrial”.

Ndër degët kryesore janë dhe: industria e lehtë dhe ushqimore, industria e drurit dhe e letrës, e përpunimit të mineraleve etj. Në lidhje me këtë të fundit, Shqipëria disponon pasuri të konsiderueshme: naftë, bitum, krom, bakër, hekur-nikel, rezerva qymyrguri, squfur, mermer etj.¹²

Është mjaft i rëndësishëm për t'u përmendur fakti se meritën kryesore të kësaj ecurie në industri e bujqësi e ka puna vullnetare e papaguar e mijëra të rinjve e të rejave, burrave e grave që punonin në sektorë të ndryshëm të ekonomisë: ndërtimin e hekurudhave, hapjen e brezareve e të kanaleve vaditëse si dhe shumë fronteve të tjera, ku ata dhanë forcë e energji nga jeta e tyre, ndoshta edhe të detyruar, por prapë me idenë e rimëkëmbjes së atdheut të tyre.

Shumë artikuj në gazeta të ndryshme¹³përmendin të njëjtën vijë zhvillimi.

Duke qenë se mbështesin rrugën e zhvillimit ekonomik në Shqipëri, mendohet që një pjesë e shkruësve të artikujve janë pjesë e grupeve marksiste-leniniste në botë, njerëz të udhëzuar nga Tirana zyrtare nëpërmjet ambasadorëve të saj për të bërë propagandë prokomuniste etj. Për tone pozitive ndaj Shqipërisë dallohet edhe shtypi Lindor, marrëdhëniet e reduktuara me të cilat qenë vetëm në plane diplomatike.

Në thelb të kësaj ideje të fut më mirë artikulli i revistës hungareze "Magyar Ország"¹⁴i datës 31 dhjetor 1972. Një atashe shqiptar në një kryeqytet perëndimor citohet t'i ketë thënë një bashkëpunëtori të një gazete me precedensë, se në rast se ky i fundit do të shkruante gjashtë artikuj mbi Shqipërinë, atëherë do t'i mundësohej një vizë për të vizituar këtë vend të vogël të rrethuar nga një "Mur i Madh Kinez".

Mungesa e marrëdhënieve me KNER

KNER (Këshilli i Ndihmës Ekonomike Reciproke), për Evropën Lindore ka ndikuar në ecurinë ekonomike të këtyre vendeve. Më 22 shkurt 1949 Shqipëria u bë anëtare e KNER, dhe pas 13 vitesh më 1962 ajo u largua nga ky organizëm.

"I gjithë vendi drejtohet nga një planifikim qendror", nënvizon gazeta austriake "Die Presse"¹⁵. *"Nuk mund të bëhet asnjë paralelizëm me vendet e KNER, pasi Shqipëria ndjek politikën e saj të pavarur edhe në fushën ekonomike"*, përfundon kjo gazetë.

¹² Gazeta *Horizont*, Berlin, 8.1.1971, "Industria e RPSH" Astrit Berger.

¹³ Revista *La vie catholique*, Paris, janar 1973 "Shqipëria një vend i harruar", Gazeta *Rynki Zagraniczne*, Varshavë, 17.8.1972 "Ekonomia në Planin 5-Vjeçar".

¹⁴ Revista *Magyar Ország*, Butapest, 31.12.1972 "Shqipëria pas gjashtë artikujsh".

¹⁵ Gazeta *Die Presse*, Vjenë, 26.6.1970, "Shqipëria një vend pa taksë".

Sipas gazetës gjermano-lindore “Horizont”¹⁶ shumë mosrealizime në ekonominë shqiptare i dedikohen mungesës së bashkëpunimit me KNER. Shtjellohet ideja se ndërprerja e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik dhe KNER i uli ritmet e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë. Vështirësitë në këtë fushë janë dhe si rezultat i mosrespektimit dhe mosshfrytëzimit të kërkesave të mëtejshme të parimeve të socializmit, si: rritja e produktivitetit të punës shoqërore; interesi material; vënia në lëvizje e të gjitha mjeteve ekonomike; përsosja e bazave shkencore me kërkesat e kohës etj.

Plani V Pesëvjeçar bazohet vetëm në kreditë e lëvrimet e Republikës Popullore Kineze dhe në mungesën e tyre diçka edhe nga vendet e tjera të kampit socialist. Kjo pengon ecjen e mëtejshme në ekonomi.

Gazeta polake “Nowe Czasy”¹⁷ më 10.10.1970 shkruan artikullin me titull “Shqipëria dhe bota e jashtme”. Duke vlerësuar marrëdhëniet e jashtme të Shqipërisë cilëson se në jetën politike dhe ekonomike të Shqipërisë dominon influenca e Kinës. Kjo është partnerja kryesore në tregtinë e jashtme shqiptare. Duke ecur në gjurmët e Pekinit, Tirana zyrtare orientohet të vendosë marrëdhënie diplomatike me vendet perëndimore, të cilat nga ana e tyre tregojnë interes për këtë vend ballkanik.

Gazeta “Washington Post”¹⁸ datë 13 gusht 1972 botoi artikullin e Erik Bourn të shkruar në “Lonton Observer”, me titull: “Ndihma kineze akoma është esenciale në Shqipëri”, ku midis të tjerave shkruhet: *“Shqiptarët akoma nuk e kanë përtypur pritjen që iu bë armikut të tyre Riçard Niksonit në Pekin. Por Kina mbetet “prania” e vetme e huaj këtu, miku i vetëm i besueshëm i këtij vendi që e shikon veten të rrethuar nga të gjitha anët, me gjithë lidhjet e kujdesshme të këtij të fundit me fqinjët dhe me Evropën Perëndimore”*.

Hidrocentralet, fabrikat e tekstilit, të telave elektrike dhe fabrikat e tjera të ndërtuara në të gjithë vendin nga ekspertët kinezë dhe me pajisje kineze quhen “monumente të pavdekshme të miqësisë së pathyeshme” shqiptaro-kineze. Kështu do të konsiderohet edhe kombinati i parë metalurgjik shqiptar në Elbasan dhe 30 objekte të tjera, në të cilat përfshihet Kina në planin e viteve 1971-1975.

Kjo ishte një çështje e “ndihmës internacionaliste” midis partnerëve të barabartë dhe që shqiptarët rregullisht ripaguanin kreditë nga prodhimi i

¹⁶ Gazeta *Horizont*, Berlin, 24.11.1971, “Shqipëria midis dy Planeve Pesëvjeçare”.

¹⁷ Gazeta *Nowe Czasy*, 10.10.1970.

¹⁸ Gazeta *Washington Post*, 13.08.1972.

tyre. Ky vazhdon të jetë qëndrimi i partisë. Megjithatë, udhëheqësi i Partisë, Enver Hoxha, u trazua nga kthesa në qëndrimin kino-amerikan. Por ai e mbajti këtë për veten e tij.

Teknikët dhe këshilltarët kinezë duken në Shqipëri akoma të grupuar, duke kaluar fundin e javës nëpër plazhe apo duke frekuentuar hotelet provinciale afër kantierëve të ndërtimit në qendrat ku punojnë. Porti kryesor tregtar i Durrësit është i mbushur me anije dhe rrallë ndodhen atje më pak se një dyzinë anijesh që presin radhën të ankorohen. Më të shumtët kanë flamuj kinezë.

Bashkëpunimi me Kinën bëhet shpesh i njohur. Ajo e ka ndihmuar Shqipërinë gjatë tri planeve pesëvjeçare dhe po e ndihmon gjithashtu në planin e tanishëm. Kontributi i saj i përgjithshëm mund të jetë afro 500 milionë dollarë. Kjo ndihmë e Kinës ndaj Shqipërisë u rrit mbas mosmarrëveshjeve të Enver Hoxhës dhe Hrushovit, që sollën si pasojë prishjen e marrëdhënieve diplomatike ndërmjet dy vendeve në vitin 1961. Por a do të vazhdojë ta ndihmojë Kina Shqipërinë mbas vitit 1975?

Kjo është një çështje konjunkturale. Një gjë është a qartë: në atë kohë, ky vend i vogël me dy milionë banorë dhe me një sipërfaqe prej 11.000 milje katrore do të ketë pothuaj aq kapitale, sa do t'i nevojiten për ndërtimet. Në atë kohë do të ketë gjithashtu më tepër naftë se sa i duhet. Është planifikuar që Shqipëria të eksportojë energjinë e tepërt elektrike në Jugosllavi. Për më tepër, kinezët i kanë cilësuar Enver Hoxhës, se ka erdhur koha që ai të hedhë vështrimin në vendet e afërta për nevojat e ardhshme dhe të tregojë më shumë kujdes për industrinë e lehtë.

Përpara vizitës së Niksonit në Kinë, në fakt Shqipëria kishte filluar të vendoste lidhje më të afërta me fqinjët, duke rivendosur lidhje me Greqinë, Jugosllavinë, me shumicën e vendeve të Evropës Perëndimore si dhe Skandinave. Kamionë të mëdhenj frigoriferikë shkojnë në Veri dhe në Perëndim me zarzavate dhe fruta të freskëta.

Vigjilenca ideologjike është akoma e lartë ndaj ideve të huaja, megjithëse fare pak mund të bëhet për televizionin italian dhe këngëtarin Tom Jones.

Import-eksporti nën moton “Gjithçka me forcat tona”

Duke i qëndruar besnike politikës së saj, Shqipëria socialiste, pretendon se mund të prodhojë gjithçka me forcat e veta. Por kjo nuk është e mundur, pasi një shtet i vogël e me mundësi të kufizuara, nuk mund të përballojë dot kërkesat gjithnjë e në rritje të popullsisë.

Siç shkruan gazeta polake “Rynki Zagraniczne”¹⁹, Shqipëria ka marrëdhënie tregtare me 40 vende, ku Kina luan rolin kryesor. Mallrat e

¹⁹ Gazeta *Rynki Zagraniczne*, Varshavë, 6.8.1970, “Shqipëria-Tregtia e jashtme”.

eksportit shqiptar, janë më shumë prodhime metalurgjike dhe minerare, prodhime të industrisë kimike (plehra kimike, acid sulfurik, sodë e kalçinuar), prodhime të industrisë së lehtë (tekstile, letër, rimeso). Më pak eksportohen prodhime të industrisë ushqimore e artikuj bujqësorë.

Sipas Agjencisë “Tanjug”²⁰ datë 21 tetor 1970, miqësia Shqiptaro-Kineze vazhdon të jetë e fortë. Kina ka marrë angazhime për të financuar ndërtimin e 30 objekteve të mëdha industriale në Shqipëri. Është projektuar ndërtimi i Kombinatit Metalurgjik në Elbasan, i një hidrocentrali me kapacitet prodhimi rreth 1.79 milionë kilovat për orë, ndërtimi i një sërë fabrikave, hapja e minierave të reja e rindërtimi i disa të vjetrave. Në vazhdim kjo agjenci njofton se Shqipëria deri tani nuk ka arritur të çlirohet nga importimi i drithërave dhe për këtë Kina është financuesja kryesore.

“Eksporti Shqiptar,- shkruan gazeta e Turqisë “Egje Ekonomi”²¹, - përbëhet nga 50% sende industriale, 30% minerale, 18% bujqësore dhe 2% produkte gjysmë të gatshme. E rëndësishme është që të gjitha mallrat janë të një cilësie të lartë dhe mjaft të preferuara nga tregu i jashtëm. Pjesa më e mirë e mallrave që prodhohen në vend janë të destinuara për eksport, kurse pjesa tjetër e një cilësie disi më të ulët rezervohet për popullsinë vendase”.

Sipas Agjencisë së Lajmeve “Tanjug”²², Shqipëria zhvillon disa marrëveshje tregtare me Greqinë. Sipas saj Shqipëria interesohet për blerjen e makinave bujqësore, prodhime industriale dhe orendi shtëpiake. Në veçanti gazeta e Turqisë “Egje Ekonomi” interesohet për blerjen e kuzhinetave, kamionëve, e pjesëve rezervë për makina të ndryshme, brisqe rroje, tuba të shiut artificial, artikuj elektrikë, televizorë etj. Shqipëria nga ana tjetër eksporton produkte blegtorale, bujqësore, pyjore, produkte industriale etj.

Marrëveshje tregtare zhvillohen dhe me Japoninë. Gazeta polake “Rynki Zagraniczne”²³, shkruan se Japonia zhvillon një tregti të jashtme aktive me vendet socialiste. Ndër to edhe me Shqipërinë. Aty thuhet se eksporti japonez në fillim të Pesëvjeçarit V, arriti në 157 mijë dollarë, kurse importi vetëm 1 mijë dollarë.

Megjithëse në shifra modeste import-eksporti, tregon një lloj gjallërie të kapitalit socialist në Shqipëri, e një lloj frymëmarrje disi më të lehtë. Por sa do të zgjasë kjo situatë?

²⁰ Agjencia e Lajmeve *Tanjug*, 21.10.1970.

²¹ Gazeta *Egje Ekonomi*, Ankara, 8.1.1972, “Eksporti shqiptar”.

²² Agjencia e Lajmeve *Tanjug*, 15.11.1970.

²³ Gazeta *Rynki Zagraniczne*, Varshavë, 29.8.1970, “Këmbimet Japoni-Shqipëri”.

Marrëveshje ekonomike janë nënshkruar dhe me Rumaninë. Në bazë të tyre Rumania do të shfrytëzojë disa kripore në zonën jugore të Shqipërisë, kryerjen e disa punimeve në thellësi të mëdha për nxjerrjen e naftës, ndihmë për përpunimin e kromit etj.²⁴

Italia është një tjetër shtet që nënshkruan marrëveshje ekonomike me Shqipërinë socialiste. Sipas gazetës “Il Popolo”²⁵, datë 11.11.1972, midis dy vendeve u mbyll me sukses takimi i zv/ministrit të tregtisë së jashtme të Italisë Giulio Orlando me zv/ministrin e tregtisë së jashtme të Shqipërisë Vasil Kati. Pretendohet se Italia do të jetë vendi i dytë për marrëdhëniet ekonomike me Shqipërinë, pas Kinës. Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, për të ardhmen synohet një bashkëpunim i konsiderueshëm midis këtyre shteteve.

Shtypi hungarez njofton për një marrëveshje midis Polonisë dhe Shqipërisë. Sipas gazetës “Magyar Hirlap”²⁶, Polonia do të eksportojë në Shqipëri makineri, mineral koks, pajisje industriale dhe do të importojë së këtejmi krom, zarzavate, fruta e mallra të tjera.

Por a do realizohen këto marrëveshje?... Sa efektivitet do të kenë ato për të ardhmen?...

Koha do të tregojë se këto marrëveshje tregtare do të jenë shumë të kufizuara dhe nuk do të arrijnë të shpëtojnë dot ekonominë shqiptare, e aq më pak ta çojnë atë më përpara. Izolimi total, qoftë edhe me shtetet socialiste të Evropës Lindore, do të ndikojë negativisht në ekonominë shqiptare. Mungesa e kooperimit dhe e bashkëpunimit me vendet e tjera do të frenojë zhvillimin ekonomik dhe do ta çojë Shqipërinë drejt një varfërie të madhe.

Shtypi i huaj, me gjithë kufizimet e izolimit që karakterizojnë Shqipërinë, arrinte të merrte informacione duke pasqyruar në faqet e gazetave situatën ekonomike. Pavarësisht orientimit dukshëm propagandistik të disa gazetave jepen të dhëna konkrete mbi zhvillimin bujqësor dhe industrial të vendit tonë. Duke patur parasysh nivelin e lartë të prapambetjes të trashëguar pasqyrohen ndryshimet dhe arritjet në disa sektorë kyç të ekonomisë shqiptare. Rritjet e treguesve ekonomikë i atribuohen politikave shtetërore, por dhe mbështetjes nga Republika Popullore Kineze. Nga ana tjetër nuk anashkalohet mungesa e marrëdhënieve zyrtare me KNER, por vlerësohen disa marrëveshje tregtare import-eksporti me shtete të veçanta kryesisht të rajonit.

²⁴ Revista *Lurica*, Bukuresht, 27.8.1970.

²⁵ Gazeta *Il Popolo*, Romë, 11.11.1972, “Shkëmbimet Italo-Shqiptare”.

²⁶ Gazeta *Magyar Hirlap*, Butapest, 13.2.1973, “Marrëveshja Shqiptaro-Polake”.

BIBLIOGRAFIA

- Agjencia e Lajmeve *Tanjug*, 15.11.1970.
 Agjencia e Lajmeve *Tanjug*, 21.10.1970.
 Radio *Austria*, 7.12.1970.
 Gazeta *Nowe Czasy*, 10.10.1970.
 Gazeta *Bari-Licata*, Bari, 8.1.1971.
 Gazeta *Başkent*, Ankara, 28.11.1970.
 Gazeta *Die Presse*, Vjenë, 26.6.1970.
 Gazeta *Egje Ekonomi*, Ankara, 8.1.1972.
 Gazeta *Horizont*, Berlin, 24.11.1971.
 Gazeta *Horizont*, Berlin, 8.1.1971.
 Gazeta *Il Popolo*, Romë, 11.11.1972.
 Gazeta *Magyar Hirlap*, Budapest, 13.2.1973.
 Gazeta *Rynki Zagraniczne*, Varshavë, 17.8.1972.
 Gazeta *Rynki Zagraniczne*, Varshavë, 29.8.1970.
 Gazeta *Rynki Zagraniczne*, Varshavë, 6.8.1970.
 Gazeta *Rynki Zagraniczne*, Varshavë, 29.9.1972.
 Gazeta *Skentea*, Varshavë, 23.7.1970.
 Gazeta *Yeni Gyn*, Stamboll, 11.2.1971.
 Revista *Agri-Forum*, Romë, 12.7.1972.
 Gazeta *Washington Post*, 13.08.1972.
 Revista *L'informatore Agrario*, Romë, 1972.
 Revista *La vie katholique*, Paris, janar 1973.
 Revista *Lurica*, Bukuresht, 27.8.1970.
 Revista *Magyar Orszag*, Butapest, 31.12.1972.

**The world press on the centralized Albanian economy in the
years 1970-1973**

ABSTRACT

This paper focuses on the economic situation of Albania during the years 1970-1973, seen from the point of view of the foreign press. Newspapers and articles by foreign news agencies, especially those with a left-wing political orientation and obvious propaganda tendencies, as being translated by the Albanian Telegraphic Agency (ATSH), were served only to the Albanian upper class. The purpose of this paper is to present the views that the foreign press maintains regarding the features of the Albanian economy and the way of its development, at a moment which preceded the path of economic self-isolation and beyond. Focusing on the development of agriculture, industry, Chinese support, the lack of relations with the Council of Mutual Economic Assistance, while having a number of economic agreements and trade exchanges with some countries such as Greece, Romania, Italy, etc., the data on the pace of the Albanian economic development shall be actually presented.

During the research work, the qualitative method was generally applied by conducting a collective, descriptive and evaluative research, based mostly on the presentation and analysis of foreign news articles.

Keywords: world press, centralized and planned economy, communist ideology, propaganda.

LËVIZJET MIGRUESE NË ZONAT URBANE TË VENDIT TONË. DINAMIKA E FAKTORËVE NDIKUES

Hyrje

Urbanizimi në tërësinë e dimensioneve të shfaqjes së tij është paraqitur me mjaft tipare dhe karakteristika interesante, të cilat natyrshëm kanë nxitur studiuesit për të hulumtuar mbi të. Studiues të ndryshëm, por në mënyrë të veçantë urbanistët dhe historianët, ekonomistët dhe sociologët, planifikuesit e territorit, ambientalistët etj., në hulumtimet e tyre kanë dhënë mjaft qasje, ide dhe argumente, të cilat janë bërë pjesë jo vetëm e debatit shkencor në veçanti, por edhe atij publik në përgjithësi. Ndër të tjera mjaft specifike në hulumtimet shkencore rreth çështjeve të tilla mbi urbanizimin, kanë qenë dhe janë aktualisht, analizat e shumta referuar mënyrës dhe formës, apo edhe dimensioneve të zonave urbane, larmishmërisë, varietetit dhe sidomos dinamikës së shfaqjes së tyre, shtrirjes territoriale në hapësirat e ndryshme, jetës urbane dhe pasurimit të funksioneve sociale të saj, vendbanimeve dhe evolucionit të tyre, veçorive të diversitetit kulturor, problemeve të shumta që lidhen me evolucionin, ndryshimin dhe transformimin e tyre, relacionet ndërmjet peizazhit urban dhe zhvillimit të qëndrueshëm, industrializimi i tyre dhe ambienti, mjedisi dhe urbanizimi etj. Tematika të tilla në mënyrë periodike janë bërë edhe pjesë e forumeve dhe organizimeve shkencore lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, apo edhe pjesë e rëndësishme e projekteve me fokus kryesor, urbanizimin.

Nën këtë këndvështrim paraqitet mjaft e nevojshme dhe e domosdoshme edhe roli dhe kontributi i disiplinave gjeografike me objektet e tyre mjaft diverse e tepër të larmishme. Gjeografia e popullsisë, gjeografia sociale, gjeografia urbane, ajo ekonomike, industriale, regjionale, e mjedisit, e turizmit etj. gjithnjë e më tepër po e përfshijnë në tematikat e saj edhe këndvështrimin drejt analizës së zonave urbane, referuar gjithnjë në sinkron të objekteve të tyre specifike shkencore. Marëdhëniet dhe realacionet që shfaqen ndërmjet popullsisë, zhvillimeve sociale të saj, proceseve të zhvillimit ekonomik, sidomos atyre industriale, turizmit, lokalizimet regjionale të popullsisë dhe aktiviteteve kryesore ekonomiko-industriale, shpërndarja gjeografike e tyre shoqëruar me

ndikimet reciproke popullsi - ekonomi - urbanizimi, impaktet mjedisore bashkëshoqëruese dhe zhvillimi i qëndrueshëm, janë tregues të drejtpërdrejtë të domosdoshmërisë shkencore studimore edhe në aspektin gjeografik. Prandaj mjaft studiues gjeografë, pjesë e rëndësishme e universiteteve të ndryshme apo qendrave kërkimore gjeografike në vende të ndryshme të botës, në mënyrë gjithnjë e më të avancuar po hulumtojnë e debatojnë në këtë drejtim.

Me mjaft interes është edhe përfshirja e studiuesve gjeografë shqiptarë në hulumtime shkencore e studime të tilla. Qasje, analiza, projekte, studime, botime për njësi të ndryshme administrative urbane, tashmë janë pjesë e opinionit shkencor gjeografik në veçanti, por edhe opinionit publik. Në materialin e mëposhtëm jemi orientuar për të dhënë një analizë të përgjithshme të rolit dhe kontributit të faktorëve ndikues të lëvizjeve migruese, pas vitit 1990, të cilat janë orientuar drejt zonave urbane të Shqipërisë. Një migrim i tillë është paraqitur më një ndikim të drejtpërdrejtë në tërësinë e hapësirës sociogjeografike të zonave urbane të vendit tonë, duke u shoqëruar me impaktet mjaft të ndjeshme në disa drejtime. Ndër to mund të veçojmë ndryshimin e konfiguracionit të hapësirës gjeografike në kuadrin e pasurimit të saj me vende të reja sociale, ndikime mjaft të shprehura në popullsitë lokale të tyre (sidomos në numrin e popullsisë, strukturat e saj), në pasurimin e hapësirës sociale (sidomos të funksioneve sociale të tyre), të ndryshimit dhe pasurimit të aktiviteteve ekonomike në përgjithësi, ndikimeve mjedisore etj. Në mënyrë të detajuar materiali ynë është orientuar drejt hulumtimit dhe analizës që u referohet dinamikës së këtyre faktorëve gjatë evolucionit prej afro tri dekadash të migrimit drejt zonave urbane të Shqipërisë.

Njësitë administrative urbane në vendin tonë dhe lëvizjet migruese

Që në fillimet e vitit 1990 teksa kemi qasjet e para masive të migrimit të popullsisë u vu re mjaft qartë se drejtimi kryesor i tyre krahas migrimit të jashtëm do të ishin qytetet kryesore të Shqipërisë apo zonat urbane. Në mënyrë të shpejtë dhe mjaft të shprehur, qartësisht kjo u ndje në qytetet kryesore të vendit, si në: Tiranë, Durrës, Fier, Shkodër. Elbasan, Vlorë, Korçë, Berat etj. Një lëvizje e tillë migruese dhe zhvendosje imediate e popullsisë, mendojmë se i gjeti mjaft të papërgatitur në shumë drejtime hapësirat sociogjeografike respektive urbane, të cilat gradualisht u përfshinë në një “diversitet” të drejtpërdrejtë në aspekte ekonomike, sociale, kulturore me të ardhurit. Studiues të ndryshëm vlerësonin faktin e ndryshimeve dhe transformimeve që ndodhen në zonat urbane të vendit tonë. Mjaft prej tyre, siç është studiuesja Shaqiri, në hulumtimet e saj

shkencore mbi raportet urbanizim - migrim vlerëson se *“urbanizimi në shoqërinë shqiptare, është një proces në zhvillim, si nga ana sociale, ashtu edhe nga ana infrastrukturore. Pas viteve 1990, qytetet shqiptare kanë fituar një strukturë të re sociale dhe arkitekturore”*. Kryesisht prania e migrantëve të brendshëm që u vu re në zonat urbane ishin pjesë e qyteteve të vogla të Shqipërisë së fillimviteve të tranzicionit. Ndër to mund të përmenden sidomos lëvizjet e popullsisë nga Puka, Fushë Arrëzi, Tropoja, Peshkopia, Kukësi, Kruma, Rrësheni, Kurbneshi, Laçi, Çorovoda, Poliçani, Përmeti, Leskoviku, Erseka, Tepelena, Ballshi, Memaliaj, por edhe grupe të veçanta të popullsisë rurale periferike e këtyre njësive administrative kryesore urbane etj. Përgjithësisht graviteti i lëvizjes së tyre ishte orientuar drejt qendrave kryesore urbane të sipërpërmendura.

Një zhvendosje e tillë e kësaj popullsie e orientuar në drejtimin e saj migrator drejt qyteteve më të mëdha dhe të rëndësishme të Shqipërisë në fillimet e tranzicionit, përfshinte në vetvete disa elemente të spikatura apo faktorë thelbësorë, motivues të lëvizjes së tyre. Në varësi të tyre dhe ndikuar nga to, individët e ndryshëm, familjet e tyre, grupe të veçanta sociale të popullsisë, kategori të larmishme sociale, pjesë të strukturave profesionale të popullsisë së vendit tonë, u nxitën për të lëvizur apo zhvendosur nga njësitë e tyre administrative të origjinës drejt këtyre qendrave urbane, si: Tirana, Durrësi, Elbasani, Shkodra, Vlora, Korça, Fieri etj. Jemi të mendimit se në vështrimin e përgjithshëm **elementi prioritar apo faktori determinant**, padyshim që lidhet me ndryshimin dhe transformimin e rëndësishëm politik që përfshiu vendin tonë me ndryshimet demokratike që ndodhën në Shqipërinë e pas viteve 1990. Në sajë të këtyre ndryshimeve kemi krijimin e një këndvështrimi dhe filozofie të re, të pasjes dhe krijimit të mundësive për individët dhe familjet shqiptare, për të lëvizur lirisht në aspektin administrativ anekënd vendit. Një gjë e tillë bëri të mundur edhe lindjen dhe zhvillimin e lëvizjeve migruese të brendshme, në forma, përmasa dhe dimensione nga më të larmishmet. Krahas tyre është evidente edhe qasja drejt analizës shkencore të dukurive të tilla të karakterit migrativ, sidomos në faktorët ndikues, format dhe tipet e migrimit, si dhe impaktet bashkëshoqëruese. Më poshtë po mundohemi në mënyrë më të detajuar të paraqesim disa nga motivet me të spikatura.

Së pari, mundësitë për të gjetur punësim dhe vendbanim në këto qytete të mëdha të vendit, të cilat duhet të theksojmë, se përfaqësonin edhe qendrat kryesore urbane të Shqipërisë. Nisur nga të dhënat e disponuara nga INSTAT, në fillimin e viteve 1990 Tirana, Durrësi, Elbasani, Shkodra, Fieri, Vlora, Korça, Berati, paraqiteshin si qytetet më të zhvilluara të vendit. Një zhvillim i tillë përfshinte kryesisht aspektet kryesore

ekonomike, të shprehura në ato industriale, si dhe në fushën e shërbimeve etj. Prezenca e fabrikave, uzinave dhe kombinateve, ndërmarrjeve nga më të ndryshmet, pjesë e degëve të ndryshme të industrisë, ishin më të përqendruara në këto qendra urbane. Në këtë mënyrë ato paraqiteshin me mundësi për sigurimin e vendeve të punës. Kapacitetet bartëse në aspektin e vendeve sociale të prodhimit, ndikuar nga pesha e konsiderueshme specifike që zinin, sidomos në këto degë të ndryshme të industrisë gjatë kohës në fillimvitet 1990, ishin një mundësi mjaft e mirë në kuadrin e plotësimit të pritshmërive nga ana e popullsisë migratore të brendshme e cila orientohej të vendosej në këto qendra të mëdha urbane të vendit. Njëkohësisht prania e vendbanimeve në këto qytete ishte më e lartë në numër në raport me pjesët e tjera të vendit gjë që i bënte optimistë grupet e ndryshme të popullsisë për t'u vendosur dhe stabilizuar jetën e tyre në to. Edhe një gjë e tillë paraqitej mjaft motivuese për popullsinë që lëvizti në kuadrin e migrimit të brendshëm dhe që u orientuan drejt tyre. Të dy këto elemente shërbyen si shtysa të rëndësishme të lëvizjeve të para migrative të brendshme orientuese për zhvendosjet e popullsisë së vendit tonë drejt qendrave të mëdha urbane.

Se dyti, fillimet e para të tranzicionit, ndryshuan dhe transformuan sistemin ekonomik të trashëguar shtetëror drejt ekonomisë së tregut. Ky ndryshim dhe transformim ndonëse përfshiu gjithë ekonominë e vendit, njohu zhvillime diverse në njësitë e ndryshme administrative në qytetet e ndryshme të vendit apo në zonat urbane. Një situatë e tillë u paraqit e ndikuar edhe nga raportet ekonomike të trashëguara në vite, pesha specifike e zhvillimeve industriale, lokacioni gjeografik dhe afërsia me portet, aeroportet dhe pikat kufitare ndërshtetërore, vendndodhja e vendeve sociale të prodhimit, siç ishin objektet ekonomike industriale apo të sektorit të shërbimeve, prezenca e fuqisë punëtore në varësi të migrimit të jashtëm të ndodhur në fillimet e tranzicionit, rëndësia historike, tradicionale e administrative e qyteteve përkatëse etj. Në varësi të tërësisë së këtyre elementëve të sipërpërmendur duhet vlerësuar fakti se ndryshimet dhe transformimet ishin më të ndjeshme pikërisht në qytetet e mëdha, në zonat urbane kryesore të vendit. Në Tiranë, Durrës, Shkodër, Elbasan, Fier, Berat, Vlorë, Korçë, ndonëse gradualisht, por me ritme më të shpejta se në njësitë e tjera administrative të Shqipërisë kemi startimin e mjaft ideve, iniciativave, sipërmarrjeve, bizneseve nga më të larmishmet në sektorë të ndryshëm të industrisë dhe fushës së shërbimeve. Tërësia e aktiviteteve të tilla ekonomike ndikuan në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe në gjenerimin e mundësive të shumta të përfshirjes së grupeve të ndryshme sociale të popullsisë në këto aktivitete. U vu re me ritme të shpejta prania e

zhvillimeve pozitive nëpërmjet aktivizimit të tyre, ndikuese në ekonominë familjare të kohës, në mjaft prej grupeve sociale, pjesë e popullsisë banuese dhe të ardhur në njësitë administrative urbane të mëdha të Shqipërisë së dekadës së parë të tranzicionit. Një situatë e tillë shërbeu si një shëmbylltë apo si model i ri ekonomik, i cili duhej ndjekur në njësitë e ndryshme administrative të vendit. Po ashtu, mundësitë dhe potencialet për të ushtruar këto aktivitete ekonomike, u vunë re që ishin më aktive dhe përfituese, pikërisht në këto njësi të mëdha urbane të vendit. Prandaj një element i tillë shërbeu dukshëm për nxitje të migrimit të brendshëm të popullsisë nga njësitë e ndryshme administrative të vendit drejt këtyre qendrave të mëdha urbane.

Se treti, transformimet e shpejta drejt sistemit të ri ekonomik të tregut bënë të mundur gradualisht edhe një risi mjaft të rëndësishme, e cila lidhej me investimet e huaja. Investitorë të ndryshëm, kryesisht nga vendet fqinje, por edhe më gjerë filluan që të depërtonin në sektorë të ndryshëm të ekonomisë shqiptare. Sipërmarrës italianë, grekë, gjermanë, amerikanë etj., filluan që të hapnin linja të reja prodhimi, që lokalizoheshin kryesisht në zonat e mëdha urbane të vendit. Në këtë mënyrë Tirana, Durrësi, Fieri, Shkodra, Vlora, Gjirokastra etj., ishin “target” kryesor i këtyre investitorëve të ndryshëm. Në këtë sens u ndje nevoja dhe domosdoshmëria e përfshirjes së mjaft punëtorëve, pasi u gjeneruan vende të reja pune në këto sipërmarrje e biznese. Mjaft aktive u bënë situata të tilla me tendencën drejt sektorëve të tjerë të ekonomisë, industrisë. Në mënyrë të veçantë zhvillimet që shoqëruan sektorë të tillë, si: ndërtimi dhe turizmi, industria e lehtë dhe ushqimore, fasoneritë e ndryshme, sektori i shërbimeve etj., nxitën në mënyrë mjaft aktive kërkesën për fuqi punëtore. Vlerësojmë se në këtë drejtim kërkesa më të mëdha pati sidomos në zonat e mëdha urbane të vendit. Tirana, Durrësi, Fieri, Vlora, u përfshinë në një ndryshim intensiv dhe transformim të konsiderueshëm të mjaft prej vendeve sociale të banimit, prodhimit, shkëmbimit, argëtimit etj. Në mënyrë më graduale u përfshinë më pas edhe njësi të tjera administrative urbane, kryesore, siç ishin veçanërisht Shkodra, Korça, Elbasani etj. Intensitet më gradual në zhvillimet e ndryshme urbane transformuese u ndjenë edhe në njësitë administrative urbane më të vogla, siç ishin Lezha, Saranda etj., dedikuar kryesisht aseteve turistike të pranishme në to.

Së katërti, urbanizimi i njësive administrative urbane të vogla. Afërsia me qytetin bëri të mundur, që një pjesë e konsiderueshme e popullsisë rurale, të zhvendosej me ritme të ndryshme drejt zonave urbane të vogla. Kryesisht kjo u vu re në njësi administrative urbane industriale si Bulqiza, Krasta, Ballshi etj. Ardha e kësaj popullsie ishte si pasojë edhe e

largimit të mjaft prej forcës punëtore, stafeve inxhiniero-teknike të këtyre qyteteve industriale drejt zonave urbane të mëdha të vendit, si dhe drejt migrimit të jashtëm. Një tendencë e tillë ndryshoi më pas teksa lëvizjet e kësaj popullsie të zonave rurale, rriti intensitetin e lëvizjes së saj numerike drejt njësive urbane të mëdha të vendit, sidomos Tiranës, Durrësit, Shkodrës, Vlorës etj. Tipar karakteristik i tyre është lokalizimi specifik, duke u vendosur në aspektin administrativ në hapësirat gjeografike periferike të këtyre zonave urbane. Evidente paraqiten zonat periferike të Shkodrës në drejtim të njësive administrative aktuale nr.5, zonat e ish - kënetës në Durrës, Lapraka, Sauku në Tiranë etj.

Tërësia e këtyre faktorëve apo elementeve të përmendur me sipër përfaqësojnë në mënyrë të përgjithshme edhe motivet kryesore të zhvendosjes së popullsisë drejt qendrave kryesore urbane gjatë fillimit të periudhës së tranzicionit në vendin tonë. Patjetër, që krahas tyre, kanë ndikuar edhe faktorë të tjerë të përgjithshëm dhe lokalë, por gjithsesi sipas mendimit tonë me rol dhe kontribut minor në raport me ato të përmendur më sipër. Gjithashtu, nënvizojmë faktin se gjatë dekadës së dytë dhe të tretë pas tranzicionit të viteve 1990, kryesisht pas viteve 2000, gradualisht lëvizje të tilla migratore të brendshme fillojnë të ulin ritmin e tyre, madje stabilizohen gjatë dekadës së tretë duke shfaqur më shumë trend drejt migrimit të jashtëm.

Dinamika e faktorëve ndikues në lëvizjet migruese drejt qendrave urbane

Në kuadrin e ecures së tyre tërësia e faktorëve ndikues të paraqitur edhe në çështjen e mësipërme, në migrimin e brendshëm të popullsisë shqiptare e orientuar drejt qyteteve kryesore, apo qendrave urbane të mëdha të vendit, është shoqëruar me një dinamikë mjaft të spikatur dhe interesante. Një dinamikë e tillë ka përfshirë jo vetëm përmasat dhe dimensionin e këtyre lëvizjeve migruese, por edhe formën dhe përmbajtjen e tyre. Luhatjet e shfaqura në ecurinë e dinamikën e tyre, padyshim kanë qenë të lidhura ngusht dhe të ndikuara edhe nga zhvillimet politike, ekonomike, sociale dhe administrative që kanë shoqëruar Shqipërinë e tranzicionit. Gjithnjë e më tepër po merrte formë dhe trajtë një mënyrë dhe model i ri ekonomiko-politik i orientuar drejt vendosjes së demokracisë dhe ekonomisë së tregut. Nën efektin e këtyre zhvillimeve edhe popullsia shqiptare në përgjithësi, po ashtu edhe ato grupe sociale të popullsisë migratore të brendshme në veçanti, ndjenë dhe u përfshinë në to, duke evidentuar tipare dhe veçori të spikatura. Tërësia e tyre ka pasuruar dukshëm hapësirën sociogjeografike të vendit tonë në shumë drejtime.

Madje ndikimi është mjaft i spikatur në efektet e larmishme bashkëshoqëruese të tyre.

Vlerësojmë se dinamika e faktorëve ndikues në lëvizjet migruese drejt qendrave urbane të Shqipërisë është shfaqur në mënyrë të drejtpërdrejtë me ndikime të rëndësishme drejt ndryshimeve që kanë pësuar sidomos ritmet migratore dhe fluksi i këtyre lëvizjeve migruese, prioriteti dhe qëllimet apo arsyet migratore, destinacionet dhe diversiteti i tyre etj. Ndërsa në fillimet e tranzicionit të vendit tonë, ndjesia e izolimit ishte ndër motivet themelore dhe të përgjithshme të lëvizjeve migruese të popullsisë si në migrimin e jashtëm, ashtu edhe në atë të brendshëm, me kalimin e viteve gjenerohen motive të tjera prioritare, kryesisht ato ekonomike dhe sociale. Në mënyrë të veçante një kombinim i tillë motivesh ndjehet më i shprehur në drejtim të lëvizjes së tyre drejt zonave urbane. Një qasje e tillë drejt këtyre dy motiveve kryesore u ndikua në mënyrë mjaft të qartë nga vetë evolucioni që pësuan zonat urbane kryesore të vendit, apo qytetet e mëdha, si: Tirana, Durrësi, Shkodra, Vlora, Elbasani, Fieri, Korça etj.

Efektet e para të kalimit drejt ekonomisë së tregut nxitën në mënyrë mjaft aktive lëvizjen e popullsisë nga pjesë të ndryshme të vendit drejt këtyre qyteteve kryesore për shkak të mundësive të reja ekonomike të pranishme në to. Njëkohësisht me dinamizimin e faktorit ekonomik në shumë drejtime, sidomos nga struktura e re ekonomike e krijuar me zhvillimin e disa sektorëve të veçantë, siç ishin ato të industrisë së lehtë dhe ushqimore, fasonerive të ndryshme, sinjaleve të shpejta në industrinë tekstile, të konfeksioneve, këpucëve, sektorit të turizmit, ndërtimit etj., dinamizoi qartësisht edhe vetë faktorin ekonomik si prioritar në zhvillimet migrative të popullsisë drejt qendrave të mëdha urbane të vendit. Ngritja dhe funksionimi i mjaft prej vendeve të reja sociale të prodhimit në këto qytete kryesore të vendit kërkuan nevojën e rritjes së kapaciteteve bartëse për vënien në funksion të tyre. Studiueset Kopliku&Dibra në hulumtimin e tyre shkencor në lidhje me një nga zonat urbane kryesore të Shqipërisë, siç është Shkodra, vlerësojnë se *“Para 1990 ishin zonat rurale që mbanin përqindjen më të lartë të krahut të punës me qëllim punësimin në kooperativa, por rënia e ekonomisë bujqësore solli edhe rritjen e numrit të të papunëve në këto zona. Ata u drejtuan drejt qytetit i cili ishte qendër e shërbimeve dhe e punësimit industrial. Shpërndarja e pabarabartë e kërkesës dhe ofertës për krahun e punës, rënia e aktivitetit bujqësor, shkatërrimi ose reduktimi i aktiviteteve industriale që operonin në qytetin e Shkodrës ndikoi në rritjen e vlerave të papunësisë.”* Duhet evidentuar fakti se një pjesë e konsiderueshme e fuqisë punëtore ishte zhvendosur në kuadrin e migrimin të jashtëm në shtete të ndryshme të botes, duke krijuar

edhe boshllëqe në fuqitë punëtore respektive në këto qendra të mëdha urbane. Një gjë e tillë bëri të mundur që ky faktor ekonomik të ishte gjithnjë e me shumë nxitës dhe përthithës i ardhjes së popullsisë migratore drejt këtyre qendrave të mëdha urbane.

Dinamika dhe evolucioni i faktorit ekonomik lidhet edhe me vetë diversitetin e tij, zhvillimet e ndryshme me të cilat ai bashkëshoqërohet së bashku me efektet që shfaq. Në këtë drejtim dinamizimi dhe evolucioni i një faktori të tillë, i dedikohet edhe ndryshimeve dhe transformimeve ekonomike të shfaqura në këto qendra urbane në kuadrin e sektorit të turizmit. Hapësira të tëra turistike në qendrat urbane të Durrësit, Vlorës, Sarandës, Lezhës etj., u përfshinë nga një zhvillim mjaft interesant në drejtim të ndryshimeve dhe transformimeve të këtij sektori të rëndësishëm për ekonominë e vendit. Ndërtimtaria, agrobiznesi, shërbimet hoteliere dhe gastronomike, peshkimi, atraktiviteti në to, u paraqitën disa nga drejtimet kryesore, risi jo vetëm për evolucionin e këtyre qendrave urbane, por edhe vetë mënyrën e funksionimit të një industrie turistike nga njëra anë dhe hapësirës sociogjeografike turistike nga ana tjetër. Zonat e plazhit të Durrësit, të rivieres shqiptare, Sarandës, Shëngjinit, në mënyrë mjaft të shpejtë u futën në rrugën e një ndryshimi dhe transformimi jashtëzakonisht masiv. Nga muaji në muaj, nga viti në vit, këto hapësira sociogjeografike turistike, pjesë e rëndësishme e këtyre qendrave urbane, njohën mjaft zhvillime të qenësishme dhe tepër të rëndësishme në ndërtimin e mjaft vendeve sociale të banimit, prodhimit, shkëmbimit, argëtimit. Tashmë pallatet e shumta të banimit, hotelet dhe resortet e larmishme turistike, baret dhe restorantet, marketet dhe qendrat e ndryshme tregtare, atraksionet e larmishme në to, i kemi të pranishme në Durrës, Vlorë, Sarandë, Shëngjin etj., duke ndikuar në mënyrë të ndjeshme edhe në ekonominë tonë kombëtare. Një gjë e tillë paraqitet mjaft evidente edhe në ditët e sotme.

Duhet të vlerësojmë faktin, se është e nevojshme dhe e domosdoshme, prania e një numri të konsiderueshëm të fuqisë punëtore për të bërë të mundur tërësinë e këtyre realizimeve në vite dhe ato të sotme në aspektin turistik, të pranishme në këto qendra urbane. Një gjë e tillë ka pasur në sfondin e saj një fluks dhe ritëm të rëndësishëm migrator të brendshëm që u orientua për t'u vendosur në këto qendra të rëndësishme të zhvillimit të turizmit në zonat urbane të vendit. Këto flukse migratore përfshinë popullsi rurale dhe urbane (pjesë e qyteteve të vogla) nga pjesë të ndryshme të Shqipërisë. Rol në këtë drejtim ka luajtur në mënyrë të veçantë edhe lokacioni gjeografik, afërsia me këto qendra urbane me fokus zhvillimin e turizmit, ndonëse në mjaft raste shohim dhe evidentojmë edhe dalje nga ky rregull i migrimit të brendshëm të shfaqur në vendin tonë. Një

situatë tipike e vërejmë në zonën e Sarandës ku përfshihet migrim i brendshëm edhe nga Dibra, Kukësi apo Mirdita. Po ashtu edhe në Durrës ku kemi praninë e mjaft komuniteteve, si: nga Tropoja, Kukësi, Dibra, Malësia e Madhe, Puka, por edhe nga Skrapari, Erseka, Leskoviku, Devolli etj.

Mjaft i rëndësishëm për t'u trajtuar në kuadrin e kësaj dinamike faktoriale migrative paraqitet ritmi i këtyre lëvizjeve, cikli dhe fluksi migrator. Në mënyrë mjaft të spikatur vihet re ndryshim i rëndësishëm në raportet e ndryshimeve të flukseve migratore gjatë dekadës së parë të zhvendosjeve të popullsisë drejt qendrave urbane, respektivisht 1990-2000, me dy dekadat e tjera 2000-2010 dhe 2010-2020. Madje vlerësojmë se ndryshimet janë mjaft të dukshme duke marrë në konsideratë edhe vetë ndryshimet që përfshinë popullsitë respektive të qyteteve kryesore të vendit të evidentuara në regjistrimet periodike të popullsisë dhe banesave nga ana e INSTAT. Në to vihen re dallime dhe evidentohen edhe ndryshimet në drejtim të flukseve migratore të orientura drejt qyteteve kryesore të vendit, siç ishin: Tirana, Durrësi, Fieri, Shkodra, Elbasani, Vlora etj. Në varësi të këtyre lëvizjeve kemi edhe krijimin e njësive administrative të reja në Durrës (zona e ish - kënetës), Shkodër (njësia administrative nr.5, zgjerimi i Laprakës e Saukut në Tiranë, Kamzës etj.

Tepër evident në aspektin e zhvillimeve dinamike paraqitet edhe vetë evolucioni i faktorëve dhe motiveve migruese edhe në drejtime të tjera. Krahës aspekteve ekonomike zgjerohen përmasat e ndikimit të faktorit social. Studiueset Karaguni & Dumani vlerësojnë në hulumtimet e tyre shkencore, se *“Funksionimi i hapësirës urbane është shumëdimensional. Njerëzit, shoqëria kanë nevojë për kushte banimi e punësimi, për arsimim apo shërbime shëndetësore e sociale”*. Në mënyrë të veçantë një jetë sociale më e mirë dhe tepër diverse në zonat urbane të mëdha, si: Tirana, Durrësi, Shkodra, Fieri, Vlora, Elbasani, Korça, etj., ishte një arsye e rëndësishme e viteve të tranzicionit të Shqipërisë për popullsinë e saj që të orientohej për t'u vendosur drejt këtyre qyteteve kryesore. Në këto qendra kryesore urbane, krahës saj mundësitë për edukimin, shkollimin dhe kujdesin shëndetësor ishin dukshëm me kushte më të arrira për familjet shqiptare, fëmijët e tyre etj. Theksojmë se në mjaft prej njësive administrative të origjinës migratore të brendshme, në mënyrë graduale filluan të ndjeheshin situata problematike në drejtim të funksioneve të institucioneve arsimore dhe shëndetësore. Braktisja e tyre nga mësuesit dhe personeli shëndetësor i kualifikuar, i la vendin përfshirjes në institucionet arsimore dhe shëndetësore të mjaft mësuesve pa arsimin përkatës dhe personelit shëndetësor të pakualifikuar. Njëkohësisht në disa

prej spitaleve të vendit në njësi të ndryshme administrative, si pasojë e migrimit të jashtëm dhe të brendshëm, vihej re se nga viti në vit shumë specialitete dhe fusha të caktuara ishin të paplotësuara me kuadrot respektive profesionale. Mungesa e investimeve në fushat e arsimit dhe shëndetësisë, ishin një arsye tjetër evidente për prezencën e problemeve sociale që po shkaktonin këto dy sektorë në popullsitë lokale rurale dhe urbane të Tropojës, Pukës, Kukësit, Hasit, Dibrës, Bulqizës, Matit, Devollit, Ersekës, Skraparit, Memaliajt, Ballshit etj. Një gjë e tillë paraqitej tepër motivuese në aspektin social, si një faktor mjaft ndikues në migrimin e brendshëm të popullsisë, i cili u orientua kryesisht drejt qyteteve kryesore të vendit, apo qendrave të mëdha urbane, si: Tirana, Durrësi, Fieri, Shkodra, Elbasani etj.

Një element tjetër, ndaj të cilit kemi mendimin që shfaq një dimension tjetër të dinamikës në vite të faktorëve ndikues migrativ të brendshëm në aspektin social-ekonomik, kishte të bënte edhe me mundësitë më të mëdha për punësim dhe për zhvillimin e karrierës së tyre të mjaft profesionistëve të fushave të ndryshme, të cilët mendonin dhe shpresonin se këto qendra të mëdha urbane të Shqipërisë posedonin mundësi për realizimin e “endrrave” dhe “dëshirave” të tyre profesionale. Kjo shfaqet edhe si një arsye e rëndësishme e migrimit të mjaft profesionistëve të kualifikuar, pjesë e diversitetit të strukturës profesionale të popullsisë në njësitë administrative të origjinës. Mjaft prej tyre, duke mos pasur mundësi të ushtronin profesionet e tyre, u përfshinë krahas migrimit të jashtëm edhe në migrimin e brendshëm të orientuar drejt këtyre qendrave të mëdha urbane, në kërkim të gjetjes së mundësive për punësimin dhe karrierën e tyre profesionale. Mjaft e shprehur paraqitet një situatë e tillë, sidomos në diversitetin e profesioneve të lira, në të cilat këta individë, pjesë e grupeve migratore të brendshme, ndërtuan dhe vazhdojnë aktivitetet e tyre profesionale në Tiranë, Shkodër, Durrës, Fier, Elbasan, Vlorë, Korçë, Berat etj.

KONKLUZIONE

Migrimi dhe zonat urbane paraqesin një binom mjaft të spikatur të zhvillimeve të popullsisë sidomos gjatë periudhës së tranzicionit në Shqipëri. Ajo që vlen të evidentohet si një ndër konkluzionet kryesore të këtij materiali shkencor, të hulumtuar nga ana jonë, lidhet me rolin mjaft evident që kanë luajtur faktorët ndikues në zhvendosjet migrative të popullsisë së Shqipërisë të orientuara për t’u vendosur drejt zonave urbane. Në këtë kuadër vlerësojmë sidomos diversitetin dhe larmishmërinë e këtyre lëvizjeve migruese të shfaqura në tërësinë e dimensioneve të tyre. Ndër to

evidentojme faktorët, format dhe tipet e migrimit, shoqëruar me impaktet e shumta, që luajtën rol të spikatur në zhvillimin dhe dinamizimin e hapësirave të ndryshme sociogjeografike urbane të vendit tonë.

Ndër faktorët dhe motivet kryesore kemi mendimin se duhen nënvizuar: mungesa e lëvizjes së lirë në njësitë administrative të vendit, për shkak të lëvizjes së kontrolluar të popullsisë gjatë periudhës 1945 - 1990, ndryshimet e shfaqura në aspektet politike dhe ekonomike që shoqëruan Shqipërinë e fillimit të viteve 1990, si dhe drejtimet e tjera që lidhen me faktorët ekonomikë dhe socialë. Në mënyrë më të detajuar, sipas analizës së realizuar më sipër, vlerësojmë se paraqiten si motive të rëndësishme dhe kryesore mundësitë për të gjetur punësim dhe vendbanim në këto qytete të mëdha të vendit, që përfaqësonin edhe qendrat kryesore urbane të Shqipërisë, fillimet e para të tranzicionit, të cilat ndryshuan dhe transformuan sistemin ekonomik të trashëguar shtetëror drejt ekonomisë së tregut, transformimet e shpejta drejt sistemit të ri ekonomik të tregut, investimet e huaja, si dhe urbanizimin e njësive administrative urbane të vogla.

Një konkluzion tjetër mjaft aktiv është edhe dinamizimi i këtyre faktorëve gjatë viteve të ndryshme të tranzicionit, lidhur ngusht me prioritetet dhe avantazhet e tyre nga njëri moment në tjetrin. Në këtë mënyrë, shohim të shfaqen në një moment të caktuar, në një kombinim të spikatur e të dyfishtë në rolin e tyre, faktorët ekonomikë e socialë, e më pas, kemi ndryshime dhe dinamikë të rolit e kontributit të tyre duke ndryshuar rendin dhe prioritetin e tyre.

Duhet të vlerësojmë edhe një konkluzion tjetër, i cili është i lidhur me rolin e këtyre faktorëve ndikues në hapësira të ndryshme sociogjeografike. Këta faktorë ndonëse në përgjithësi shfaqen në unison dhe bashkëpunim të ngushtë me njëri - tjetrin, në disa raste kemi edhe kontribut specifik të veçantë të faktorit ekonomik ndaj atij social ose anasjelltas. Një gjë e tillë ka shoqëruar edhe ndikimin e tyre në shpërndarjen gjeografike të popullsisë në kuadrin e migrimit të brendshëm drejt zonave të ndryshme urbane të vendit.

LITERATURA

- Axhemi, Sokol: *Migrimi dhe zhvillimi social ekonomik*. (Grup leksionesh. Dorëshkrim.Tiranë, 2020).
- Dollma, M.: *Gjeografia ekonomike*. Cikël leksionesh. Botim.Tiranë, 2014.
- Karaguni, M.& Dumani, B.: *Tirana - Reliev demo-ekonomik e social*. Monografi. Tiranë, 2005.
- Kopliku,B. &Dibra, N.: *Urbanizimi dhe problemet sociale të lidhura me të. Sfida të*

reja për qytetin e Shkodrës. AKTET, AlbShkenca VI,3, 2013.

- INSTAT: *Një klasifikim i ri urban-rural i popullsisë shqiptare*. Botim, Tiranë, 2014.
- INSTAT: *Qytetet dhe shkalla e urbanizimit*. Botim, 2014.
- Shaqiri, Matilda: *Urbanizimi, vendbanimet dhe migrimi: identitet urban pas viteve 1990 në shoqërinë shqiptare*. Zani i Nalte, Sociologji, studime, 2 nëntor 2013.

**Migratory movements in the urban areas of our country.
Dynamics of influencing factors**

ABSTRACT

In this article we are oriented to give a general analysis of the role and contribution of the influencing factors of migratory movements, after 1990, which are oriented towards the urban areas of Albania. Such a migration is presented with a direct impact on the whole of socio-geographical space of urban areas of our country, being associated with very significant impacts in some directions. their local (especially in the number of population, its structures), in the enrichment of social space (especially of their social functions), change and enrichment of economic activities in general, etc. In detail our material is oriented towards research and analysis that refers to the dynamics of these factors during the evolution of nearly three decades of migration to urban areas of Albania. The article is divided in two main issues, which include the identification of influencing factors and their dynamic character. at the same time we have presented some conclusions.

Flora GJONI
Bresena KOPLIKU
Migena MUÇAJ

APLIKIMI I TRANSHUMANCËS, QASJE ZHVILLIMI AKTUALE NË ALPET PERËNDIMORE, IMPAKTI I TIJ NË KRIJIMIN E VENDBANIMEVE SEZONALE

1. Hyrje

Transhumanca është pjesë e gjeohapësirës shqiptare, pak e njohur me këtë term, por me një tradicion shumë të hershëm prehistorik. Transhumanca është një formë e zakonshme e organizimit ekonomik dhe social baritor në të cilin kopetë ose tufat lëvizin në distanca të gjata dy herë në vit, midis kullotave verore malore dhe kullotave dimërore fushore. (Chang, 2009). Mbështetur në traditën e hershme dhe përvojën e vendeve të rajonit të Ballkanit, ku transhumanca ka vlerësimin e duhur, hulumtimi ynë është fokusuar në evidentimin e potencialeve fizike e humane të Alpeve perëndimore për ushtrimin e saj. Hershmërinë e traditës së ushtrimit të saj prej shqiptarëve në shekuj e evidentojnë edhe studiues të huaj. Kullotja është ekskluzivitet i hershëm i shqiptarëve, serbëve, grekëve, rumunëve që nga mijëvjeçarët e hershëm (Ionel Calin, 2013). Periudha e Neolitit mendojmë se duhet të jetë fillimi i këtij fenomeni, atëherë kur bujqësia e blegtoria evidentohen si degë më vete. Këtë traditë të hershme të lëvizjeve baritore e kanë patur edhe trevat malore të Veriut të Shqipërisë e specifikisht edhe Alpet Perëndimore. Transhumanca është e lidhur ngusht me mjedisin natyror, sepse ai përbën bazamentin ku ushtrohet. Trajtimi i tyre së bashku me aspektet kulturore të kësaj tradite do të jenë në fokus të këtij hulumtimi. Zona e marrë në studim ka një sipërfaqe të vogël, por me një dinamikë elementësh natyrorë e humanë të favorshëm në funksion të ushtrimit të këtij fenomeni dhe me impakte të shumta mjedisore e humane. Në Alpet Perëndimore formohen mjedise të tilla gjeografike, që janë favorizuese për lëvizje transhumante, të lidhura kryesisht me pasurinë klimatike, pedalogjike e biotike. Midis tyre ka një ndërvarësi të dyanshme, nga i cili varet shumë rrijetësimi i natyrës, traditës dhe proceseve të zhvillimit ekonomik të gjeohapësirës së kësaj pjesë të Alpeve. Duke u vlerësuar siç duhet ky fenomen në aspekt kombëtar, rajonal dhe më gjerë, bëhet premisë vlerësimi edhe nga organizmat ndërkombëtarë. Këto etapa vlerësimi ka pasur transhumanca në vendet fqinje me Shqipërinë, ku

tashmë kjo traditë është bërë pjesë e UNESCO-s.

2. Metodologjia e përdorur

Qëllimi i studimit të këtij hulumtimi imponoi përdorimin e një larmie metodash në funksion të realizimit të tij. Studimi bazohet në shfrytëzimin e një bibliografie të gjerë të autorëve vendas e të huaj mbi transhumancën nga fusha të ndryshme, gjeografë, historianë, gjuhëtarë dhe etnografë të vendeve të rajonit dhe më gjerë. Kjo është e lidhur me faktin se komunikimet e blegtorëve të gjeohapësirës ballkanike nuk kanë njohur kufij fizikë e politikë, për shkak se korridoret dhe rrugëtimet baritore përfshinin hapësira të mëdha. Gjithashtu ata kanë një gjuhë komunikuese të njëjtë me kopetë e bagëtive, pavarësisht origjinës etnolinguistike të tyre.

Në punim janë përdorur metoda të shumëllojta në funksion të arritjes së qëllimit të analizës së këtij fenomeni, që nga metoda historike, në një analizë që nga antikiteti e deri më sot; metoda deduktive, sintezës, përpilimit të hartave etj. Qasjet e aplikuara në hulumtimet e analizuara në vende të ndryshme të botës, veçanërisht të rajonit, na kanë ndihmuar që të analizojmë faktorët favorizues në ushtrimin e transhumancës në Alpet Perëndimore, ndërvartësinë midis tyre dhe se si ky fenomen mund të ndikojë në të ardhmen në krijimin e një tipologjie të re vendbanimesh, atyre sezonale.

3. Diskutime dhe Gjetjet

Transhumanca në Shqipëri daton shumë herët, kur dega e blegtorisë shndërrohet në një aktivitet të rëndësishëm të njeriut. Transhumantët sot, janë një element i rëndësishëm për disa vende, të cilët kanë ruajtur akoma kontaktet midis tyre, duke ndihmuar në ruajtjen e gjallë të identitetit baritor që nga periudha e romakëve orientale. (Ionel Calin, 2013). Në rrugëtimin e tyre baritor, ata ishin në kontakt me kultura të ndryshme, por autenticiteti i tyre mbetet unik në llojin e tyre, sidomos për transhumantët e Ballkanit. Ata mbeten dhe mund të jenë, një urë lidhëse midis këtyre vendeve. Veprimtaritë baritore, në fakt, kanë lënë gjurmë në peizazhin gjeografik, i cili në disa aspekte ka pësuar transformime të theksuara dhe të qëndrueshme, sidomos tek biodiversiteti etj. Prandaj kontributi ynë si gjeografë, duke parë korrelacionin e ndërsjelltë të këtij fenomeni me veçoritë natyrore, është t'i evidentojë këto transformime, në mënyrë që mos të ketë çënime mjedisore. Kullotja e bagëtive ka një ndikim të madh në heterogjenitetin hapësinor të bimësisë, duke ndikuar në proceset e ekosistemit dhe diversitetin e peizazhit. Këto lëvizje baritore, kryesisht në

kullotat verore, krijojnë korridore në pyje, dhe kjo e fundit shoqërohet me shfaqjen dhe krijimin e peizazheve të ngjashme të vegjetacionit përgjatë këtyre rrugëtimeve. Hulumtimi ynë synon të paraqesë prezencën e pasurive natyrore të këtij rajoni në funksion të transhumancës dhe formave të ushtrimit të saj. Për t'u ushtruar lëvizjet transhumante duhen disa kushte favorizuese fiziko-gjeografike. Konkretisht: *një topografi ku alternohen relievet malore me ato të ulëta; klimë favorizuese malore; pasuri ujërash rrjedhëse e nëntokësore, disponueshmëri kullotash e livadhesh etj.* Nisur nga këta faktorë hulumtimi ynë do të mbështetet në analizën e përshtatshmërisë së kushteve natyrore në Alpet Perëndimore në favor të ushtrimit të bjeshkëzimit. Bazamenti topografik për ushtrimin e bjeshkëzimit (gjatë sezonit veror) në Alpet Perëndimore është në lartësitë e maleve, aty ku kemi të përqendruar zonat alpine e subalpine dhe për pasojë edhe një lloj të veçantë pa të cilën nuk është e mundur lëvizja baritore e bagëtive, pra kullotat e livadhet malore.

Harta 1 e 2: Harta gjeologjike e relievit të Alpeve Perëndimore (geoportal.asig.al)



Burimi: Geoportal.asig.al

Bjeshkëzimi si fenomen, ka nevojë për shumë hapësira në favor të kullotjes së bagëtive, për të cilën transhumanti është plotësisht në dijeni. Natyrisht që ai e di që këto kushte natyrore kanë ekzistuar prej epokave të hershme, duke qenë kështu një njohës shumë i mirë i terrenit ku kryhet kjo lëvizje. Alpet Perëndimore me një zonalitet vertikal të theksuar të relievit, janë të pasura me kullota e livadhe malore, të cilat janë shumë pak të populluara, por në funksion të kullotjes së bagëtive. Këto njësi malore, siç shihet nga harta nr. 2 dallohen për kontraste të theksuara të relievit, ku ndryshimi midis fundit të luginave dhe kreshtave të maleve është rreth 2000 m (ASH, 1991). Ngritjet e mëdha malore në këtë pjesë janë të lidhura me lëvizjet e


fuqishme neotektonike dhe përbërjen gjeologjike nga shkëmbinj të fortë (gëlqerorët). Këtë përbërje e tregon edhe harta nr. 1, ku trashësia e këtyre shkëmbenjve arrin deri në 3000-5000 m dhe që shpjegon edhe lartësinë e madhe mbi nivelin e detit. (ASH, 1991) Këto njësi të larta malore ndërthuren me luginat e thella alpine, të cilat kur zgjerohen marrin pamjen e koritave, dhe që korrespondojnë me prezencën e livadheve e kullotave. Pikërisht ky alternim morfografik mundëson ushtrimin e transhumancës, pra lëvizjeve baritore (transhumancës vertikale). Distancat e vogla të zonës në studim, me gjatësi V-J 64 km e L-P 20 km (ASH, 1991), e mundëson shumë edhe ushtrimin e lëvizjeve baritore nga kjo njësi drejt Ultësisrës së Shkodrës, pra të transhumancës horizontale. Prezenca e maleve me lartësi të madhe mbi 2000 m në Veri e VL të Alpeve Perëndimore dhe me zbutje të kontrasteve të relievit drejt Perëndimit e Jugperëndimit në 1500-1700 m (ASH, 1991), janë parakusht topografik për t'u ushtruar kjo lloj lëvizje baritore. Pjesët malore kryesore, siç shihet edhe nga harta nr. 2 në këtë pjesë të Alpeve, dhe ku mund të ushtrohet transhumancë janë: *Malet e Bigaj Gimajt, Majën e Ndreut, Livadhet e Bogës, Majën e Radohinës, Majën e Thatë, Harapit, Vishnjës, Majën e Mrizit, Berizhdolit, Golishit, Majën e Grebenit, Vilës, Livadhet e Lëpushës, Malin e Trajanit, si dhe kullotat më veriore në veri të Luginës së Vermoshit ato të Seferces, Smutirogës, Lugut të Dolit, Përbicës* etj. (ASH, 1991).

Alpet Perëndimore kanë klimë tipike malore me tipare mesdhetare, e shprehur me një dimër të ashpër e të lagësht, me ngrica të herëpashershme, si dhe verë e freskët për shkak të lartësisë së madhe mbi nivelin e detit. *Vlerat termike* janë të lidhura me konfiguracionin e relievit (kompleksitetin e prezantimit morfografik, morfometrik e morfogjenetik), lartësinë e madhe mbi nivelin e detit, bimësinë etj. Vlerat më të larta të temperaturave mesatare vjetore janë në Perëndim dhe Jug të Alpeve Perëndimore, ndërkohë që duke shkuar drejt Lindjes apo Veriut të tyre, temperaturat fillojnë të bien. Më të ulëtat janë regjistruar në Vermosh deri në -2.6 gradë C, Theth 0.3 gradë C e Razëm 0.4 gradë C. Mesataret e korrikut lëkundën nga 16 gradë C në Vermosh, deri në 19 gradë C në Theth e 17 gradë C në Razëm (ASH, 1991). Përsa i përket *reshjeve atmosferike* këto njësi gjeografike klasifikohen si më të lagështat në vendin tonë. Kjo është e lidhur më faktin se masat ajrore shprurëse nga Perëndimi përplasen menjëherë me ngritjet malore të kësaj pjese, duke mundësuar rënien e një sasive të madhe reshjesh. Mesatarisht në vit ato marrin 2000-3000 mm reshje, dhe dallohet në veçanti Boga 3100-3200 mm në vit (ASH, 1991). Sasia më e madhe e reshjeve, rreth 70% e tyre, bien gjatë gjysmës së ftohtë të vitit.

Në aspekt *hidrografik* Alpet janë të pasura me objekte hidrografike të shumta, të cilët përdoren si burime uji për popullsinë dhe ushtrimin e këtij fenomeni. Hidrografia është një element natyror mjaft favorizues dhe original, që e dallon nga krahinat e tjera, me një prezencë të ujërave rrjedhës sipërfaqësorë e nëntokësorë të llojeve të ndryshme. Për zonën e Alpeve Perëndimore, siç shihet nga harta nr. 3, ka objekte të shumta hidrografike, kushtëzuar nga ndërtimi gjeologjik, relievi me kontraste, reshjet e bollshme atmosferike etj.

Harta nr 3: Harta hidrografike e Alpeve Perëndimore

Burimi kryesor i rrjedhjeve sipërfaqësore janë reshjet atmosferike të shiut dhe burimet nëntokësore karstike. Maksimumi i ujërave të Shalës, Kirit,



Cemit është në muajin dhjetor dhe kanë regjim tipik alpin. Këta lumenj në rrugëtimin e tyre kalojnë edhe në shkëmbenjtë gjelqerorë, duke qenë ushqyes edhe ujërat nëntokësorë. Përmendim këtu burimet e Okolit, që ushqejnë lumin e Shalës; burimet e Vuklit, që ushqejnë lumin e Cemit të Vuklit; burimet e Berizhdolit, që ushqejnë Cemin e Selcës. (ASH, 1991). Pavarësisht prezencës natyrale të ujërave, vetë komunitetet, që merren me këtë

praktikë duhet të krijojnë korita të veçanta apo lugje prej guri për të lehtësuar pirjen e ujit nga bagëtitë. Lumenjtë malorë, burimet nëntokësore që dalin në sipërfaqe, liqenet akullnajorë dhe krojet e shumta, janë jetë në këto treva për mbarështimin e bagëtive.




Foto nr. 1 e 2: Koritë në Vrith të Shkrelit për bagëtitë

Faktorët e mësipërm kanë ndikuar edhe në *shumëllojshmërinë pedalogjike* të gjeohapësirës së kësaj pjesë të Alpeve. Tokat përbëjnë një element

natyror shumë të rëndësishëm në shërbim të transhumancës, me një shumëllojshmëri llojore dhe ku zonaliteti vertikal është i shprehur qartë. Nisur nga kjo e fundit në këtë pjesë të Alpeve dallojmë këto toka: tokat e kafenjta malore, tokat e murme pyjore, tokat livadhore malore. Këto të fundit kanë një rëndësi të madhe për ushtrimin e fenomenit të transhumancës, sepse në to rritet një bimësi barishtore shumëvjeçare, të cilat duke lënë në tokë një sasi të madhe lëndësh organike, ndikojnë në përmirësimin e strukturës së tokës dhe shërbejnë si kullota alpine për blegtorinë. Në hartën e nr. 4, është e prezantuar llojshmëria pedalogjike e zonës në studim:


Harta nr 4. Harta e tokave në Alpet Perëndimore (geoportal.asig.al)



Tokat livadhore gjenden në lartësitë 1700-2400 m mbi nivelin e detit dhe karakterizohen nga një përqindje e lartë e humusit në rreth 25-30% me trashësi 60-70 cm, potencial për kullotë. (ASH, 1991) Në zonën që ne kemi marrë për t'u hulumtuar shpërndarja gjeografike e tyre është në Vermosh, Bjeshkët e Namuna, Veleçik, malet rrethuese të luginës së Bogës etj. Bimësia barishtore që rritet në to, lë në tokë një sasi të madhe lëndësh organike, që ndikon në përmirësimin e strukturës së tokës dhe shërben si kullotë alpine cilësore për blegtorinë dhe ushtrimin e fenomenit të transhumancës. Bimësia barishtore në to kanë një cikël të shkurtër vegjetativ dhe janë të pasura

me humus me trashësi të madhe. Këto tip tokash mund të mbahen në gjendjen aktuale vetëm nëpërmjet kullotjes. (Felix H, 2005).

Një element tjetër natyror me impakt në fenomenin e transhumancës është edhe pasuria e **biodiversitetit**, i ndikuar nga tërësia e elementëve të tjerë fiziko-gjeografikë. Këta faktorë e veçanërisht këtu pasuria e elementëve klimatikë dhe veçoritë e relievit kanë përcaktuar zonalitetin vertikal të tij me një variabilitet të madh dhe përhapje të gjerë llojore. Këtë variabilitet shtrirjeje gjeografike synon të japë edhe harta nr. 5.

Harta nr 5: Harta bimore e Alpeve (geoportal.asig.al)

Pasuria bimore dhe që lidhet drejtpërsëdrejti me ushtrimin e transhumancës është kati i kullotave alpine. Janë faktorët klimatikë dhe shumëllojshmëria e tokave, të cilët kanë kushtëzuar edhe botën bimore mjaft të pasur të kësaj krahine në përgjithësi. Ndryshe nga krahinat e tjera, në këtë hapësirë përhapjen më të madhe e kanë dy kate bimore me një shtrirje të gjerë gjeografike: *kati i ahut dhe kullotave alpine*. Këto të

fundit shtrihen në lartësitë 1600-2500 m mbi nivelin e detit. (ASH, 1991). Janë të përmendura kullotat e Vermoshit, Lëpushës, Bjeshkëve të Namuna, malit Bridashit etj. Ndër bimët kryesore të këtij kati janë ato të boronicës, dëllinjës xhuxhe, kërlekës, shkurret e trëndafilin të egër (relikte e periudhës së kuaternarit), gentianës, bari shpatë etj. (ASH, 1991). Në përgjithësi, aktiviteti i kullotjes kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në krijimin e një mozaiku të pasur të vegjetacionit (Balent dhe Gibon 1996) dhe rezulton në krijimin dhe ruajtjen e të gjitha dimensioneve të biodiversitetit (Rook et al. 2004; Clergue et al. 2005; Dover et al.2). Ka prova të forta se pasurimi i tokës dhe përmirësimi i kullotave në zonat malore ka ndodhur si rezultat i plehut organik të mbetur nga tufat migruese. (Sezen O, 2016). Mbikullotja nga ana e tufave të bagëtive mundet të degradojë seriozisht përbërjen dhe pasurinë floristike të vargmaleve natyrore. Kullotja e kontrolluar duhet të jetë një zgjidhje inxhinierike ekologjike për të lehtësuar çekuilibrat në këtë aspekt. (AssaniS & Alkoirett. I , 2017).



Foto 1 e 2: Pamje e kullotave në Lëpushë e Vermosh

Pjesë e biodiversitetit e kësaj hapësire gjeografike me një shprehje të veçantë është edhe endemizmi. Ky fenomen është favorizuar nga relievi i

thyer malor dhe vertikalteti i theksuar i tij, të cilët kanë krijuar kushte për ekzistencën dhe ruajtjen e një numri të madh llojesh relikte, endemike e sub-endemike, si p.sh.: *Wulfenia baldaccit*, *Forsythia europea*, *boshtra*, *lule helmi*, etj (ASH, 1991). Modelet e kullotjes së tufës së lëvizshme transhumante kanë ndihmuar në përhapjen e farave të varieteteve endemike lokale dhe formimin e ekosistemeve unike (Sezer O, 2016) të rajonit të Alpeve Perëndimore dhe ruajtjen e përbërjes interesante floristike të saj.

Në konkluzion të kësaj analize të elementëve fiziko-gjeografikë, ajo që vlen të theksohet është pasuria e tyre dhe diversiteti llojor i tyre në favor të ushtrimit të transhumancës në Alpet Perëndimore.

Lind pyetja: *Nisur nga këto elemente çfarë lloj transhumance mund të ushtrohen në këtë hapësirë?*


Dy janë llojet e transhumancës, *transhumancë vertikale e horizontale* (Trifu A & Terec-Vlad L, 2015). E para në të gjitha periudhat është bërë më këmbë, ndërsa ajo horizontale është në distanca më të gjata dhe për këtë qëllim në disa vende të botës janë përdorur edhe kamionë. Transhumanca, për vetë specifikat e saj formon marrëdhënie të ndërsjellta midis njeriut, kafshëve dhe ekosistemeve natyrore. Barinjtë transhumantë janë jo vetëm njohës të mirë të mjedisit natyror, por njohuri shumë të mira mbi ekuilibrin ekologjik dhe ndryshimet klimatike të zonave ku kalojnë. Ndërthurja e luginave të shumta lumore me rajonet malore të Alpeve Perëndimore krijon kushte të favorshme për transhumancë vertikale, duke nënkuptuar lëvizjen e bagëtive midis kullotave në lartësi gjatë stinës së verës dhe luginave me lartësi më të ulët në dimër, ku janë të përqendruara edhe vendbanimet rurale të përhershme. Kjo është lëvizje në distanca të shkurtra. Shpatet me tarraca kanë shërbyer si hapësira të përqendrimit të



Harta nr 4 e 5: Transhumanca vertikale
Burimi: Geoportal.asig.al

vendbanimeve, të cilat në Shqipëri kanë patur një kufi maksimal deri në 1500 m, dhe që njëkohësisht kanë shërbyer, si baza për "nomadizmin alpin". Periudhat e alternuara kur mund të zhvillohet zakonisht transhumanca janë: Vjeshtë-Dimër dhe Pranverë-Verë. (Trifu A & Terec-Vlad L, 2015). Në rastin e transhumancës vertikale barinjtë kanë shtëpitë e tyre të përhershme në luginë. (Sezen O, 2016). Në hartat e mëposhtme kemi prezantuar dy llojet e transhumancës në Alpet Perëndimore:

Harta nr 6: Transhumancë horizontale



Prezenca e territoreve të ulëta në Perëndim (Ultësira e Shkodrës) të zonës në studim, kanë shërbyer si kullota të ekonomive blegtorale gjatë stinës së dimrit. Lëvizja baritore në këtë rast është në distanca më të mëdha gjeografike, duke kaluar në zona me specifika përsa i përket relievit, klimës, hidrografisë, biodiversitetit. Kalimet nga

një njësi më e lartë gjeografike, drejt një tjetre më të ulët në mënyrë sezonale shpjegon thelbin e transhumancës horizontale. Në rastin konkret gjatë sezonit dimëror, kur njësitë malore të Alpeve Perëndimore janë të mbuluara me dëborë, kemi lëvizje transhumante nga kjo njësi gjeografike me lartësi të madhe mbi nivelin e detit, drejt hapësirave më të ulëta gjeografike (Ulëtësirës shkodrane), dhe gjatë sezonit veror ndodh e kundërta. Është e kuptueshme që transhumanca horizontale realizohet për shumë ditë, e lidhur me distancat e mëdha, ndërkohë që ajo transhumanca vertikale bëhet brenda ditës. Periudhat oportune të lëvizjeve sezonale baritore kryhen nga fundi i muajit tetor dhe fillimi i muajit nëntor, në rastin e lëvizjeve nga zonat malore drejt ultësirës, dhe muaji i marsit dhe prillit, kur kemi lëvizje nga zonat e ulëta drejt njësisë të larta malore.

Lëvizjet baritore në përgjithësi kanë ndikuar në krijimin e një tipi të veçantë vendbanimi, atij sezonal, ose siç quhen ndryshe në vendin tonë stanet. Në shumë gjuhë ka fjalë të veçanta që personifikojnë këto vendbanime të barinjve, por që në thelb janë e njëjta gjë. Në Ballkan këto fjalë janë "Katun", "Stan", "Baçija", "Torine" etj. (Ionel Calin M. (2013) Tradicionalisht nomadët baritorë, krijojnë stanet e tyre në lartësitë e

maleve, aty ku ka prezencë të kullotave për bagëtitë, duke ndërtuar banesa të ulëta prej druri të çmontueshme, guri, plastmasi etj. Modelet e “nomadizmit baritor” janë të shumta, shpesh në varësi të llojit të bagëtisë, topografisë së relievit, dhe klimës etj. Në ndryshim nga vendbanimet e tjera rurale, tipizuar sipas relievit dhe veprimtarisë ekonomike, në hapësirat ku ushtrohet transhumanca nuk ka planifikim arkitektonik apo të përdorimit të tokës. Stanet e trevave të kësaj hapësire duke qenë larg teknologjisë janë të thjeshta në kushte, dhe çdo gjë e kanë në funksion të aktivitetit blegtoral. Duke vizituar këto stane të këtyre bjeshkëve njihemi edhe me një nga cilësitë e malësorëve, atë të mikpritjes, duke u bërë pjesë dhe shijues të proceseve artizanale të përpunimit të nënprodukteve të qumështit, duke marrë kështu një energji krejt tjetër nga përditshmëritë tona.

Foto nr 3 e 4: Stanet dhe përpunimi i produkteve blegtorale nga çobanët



Transhumanca është një pasuri kulturore dhe profesion njëkohësisht. Ky fenomen përfshin një mori traditash, njohuri shumë të specializuara lokale, gjuhë, mentalitete dhe artizanat/art. (Felix H, 2005). Historikisht, sistemet transhumante përbëhen nga vendet e kullotjes sezonale, korridoret baritore ku kalojnë bagëtitë dhe tregje lokale. Çobani, ose ndryshe bariu transhumant, konsiderohet një profesion i lashtë, të cilin e kanë trashëguar brez pas brezi. Ata janë artizanë të mrekullueshëm të përpunimit të qumështit në kushte krejtësisht natyrore e pa asnjë teknologji.

Kjo ka bërë që sot, stanet e krijuara në Alpet Perëndimore të vizitohen nga turistë të shumtë, veçanërisht të huaj, të cilët shijojnë një lloj të ri turizmi të paeksploruar më parë në vendin tonë, ku turisti shijon ushqime blegtorale bio, të prodhuara nga vetë çobanët. Në disa raste turistët bëhen pjesë e këtij aktiviteti duke krijuar një emocion të veçantë e mbresëlënës.

Çobanët e vjetër në përgjithësi e kanë pasion dhe janë të përfshirë edhe emocionalisht në këtë lëvizje baritore. Ndërkohë që janë të paktë të rinjtë që e ushtrojnë, sepse rinia e këtyre hapësirave gjeografike ose është larguar, ose e ushtron përkohësisht, deri sa t'i dalë një mundësi tjetër më e mirë për të fituar më shumë. Aplikimi i transhumancës në Alpet Perëndimore do të ndikonte në ruajtjen dhe mbrojtjen e zejeve të vjetra në rrezik zhdukjeje, veçanërisht në një periudhë krize punësimi, mund të përfaqësojë një mundësi të dobishme për brezat e rinj për të ruajtur dhe rizbuluar traditat e familjeve të tyre.

KONKLUZIONE E REKOMANDIME

Transhumanca ka kushte favorizuese fiziko- natyrore për t'u ushtruar në Alpet Perëndimore. Prandaj ushtrimi i saj jo vetëm na rikthen në tradita, por impulson edhe zhvillimin e degëve të tjera të ekonomisë, veçanërisht të disa nëndegëve të tjera të ekonomisë dhe të disa nëndegëve të industrisë ushqimore.

Ky fenomen duke u ushtruar në hapësira me kushte favorizuese natyrore e humane, është një premisë pozitive për punësim të personave që janë marrë me këtë profesion, por edhe rininë si trashëguese e baballarëve të tyre. Përvoja botërore ka treguar se nga ushtrimi i këtij fenomeni është bërë e mundur shfrytëzimi i hapësirave gjeografike, në të cilat nuk është e mundur zhvillimi i bujqësisë dhe për pasojë edhe e vendbanimeve të përhershme. Prandaj e theksuam që nga ushtrimi i këtij fenomeni kemi si rezultante krijimin e një tipi të veçantë vendbanimesh, atyre sezonale ose staneve.

Alpet Perëndimore kanë mundësi për vetë specifikat natyrore, të ushtrimit të transhumancës horizontale e vertikale. Gjatë ushtrimit të tyre bëhet e mundur që fshatrat e vendosura përgjatë rrugëve baritore, të përshtaten me procesin e zhvillimit të vazhdueshëm të tyre, duke u bërë qendra zhvillimi komplekse (blegtori, përpunim, turizëm). Zhvillimi në këto përmasa të tyre, do të krijonte mundësi për rikthim të popullatave të shpërngulura nga eksodi rural, proces ky që ka prekur shumë edhe këtë hapësirë gjeografike.

Praktikimi i transhumancës në zonën e Alpeve Perëndimore, bëhet burim identiteti për këto zona dhe do të mundësonte një zhvillim të

qëndrueshëm të tyre dhe dalja nga prapambetja e thellë. Përfshirja e Transhumancës shqiptare si pjesë e UNESKOS, do të ndihmonte në ushtrimin e saj.

REFERENCA

- Akademia e Shkenca të RSH**, (1991), “ *Gjeografia Fizike e Shqipërisë*” pjesa e II, Qendra e studimeve gjeografike, faqe 25-40
- AssaniS & Alkoirett. I** , (2017). “Transhumance and protected areas in west Africa: State of play and Management mechanisms review” Haya: *The Saudi Journal of Life Sciences* ISSN 2415-623X (Print) Scholars Middle East Publishers ISSN 2415-6221 (Online) Dubai, United Arab Emirates: <http://scholarsmepub.com/>
- Balent, G., & Gibon, A.** (1996). Organisation collective et individuelle dans la gestion des ressources pastorales: Consequences sur la durabilite agroecologique des ressources. In G. Zervas, & J. Boyazoglu, (Eds.), *The optimal exploitation of marginal mediterranean areas by extensive ruminant production systems* (Vol. 83, pp. 365–375). Zaragoza: EAAP Publication, faqe 82-87.
- Cheng C.** (2009) Source: American Anthropologist, “*Pastoral Transhumance in the Southern Balkans as a Social Ideology: Ethnoarcheological Research in Northern Greece*” New Series, Vol. 95, No. 3 (Sep., 1993), pp. 687-703 Published by: wiley on behalf of the American Anthropological Association Stable URL: <https://www.jstor.org/stable/679657> Accessed: 27-11-2018 00:51 UTC.
- De Pascale A. & Di Matteo D.** (2019) “*The transhumance perception: a macro-regional phenomenon in the Mediterranean basin. A comparison between verbal descriptions of the tradition in Calabria and Molise (Southern Italy)*” International Journal of Anthropology 34(3-4):199-211. DOI: 10.14673/IJA2019341051.
- Felix H.** (2005). “Policy Options to Support Transhumance and Biodiversity in European Mountains: A Report on the TRANSHUMOUNT” Stakeholder workshop, Landquart/Zurich, Switzerland, Mountain Research and Development, <https://www.academia.edu/10876805/>
- Ionel Calin M.** (2013) “*From Carpathians to Pindus. Transhumance – a bridge between Romanians and Aromanians*”, Central European Regional Policy and Human Geography, Article no. 2013-3, Year III, no. 1, pp. 27-33 HU ISSN 2062-8870, http://cerphg.unideb.hu/PDF/2013_1/3_calin_nyomda.pdf, HU E-ISSN 2062-8889.
- Rook, A. J., Dumont, B., Isselstein, J., Osoro, K., wallis DeVries, M. F.,**

- Parente, G., & Millsi, J.** (2004). Matching type of livestock to desired biodiversity outcomes in pastures-A review. *Biological Conservation*, 119, 137–150.
- Sezen O, 2(016)**, “*Transhumance in Central Anatolia: A Resilient Interdependence Between Biological and Cultural Diversity*”, Journal of Agricultural and Environmental Ethics ISSN 1187-7863 J Agric Environ Ethics, DOI 10.1007/s10806-016-9613-z.
- Trifu A & Terec-Vlad L**, (2015), “*Understanding the Transhumance and Migration as Phase in the Humanity Cycles*”, International Letters of Social and Humanistic Sciences Online: 2015-11-30 ISSN: 2300-2697, Vol. 63, pp 91-94 doi:10.18052/www.scipress.com/ILSHS.63.91 CC BY 4.0. Published by SciPress Ltd, Sëtizerland, 2015

The application of transhumance, current development approach in the Western Alps, its impact on the creation of seasonal residences

ABSTRACT

Transhumance, is a geospatial phenomenon and a culture non-material treasure, that is very old for the mountain communities in our place. We saw the treatment of this phenomenon as a challenge, but not as an exercised phenomenon, because being residents in Shkodra, it makes as a good economical activity for the community of western Alps. Transhumance is practiced in mountain areas, that have a potential of phisico-geographical elements. Along this, even human factors are impactful elements in this phenomenon. We seek to highlight in this scientific research, these days we are having a more careful look, based on the initiative of researchers from multidisciplinary fields, to make it part of UNESCO. Being a mountainous geospace, with mass population movement in the zone of lowland of Shkodra, the practicing of this phenomenon is an important asset with not only environmental impact, but even human impact. The project's purpose is not only the representation of the influence of human and physical factors, but to highlight the connection of this phenomenon with the nature of the zone, the lifestyle and the creation of a special settlement. Transhumance is not considered without a reason a life philosophy that has to do with the evolution of a special and intelligent life and how it creates a relation with the nature, away from science and technology. This makes it more attractive to enjoy

and try, and where the naturalness personifies every component of this phenomenon

Key words: vertical transhumance, horizontal transhumance, natural diversity, seasonal settlements, etc.

**Elvira BOLLOBANI
Majlinda MUKA**

POTENCIALI NATYROR DHE KULTUROR I BASHKISË KUÇOVË - BAZË E NJË ZHVILLIMI TË QËNDRUESHËM

Hyrje

Potenciali natyror dhe kulturor i bashkisë Kuçovë është i favorshëm për zhvillimin social - ekonomik. Arsyeja e ndërmarrjes së këtij studimi është fakti që kjo zonë pas ndryshimeve administrative nuk ka patur studime të mirëfillta gjeografike, si dhe të njihet bashkia Kuçovë në fokusin e studimeve rajonale. Banorët e Kuçovës nuk duhet të braktisin territorin e tyre dhe të largohen drejt rajoneve më të zhvilluara, por ata duhet të sigurojnë të ardhura në këtë hapësirë, për të siguruar jetesë mesatare duke shfrytëzuar në mënyrë racionale resurset natyrore dhe kulturore. Metodika e përdorur për studimin e bashkisë së Kuçovës është ajo e hulumtimit të literaturës së shkruar, e vrojtimit në terren, fotografimi i dukurive dhe i analizës përkatëse.

1. Pozita gjeografike dhe organizimi administrativ i bashkisë Kuçovë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm

Bashkia Kuçovë shtrihet në pjesën lindore të zonës qendrore të Ultësirës Perëndimore të vendit tonë. Kufiri verior dhe veriperëndimor ndahet nga kodrat e Sulovës dhe lumi Devoll, ndërsa në jug dhe jugperëndim nga rrjedha e poshtme e lumit Osum. Bashkia Kuçovë kufizohet në perëndim dhe jugperëndim me bashkinë e Dimalit, ndërsa në jug dhe juglindje me bashkinë Berat. Në veriperëndim me bashkinë Lushnjë, ndërsa në veri me bashkinë Belsh dhe Cërrik, kurse në lindje dhe pjesërisht në juglindje me bashkinë Gramsh.

Bashkia Kuçovë ka sipërfaqe 160.22 km², ku 3.15 km² e zë zona urbane e qytetit, ndërsa pjesa tjetër e sipërfaqes është hapësira rurale, e cila përbëhet nga 3 njësi administrative, të cilat janë Kozare, Perondi dhe Lumas¹. Njësia administrative Kozare me sipërfaqe 42.87 km², me qendër

¹ Bashkia Kuçovë: *Strategjia e Zhvillimit për Territorin e Bashkisë Kuçovë*, 2016, f. 16.

në fshatin Havaleas, i cili ndodhet rreth 3 km nga qyteti i Kuçovës². Në këtë njësi përfshihen fshatrat Kozare, Ferras Kozare, Salcë Kozare, Vlashuk, Demollarë, Fier Mimar, Zdravë, Gegë, Drizë dhe Frashër. Njësia administrative Perondi me sipërfaqe 37.79 km², me qendër në fshatin po me të njëjtin emër³. Fshatra të tjerë që përfshihen në këtë njësi administrative janë Magjatë, Tapi, Goraj Rreth Tapi dhe Polovinë. Dy njësitë administrative Kozarë dhe Perondi kanë qenë pjesë e rrethit Kuçovë, ndërsa njësia administrative ka qenë pjesë e rrethit të Beratit, por me reformën administrative të vitit 2014 ka kaluar në varësi të bashkisë Kuçovë. Vetë




Figura 1. Pozicioni i bashkisë Kuçovë në Republikën e Shqipërisë

² Bashkia Kuçovë: *Strategjia e Zhvillimit për Territorin e Bashkisë Kuçovë*, 2016, f. 17.

³ Po aty, f. 17.

(Punoi E. Bollobani)



Figura 2. Harta administrative e bashkisë Kuçovë (Punoi E. Bollobani)

Kuçova deri në vitin 1990 ka qenë bashkë me rrethin e Beratit. Njësia administrative Lumas ka një sipërfaqe 76.41 km² me qendër në fshatin po me të njëjtin emër, si dhe përfshin fshatrat Luzaj, Pëllumbas, Katundas, Zelevizhdë, Belesovë, Mëndrakë, Sheqëz, Bardhaj, Pashtraj, Vodëz, Krekëz dhe Koritëz⁴. Kuçova është e vetmja qendër urbane dhe njëkohësisht qendra administrative e bashkisë, po me të njëjtin emër. Në nder të miqësisë shqiptaro-sovjetike, më 10 korrik 1951, Kuçovës i'u ndërrua zyrtarisht emri në Qyteti Stalin. Këtë emër qyteti e mbajti deri më 1990, kur rimori përsëri emrin Kuçovë.

Bashkia ndodhet midis Beratit dhe Lushnjës, si dhe krijon tërthore Berat -Lushnje, por komunikon drejtpërdrejt me qytetin e Dimalit në pjesën hyrëse të tij. Zgjerimi dhe rikonstruksioni i rrugës Grekan (Belsh) – Kozarë (Kuçovë) me gjatësi 13.5 km solli shkurtimin Kuçovë – Elbasan – Tiranë, u ka krijuar mundësi banorëve të zonës të lëvizin për qëllime të ndryshme tregtare - shëndetësore etj., drejt kryeqytetit, duke i dhënë mundësi për një

⁴ Bashkia Kuçovë: *Strategjia e Zhvillimit për Territorin e Bashkisë Kuçovë*, 2016, f. 17.

zhvillim të qëndrueshëm zonës në studim.



Foto 1. Bulevardi (E. Bollobani)

Foto 2. Qyteti i Kuçovës (E. Bollobani)

2. Kushtet natyrore dhe rëndësia e tyre në zhvillimin e qëndrueshëm të bashkisë Kuçovë

2.1. Ndërtimi gjeologjik dhe relievi

Me pozitën gjeografike lidhet njëkohësisht shtrirja e truallit të zonës Kuçovë në zonën tektonike Jonike, me veçoritë karakteristike të përbërjes litologjike e strukturore, të cilët kanë përcaktuar format e relievit krahas pasurisë së vendburimeve të naftës. Ndërtimi gjeologjik i zonës së Kuçovës është i larmishëm. Formacionet përbërëse në territorin e saj janë; formacioni molasik me dy cikle sedimentimi, në ciklin e Miocenit të Sipërm e të Mesëm dhe cikli Pliocenik⁵. Depozitimet e Miocenit të Sipërm përfaqësohen nga ranorë masivë me ndërshtresa argjilore dhe janë vazhdim gradual i depozitimeve Tortoniane në suitën e Kuçovës, e cila lidhet me vendburimet e naftës⁶. Vendburimi i naftës në Kuçovë është më i vjetri në vendin tonë. Që nga viti 1800 territori shfrytëzohej për naftën që dilte me vetërrjedhje, e cila u shitej tregtarëve myzeqarë si vaj grasatues dhe për djegie. Në vitin 1927 u zbulua nga italianët, ndërsa në 1928 u shpua dhe dha naftë pusi i parë në Shqipëri. Vendburimi i Kuçovës u shfrytëzua deri në vitin 1943 nga shoqëria italiane AIPA, e cila kishte bërë marrëveshje me qeverinë e mbretit Zogu I⁷. Ngritja e industrisë së nxjerrjes së naftës në Kuçovë në vitet '30 të shekullit XX e në vazhdim pati pasoja sociale, ekonomike dhe mjedisore. Prania e shtresave naftëmbajtëse dhe fillimet e shfrytëzimit të saj kushtëzuan kalimin dora - dorës të Kuçovës nga një fshat

⁵ Aliaj, Sh.: *Neotektonika e Shqipërisë*, Tiranë, 2012, f. 76.

⁶ Aliaj, Sh.: *Neotektonika e Shqipërisë*, Tiranë, 2012, f. 86.

⁷ Bashkia Kuçovë: *Strategjia e Zhvillimit për Territorin e Bashkisë Kuçovë*, 2016, f. 38.

i zakonshëm në një qytezë industriale, pas vitit 1928. Shfrytëzimi i naftës sidomos në vitet 1975 - 1990 e shndërroi Kuçovën në qytetin e parë të industrializuar në vend. Në qytet u ngritën 15 ndërmarrje të rëndësishme, si: uzina e Përpunimit të Naftës, Shpim-Shfrytëzimi, ndërmarrja e Nxjerrjes së Naftës, TEC-i, shkolla e Mesme e Naftës etj. Sot nafta shfrytëzohet nga Bankers Petroleum pas një marrëveshje të vitit 2007 me afat 30 vjet⁸.

Ruajtja e nëntokës mbetet sfidë për bashkinë e Kuçovës, për shkak të shfrytëzimit për një kohë relativisht të gjatë të vendburimit të naftës. Zona ka një fond prej 1700 pusesh, ku deri më sot janë shfrytëzuar deri në 5 % të rezervave gjeologjike dhe 32 % të rezervave industriale⁹. Zona naftëmbajtëse e Kuçovës është e ndotur me hidrokarbure, ku dallohet Kozarja me një ndotje shumë më të lartë, e cila ka ardhur si rezultat i përdorimit të teknologjisë së vjetër të përdorur për nxjerrjen e naftës. Nëntoka e pasur me naftë i jep prioritet zhvillimit ekonomik të zonës sot dhe në ardhmen.



Foto 3. Puset e naftës (M. Muka) Foto 4. Depozitat e naftës (M. Muka)

Zona kodrinore e bashkisë Kuçovë ndërtohet nga depozitime flishore të Oligocenit të Poshtëm, nga gëlqerorët mergelorë të Eocenit dhe nga molasa. Përhapje kanë flishet dhe depozitimet e Kuaternarit në kodrat e Lumasit, si dhe dalje në sipërfaqe të shkëmbinjve gëlqerorë në kodrat e Luzajve dhe të Katundasit¹⁰.

Nga pikëpamja e relievit zona në studim shtrihet në juglindje të Ultësirës Perëndimore. Këtu bëjnë pjesë zona fushore e qytetit të Kuçovës dhe disa fshatra të njësisë Perondi, të cilat përfshihen në Myzeqenë e Beratit, që është pjesë e Myzeqesë së Madhe. Territori i njësisë

⁸ Bashkia Kuçovë: *Strategjia e Zhvillimit për Territorin e Bashkisë Kuçovë*, 2016, f. 17.

⁹ Hoxha, R.: *Industria e naftës në Kuçovë dhe sfidat e zhvillimit*, Studime gjeografike 19, Tiranë, 2015, f. 165.

¹⁰ Grup autorësh.: *Gjeografia Fizike e Shqipërisë*, ASHSH, vol II, Tiranë, 1991, f. 518.

administrative Kozarë shtrihet përgjatë luginës së Devollit të Poshtëm, në sektorin e dytë Gostimë - Kozarë, në krahun e majtë të saj. Lugina ndërtohet nga formacionet flishore të Paleogjenit. Lugina shtrihet në lartësinë 95 - 6 m. Copëtimi horizontal i luginës në këtë sektor është mesatar ($1 - 3 \text{ km/km}^2$). Energjia e relievit arrin vlerat 100 m/km^2 – Kozarë deri në 200 m/km^2 – Frashër¹¹.

Territorin lindor të bashkisë e zë njësia administrative Lumas, territori i së cilës është pjesë e kodrave të Sulovës, të cilat kanë përbërje gjeologjike të larmishme, flishe, gëlqerorë dhe terrigjenë. Në zonën kodrinore të bashkisë Kuçovë dallojmë këto vargje kodrinorë: Perondi – Velagosht -Luzaj, ku maja më e lartë është ajo e Gereçit me 445 m në Luzaj, si dhe vargun kodrinor Koritëz - Zelevizhdë - Mëndrakë - Belesovë, të cilat shkojnë deri mbi 650 m lartësi në lindje të Zelevizhdës¹².

Në këtë territor dallohen tipe të relievit lumor, erozivo – denudues dhe karstik në sistemin kodrinor Lumas - Pëllumbas - Katundas. Kanionet e Sinecit ose të Katundasit me gjatësi rreth 2 km, thellësi nga disa dhjetëra m deri në 200 – 250 m dhe gjerësi rreth 10 – 15 m¹³.



Foto 5. Kodrat dhe ujëmbajtësi i Belesovës



Foto 6. Kodrat e Lumasit (E.Bollobani)

Këto kanione janë formuar tërthor strukturës antiklinale të Sulovës duke nxjerrë në sipërfaqe bërthamën e saj (strukturës). Përroi i Katundasit në këtë grykë të thellë ka formuar disa pragje e ujëvara interesante. Këtu afër është dhe shpella e Katundasit e ndodhur pranë kanionit të Sinecit në lartësinë 405 m paraqet vlera të veçanta¹⁴. Nga vendasit njihet me emrin shpella e Xhërxhillës. Gjatësia e saj horizontale aktualisht 54 m e me lartësi

¹¹ Grup autorësh: *Gjeografia Fizike e Shqipërisë*, ASHSH, vol II, Tiranë, 1991, f. 513.

¹² *Harta topografike e Qarkut Berat*, me shkallë 1: 50000.

¹³ Grup autorësh.: *Gjeografia Fizike e Shqipërisë*, ASHSH, vol II, Tiranë, 1991, f. 522.

¹⁴ Belli, P., Starova, S.: *Vendbanimi shpellor i Katundasit*, Iliria Nr. 1, 1983 f. 79.

deri me 6 m të befason nga një bukuri mahnitëse. Gërmimet arkeologjike u përqendruan në qendër të saj, ku dolën horizonte të shumta banimi që shkojnë deri në thellësinë 3.4 m. Materialet e gjetura i takojnë periudhës së Neolitit. Në materialet prej guri të neolitit të hershëm janë disa ashkla në formë gërryesesh apo thikash. Në shtresën fundore, ku doli neoliti i hershëm, është gjetur dhe vatra e zjarrit e vendosur në qendër të shpellës. Në neolitin e vonë me shumicë janë gjetjet interesante të lopatave tip kallëp këpucë, ajo në formë gjuhe dhe dalte guri. Gjithashtu në shpellë janë gjetur materiale qeramike të Epokës së Bronzit dhe të Hekurit. Në sipërfaqen e brendshme të saj, e cila është rreth 350 m², ka mjedise interesante, si: dhoma, paradhoma, salloni qendror e shumë galeri e labirinte. Në këtë mjedis të bollshëm që ka dy hyrje ku më kryesorja është hyrja e dytë, e cila ndahet në dy degëzime dhe me një dritare ku qarkullon ajri¹⁵.



Foto 7. Kanioni i Sinecit (E.Bollobani)

¹⁵ Belli, P., Starova, S.: *Vendbanimi shpellor i Katundasit*, Iliria Nr. 1, 1983, f. 80.

Kanioni i Sinecit dhe shpella e Katundasit janë destinacioni atraktiv si për turistët vendas dhe ata të huaj, të cilët vijnë këtu si amatorë dhe të apasionuar pas natyrës. Këtu është ngritur dhe një lokal shërbimi. Zgjerimi dhe asfaltimi i rrugës që të çon në Sinec do të shtonte numrin e vizitorëve në këtë perlë të natyrës shqiptare, si dhe jep impakt zhvillimi i njesisë Lumas.

2.2. Klima

Ndër treguesit fiziko - gjeografikë, rëndësi paraqesin dhe kushtet klimatike, të cilat lidhen me relievin kryesisht kodrinor - fushor të zonës dhe sidomos me ndryshimet e dukshme të lartësive. Në tiparet e klimës ka ndikuar gjithashtu, pozita gjeografike e bashkisë, lidhja e hapur me perëndimin, nëpërmjet pjesës së poshtme të luginës së Devollit etj. Këta faktorë kanë kushtëzuar tiparet e një klime mesdhetare fushore e kodrinore, me dimër të butë e të lagësht e verë relativisht të nxehtë e të thatë. Temperatura mesatare vjetore e ajrit është 15.5°C në qytetin e Kuçovës, ndërsa në brendësi të zonës kodrinore, temperatura mesatare vjetore e ajrit mund të arrijë $2 - 3^{\circ}\text{C}$ më pak. Maksimumi i temperaturës është regjistruar në 18.07.1973 me 43.9°C në qytetin e Kuçovës, si dhe po këtu është arritur minimumi absolut me $- 11.2^{\circ}\text{C}$ ¹⁶. Këto vlera ekstreme kanë ndikim të dukshëm në bimësinë natyrore dhe kulturat e mbjella, por edhe në proceset e copëtimit të shkëmbinjve sipërfaqësorë. Territori i bashkisë merr një sasi reshesh vjetore prej 927.6 mm reshje shiu në qytetin e Kuçovës, ndërsa në brendësi të zonave kodrinore shkon deri në 1208.9 mm shi¹⁷. Ndryshimi prej 218.3 mm, ka të bëjë drejtpërdrejt me ndryshimin hipsometrik. Masat ajrore me lagështirë vijnë nga perëndimi duke u përplasur në lartësitë e kodrave të Lumasit, Belesovës, Mëndrakës etj. Gjatë gjysmës së ftohtë të vitit bien mbi 65 % të shumës vjetore të reshjeve. Reshjet në trajtë bore bien rrallë, në rreth 2-3 ditë në vit dhe nuk formojnë shtresë të qëndrueshme, ndërsa dhe ditët me ngrica janë të pakta. Klima e kësaj bashkie është një përbërës natyror që ndikon në zhvillimin e saj, pasi krijon kushte të përshtatshme për kulturat bujqësore. Sasia e reshjeve dhe amplituda vjetore e temperaturës kanë rolin pozitiv e të rëndësishëm të klimës në zhvillimin e bujqësisë në territorin rural të kësaj bashkie.

Energjia diellore përbën një burim alternativ energjie që duhet të përdoret në territorin e Kuçovës, e cila ndodhet ndërmjet izolinjave 1450 – 1500 KW/m² në vit. Kjo energji sot shfrytëzohet në nivel kombëtar 0.1 %

¹⁶ Sala, S.: *Sulova, gjeomorfologjia, mjedisi dhe njerëzit*, Tiranë, 2007, f. 24.

¹⁷ Po aty, f. 24.

dhe shfrytëzohet për prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar dhe në mënyrë individuale me panele fotovoltaike.

2.3. Hidrografia

Territori i bashkisë ka një rrjet hidrografik të pasur. Kjo kushtëzohet nga pasuritë e elementeve klimatike, ndërtimi gjeologjik dhe në veçanti nga veçoritë e relievit. Rrjeti hidrografik përfshin lumenjtë Devoll dhe Osum, si dhe përrenjtë që derdhen në këta lumenj. Arteria kryesore në këtë bashki është rrjedhja e poshtme e lumit Devoll, me gjatësi 12.5 km, ku derdhen në këtë territor përrenj të vegjël, si ai i Gegës, i Frashërit etj. Në lumin Osum me 3.9 km gjatësi në këtë zonë, derdhen përrenjtë e Lushës, e Gjylyvanit dhe Lapardhasë. Në këtë të fundit, në pjesën e sipërme të tij i ka fillesat nga përrenjtë e vegjël të Pëllumbasit, Luzajve dhe Katundasit, të cilët derdhen në përroin e Lumasit, ndërsa në pjesën e mesme quhet përroi i Bardhajve dhe në pjesën e poshtme njihet me emrin si përroi i Lapardhasë, sipas territorit të fshatrave ku ai kalon.

Këta përrenj dallohen për pjerrësi mesatare deri të lartë të shtratit, luhatje të theksuar të prurjes ujore gjatë vitit dhe aftësi të madhe gërryese e transportuese, si dhe janë të shkurtër, disa prej tyre arrijnë deri në 5 - 6 km gjatësi. Kanë shtrat të ngushtë e të papërpunuar mirë dhe profil gjatësor të shkallëzuar, përjashtim bën përroi i Lumasit, i cili dallohet për shtrat të gjerë.

Burimet ujore kryesore janë Sinecit, Katundasit, Pëllumbasit, Luzajt, Mëndrakës, Koritëzës, Belesovës, ndërsa zona fushore ka puse, të cilat furnizojnë me ujë fshatrat. Vetë qyteti, Perondia e Kozarja marrin ujë nga burimi i Bogovës në Poliçan. Në këtë territor janë ndërtuar disa ujëmbledhësa, si në: Salcë Kozarë, Goraj, Drizë, Gegë, Lumas, Luzaj, Sheqëz, Belesovë etj. Më i madhi nga të gjithë këta ujëmbajtës, është ai i Belesovës. Ndërtimi i tij nisi në vitin 1971 dhe përfundoi në vitin 1977, me sipërfaqe 30 ha, ndërsa thellësia në fillim ishte 27 - 30 m, ndërsa tani është zvogëluar shumë nga mbushja me materiale të ngurtë. Dy digat e ndërtuara në dy përrenjtë kryesorë që ushqejnë këtë ujëmbajtës: përroi i Mëndrakës dhe ai i Mullirit, që prej 25 vjetësh kanë dalë jashtë funksionit të tyre, madje e para është çarë plotësisht nga rrjedhja ujore¹⁸. Sipas banorëve që peshkojnë me varka në ujëmbajtësin e Belesovës, thellësia e tij më e madhe është rreth 8 - 9 m. Këtu janë instaluar dy hidrocentralë të vegjël.

Rrjeti hidrografik ka rëndësi në zhvillimin e zonës, sidomos në aspektin bujqësor. Uji i liqeneve artificiale është përdorur gjerësisht për

¹⁸ Sala, S.: *Sulova, gjeomorfologjia, mjedisi dhe njerëzit*, Tiranë, 2007, f. 28.

ujitje gjatë regjimit komunist. Pas vitit 1997, përdorimi i tyre është kufizuar, pasi është dëmtuar shumë rrjeti i kanaleve. Për ujitje banorët e fshatrave të njësisë administrative Lumas përdorin ujin e burimit të Sinecit. Banorët e fshatrave të njësisë administrative Kozarë shfrytëzojnë gjerësisht për ujitje të kulturave bujqësore ujërat e lumit Devoll, por dhe rezervuarët në Salcë Kozarë e Fier Mimar.

2.4. Tokat

Me kushtet klimatike, përbërjen litologjike dhe tiparet e relievit lidhet ngusht dhe tipi i tokave të kësaj bashkie. Kushtet e relievit kodrinor, ndërtimi gjeologjik (terrigjenë dhe më shumë flish), kushtet e klimës mesdhetare fushore -kodrinore, si dhe bimësia e shkurreve dhe e dushkut janë faktorët kryesorë natyrorë, që kanë kushtëzuar tipin e tokave në këtë zonë. Tokat aluvionale janë të përhapura në rrjedhën e poshtme të lumit Devoll dhe Osum, të cilat shtrihen nga 50 deri në 100 m. Këto toka janë formuar mbi aluvionet e lumenjve Devoll dhe Osum dhe kanë ndërtim shtresor, si rrjedhim i depozitimeve të herëpashershme gjatë vërshimeve dhe përmytjeve të tyre në të kaluarën. Këto toka janë të trasha (rreth 40 cm), por poshtë kësaj trashësie dalin zhavorret e trasha¹⁹. Megjithëse janë të shkrifta, për shkak të pjerrësisë dhe lartësisë absolute shumë të vogël. Këto toka mbajnë shumë lagështirë, sidomos gjatë stinës së dimrit. Në këto toka shtrihen fshatrat e njësisë administrative Kozarë (Havaleas, Kozarë, Ferras -Kozarë, Salcë- Kozarë, Fier Mimar, Zdravë, Vlashuk), si dhe fshatrat Perondi, Tapi e Rreth Tapi. Në territorin e bashkisë Kuçovë më të përhapura janë tokat e hirta kafe, të cilat më shumë janë vendosur në lartësitë deri në 500 m. Formohen në ato territore, ku në sipërfaqe dalin shkëmbinjtë flishorë, molasikë, më pak gëlqerorët, por edhe në deluvionet dhe proluvionet në shpatë²⁰. Këto toka kanë kryesisht reaksion asnjës, përbërje subargjilore të lehtë deri në mesatare me strukturë granulo – kokrrizore, e cila lejon depërtimin e rrënjëve të bimëve në thellësi. Ky tip toke është i varfër në azot dhe fosfor, por ka shumë potas. Shtrirjen më të gjerë ky rrip toke e ka në kodrat e fshatrave Gegë, Drizë, Magjatë Tapi, Goraj, Velagosht, Polovinë, Lumas, Krekëz, Sheqëz, Bardhaj etj.

Sipërfaqe më të kufizuar kanë tokat e kafenjta, të cilat i takojmë në bimësinë e dushkut, në klimë mesdhetare kodrinore, në shkëmbinjtë molasikë dhe flishorë, por edhe në ato gëlqerorë. Këto toka janë pjellore dhe shtrirjen më të madhe e kanë në fshatrat Luzaj, Katundas, Zelevizhdë,

¹⁹ Grup autorësh.: *Gjeografia Fizike e Shqipërisë*, ASHSH, vol II, Tiranë, 1991, f. 446.

²⁰ Sala, S.: *Sulova, gjeomorfologjia, mjedisi dhe njerëzit*, Tiranë, 2007, f. 29.

Belesovë, Mëndrakë.

Tokat bujqësore përbëjnë 52 % të territorit, me sipërfaqe të përgjithshme prej 84 km²²¹. Kjo sipërfaqe toke përdoret për kultivimin e drithërave, foragjereve, bimëve industriale, pemëve frutore, ullinjve në të tre njësitë administrative Lumas, Perondi e Kozarë, ndërsa agrumet në Perondi e Kozarë. Në gjendjen se si po ecën përdorimi i tokës duket se rreziku i dëmtimit të saj është i madh dhe kjo gjë ndikon në zhvillimin ekonomik të zonës. I takon shtetit, me politikat kombëtare dhe ato rajonale, të rrisë më shumë kujdesin për tokën, përdorimin e saj sa më korrekt dhe në mënyrë shkencore, në mënyrë që të shfrytëzohet sa me më shumë efikasitet, si një mundësi për zhvillim të qëndrueshëm.

2.5. Bimësia

Kushtet klimatike, litologjike e pedologjike, por edhe veçoritë e relievit të kësaj bashkie kanë përcaktuar një mbulesë bimore të pasur në lloje, e të shtrirë në sipërfaqe të konsiderueshme. Brezi i dushkut më shumë se 70 - 80 vjet më parë ka pasur shtrirjen më të gjerë në të gjithë territorin kodrinor, gjë e cila dëshmohet edhe nga banorë më të moshuar, apo drurë të mbetur të ish-pyllit të dushkut. Kushtet klimatike janë shumë të përshtatshme për rritjen e dushkut, veçanërisht të lisit. Shkaku i zvogëlimit të vazhdueshëm të sipërfaqes së pyllit, ka qenë përdorimi pa kriter i tij nga njeriu, kryesisht për dru zjarri, lëndë ndërtimi, për ushqim për blegtorinë në stinën e dimrit etj. Tashmë ruhen sipërfaqe të kufizuara pylli dushku në kodrat e Mëndrakës, Katundasit, Luzajt etj. Në fakt në këto fshatra, popullsia është më e pakët në numër dhe rrugët e komunikacionit nuk e kanë favorizuar shumë depërtimin e popullsisë të fshatrave përreth deri në këto kodra. Këto 13 - 15 vitet e fundit, pylli i dushkut po ndjen ripërtëritje të dukshme, ku faktori kryesor i kësaj ripërtëritje është largimi i popullsisë fshatare drejt territoreve më të ulëta. Brezi i shkurreve mesdhetare (makie dhe shibljak), i cili në shumë shpate kodrash është nënkat i pyllit të dushkut të degraduar. Sipërfaqet më të mëdha prej tyre janë në lartësitë e mëdha të relievit dhe në shpate me pjerrësi të madhe dhe disi larg qendrave të banuara. Brezi i shkurreve shtrihet në kodrat e Gegës, Drizës, Pëllumbasit, Koritëzës, Krekëzës etj.

²¹ Bashkia Kuçovë.: *Strategjia e Zhvillimit për Territorin e Bashkisë Kuçovë*, 2016, f. 57.

3. Potenciali kulturor i bashkisë Kuçovë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm

Pasurisë natyrore, i shtohet dhe trashëgimia kulturore (materiale dhe shpirtërore) e kësaj zone. Kjo lidhet me popullimin e hershëm të kësaj treve, me ruajtjen dhe përcjelljen e këtyre traditave e zakoneve deri në ditët e sotme. Zbulimet arkeologjike të kryera në zonë kanë evidentuar shumë objekte të periudhës së Neolitit në “Vendbanimi shpellor i Katundasit”. Në këtë objekt duken qartë gjurmët e një vendbanimi Neolitik, Eneolitik etj. Këto të dhëna argumentojnë që kjo zonë ka një popullim të hershëm dhe reflekton një kulturë e histori të vjetër.

Kalaja e Gurit ndodhet në lindje të fshatit Mëndrakë. Për herë të parë është identifikuar nga studiuesi Petrit Basha dhe ka formën e një trekëndëshi të çrregullt të zgjatur, me sipërfaqe 0.7 ha²².

Fragmentet e mureve kanë lartësi të ndryshme që shkojnë nga 20 deri në 40 cm, ndërsa trashësia e tyre është mbi 0.5 - 1 m. Ndërtimi i kësaj kështjelle daton në IV - VI, në periudhën e antikitetit të vonë²³.

Kisha e Shën Kollit

Është një monument i trashëgimisë kulturore në Perondi, Kuçovë, është 18 kilometra në veri të Beratit dhe konsiderohet si një nga monumentet bizantine më të hershme në Shqipëri. U ndërtua në shekullin XI si bazilikë me tri nefe, me çati druri dhe me ambientin e altarit të mbuluar me qemer²⁴. Në një periudhë të dytë kishës i'u shtua narteksti dhe kambanarja. Më vonë i'u bë një rrethim me kjustër. Një meremetim i rëndësishëm ishte ai i vitit 1786, kur u rindërtua çatia dhe iu shtuan harqe. Pastaj një meremetim i'u bë në vitin 1931, dhe së fundmi një tjetër në 1970, nga specialistët e Institutit të Monumenteve²⁵. Edhe pse ka pasur shumë meremetime në shekuj, vjetërsia e saj duket qartë.

²² Basha, P.: *Gjurmë fortifikimesh mesjetare në Gramsh*, Monumentet 1, 1986, f. 157.

²³ Basha, P.: *Gjurmë fortifikimesh mesjetare në Gramsh*, Monumentet 1, 1986, f. 157 - 159.

²⁴ Meksi, A.: *Arkitektura dhe restaurimi i kishës së Perondisë*, Monumentet 5 - 6, Tiranë, 1973, f. 19, 39.

²⁵ Meksi, A.: *Arkitektura dhe restaurimi i kishës së Perondisë*, Monumentet 5 - 6, Tiranë, 1973, f. 19, 39.



Foto 8. Kisha e Shën Kollit në fshatin Perondi (M. Muka)

Kisha e Shën Marisë në Kozarë

Kisha e Ungjillëzimit (Shën Marisë) ndodhet në fshatin Kozarë të Kuçovës. Është një kishë e tipit bazilikal. Sipas mbishkrimeve është ndërtuar në dy faza. Ndërtimi i parë, Naosi dhe Bema i takon vitit 1768. Në vitin 1791 i janë shtuar ambienti i Narteksit dhe një hajat me një arkadë të ulët në anën jugore që dëshmohet nga mbishkrimi i lënë në faqen perëndimore. Në pjesën jugore të kishës ndodhet portiku i përbërë nga 8 kolona në formë rrethore prej guri ku mbështeten arkadat, interkolumni këtu është rreth 1m. Narteksi i kishës paraqitet një kuadrat në formë drejtkëndëshi me përmasa (10.7 x 5.8 m)²⁶.

²⁶ Meksi, A.: *Arkitektura e kishave në Shqipëri*, Tiranë, 2004.

Struktura ndahet në dy ambiente nëpërmjet një kolonade të përbërë nga tri kolona në formë katrore. Në të dyja anët e narteksit ndodhen dy ambiente të tjera shërbimi. Ndërsa në anën veriore të kishës ndodhet një ambient shërbimi me përmasa (18.8 x 3.2 m) i cili shkon paralelisht me drejtimin lindje-perëndim të monumentit. Në pjesën Jugore ndodhet edhe kambanorja e kishës. Kisha e Ungjillëzimit së Kozarës spikat së tepërmi për vlerat që prezanton ruajtja në një gjendje të mirë e afreskut mural, i cili shtrihet në gjithë sipërfaqen e brendshme të mureve.



Foto 9. Kisha e Shën Marisë në fshatin Kozarë (Instituti i Monumenteve të Kulturës)

Këto objekte të trashëgimisë kulturore duhet të restaurohen dhe vihen në destinacionet e turistëve që kanë në fokus vizitat në objektet e kultit. Ndalesë për turistët është dhe Aerodromi i Kuçovës.

Aerodromi i Kuçovës

Baza ajrore në Kuçovë u krijua në vitin 1939. Projektimi dhe ndërtimi i saj u bë nga italianët, pasi fusha e aviacionit, e cila ishte deri atëherë në Otlak, nuk i plotësonte kushtet për një rikonstrukcion dhe ishte larg prej puseve të naftës. Në prill të vitit 1951 u krijua Regjimenti i Aviacionit Ushtarak Shqiptar, si një formacion i fuqishëm kombëtar; ndërsa më 15 maj 1955 u themelua regjimenti i aviacionit, i koduar “Peza 23”. Në këtë kohë erdhën nga Bashkimi Sovjetik edhe avionët e parë Mig-15 dhe më pas, me radhë: avionët Mig-17, Mig-19 dhe Jak-18, të cilët ishin më modernët e kohës²⁷.

Pas prishjes së marrëdhënieve të Shqipërisë me BRSS, e gjithë baza ajrore u gjend në vështirësi, si për pjesë këmbimi, ashtu edhe për karburant. Në vitin 1967-68 u ndërtua këtu uzina e riparimit të avionëve, e cila u bë edhe baza kryesore e shërbimit për ta. Uzina arriti të prodhojë me sukses pjesë këmbimi, sikundër edhe të bënte riparime komplet të avionëve luftarakë. Ndërsa në bashkëpunim me specialistët vendas, u arrit të prodhohej nafta TS1, e destinuar për fluturimin e avionëve. Në nëntor të vitit 2001 filloi rikonstrukcioni i bazës ajrore në përputhje me standardet e NATO-s, në një bashkëpunim shqiptaro-turk. Pista e sotme ka një sipërfaqe prej 30.000 m², ndërsa rrugët lidhëse ndërmjet fundit dhe kreut të saj, kanë një sipërfaqe prej afro 20.000 m² ²⁸.

PËRFUNDIME

Bashkia Kuçovë shtrihet në lindje të Ultësirës Perëndimore dhe është zona më e pasur me naftë në vendin tonë, por dhe më e ndotura. Ndërtimi gjeologjik i Kuçovës është i larmishëm, ku dallohen depozitimet e Miocenit të Sipërm, të cilat përfaqësohen nga ranorë masivë me shtresa argjilore që përbëjnë suitën e Kuçovës, e cila lidhet me vendburimet e naftës. Shfrytëzimi i naftës në këtë zonë e ktheu Kuçovën nga një fshat që ishte para Luftës së Dytë Botërore, në qytetin kryesor industrial të vendit në vitet 1945 - 1990. Disa prej ndërmarrjeve pas vitit 1990 u mbyllën, fenomen që solli rritje të papunësisë, si dhe largim të popullsisë. Industria e naftës ka rolin parësor në ekonominë e bashkisë Kuçovë, por edhe të vendit, pasi ka një numër të konsiderueshëm punonjësish, si dhe të ardhurat që siguron shteti nga kjo industri.

²⁷ Bashkia Kuçovë: *Strategjia e Zhvillimit për Territorin e Bashkisë Kuçovë*, 2016, f. 65.

²⁸ Bashkia Kuçovë: *Strategjia e Zhvillimit për Territorin e Bashkisë Kuçovë*, 2016, f. 65.

Zona shtrihet midis rrjedhjeve të poshtme të lumenjve Devoll dhe Osum, si dhe në kodrat e Sulovës. Banorët janë mikpritës dhe punëtorë dhe i kanë kthyer kodrat në brezare me ullinj, duke siguruar të ardhura nga shitja e ullirit. Shumë banorë kanë mbjellë sipërfaqe të konsiderueshme me perime në sera, të cilat i tregtojnë dhe drejt kryeqytetit.

Në këtë territor ndodhet dhe një nga perlat e natyrës shqiptare kanioni i Sinecit, që gëzon statusin e mbrojtjes së monumentit të natyrës të kategorisë së tretë. Afër tij ndodhet shpella e Katundasit, që është një nga vendbanimet më të hershme në vendin tonë.

Në fshatin Perondi ndodhet një nga kishat më të hershme bizantine në vendin tonë, ajo e Shën Kollit, të cilën e vizitojnë shumë turistë të apasionuar pas objekteve religjioze. Kisha e Shën Marisë në fshatin Kozarë dallohet për afreskun mural që shtrihet në të gjithë sipërfaqen e mureve dhe ruhet në gjendje të mirë.

Bashkia Kuçovë ofron resurse natyrore dhe kulturore për mundësi të mira jetesë për banorët, por shfrytëzimi i tyre duhet të bëhet me efikasitet që të ketë një zhvillim të qëndrueshëm.

REKOMANDIME

Përmirësimi i aksit rrugor Kuçovë - Frashër - Gostimë, që lidh Kuçovën me Gramshin u krijon mundësi banorëve të shkojnë më shpejt jo vetëm drejt Gramshit, por dhe Korçës dhe Greqisë.

Ndërtimi i një aksi rrugor që të lidhë njësinë administrative Lumas me qytetin e Kuçovës, do të shkurtonte distancën dhe me kryeqytetin.

Specialistët e mjedisit në bashkinë e Kuçovës duhet të kryejnë një studim të detajuar, për nivelin e ndotjes së ujit, tokës dhe të ajrit, gjithashtu dhe një plan masash urgjente, për të minimizuar situatën.

Duhet të rritet shfrytëzimi i energjisë diellore, duke ulur në minimum përdorimin e energjisë elektrike, pasi Kuçova ka potenciale të larta të energjisë.

Investime duhet të bëhen në rindërtimin e kanaleve ujitëse jo vetëm në lumin Devoll, por edhe në ujëmbledhësit, të cilët janë jashtë funksionit.

LITERATURA

1. Aliaj, Sh.: *Neotektonika e Shqipërisë*, Tiranë, 2012.
2. Baçe, A.; Meksi, A., Riza, E.; *Berati, historia dhe arkitektura*, Tiranë, 1987.
3. Basha, P.: *Gjurmë fortifikimesh mesjetare në Gramsh*, Monumentet 1, 1986, f. 157 - 159.
4. Bashkia Kuçovë.: *Strategjia e Zhvillimit për Territorin e Bashkisë Kuçovë*, 2016.
5. Belli, P., Starova, S.: *Vendbanimi shpellor i Katundasit*, Iliria Nr. 1, 1983.
6. Grup autorësh.: *Gjeografia Fizike e Shqipërisë*, ASHSH, vol II, Tiranë, 1991.
7. Grup autorësh.: *Harta gjeologjike e Shqipërisë dhe teksti sqarues Gjeologjia e Shqipërisë*, Tiranë, 1983.
8. *Harta topografike e Qarkut Berat*, me shkallë 1: 50000.
9. Hoxha, R.; *Industria e naftës në Kuçovë dhe sfidat e zhvillimit*, Studime gjeografike 19, Tiranë, 2015.
10. Meksi, A., *Arkitektura dhe restaurimi i kishës së Perondisë*, Monumentet 5 – 6, Tiranë, 1973, fq. 19, 39.
11. Meksi, A.; *Arkitektura e kishave në Shqipëri*, Tiranë, 2004.
12. Sala, S.; *Sulova, gjeomorfologjia, mjedisi dhe njerëzit*, Tiranë, 2007.

**The natural and cultural potential of the municipality of Kucovo are
the basis of a sustainable development**

ABSTRACT

Achieving sustainable development is already a global trend, where each country is making efforts with relevant policies to achieve this goal. Natural and human resources are the main vital resource of a country, which ensure a comprehensive and continuous development for that community. country. The Municipality of Kuçova is distinguished for its great natural resources, but also for its cultural resources which, if well managed, will help in the sustainable development of the Kuçova area.

In this paper we treat the natural and cultural potential as an opportunity for sustainable development. Sustainable development relies on managing economic, social resources and environments in a way that complements each other, while preserving cultural integrity, ecological aesthetic processes, biological diversity and promoting social life in the area.

The article evaluates natural resources for sustainable development. The paper aims to sensitize the central and local government bodies, in drafting the most efficient strategies for the development of priority branches, so that this forgotten area receives due attention. The issues are treated in an original way and in the methodological and practical plan,

they form the basis for the development of the area. For the realization of the article, written sources were used, information provided in the field, the city of Kuçova, as well as in the villages of the administrative units of this municipality.

On the basis of the analysis, it is intended to give concrete recommendations on the possibilities of perspective development of the area, in order to achieve sustainable development.

Key words: natural potentials, cultural potentials, complex and sustainable development.

NEKROLOGJI
Prof. as. dr. Nevila DIBRA
(1969 – 2022)



Më 26 qershor 2022, në moshën 53- vjeçare, pas një sëmundjeje të rëndë, ndërroi jetë kolegja dhe mikja jonë e dashur, prof. as. dr. Nevila Dibra. Ajo do të kujtohet për kontributin e dhënë në fushën e gjeografisë, turizmit dhe mjedisit, por edhe si anëtare e respektuar e departamentit të Gjeografisë, lektore e aftë, pedagoge e përkushtuar dhe mike e dashur.

Lindi në Shkodër më 20 maj të 1969-ës në një familje të njohur dhe fisnike qytetare shkodrane. U formua dhe u shkollua në qytetin e Shkodrës. Shkollën e mesme e kreu pranë gjimnazit “28 Nëntori”, studimet e larta në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në degën “Histori-Gjeografi”, ku në vitin 1992 edhe u punësua. Ajo ka qenë lektore e disa prej lëndëve më të rëndësishme të kurrikulave të programeve të gjeografisë, sikurse: Gjeografi e turizmit, Gjeografi e peizazhit dhe ambientit dhe Gjeografi fizike. Përveç punës së saj si lektore, ajo njihet edhe për angazhimet si konsulente në fushat e saj të ekspertizës.

Prof. as. dr. Nevila Dibra do të kujtohet edhe për kontributin e dhënë në mbarëvajtjen administrative të Universitetit. Nga viti 2000 deri në vitin 2012 ka qenë përgjegjëse e sektorit të Gjeografisë fizike, në vitet 2012 - 2020 përgjegjëse e departamentit të Gjeografisë, nga viti 2012 anëtare e senatit akademik të këtij Universiteti. Së fundmi, nga viti 2020 e deri në ndarjen e parakohshme nga jeta ka mbajtur pozicionin e zëvendësdekanes së Fakultetit të Shkencave Shoqërore.

Falë kontributit të saj në kërkimin shkencor, ajo fitoi në Mars 2009 gradën “Doktor” me disertacionin me temë “*Turizmi në kuadrin e zhvillimit rajonal në Alpet perëndimore shqiptare*”. Në mars 2016 mori titullin shkencor “Profesor i asociuar” nga Këshilli i Profesorëve të Universitetit të Tiranës.

Prof. as. dr. Nevila Dibra ka qenë pjesëmarrëse e shumë trajnimeve, seminareve, workshopeve dhe konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare. Ajo gjithashtu njihet për artikujt e shumtë të botuar mbi çështje të turizmit dhe të mjedisit në rajon, Shqipëri dhe më gjerë. Është autore e dy teksteve

universitare, *“Peizazhi dhe ambienti, ndikime njerëzore”* (2015) dhe *“Gjeografi e turizmit”* (2016).

Prof. as. dr Nevila Dibra përcolli dije tek shumë breza studentësh, të cilët e vlerësojnë për shkallën e lartë të përgatitjes dhe përkushtimin e treguar. Kontributi i saj do t’i mungojë botës akademike, miqve dhe bashkëpunëtorëve, që ruajnë kujtimet e një kolegeje dashamirëse.

Dr. Bresena Kopliku

JETA SHKENCORE

Konferencë shkencore ndërkombëtare

“Akademiku Bahri Beci - Figurë poliedrike e gjuhësisë shqiptare”

Në kuadër të 85-vjetorit të lindjes së akademikut prof. dr. Bahri Beci, Qendra e Studimeve Albanologjike, të Fakultetit të Shkencave Shoqërore, Universiteti i Shkodrës “*Luigj Gurakuqi*” dhe Akademia e Shkencave të Shqipërisë, me datë 7 tetor 2021, organizuan konferencën shkencore ndërkombëtare “*Akademiku Bahri Beci - Figurë poliedrike e gjuhësisë shqiptare*”. Të pranishëm në këtë aktivitet shkencor ishin kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, prof. dr. Skënder Gjinushi, rektorja e Universitetit të Shkodrës, prof. dr. Suzana Golemi, kryetarja e Qarkut Shkodër, znj. Majlinda Angoni, pedagogë të Universitetit të Shkodrës, miq e familjarë të akademikut Bahri Beci.

Seanca plenare u përshëndet nga rektorja e Universitetit të Shkodrës, prof.dr. Suzana Golemi, e cila vuri në dukje veprën e vlerë dhe ndihmesën e pashquar të akademikut Bahri Beci në fushë të shqipes, duke shprehur bindjen se do të vendoset edhe një gur i çmuar në lëmin e kulturës dhe gjuhës shqipe.

Në seancën plenare kumtuan: prof. dr. Artan Haxhi me temën: “*Bahri Beci - albanologu dhe akademiku*”; prof. dr. Shaban Sinani: “*Dialektet si bartës kulture: e folmja e Reç-e Dardhës në kërkimet dialektologjike të Bahri Becit*”; prof.dr. Tomor Osmani: “*Rreth kontributit të veçantë të akademikut B. Beci për historinë e standardizimit të shqipes*”. Në fjalën e tij akademiku prof. dr. Bahri Beci falënderoi Universitetin e Shkodrës “*Luigj Gurakuqi*” për vlerësimin dhe organizimin e kësaj konference në kuadrin e 85-vjetorit të lindjes së tij. Akademiku vlerësoi punën 25-vjeçare të Qendrës së Studimeve Albanologjike të këtij Universiteti me një veprimtari të admirueshme, ku spikat kontributi i të rinjve të talentuar të këtij universiteti. *Shkodra është qyteti që jam rritur dhe formuar si njeri, ku kam mësuar të dua dhe të vlerësoj familjen, kjo ka qenë pasuria ime më e madhe që më ka shoqëruar gjatë gjithë jetës* - theksoi prof. dr. Bahri Beci. Në shenjë mirënjohjeje, akademikut Bahri Beci iu akordua titulli “*Profesor nderi*” i Universitetit të Shkodrës, me vendim të Senatit akademik me motivacionin “*Për kontribute të çmuara në shërbim të shkencës albanologjike, në veçanti të studimit të thelluar të veçorive gjuhësore të arealit të Veriut, si dhe për mbështetje të vazhdueshme shkencore dhe institucionale të Universitetit të Shkodrës*”. Konferenca vijoi punimet me kumtesat e pedagogëve të Universitetit të Shkodrës mbi kontributin në

fushën e studimeve gjuhësore shqiptare të akademikut Bahri Beci.

Seancat paralele vazhduan me kumtime tepër interesante, që nxorën në pah kontributin e studiuesit ndër vite.

Seanca 1: prof. dr. Mimoza Priku (Shkodër): *“Çështje të gramatikës së shqipes në opusin e akademikut Bahri Beci”*, prof. dr. Anila Omari (Tiranë): *“Historia e formimit të dialekteve të shqipes dhe kontributi i prof. Bahri Becit në këtë fushë”*, prof. dr. Imri Badallaj (Prishtinë, Kosovë): *“Vrojtimet e Bahri Becit mbi dialektet e gjuhës shqipe”*, prof. dr. Tomor Plangarica (Tiranë): *“Mbi disa kahe të zhvillimit të mendimit gjuhësor të zbatuar dhe kontributet e akademik Bahri Becit në këtë hapësirë të kërkimit shkencor”*, prof. dr. Gjilda Alimhilli (Bari, Itali): *“Kontributi i prof. Becit në mësimdhënien e gjuhës shqipe jashtë vendit”*, prof. dr. Abdulla Ballhysa & dr. Jonida Cungu (Elbasan): *“Prof. B. Beci - reformator i mëimit të shqipes në shkollën mbarëshqiptare”*, prof. dr. Tonin Gjuraj - Suela Bala (Tiranë): *“Përjetimet 1936-2021” nga Bahri Beci - “Shkenca albanologjike përmes dëshmisë autentike të një akademiku “par excellance”*, prof. as. dr. Teuta Toska (Elbasan): *“Shqetësimi për të vërtetën përtej shkencës ose për raportin mes gjuhëtarit dhe intelektualit në dy epoka”*, prof. dr. Nexhip Mërkuri (Vlorë): *“Konceptimi bashkëkohor i termit “gjuhë” në tekstet shkollë të gjuhës shqipe nga ak. Bahri Beci”*, prof. as. dr. Kledi Shegani (Tiranë): *“Mësimi i shqipes për të huaj dhe kontributi i çmuar i prof. Bahri Becit”*, doc. Bora Logu (Shkodër): *“Profesor Beci e ndihmesa e tij e vyer në fushë të gjuhës e të kulturës përmes librit të fundit “Përjetimet 36-21”*, dr. Anisa Kosteri - dr. Aida Uruçi (Shkodër): *“Studimi i të folmeve gege të shqipes nga prof. dr. Bahri Beci”*.

Seanca 2: prof. dr. Aljula Jubani (Tiranë): *“Kërkimet në fushën e sociofonetikës: kontributi i prof. Becit në ridimensionimin e studimeve fonetike”*, prof. dr. Mimoza Gjokutaj (Tiranë): *“Kontributi i prof. B. Becit në modernizimin-shkencor pedagogjik të mëimit të gjuhës shqipe në arsimin parauniversitar”*, prof. as. dr. Naim Berisha (Prishtinë, Kosovë): *“Akademik Bahri Beci në studimet albanologjike në Kosovë”*, prof. as. dr. Evalda Paci (Tiranë): *“Rreth konceptit të latinitetit në studimet shqiptare (vështrim analitik dhe krahasues)”*, prof. dr. Mimoza Kore (Tiranë): *“Mbi vendin dhe rolin e gjuhës shqipe në formimin e bashkësisë gjuhësore ballkanike në veprën e akademik Bahri Becit”*, prof. as. dr. Rozana Rushiti - prof. as. dr. Anila Çepani (Tiranë): *“Disa koncepte sintaksore në gramatikën e profesor Bahri Becit”*, dr. Merita Hysa - prof. as. dr. Orjeta Baja (Shkodër): *“Konceptime të teorive fonologjike në veprën gjuhësore të prof. Bahri Becit”*, dr. Zamira Shkreli - dr. Ermira Alija (Shkodër): *“Elemente konceptuale didaktike bashkëkohore në librat shkollorë të deri*

viteve 90", dr. Rezearta Murati - prof. as. dr. Rrezarta Draçini (Shkodër): *"Bahri Beci për historikun dhe problemet e planifikimit gjuhësor si realizim në praktikë i politikës gjuhësore në Shqipëri"*, dr. Valbona Sinanaj (Tiranë): *"Ndihmesa e akademikut B. Beci në lëmin e fonetikës së shqipes"*, prof. as. dr. Albana Deda (Tiranë): *"Bahri Beci dhe koncepti i tij mbi procesin e planifikimit gjuhësor të shqipes"*, dr. Erzen Koperaj - dr. Karmen Lazri (Shkodër): *"Çështja e ballkanizmave në historinë e gjuhës shqipe"*, dr. Isida Hoxha (Shkodër): *"Bahri Beci - publicist"*.

Konferenca Shkencore Ndërkombëtare "Trans-humance and Rural Development"

[Trans-humanca dhe zhvillimi rural]

Në datat 10 dhe 11 dhjetor në ambientet e Universitetit të Shkodrës *"Luigj Gurakuqi"* u organizua Konferenca shkencore ndërkombëtare *"Trans-humance and Rural Development"* (Trans-humanca dhe zhvillimi rural), që erdhi si bashkëpunim i Fakultetit të Shkencave Shoqërore, Fakultetit Ekonomik, Fakultetit të Shkencave të Natyrës të Universitetit të Shkodrës dhe Institutit të Kërkimeve Rurale (Tiranë). Organizimi i një konference të tillë solli në qendër të vëmendjes problemet me të cilat përballet sot jeta e zonave rurale, sfidat dhe vështirësitë, si dhe rekomandimet e dhëna nga përfaqësuesit e botës së shkencës. Ekonomia shqiptare është në një fazë të rëndësishme drejt zhvillimit të qëndrueshëm, gjë që vihet re edhe tek *"Strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim - 2015-2020"* që vë theksin kryesor në dy sektorë kyç të ekonomisë: turizmin dhe bujqësinë.

Duke ndjekur të njëjtën linjë me axhendën e integritit në Bashkimin Evropian, të dy këta sektorë, si pjesë integrale të zhvillimit rural, përcaktojnë edhe vizionin e së ardhmes së Shqipërisë drejt zhvillimit social dhe ekonomik, ndërkohë që theksojnë aspiratat për integrim evropian.

Risia e konferencës konsistonte pikërisht në trajtimin e fenomenit të trans-humancës, fenomen mijërvjeçar, por pak i studiuar në kontekstin shqiptar.

Duke parë rëndësinë e kësaj tradite për komunitetet baritore që e praktikojnë, marrëdhëniet që krijohen me peizazhin natyror dhe pasurinë që mbart në aspektin kulturor, studiues nga e gjithë Shqipëria po përgatisin dosjen e trans-humancës dhe shpalljen e fenomenit si trashëgimi kulturore e mbrojtur nga UNESCO. Dosja shqiptare do t'i bashkohet aplikimit të përbashkët me vende të tjera evropiane sikurse Franca dhe Spanja.

Gjatë dy ditëve të zhvillimit të konferencës, 44 studiues të fushave të ndryshme: ekonomi, mjedis, folklor, trashëgimi natyrore, bujqësi dhe blegtori prezantuan gjetjet e tyre mbi trans-humancën dhe problematikat e zhvillimit rural. Përveçse nga universitetet shqiptare, kishte pjesëmarrës

edhe nga Kosova, Maqedonia, Kroacia, Franca, Italia apo edhe India. Konferenca u përshendet nga përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë dhe të pushtetit vendor. Përveç prezantimeve nën këndvështrimin shkencor, në konferencë u inaugurua edhe ekspozita “*Jeta baritore në Alpet shqiptare*” nga etnologia dhe antropologia franceze Martine Wolff.

Artikujt e plotë të konferencës u botuan në dy vëllime nën titullin “*Transhumance and Rural Development 2021*”, International Conference, Book of Proceedings, Volume I dhe Volume II, me ISBN 978-9928-274-88-5.

Konferenca shkencore ndërkombëtare

“Atë Gjergj Fishta: kërkime dhe interpretime”

Nën kujdesin e Rektores së Universitetit të Shkodrës “*Luigj Gurakuqi*”, prof. dr. Suzana Golemi dhe Provincës Françeskane në Shqipëri e Mal të Zi, në kuadrin e 150-vjetorit të lindjes së Atë Gjergj Fishtës, me datë 15 dhjetor 2021, u mbajt konferenca shkencore ndërkombëtare “*Atë Gjergj Fishta: kërkime dhe interpretime*”. Kjo konferencë shkencore u bë e mundur falë punës e bashkëpunimit mes Departamentit të Letërsisë, Departamentit të Gjuhësisë, Qendrës së Studimeve Albanologjike, në Fakultetin të Shkencave Shoqërore dhe Provincës Françeskane. Në praninë e shumtë të pedagogëve, studentëve dhe studiuesve të fushës së letërsisë dhe gjuhësisë, fjalën e mirëseardhjes, në emër të organizatorëve e mbajti prof. as. dr. Orjeta Baja, drejtore e departamentit të Gjuhësisë, e cila, duke theksuar rëndësinë e mbajtjes së kësaj konference, vuri në dukje vlerat e shumanshme të veprës së Atë Gjergj Fishtës, si dhe kontributin e Fakultetit të Shkencave Shoqërore, ndër vite, për studimin e kësaj vepre.

Konferenca u përshëndet nga Rektoria e Universitetit të Shkodrës “*Luigj Gurakuqi*”, prof. dr. Suzana Golemi, nga Provinciali i Provincës Françeskane në Shqipëri e Mal të Zi, Atë Pashko Gojçaj dhe nga Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. prof. dr. Skënder Gjinushi. Me këtë rast u shfaq edhe një dokumentar i shkurtër për jetën dhe veprën e poetit Atë Gjergj Fishta, së bashku me një incizim të hershëm të zërit të tij duke recituar një pjesë nga vepra “*Lahuta e Malcisë*”, çka u prit me interes të veçantë.

Në konferencë u paraqitën 40 kumtesa të përgatitura nga studiues e specialistë të fushave përkatëse nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, nga Universiteti i Prishtinës, Akademia e Shkencave të Prishtinës, nga Universiteti i Shkodrës “*Luigj Gurakuqi*”, Universiteti i Tiranës, Universiteti i Elbasanit, Universiteti i Durrësit, Instituti i Studimeve Sociologjike Shqiptare, si dhe studiues të tjerë të Fishtës. Në seancën plenare u ndoqën kumtesat e përgatitura nga prof. dr. Artan Haxhi & prof.

dr. Tefë Topalli, “Atë Gjergj Fishta personalitet i letërsisë dhe kulturës shqiptare”; akad. prof. dr. Sabri Hamiti “150 vjetori i Fishtës”; prof.dr. Tomor Osmani, “Fishta në manastir”; akad. prof. dr. Shaban Sinani, “Kanoni dhe tradita - një çështje e zgjidhur në mënyrë laike në mitologjinë e Fishtës”; prof. dr. Shefkije Islamaj nga Prishtina, në lidhjen e saj on-line, paraqiti temën “Pasuria leksikore-shenjë identifikuese e gjuhës së Gjergj Fishtës”. Seanca plenare u mbyll me kumtesën e prof. as. dr. Arben Prendit, drejtor i departamentit të Letërsisë, “Aktualiteti i veprës fishtiane”. Vëmendja kryesore e kumtuesve u përqendrua në analiza, interpretime letrare dhe gjuhësore të lirikës, satirës dhe epikës, por edhe të publicistikës, kontributit të poetit në arsimin shqiptar, si dhe vendin e veprës së tij në tekstet shkollore të nivelit parauniversitar apo universitar. Konferenca solli edhe një herë në vëmendje vlerat shumëdimensionale të veprës së Atë Gjergj Fishtës dhe vuri në pah nevojën që studimet mbi këtë autor të vijojnë në mënyrë institucionale edhe në të ardhmen, me qëllim që vepra e këtij gjeniu të letërsisë shqiptare të vendoset në vendin që i takon.

Tryezë e rrumbullakët

"Fishta, mundësi dhe sfida në mësimdhënie"

Departamenti i Letërsisë në bashkëpunim me Zyrën Arsimore Shkodër, organizuan me datë 10 dhjetor 2021 në prag të Konferencës Shkencore “Atë Gjergj Fishta: Kërkime dhe interpretime” tryezën e rrumbullakët “Fishta, mundësi dhe sfida në mësimdhënie”. Aktiviteti u zhvillua në mjediset e Bibliotekës Shkencore të Universitetit dhe u moderua nga prof. as. dr. Valbona Karakaçi. Të pranishëm në takim ishin pedagogë të Universitetit të Shkodrës, mësues, studentë të degës Gjuhë-Letërsi dhe maturantë. Prof. as. dr. Arben Prendi pasqyroi rëndësinë e veprave të Gjergj Fishtës si objekt i disa konferencave shkencore të organizuara ndër vite nga departamentet e Gjuhësisë dhe të Letërsisë. Vepra letrare e Fishtës është pjesë e integruar e programeve të lëndës Letërsi shqipe, në programin e studimit Gjuhë-Letërsi, në ciklin e parë të studimeve, në Master profesional në Mësuesi, si dhe në Master shkencor, i realizuar përmes lëndës Fishtologji e trajtuar në detaje nga prof. as. dr. Alfred Çapaliku. Takimi pati si qëllim trajtimin e Fishtës dhe të veprës së tij si figurë shumëdimensionale, si dhe sfida që ka kurrikula në interpretimin kritik të veprës së autorit. Diskutimi u përqendrua në vendin që ka vepra e këtij autori në planet mësimore dhe në tekstet e Gjuhës shqipe dhe të Letërsisë për arsimin e mesëm të lartë. Prof. as. dr. Valbona Karakaçi paraqiti edhe një punim që lidhej me këtë temë. Në takim u theksua nevoja e bashkëpunimit ndërmjet Universitetit të Shkodrës

“Luigj Gurakuqi” dhe Zyrës Arsimore Vendore - Shkodër. Mësuesit e lëndëve Gjuhë shqipe - Letërsi e mirëpritën këtë tryezë dhe përveç mendimeve me vlerë që dhanë për vendin që aktualisht ka vepra e Fishtës në tekstet e Gjuhës dhe Letërsisë, shprehën edhe nevojën e takimeve të tilla edhe në të ardhmen. Bashkëbisedimi mes pedagogëve të letërsisë dhe mësuesve të këtij profili, vuri në dukje nevojën për një risjellje në vëmendje të

Konferencë shkencore

“Vlerësojmë të kaluarën investojmë në të ardhmen...”

- Portrete të spikatura të pedagogësh”

institucioneve arsimore dhe studimore të veprës së Atë Gjergj Fishtës, si një vepër komplekse, ende e pastudiuar siç duhet.

Kjo konferencë shkencore u zhvillua në kuadër të 65-vjetorit të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, me 7 Mars 2022. Në këtë veprimtari morën pjesë prof. dr. Suzana Golemi rektore e Universitetit të Shkodrës, zv/rektorja prof. as. dr. Paulina Guli, zv/rektorja për Marrëdhëniet me jashtë, prof. dr. Rajmonda Këçira, ish - rektore të Universitetit të Shkodrës, figura të spikatura pedagogësh ndër vite, të ftuar e dashamirës të Universitetit tonë. Aktiviteti u ideua nga Qendra e Studimeve Albanologjike. Veprimtaria solli ndërmendje kontributin e figurave të nderuara, të profesorëve të parë, që në rrjedhë të viteve hodhën dhe konsoliduan themelet e këtij institucioni me rëndësi të veçantë në historinë tonë kombëtare, sidomos në fushë të arsimit dhe të kulturës. Konferencën e përshëndeti prof. dr. Suzana Golemi, rektorja e Universitetit të Shkodrës, e cila shprehu mirënjohjen e konsideratën e saj ndaj misionit, përvojës dhe kontributit që dhanë gjatë 65-viteve pedagogë të nderuar të këtij Universiteti. Aty u theksua se duhet të ndjehemi krenarë që Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” mbart me vete emra pedagogësh shumë të nderuar në plan kombëtar e më gjerë, të atyre që kontribuan në edukimin e brezave të tërë mësuesish, specialistësh, studiuesish seriozë, artistësh të mëdhenj e profesionistësh model. Veprimtaria u përshëndet gjithashtu nga ish-rektori prof. dr. Dhimitër Dhora, ish-rektori prof. dr. Gjovalin Gruda, ish-rektorja prof. dr. Dhora Lloja, profesori i nderuar prof. dr. Irakli Beka, akademiku Bahri Beci, e z. Adem Bala, të cilët shprehën mirënjohjen e falënderimet e tyre ndaj punës së përkushtuar dhe kontributit të pamatë që dhanë në përcjelljen e dijes gjatë karrierës së tyre akademike e shkencore.

Aktiviteti shkencor – promovues kushtuar Ditës botërore të librit

Dita botërore e librit ka bashkuar në një aktivitet shkencor, Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, me Fakultetin e Shkencave Shoqërore të Universitetit të Shkodrës. Në këtë aktivitet mori pjesë edhe rektorja e Universitetit të Shkodrës, prof. dr. Suzana Golemi, e cila e vlerësoi këtë nismë, si dhe pedagogë e studentë. Megjithëse si tematikë kryesore aktiviteti ka pasur promovimin e revistës shkencore “*Studime filologjike*” dhe paraqitjen e veprave të përgatitura nga punonjësit shkencorë të institutit, synimi kryesor i takimit ishte njohja e lexuesit shkencor me rezultatet e kërkimeve të realizuara kryesisht në fushën e gjuhësisë. Kjo duhet të jetë një nismë që duhet të kthehet në traditë, ka qenë mesazhi i përbashkët që kanë dhënë në fjalën e tyre drejtuesit e dy institucioneve përkatëse, zëvendësrektori i ASA-s, prof. dr. Valter Memisha dhe dekani i Fakultetit të Shkencave Shoqërore të Universitetit të Shkodrës, prof. dr. Artan Haxhi. Pedagogë dhe kërkues shkencorë të të dy institucioneve përkatëse kanë referuar mbi veprat shkencore të prezantuara, duke trajtuar dhe ngritur diskutime mbi çështje të gjuhësisë. Drejtori i Departamentit të Gjuhësisë në ASA, prof. dr. Artur Lama, duke folur për ecurinë shkencore në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, ka vënë theksin mbi rezultatet e kërkimeve të realizuara në grup në kuadër të projekteve të përbashkëta; me të rejtat dhe me rezultatet më të fundit të punës kërkimore rreth çështjeve shkencore aktuale, rreth tezave e hipotezave që gjuhësia dhe albanologjia ka në vëmendje të saj. Ai ka parashtruar si domosdoshmëri bashkëpunimin në mes të dy institucioneve në këtë fushë. Më pas kanë referuar, prof. dr. Anila Omari dhe prof. as. dr. Evalda Paci mbi revistën “*Studime filologjike*” nr. 1-2, 3-4/2019; prof. as. dr. Orjeta Baja për “*Studime për fjalën shqipe*” 5 (përmbledhje artikujsh) të Valter Memishajt; dr. Anisa Kosteri ka kumtuar për “*Pasuri të ligjërit shqip*” II (Vështirime leksikore e sociolinguistike) të Artur Lamajt; prof. as. dr. Rrezarta Draçini ka kumtuar mbi “*Aspekte të gjuhësisë së zbatuar*”, 3 të Tomorr Plangaricës; dr. Erzen Koperaj ka kumtuar për “*Gjurmime filologjike mbi latinitetin dhe shkrimet e vjetra shqipe*” të Evalda Pacit; dr. Zamira Shkreli ka kumtuar mbi “*Fjalor i gjuhës shqipe (Mosha 12+); Fjalor i ilustruar i gjuhës shqipe (Mosha 5-11 vjeç)*” me autorë A. Kananaj - Sh. Rrokaj; prof. dr. Mimoza Priku – prof. dr. Tomor Osmani kanë kumtuar mbi “*Gjedhet eptimore të foljeve në gjuhën shqipe (monografi)*” të L. Dautit; prof. as. dr. Arben Prendi ka kumtuar mbi veprën “*Publicistika e Lazër Shantojës (Paradigmë shqiptare e mendimit modern)*” të R. Martetës;

dr. Merita Hysa – dr. Rezearta Murati kanë kumtuar mbi veprën “*Ndikimi ndërgjuhësor në kontaktin midis dy gjuhëve (Rasti i shqipes me italishten)*” të V. Sinanajt.

**Aktiviteti “E ardhmja e së kaluarës sonë:
Trashëgimia kulturore dhe klima”**

Ky aktivitet u organizua në 18 Prill 2022, Ditën Ndërkombëtare të Monumenteve, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, Shkodër. Tematika e këtij viti “*Trashëgimia dhe Klima*” kishte për qëllim ndërgjegjësimin e komunitetit dhe rritjen e debatit në mes studentëve e aktivistëve mbi sfidat që lidhen me ndryshimet klimatike nën optikën e specialistëve të trashëgimisë kulturore. Mjedisi i përzgjedhur për këtë aktivitet, në përputhje edhe me qëllimin e këtij organizimi, ishte në Kishën e Shirgjit, Dajç.

**Konferenca shkencore:
“Jehonë auditorësh”**

Me datë 17 qershor 2022, në sallën e konferencave të rektoratit të Universitetit të Shkodrës, Fakulteti i Shkencave të Edukimit, Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Fakulteti i Shkencave Shoqërore, organizuan konferencën shkencore me titull “*Jehonë auditorësh*” në nderim të figurës së profesor Vehbi Hotit, me rastin e 80-vjetorit të lindjes së tij. Të pranishëm në aktivitet ishin rektorja e Universitetit të Shkodrës, prof. dr. Suzana Golemi, zv/rektorja, prof. as. dr. Paulina Guli, zv/rektorja për Marrëdhëniet me Jashtë, prof. dr. Rajmonda Këçira, dekanët e fakulteteve, pedagogë të Universitetit të Shkodrës, përfaqësues së politikës, miq, të ftuar e familjarë të prof. dr. Vehbi Hotit. Rektorja e Universitetit të Shkodrës prof. dr. Suzana Golemi në fjalën e saj përshëndetëse theksoi se prof. dr. Vehbi Hoti është pikë referimi për pedagogët e rinj, i cili i ka kushtuar këtij institucioni rreth 60 vite të jetës së tij. Prof. dr. Vehbi Hoti është shquar jo vetëm si mësimdhënës, por edhe si studiues e si drejtues, duke u afirmuar si një personalitet i nderuar në arsimin e lartë. Në fjalën e saj rektorja e Universitetit prof. dr. Suzana Golemi theksoi se Universiteti i Shkodrës krenohet me personalitetet dhe figurat që ka pasur dhe ka në gjirin e vet, të cilët kanë punuar me devotshmëri e përkushtim në këtë institucion. Prof. dr. Vehbi Hoti është pjesë e vyer e një tradite e trashëgimie intelektuale që zë vend ndër figurat më të rëndësishme të pedagogjisë dhe psikologjisë në Shqipëri. Me profesionalizmin e tij dhe korrektësinë shkencore profesori i

nderuar ka krijuar profilin e shkencëtarit të formuar dhe shumëpalësh, po ashtu edhe të mësimdhënësit fisnik. Aktiviteti i ideuar nga të dy fakultetet erdhi si një shenjë falënderimi dhe mirënjohjeje për profesorin e nderuar.

Konferenca studentore “Gjeografia vlen”

Me datë 13 qershor 2022 u organizua konferenca studentore “Gjeografia vlen”. Ky aktivitet studentor u organizua nga studentët e programeve të studimit Bachelor në “Gjeografi” dhe Master shkencor në “*Studime regjionale në gjeografi*”. E ideuar në formën e ditëve të hapura, si mënyrë njohjeje me programet e Gjeografisë për maturantët, publiku përbëhej pikërisht nga nxënës dhe mësues të shkollave të mesme të rajonit të Shkodrës.

Në fjalën përshëndetëse, përgjegjësjë e departamentit të Gjeografisë, dr. Bresena Kopliku, vuri theksin në rëndësinë e disiplinës së Gjeografisë në formimin e mendimit kritik dhe vëmendjes që duhet t’u kushtohet asaj jo vetëm nga mësuesit, por edhe nga politikëbërja, përfaqësuesit e institucioneve vendore dhe të atyre qendrore.

Më pas studentët paraqitën disa prej projekteve kryesore të punuara gjatë viteve të studimit në Gjeografi. Punimet prezantuan koncepte të reja të studiuar në detaje, sikurse trans-humanca në Alpet e Shqipërisë, evolucionin e shtrirjes së qytetit të Shkodrës, fenomenin e tërmetejeve, impaktin e ndryshimeve klimatike në vijën bregdetare, rrezikun e përmytjeve për zonën e Dajçit, si dhe veçori të zhvillimit të turizmit në zonën e Lezhës. E konceptuar jo vetëm me tipare shkencore, por edhe me nota emocioni, studentët prezantuan edhe momentet më të bukura të rrugëtimit të tyre studentor, gjë që mallëngjeu të pranishmit.

Takimi “Letërsia, mes profesionit dhe pasionit”

Në kuadrin e “Ditës ndërkombëtare të librit” Biblioteka Shkencore e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” në bashkëpunim me departamentin e Letërsisë në këtë universitet, organizoi me datën 28 prill 2022, në mjediset e bibliotekës, takimin me temë “Letërsia, mes profesionit dhe pasionit”. Aktiviteti i kushtohej veprës letrare të pedagogëve të departamentit të Letërsisë (të pedagogëve Alfred Çapaliku, Ridvan Dibra, Arben Prendi dhe Ledri Kurti). Merrnin pjesë pedagogë, studentë, maturantë, mësues të gjuhës dhe letërsisë. Drejtoresha e bibliotekës znj. Alketa Bektashi në çelje të takimit shprehu angazhimin e këtij institucioni për të promovuar veprimtarinë akademike dhe atë letrare të pedagogëve dhe studentëve të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Ndërsa

drejtori i departamentit të Letërsisë prof. as. dr. Arben Prendi theksoi faktin se ky departament përbëhet nga pedagogë të kualifikuar me grada e tituj shkencorë, por edhe nga krijues të njohur të letërsisë shqiptare, në nivel kombëtar e ndërkombëtar, si: poeti Alfred Çapaliku, romancieri, dramaturgu dhe poeti Ridvan Dibra, poeti Arben Prendi, poetja Ledri Kurti. Ky fakt përbën një nga pikat e forta të këtij departamenti, që mbështetur në këto kapacitete akademike dhe krijuese, ka një ofertë serioze për maturantët e Veriut të Shqipërisë, të qytetit të Shkodrës me rrethina, por edhe për maturantët shqiptarë në Malin e Zi, në Ulqin, Tuz e në trojet tjera shqiptare, në të dy programet e studimit: Bachelor në Gjuhë-Letërsi (në bashkëdrejtim me departamentin e Gjuhësisë) dhe Bachelor në Gazetari-Komunikim.

Maturantët e talentuar në letërsi, gazetari dhe profilin shoqëror, në këto programe studimi që ruajnë dhe kultivojnë identitetin kulturor, gjuhësor e letrar kombëtar mund të bashkojnë profesionin me pasionin, në qytetin e korifejve të kulturës dhe artit shqiptar, në Shkodër.

Takimi që u moderua nga dr. Ermira Ymeraj, specialiste e sektorit të bibliografisë në këtë bibliotekë, ishte konceptuar në 3 pjesë: paraqitje e veprave letrare të secilit autor, lexime nga studentët, intervista dhe vlerësime nga studiuesit dhe kritika letrare për veprën e tyre. Në aktivitet u përfshinë me lexime nga krijimtaria e pedagogëve, intervista, përshkrime të veprave të tyre letrare edhe studentët e vitit të parë të programit të studimit Bachelor në Gjuhë-Letërsi, Xhuljana Guri, Rosela Vata, Marsida Vallasi, Valbona Pllumaj dhe nga programi i studimit Gazetari-Komunikim Blerta Mlloja, studente e vitit të parë. Ndërkaq pjesë e leximeve ishin edhe poezitë e studenteve të programit Gjuhë-Letërsi, Klevisa Bardeli në vitin e tretë dhe Xhuliana Guri, studente në vitin e parë. Për një orë e gjysmë veprimtaria u ndoq me mjaft interes nga të pranishmit dhe pati një jehonë të gjerë në median lokale dhe kombëtare.

Takimi letrar “*Dielli më perëndon në lindje*” me shkrimtaren Eralda Baze

Në sallën “*Vehbi Bala*” të Bibliotekës Shkencore Universitare u zhvillua më 19 maj 2022 aktiviteti letrar “*Dielli më perëndon në lindje*”, në qendër të cilit ishte njohja dhe bashkëbisedimi i studentëve të degës Gjuhë-Letërsi dhe Gazetari-Komunikim me shkrimtaren e re Eralda Baze. Ky aktivitet erdhi në vijim të aktiviteteve letrare e kulturore që janë organizuar gjatë vitit akademik 2021-2022 dhe si një bashkëpunim i Departamentit të Letërsisë, në Fakultetin e Shkencave Shoqërore, Bibliotekës Universitare dhe botuesin Schnell. Autorja Eralda Baze ka lindur në Skrapar. Studimet e universitare i ka kryer në degën Inxhinieri Ndërtimi në Ankara dhe në

Tiranë. Romani “*Dielli më perëndon në Lindje*” është romani i saj i parë, roman i cili ka ngjallur interesimin e lexuesit. Në pjesën e parë të takimit u mbajtën tri kumtesa për temat, personazhet, gjuhën artistike të përdorur në këtë roman. Prof.as. dr. Arben Prendi, pedagog i Letërsisë shqipe bashkëkohore dhe drejtor i departamentit të Letërsisë, me kumtesën: “*Fati i femrës shqiptare në shoqërinë e tranzicionit*” nënvizoi temat kryesore të romanit dhe u përqendrua në mënyrën e përshkrimit artistik të fatit të femrës shqiptare të periudhës së tranzicionit në roman. Ai vlerësoi kurajon e autores për të trajtuar edhe tema delikate që kanë të bëjnë me emancipimin shoqëror, fetar e kulturor. Ndërsa dr. Ermira Alija, kërkuese shkencore pranë Qendrës së Studimeve Albanologjike në kumtesën e saj: “*Sarkazma dhe kategorizimi dy shkak-pasoja që ndërrojnë rolet*” analizoi në detaje përdorimin e sarkazmës dhe kategorizimeve të lidhura ngusht në gjuhën artistike të romanit. Dr. Ermira Ymeraj, punonjëse e Bibliotekës shkencore me temën: “*Veçori të ndërtimit të personazheve letrare*” u ndal në portretizimin e personazheve dhe botës së tyre origjinale në këtë roman. Në pushimet ndërmjet kumtesave, studentët e degës Gjuhë-Letërsi dhe Gazetari Komunikim: Xhuliana Guri, Valbona Pllumaj, Blerta Mlloja etj., lexuan disa fragmente nga romani. Pas kumtesave u kalua në një bashkëbisedim të ngrohtë ndërmjet autores Eralda Baze dhe të pranishmëve. Në fjalën e saj, autorja shprehu kënaqësinë që ishte e ftuar në këtë takim në Universitetin e Shkodrës “*Luigj Gurakuqi*” dhe e cilësoi si më të veçantën nga të gjitha takimet që kishte bërë deri tani. Studentët i drejtuan disa pyetje që kishin të bënin me konceptin e saj për letërsinë, me mënyrën e shkrimit të romanit, me domethënien e personazheve letrare në romanin “*Dielli më perëndon në Lindje*” etj. Baze në përgjigje të interesimit të të pranishmëve, tha se nxitje për shkrimin e romanit përveç të tjerash ishte edhe realiteti shumë dinamik dhe kaotik në Shqipërinë e këtyre viteve. Në takim ishin të pranishëm pedagogë, studentë, mësues të gjuhës dhe letërsisë, maturantë të shkollave të mesme të qytetit të Shkodrës.

BOTIME

Këtë vit u vunë në qarkullim këto botime të anëtarëve të Fakultetit të Shkencave Shoqërore :


1. Zamira Shkreli, “*Parashkollorët në njohjen e parë me gjuhën amtare*”, Shtëpia botuese FIORENTIA, Shkodër, 2022, fq.288, ISBN: 978-9928-274-86-1.



2. Ermira Alija, *Albanian Literature as Metaphysics and Transcendence, A History of Thought and Attempts to Interpret the Albanian Literature of Tradition*, Lambert Academic Publishing, (Translator: Prof. Arben Bushgjokaj, Reviewer Prof. Ardian Marashi), fq.106, Berlin 2022.



3. *Arti poetik*, Nikola Bualo [Dukagjini, Prishtinë, 2022. ISBN: 9789951-05-742-4. (308 fq)], përkthyer në dy versione, me rimë (fq. 28-73) dhe në prozë (fq. 74 - 114) dhe pajisur me një hyrje të gjatë dhe me disa studime nga prof. as. dr. Vinçens Marku.



ISSN 2221 - 6855

***Doli nga shtypi mars 2023 – tirazhi 120 kopje – Formati 176 x250 mm. Shtypur
në shtypshkronjën e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”***